Duke pasur një pozitë gjeografike dhe gjeopolitike të përshtatshme, Prizreni ka qenë gjithnjë në udhëkryqet e kulturave të mëdha etnike që kanë jetuar njëra afër tjetrës si: Dardanët – Ilirët-Shqiptarët, Romakët, Bizantinët, Serbët, Otomanët etj. Në Prizren janë përdorur shumë gjuhë zyrtare gjatë shekujve. (Drançolli, J., 2008). Në kohët e lashta Prizreni është njohur si Theranda dhe është zhvilluar historikisht në rrugët tregtare të Ballkanit. Gjatë periudhës bizantine, qyteti quhej Prisdriana. Në vitet 1018/1019 sipas Kartës se perandorit Bizantin Bazil II, Prizreni përmendet si peshkopi nën juridiksionin e Krye Peshkopisë së Ohrit. Në vitin 1072 Ballkani nën udhëheqjen e George Voiteh u ngrit kundër regjimit të perandorit Bizantin Michael VII Doukas, kryengritje që u shua më 1073. Pas kryqëzatës së katërt në vitin 1204, Prizreni ka qenë i sunduar nga Bullgarët. Prizreni është pushtuar nga Stefan

Prvovenčani në vitet 1214-1216, por qyteti prapë pushtohet më vonë nga bullgarët. Gjatë kësaj periudhe Prizreni ka qenë i mbrojtur me fortifikata. Prizreni ka qenë një qytet i tregtisë së lirë, rezidencë e Peshkopisë katolike, bizantine, bullgare dhe serbe si dhe qendër e artit dhe kulturës.

Prizreni ka arritur kulmin e zhvillimit në shekullin 14. Në atë kohë Prizreni dukej si qytetet tipike mesjetare perëndimore: civitas (qendër administrative dhe ekonomike) dhe castrum apo castellum (qytet kala). Sipas përshkrimeve të udhëtarëve ajo i përngjante shumë Raguzës (Dubrovnikut). Në pjesën e parë të shekullit 14, Prizreni ishte qendër e madhe e kolonisë së Raguzës. Për të mbrojtur interesat e tyre, tregtarët e Raguzës që vepronin në Prizren kanë kërkuar emërimin e Konsullit në qytet. Sipas vendimit të Këshillit të Madh të Raguzës së datës 08.03.1332, në Prizren është themeluar Konsullata e Raguzës (quod eius mansio sit in Prisren). Prizreni ka pasur eksterritorialitet ligjor. Qytetet tjera si Novobërda, Trepça, Prishtina, Peja dhe Janjeva kishin situatë të ngjashme. Pos Konsullatit, Raguza formoi edhe institucione tjera si doganat, vendin për prodhimin e monedhave, kishën dhe spitalin. Në qytet janë prodhuar monedhat ku është stampuar fjala “Prisren”. Në pjesën e dytë të shekullit 14, qyteti u dobësua për shkak të konflikteve dhe ndarjeve politike. Pas vdekjes së Car Dushanit, (1355) qyteti udhëhiqet nga mbreti serb Vukashin (1360-1371), dhe më vonë pas vdekjes së mbretit Vukashin në 1371, Prizreni sundohej nga princi arbëror nga familjet Balshaj dhe Kastriot. Në mesjetë në Prizren janë ndërtuar monumentet e njohura katolike (Sancta Maria de Prisren dhe Sanctus Petrus supra Prisren), si dhe monumentet bizantine dhe ortodokse. (Kisha e Shën Premtes/Bogorodica Ljeviška dhe manastiri i Kryeengjëjve/Sveti Arhandjel afër Prizrenit.)



Si duket Prizreni është pushtuar disa herë nga Perandoria osmane, por përfundimisht në vitin 1459 ajo hyn në administrimin zyrtar otoman dhe prapë pëparon. Në shekullin 16 janë ndërtuar monumentet mahnitëse si: xhamia e Sinan Pashës, hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe xhamia e Gazi Mehmet Pashës. Në atë kohë, Prizreni bëhet pjesë e provincës otomane Rumelia. Ajo u bë e njohur si qytet tregtar dhe qyteti më i madh i administratës otomane në Kosovë. Qyteti është pushtuar disa herë nga austriakët dhe forcat aleate në shekullin 17. Por otomanët shpejtë e rikthenin kontrollin.

Gjatë perandorisë osmane, Prizreni ishte qendra kulturore dhe intelektuale e Kosovës. Ajo është dominuar nga popullata myslimane. Në vitin 1857, 70% e popullatës ishin myslimanë. Në vitin 1878, gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit, Prizreni bëhet qendra më e madhe kulturore e shqiptarëve si dhe qyteti kryesor për koordinimin e politikës dhe kulturës shqiptare jo vetëm në Kosovë.



*http://www.shqiperia.com/galeria/main.php*

**Figura I.9**: Prizreni në vitin 1900



*http://www.shqiperia.com/galeria/main.php*

**Figura I.10**: Prizreni në vitin 1935

Në shekullin 20, qyteti ka përjetuar një periudhë të ndryshimeve të shpejta sidomos në tregti. Kah fundi i vitit 1918 kur është formuar mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, Prizreni është ripushtuar dhe bëhet pjesë e mbretërisë e cila në vitin 1929 bëhet Mbretëria e Jugosllavisë. Disa dekada pas instalimit të qeverisë brutale serbe në Prizren, qyteti me një fjalë u bë një nga qendrat e nacionalizmit shqiptar në luftën e saj për pavarësi. Prizreni dhe rrethina e saj kanë qenë seriozisht të dëmtuar në luftën e vitit 1999. Pas përfundimit të luftës në qershor të vitit 1999, pjesa më e madhe e popullatës shqiptare u kthye në Prizren.





*Zona historike e Prizrenit, plani për konservim dhe zhvillim, 2008*

**Figura I.11:** Arasta (tregu tradicional) dhe rrethina e saj në fillim të shekullit



*Zona historike e Prizrenit, plani për konservim dhe zhvillim, 2008*

**Figura I.12:** Arasta dhe rrethina e saj, 2006

## QËLLIMI DHE ROLI I PZHKP 2025



Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit synon të ofrojë një kornizë të gjerë për rritjen dhe zhvillimin e Prizrenit për 15 vitet e ardhshme duke marrë parasysh tendencat zhvillimore të vendit në tërësi si dhe trendët e zhvillimit rural dhe urban në aspektin e ambientit natyror, socio-ekonomik dhe të ndërtuar. Roli i PZHKP 2025 është:

- Të udhëheq zhvillimin strategjik të Komunës së Prizrenit,
- Të prezantojë një qasje të integruar,
- Të sigurojë pjesëmarrje,
- Të lehtësojë monitorimin dhe rishqyrtimin.

PZHKP në veçanti do të lidh zhvillimin e ardhshëm me planet e nivelit të lartë, strategjitë e mirëfillta të zhvillimit ekonomik:

- Të ofrojë një mjet konsiderues për përpjekjet lokale të planifikimit,
- Të ofrojë menaxhim të balancuar të shfrytëzimit të tokës, tendencat e ardhshme të rritjes,
- Të inkurajojë angazhimin e njerëzve dhe të shfrytëzuesve në definimin dhe përfshirjen në procesin e ndryshimit.
- Të ndikojë ne lokacionin e investimeve,
- Të lehtësojë shfrytëzimin e sistemit GIS dhe të ndihmojë në monitorimin e ndikimit të planit.

## PROCESI DHE METODOLOGJIA E PZHKP

Procesi i Planit Zhvillimor të Komunës së Prizrenit është definuar si tërësi e katër fazave (Figura I.13). me referencë të pesë kapitujve tekstuale të përshkruara në kontekstin e Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinorë mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor të Komunës (Nr.rend.33; Nr.prot.29/03/2003) në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$ Ligji për Planifikim Hapësinor (Nr.2003/14); dhe ndryshimin në Ligjin për Planifikim Hapësinorë (Nr. 03/L-106/2008); Këto faza janë:

- Përcaktimi i profilit të zhvillimit hapësinor dhe Analiza e gjendjes
- Përcaktimi i Vizionit, parimet dhe caqet
- Përpilimi i kornizës së zhvillimit hapësinor komunal
- Identifikimi i strategjive dhe veprimeve zbatuese, si dhe përcaktimi i dispozitave zbatuese

Ky raport është versioni final i studimit të PZHKP 2025 dhe përfshin të gjitha raportet e fazave të dorëzuara veçmas.

Faza e parë e PZHKP 2025 është definimi i **profilit të zhvillimit hapësinor të komunës së Prizrenit.** Identifikimi i gjendjes ekzistuese formon kornizën strategjike të PZHKP 2025. Kjo fazë, rezultatet e të cilit janë dhënë në "Pjesa I: Profili Hapësinor Zhvillim dhe Analiza e situatës", është e bazuar në analizën e të dhënave bazë dhe funksionon si i shkurtër për master planin hapësinor i cili do të zhvillohet në fazën e tretë dhe të katërt. Informatat themelore ofrojnë fakte për situatën aktuale fizike, sociale dhe situatën ekonomike dhe përcakton sfidat kryesore të zhvillimit që tregojnë përparësitë, mangësitë, potencialet dhe rreziqet. Dy objektivat metodologjike të analizave janë, grumbullimi i informatave për të kuptuar zhvillimet; si dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe grumbullimin e të dhënave të krahasueshme për Komunën e Prizrenit duke pasur parasysh raportet sektoriale. Të dhënat primare për përcaktimin e profilit të gjendjes ekzistuese të Komunës së Prizrenit janë marrë drejtpërsëdrejti nga departamentet përkatëse të Ministrive të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave relevante joqeveritare. Ndërsa të dhënat tjera janë marrë nga hulumtimet në terren dhe anketimeve të bëra drejtpërsëdrejti me qytetarët e Komunës së Prizrenit. Ekipi projektues ka kryer dy vizita hulumtuese në teren ku janë intervistuar 75 kryetarë të fshatrave të Komunës së Prizrenit në Mars dhe Prill të vitit 2009. Nën rrethanat e vështira për gjetjen e të dhënave të mëparshme, të dhënat aktuale janë prodhuar për strukturat fizike, sociale dhe ekonomike të Prizrenit

Të gjitha të dhënat e grumbulluara janë aplikuar në hartat digjitale nga ekipi projektues me ndihmën e sistemit GIS.

# PROCESI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRIZRENIT

## I PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES

GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE

10/08
11/08 Misioni 1: Mbledhja fillestare, Hyrje dhe grumbullimi I tè dhënave
12/08

GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE, ANALIZAT

01/09
02/09
03/09 Misioni 2: Grumbullimi i të dhënave dhe vizita në teren

04/09 Misioni 3: Deklarata e qëllimeve, përgaTitja e vizionit
05/09 SENTEZA

## II VIZIONI PARIMET DHE QËLLIMET

VIZIONI PARIMET DHE QËLLIMET

06/09
07/09 Misioni 4: Deklarata e vizionit, vendim marrja mbi parimet dhe qëllimet e planit
08/09

09/09 PRIORITETET STRATEGJIKE
10/09

11/09 DRAFT PLANI
12/09

## III KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

12/09 KONCEPTET E ZHVILLIMIT HAPËSINOR, ORGANIZIMI PËR TË ARDHMEN

Misioni5: Shqyrtimi i vizionit , marja e reagimeve dhe vendosjen e strategjive dhe akcioneve

12/09 Vlerësim I ndikimit

## IV STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

DISPOZITAT PËR ZBATIM

01/10 Strategjitè e zbatimit, planet e veprimit, kornizë kohore
Dispozitat për zbatim
Finalizimi I Planit

Misioni6: Takimet përmbyllëse / Rezultatet e përgjithshme, rezultatet dhe vlerësimi

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRIZRENIT
ITU
Qendra Hulumtuese e
Planifikimit Urban dhe Ambiental

**Figura I.13**: Procesi i PZHKP 2025

Seksioni i dytë i Pjesës I (parë) i është përkushtuar vlerësimit të situatës komunale. Vlerësimi është bërë duke përdorur teknikat Analiza e Lidhjeve dhe SWOT. Analiza e lidhjeve, në aspektin e profilit komunal është përdorur në bazë të mjeteve për përcaktimin e dallimeve statistike dhe të varura të karakteristikave ekonomike, gjeografike dhe sociale të Prizrenit. Analiza e lidhjeve bën aplikimin e krahasimit të çiftëzuar të regjioneve gjeografike të Prizrenit për madhësitë demografike dhe densitetin (popullata dhe punësimi), efiçienca e objekteve urbane (arsimore, shëndetësore dhe ato kulturore), aktivitetet ekonomike (aktivitetet industriale dhe bujqësore), karakteristikat gjeografike (tokat e pëlleshme për aktivitete bujqësore), trashëgimia kulturore, objektet turistike dhe problemet ambientale dhe infrastrukturore. Kjo pjesë përfshin edhe identifikimin e situatës komunale në lidhje me kontekstin e gjerë hapësinor dhe udhëzimet, vlerësimin e kapacitetit të investimeve të komunës dhe sfidat kryesore të zhvillimit.

Faza e dytë e PZHKP 2025 është **definimi i vizionit, parimeve dhe qëllimeve**. Kjo fazë, rezultatet e të cilave janë dhënë në Pjesën II (dytë), përcakton perspektivën e zhvillimit të komunës së Prizrenit duke përfshirë vizionin, parimet e përgjithshme të zhvillimit, synimet afatgjata dhe prioritetet strategjike.

Procesi i vizionimit të PZHKP 2025, përfshin rolin dhe prioritetet e përcaktuara në intervistat ballë-për-ballë me 75 kryetarët e në mars dhe prill 2008. PZHKP 2025 përfshin në vete procesin e parashikimeve të rezultateve dhe kërkesave të marra nga takimet publike të mbajtura në qershor 2009, planet e mëparshme, raportet sektoriale dhe udhëzimet duke përfshirë edhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$, Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit 2003-2013 dhe Vizioni i Integruar i Prizrenit 2015+. Procesi i parashikimeve është menaxhuar duke përdorur teknika pjesëmarrëse planifikuese si pjesë e studimeve analitike. Fillimisht, problemet janë përcaktuar tërthorazi duke përdorur teknikën e “Trungut problemor” si dhe të dhënat e raportit PZHKP 2025 të Fazës I (parë) si dhe kontributi i konsulentëve sektoriale. Në hapin e ardhshëm, qëllimet prioritare janë identifikuar për çdo problem tematik. Studimi paraprak i parashikimeve dhe i qëllimeve të zhvillimit është prezantuar në takimin publik në Prizren të Qershorit 2009. Takimi publik i bazuar në pyetjen “ Si do të ishte Prizreni në vitin 2025” në rast se realizohen objektivat prioritare për çdo temë.

Faza e tretë paraqet **përgatitjen e kornizës së zhvillimit hapësinor**. Korniza e zhvillimit hapësinor, e cila është përfshirë në Pjesën III (tretë) të këtij raporti, shpreh perspektivën e dëshiruar hapësinore për Komunën e Prizrenit, duke vendosur kontekstin hapësinor për strategjitë zbatuese, planet vepruese dhe vendim marrjen. Kjo pjesë është e strukturuar në pesë seksione. Seksioni i parë i PZHKP 2025 është përcaktimi i strategjive zbatuese dhe veprimet së bashku me dispozitat për zbatimin. Seksioni i dytë jep të dhëna mbi strukturën hapësinore dhe organizimin e lokacioneve hapësinore dhe zhvillimin në të ardhmen. Ajo

trajton çështjet e zhvillimit ekonomik, infrastrukturën, popullatën, banimin, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgimin kulturore dhe mjedisin. Seksioni i tretë tregon zonat ekzistuese urbane, zonat të propozuara urbane për të ardhmen dhe zonat e ndërtimit jashtë zonave urbane. Seksioni i katërt tregon për projekte të rëndësishme strategjike dhe zonat e veçanta të cilat janë miratuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$ dhe planeve të tjera për zona të veçanta. Së fundi, seksioni i fundit paraqet vlerësimin socio-ekonomik dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis në kornizën e propozuar të PZHKP 2025.

Faza e fundit e PZHKP 2025 është **përcaktimi i strategjive zbatuese dhe veprimet zbatuese së bashku me dispozitat për implementim.** Kjo fazë, e cila është dhënë përkatësisht në Pjesën IV dhe Pjesën V të këtij raporti, përmban strategjinë zbatuese së bashku me programimin e veprimeve zbatuese, dispozitat, vlerësimin e performancës dhe procesin e monitorimit, duke ofruar një urrë në mes të situatës së tanishme dhe kornizës hapësinore. Strategjitë dhe veprimet zbatuese janë nën pesë grupe tematike duke përfshirë trashëgimin kulturore dhe natyrore, mjedisin natyror, mjedisin shoqëror, mjedisin ekonomik dhe mjedisin hapësinorë. Pos kësaj, ajo përmban edhe udhëzimet për çështjet që kanë të bëjnë me interpretimin e PZHKP 2025, konditat e posaçme dhe masat, dispozitat lidhur me bashkëpunimin si dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm.

Komunikimi dhe pjesëmarrja janë nga qëllimet parësore të PZHKP 2025 siç ceket në "Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike (54/2005; Nr.prot.15/5)". 

Procesi i PZHKP 2025 është dizajnuar asisoj që të përforcojë dialogun në mes të nivelit komunal dhe atij qendror si dhe të ofrojë proces përfshirës planifikues për çështjet që kanë të bëjnë me politikat e nivelit lokal si dhe çështjet e legjislative dhe të planifikimit. Paralel me katër faza të planifikimit, janë dizajnuar edhe gjashtë misione të pjesëmarrjes, ku tre nga to janë mbajtur në fazën e parë, për grumbullimin e të dhënave, për vizionin dhe për vendimmarrjen.

Organizatat Ndërkombëtare, qeveria qendrore, autoritetet lokale, OJQ-të, kryetarët e fshatrave dhe organet tjera relevante janë pjesëmarrësit e veprimeve të komunikimit dhe pjesëmarrjes. Deri teni, katër misione janë kryer. Takimi fillestar është mbajtur në tetor të vitit 2008 për të përcaktuar aktorët kryesor të PZHKP 2025, dhe për të realizuar një takim nismëtar me Komunën e Prizrenit dhe akterët e tjerë. Misioni i dytë është mbajtur në mars dhe prill të vitit 2009 ku është bërë grumbullimi i të dhënave si dhe studim hulumtues në teren, ku janë vizituar 75 fshatrat e Komunës së Prizrenit duke intervistuar-anketuar kryetarët e fshatrave. Misioni i tretë, i cili përfshinte prezantimin e gjetjeve paraprake, u mbajt në prill të vitit 2009. Misioni i katërt ishte takimi i mbajtur në qershor të vitit 2009 për Deklaratën e vizionit dhe vendimmarrjen për parimet dhe qëllimet e planit.

# 1. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES

Pjesa e parë e raportit është prezantimi dhe vlerësimi i të dhënave bazë duke iu referuar hulumtimit të gjerë të dokumentuar, hulumtimit dhe analizës në terren dhe anketimeve të realizuara në zonën e planifikuar. Profili komunal përfshin të dhëna mbi gjendjen gjeografike, fizike, mjedisore dhe gjendjen socio-ekonomike. Studimet në analizën e strukturës fizike përbëhen nga analizat e hollësishme të strukturës natyrore dhe resurseve mjedisore, modelet e shfrytëzimit të tokës, transporti dhe infrastruktura si dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore. Përveç analizës së strukturës fizike, raporti përfshin studimin social dhe ekonomik duke treguar aspektet ekonomike, kulturore, sociale dhe demografike të Komunës së Prizrenit të krahasuar me të dhënat për Kosovën. Përveç kësaj, sfidat kryesore të zhvillimit janë të përcaktuara duke treguar potencialet, mundësit, dobësitë dhe kërcënimet përmes përdorimit të analizës së lidhjes dhe teknikës SWOT. Kjo pjesë përfshin edhe identifikimin e situatës – gjendjes në Komunë në lidhje me kontekstin e gjerë hapësinor, udhëzimet dhe vlerësimin e kapaciteteve investuese të Komunës

## 1.1. PROFILI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

### 1.1.1. INFORMATAT MBI GJENDJEN GJEOGRAFIKE, FIZIKE, AMBIENTALE DHE SOCIO EKONOMIKE



#### 1.1.1.1. STRUKTURA NATYRORE DHE RESURSET MJEDISORE

Ky seksion synon të paraqesë strukturën ekzistuese natyrore të Komunës së Prizrenit. Ajo përbëhet nga analiza të hollësishme mbi strukturën topografike (malet dhe luginat, fushat, lartësitë dhe orientimin, lumenjtë dhe sipërfaqet tjera të ujit), strukturën klimatike (lagështia e ajrit, reshjet), klasifikimit të tokës dhe erozionit.

Të dhënat kryesore për materialin e mëposhtëm janë marrë drejtpërsëdrejti nga departamentet përkatëse të Ministrive të Qeverisë së Kosovës. Të dhënat dytësore janë mbledhur nga anketimet në terren që janë kryer në muajin mars dhe prill të vitit 2009. Nga ekipi projektues, të gjitha të dhënat e grumbulluara janë aplikuar në hartat digjitale duke përdorur Sistemin Informativ Gjeografik (GIS).

**Struktura topografike**

Prizreni në përgjithësi ka një topografi të valëzuar ku lartësia mbidetare sillet prej 300 m - 2600 m. Përderisa qyteti i Prizrenit ndodhet në sipërfaqen e rrafshët, topografia kodrinore vërehet në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës. Lartësia mbidetare e qendrës së qytetit është 400 m (Harta 1.1). Koordinatat e Prizrenit janë $42^0$ 00 dhe $42^0$ 20 veri dhe $20^0$ 30 dhe $21^0$ Lindje. Pozita gjeografike e Prizrenit ofron kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrinë e ushqimit dhe turizmin.

### Malet dhe fushat

Territori i Prizrenit mbulohet me një pjesë të maleve në vijim: Sharr, Oshlak, Koritinik, Pashtrik dhe pjesërisht përbëhet nga fusha të rrafshëta të luginës së Dukagjinit. Pjesët malore me lartësi mbidetare mbi 1500 m përfshijnë afro 15% të gjithë kufijve komunal. Maja më e lartë në Komunën e Prizrenit ndodhet në Malet e Sharrit në anën lindore dhe juglindore me një lartësi mbidetare prej 2600m (Figura 1.1). Malet e Sharrit kufizohen me Maqedoninë në juglindje, me Komunën e Dragashit në Jug, me Komunën Shtërpcës në lindje dhe me Komunën e Suharekës në verilindje. Lugina e Zhupës, baza e lumit Lumëbardhi, shtrihet përgjatë këtyre maleve drejt Prizrenit. Malet e Pashtrikut në kufirin Shqiptar në perëndim janë malet e dyta me lartësi mbidetare me 1950 m. Disa nga lartësitë e rëndësishme në Komunën e Prizrenit janë dhënë në Tabelën 1.1.



*Prill 2009*



**Figura 1.1.** Malet e Sharrit

**Table 1.1:** Lartësitë e rëndësishme në Komunën e Prizrenit

| Lokacioni | Lartësia |
|---|---|
| Nikolla e zezë | 2498 m |
| Maja e zezë | 2584 m |
| Konjusha e Madhe | 2450 m |
| Bistra | 2640 m |
| Pashtrik | 1985 m |
| Koritnik | 2384 m |
| Oshlak | 2212 m |

### Rrafshinat

Rrafshina e Prizrenit është një sipërfaqe e rrafshët me një pjerrësi 0-5%. Ajo mbulon 14000 ha apo 22% të Komunës së Prizrenit. Rrafshina përfshinë edhe fshatrat vijuese: Atmaxha, Caparci, Krusha e Vogel, Landovica, Lutogllava, Malësia e Re, Mamusha, Medveci, Novaka, Pirana, Randobrava, Sërbica e Eperme, Sërbica e Poshtme, Smaçi, Shpenadia,Trepetnica dhe Velezha si dhe qendrën e Prizrenit (Figura 1.2).






**Harta 1.1.** Analiza e lartësisë mbidetare në Komunën e Prizrenit



**Figura 1.2:** Rrafshina e Prizrenit

**Pjerrësia dhe aspekti**

Pjerrësia e terrenit është vlerësuar me pesë klasa të cilat janë : 0-5%, 5-15%, 15-25%, 25-40% si dhe mbi 40% (Harta 1.2). Pjesët me pjerrësi prej 0-5% janë basenet e lumit dhe ato formojnë rrafshinën e Prizrenit. Kjo pjerrësi është e volitshme për planifikimin e autostradave të standardit të lartë. Mirëpo duhet marrë parasysh të dhënat tjera gjeologjike. Pjesët me pjerrësi prej 5-15% janë të volitshme për rrugët urbane dhe zhvillimin e aktiviteteve bujqësore me sistem të vaditjes. Kjo pjerrësi vërehet në pjesën veriore të Prizrenit. Pjesët me pjerrësi prej 15-25% janë të volitshme për aktivitete bujqësore por është me rëndësi të futet aktiviteti i ndërgjegjshëm për të evituar erozionin. Në Luginën e Zhupës, shtrihen vargmalet me shpate, ku në disa pjesë të vargmaleve shpatet malore arrijnë pjerrtësinë mbi 40%. Në pjesët perëndimore të Komunës së Prizrenit në Malet e Pashtrikut dhe në jug të fshatit Lubizhda e Hasit, Kabashi i Hasit dhe fshatit Kushnin vërehet pjerrësia mbi 40%. Analiza e orientimit tregon se pjesa më e madhe e zonave në kufijtë komunalë janë në veri, që rezulton nga sipërfaqja e thepisur (Harta 1.3).



**Lumenjtë dhe sipërfaqet tjera ujore**

Prizreni është një nga lokacionet fatlume sa i përket resurseve ujore. Lumi më i gjatë dhe më i rëndësishëm në Prizren është Drini i Bardhe (111 km). Ajo hyn në Prizren nga ana veriore dhe vazhdon rrugën e tij kah Shqipëria dhe Deti Adriatik. Lumi formon një liqe të vogël në mes të fshatin Dobrusht dhe fshatit Vërmicë (Harta 1.4). Në terma hidrografie, tërë territori i Komunës së Prizrenit është pjesë e pellgut ujor të lumit Drini i Bardhë dhe pellgut ujor të lumit Vardar, përkatësisht Detit Adriatik dhe Detit Egje.

Lumi Lumëbardhi e gjatë 35 km, rrjedh përgjatë luginës së Zhupës dhe vazhdon nëpër qendrën e Prizrenit. Një lum tjetër i rëndësishëm është Lumi Toplluha e gjatë 37 km. Ajo hyn në Komunën e Prizrenit nga ana veriore prej Mamushës dhe derdhet ne Drinin e Bardhe në fshatin Krajk. Sipas Profilit Komunal të Prizrenit ky lum ka rrezikshmëri më të madhe të vërshimit (2007). Prizreni është i pasur me rezervat e ujërave nëntokësore si dhe ujërave sipërfaqësore që formojnë një potencial të rëndësishëm hidroenergjetik. Hulumtimet hidrogjeologjike kryesisht janë bërë në pjesën e dytë të shekullit 20 në lidhje me ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit. Këto hulumtime janë ende në vazhdim dhe janë në pritje të finalizimit të projektit dhe fillimin e punimeve.




**Harta 1.2.** Analiza e pjerësisë






**Harta 1.3.** Analiza e Orientimit




Harta 1.4. Sipërfaqet Ujore

Hedhja direkte e plehut dhe ujërave të zeza në lumenj shkakton ndotjen e ujërave në Komunën e Prizrenit. Në bazë të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Drini i Bardhë në Komunën e Prizrenit radhitet në vendin e tretë për kah prioriteti për uljen e ndotjes së ujit (Tabela 1.2).

**Tabela 1.2:** Reduktimi i ndotjes së lumenjve në bazë të prioriteteve në faza dhe domosdoshmëria e mbrojtjes së lumenjve

| Prioriteti | Lokacioni | Emri I lumit | Kategoria | Faza e parë | | Fazae dytë | Presioni ndërkombëtar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Trajtimi primar | Trajtimi terciar | | |
| I | Prishtina | Sitnica | IV | 2007-2009 | 2010-2011 | 2013-2014 | I lartë |
| II | Mitrovica | Sitnica-Ibri | IV-III | 2009-2010 | 2012-2013 | 2015-2016 | I lartë |
| III | Prizren | D.i Bardhë | I-II | 2008-2013 | 2012-2013 | 2014-2016 | I ultë |
| IV | Peja | Bistrica | I-II | 2009-2010 | 2013-2014 | 2016-2018 | I ultë |
| V | Gjakova | Ereniku | I-II | 2013-2015 | 2018-2019 | | I ultë |
| VI | Gjilan | Morava-Kriva reka | II | 2014-2015 | 2017-2018 | 2020 | I ultë |
| VII | Ferizaj | Nerodime -Lepenc | II-III | 2016-2017 | 2018-2019 | 2020 | I lartë |

*Plani Hapësinor I Kosovës 2010-2020* +



## Struktura gjeologjike

Morfologjia e terrenit të Prizrenit, bukuritë natyrore, kontrastet e mahnitshme të peizazheve (majat e larta, kodrat e pjerrëta) sipërfaqet e rrafshëta nën kodra etj, kanë tërhequr vëmendjen e shumë hulumtuesve të cilët kanë ardhur këtu si vizitorë apo si turistë. Komuna e Prizrenit është mjaft interesante sa i përket gjeologjisë së saj, aspektit tektonik, petrologjisë dhe pasurisë me minerale. Janë bërë studime, dhe janë publikuar një numër i publikimeve që kanë të bëjnë me gjeologjinë, tektonikën, stratigrafisë, hidrogjeologjisë, gjeomorfologjisë, burimeve të mineraleve etj. Aplikimi i teknologjive të reja në hulumtimin e këtyre pasurive është kusht imediat për vlerësimin e këtyre vlerave në funksion të zhvillimit ekonomik.

*Konstruksioni gjeologjik*

Prizreni ka shkëmbinj të moshave dhe litologjisë së ndryshme. Shkëmbinjtë më të vjetër datojnë nga Paleozoiku, Permiani, Triasiku i hershëm dhe i vonshëm, Jurasik, Kretaku, Neogjeni dhe Kuaternari (Harta 1.5 dhe Harta 1.6).

Shkëmbinjtë e Paleozoikut

Shkëmbinjtë e Paleozoikut formojnë majat e larta të Maleve Kuqibaba, Konjusha e Madhe, Nikolla e Zezë, pjesët e basenit të Lumit të Brodit etj. Këta shkëmbinj janë formuar nga rreshpet kristalin, graniti, migmatitet e granitit etj.




**Harta 1.5.** Struktura gjeologjike






**Harta 1.6.** Klasifikimi i tokës

Rreshpet kristaline – albit klorit sericit SAB – ndodhen në mes të Konjushës së Madhe dhe shpateve të Lumëbardhit. Ato formohen nga albiti, sericiti, muskoviti, apatitet etj.

Rreshpet klorite sericite Scose – formohen nga shkëmbinjtë me përbërje të ndryshme. Në disa shkëmbij, dominon kloriti ndërsa në të tjerat dominon sericiti. Tekstura e këtyre shkëmbinjve është rreshpore me nivele të larta të kuarcit.

Rreshpet epidot aktinolit – janë shkëmbinjtë metamorfik të formuar pas metamorfozës së shkëmbinjve vullkanike bazalti dhe sfilite.

Meta konglomeratet ndodhen kryesisht në verilindje duke filluar nga Brodosana në drejtim të vendit NIkolla e Zezë.

Gëlqeret e zeza kristaline – janë gjetur në disa pjesë të Majës së zezë, Konujsh, Kuqibabë etj. Tekstura e këtyre shkëmbinjve është e pllakëzuar me shtresat prej 1.5 m deri 20m.

Flitet – janë formuar nga sericiti, kuarci, koloriti, albiti dhe pigmentet organike. Mineralet sekondare janë magnetiti, hepatiti, rutili, zirkoni etj. Ngjyra e këtyre shkëmbinjve zakonisht është e zezë dhe në raste të radha e përhimët.

Metaranoret e kuarcit dhe kuarciti – gjenden në formë të shtresave të holla dhe ngjyra e tyre është e përhimët.



Shkëmbinjtë metagabro – gjenden në veri dhe perëndim të vendit të quajtur Nikolla i Zi. Ato kanë teksturë rreshpore dhe janë të gjelbër. Janë të formuar nga Plaglokliasi, augiti etj.

Meta – diabazat – kanë ngjyrë të gjelbër në të përhimët dhe kanë teksturë homogjene. Përbëhen nga plagioklaset, kloriti, epiroti, koesiti etj.

Granitet gneis – mund të gjenden në Malet e Sharrit dhe janë të formuar nga kuarciti, albiti, biotiti, muskoviti etj.

Granitet – janë shkëmbinjtë acidike magmatike që gjenden në kurorat e Kuqibabës dhe në Lumbardhë. Granitet janë shkëmbinj metamorfik dhe shumë rrallë kanë reliktet e strukturës preliminare.

Shkëmbinjtë Permian – Triasik – gjenden në afërsi të Lubiqevës, Jeshkovë dhe Reqan. Këto shkëmbinj formohen nga sedimentet e pelitit psamit pas një metamorfoze të dobët. Po ashtu përmbajnë konglomerate, kuarcit, shkëmbinjtë magmatike gabro, albit, kuarc – porfirin etj.

Shkëmbinjtë e Mezozoikut

Shkëmbinjtë e Triasikut – sedimentet karbonike të triasikut të mesëm dhe të vonshëm formojnë masivet e Maleve të Korritnikut, Cvilenit dhe luginën e Lumëbardhit. Shkëmbinjtë e Triasikut përfaqësohen nga gurët masive gëlqerore me shtresa të trasha, mermer dhe dolomit me ngjyrë të përhimët kah e kuqja. Këta shkëmbinj janë të rikristalizuar; struktura e

tyre është ksenoblastike dhe janë të formuar kryesisht nga kalciti. Këta shkëmbinj janë të thyer nga lëvizjet tektonike.

Shkëmbinjtë e Jurasikut – rrethojnë brezin e përmendur të shkëmbinjve të Triasikut në jug të fshatit Nashec dhe pjesët tjera të regjionit. Përfaqësues i ketyre shkëmbinjve është melanzhi olistromik.

Shkëmbinjtë e Kretakut – përfaqësohen nga sedimentet senoniane, të pasuara nga Turoniane dhe më pak nga senomaniane.

Senomanian –sedimentet e senomanianit formojnë majat e larta të Pashtrikut. Ato shtrihen në formë transgresive mbi melanzhin e Jurasikut. Shtresat primare formohen nga shtresat e holla të konglomerateve (për këtë arsye nuk duken në hartë) dhe konglomerateve gëlqerore. Fragmentet në konglomerate rrjedhin nga shkëmbinjtë e përzier dhe cementi është kryesisht karbonik. Gëlqeret kryesisht përbëhen nga 60- 80% të CaCo3 ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga komponenti argjilor i pelitit. Trashësia është 700m.

Turonian – sedimentet e Turonianit gjenden në pjerrinat e Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga gëlqeret e senomanianit. Trashësia e kësaj shtrese është 150 – 200 m

Senonian – sedimentet e senonianit gjendën nën pjesët e pjerrëta të Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga sedimentet e turonianit dhe janë shpërndarë në afërsi të fshatit Mazrek, Zym dhe Dedaj. Nivelet e larta të senonianit janë kryesisht të përbërë nga peliti dhe gëlqeret me globturkana. Këto sedimente formojnë hipuritet dhe janë të trasha 600m.



Shkëmbinjtë e Kenozoikut

Sedimentet e Pliocenit – përfaqësohen nga sedimentet e pliocenit të mesëm dhe të vonshëm që formojnë regjionin e ngushtë të fshatit Gjonaj. Rezervat kryesore të këtyre shkëmbinjve gjenden në pjesën e rrafshët të Prizrenit, në jug të luginës së Dukagjinit. Ato janë kryesisht të mbuluar me sedimentet e kuaternarit. Në afërsi të Krushës së madhe, Landovicës dhe Randobravës, këta shkëmbinj janë kryesisht të mbuluar dhe formohen nga rëra, argjila dhe zhavorri. Në bazë të studimeve, del se shtresat e thella të pliocenit dominohen nga argjila psamite dhe pelite deri në fund të kretakut të vonshëm ku janë gjetur shtresa të qymyrit.

Sedimentet e Pliocenit në Prizren kanë ruajtur zgjatimin e tyre parësor, respektivisht kanë shtrirje horizontale dhe një trashësi prej afro 350 m. Në fshatin Gjonaj janë gjetur dy horizonte të qymyrit.

Sedimentet e kuaternarit – përfaqësohen nga sedimentet e liqeve dhe të teracave të lumenjve të Pleistocenit si dhe nga depozitat proluviale të terra rosa dhe aluvialet e Holocenit.

Sedimentet e liqeve – gjenden në jug të fshatit Nashec dhe luginën e Prizrenit. Janë të përfaqësuara nga argjilat rërore me ngjyrë të verdhë, rëra dhe zhavorri. Trashësia ndryshon prej 20 deri 50 m.

Sedimentet e teracave të lumenjve janë kryesisht përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë dhe janë të trashë 20 m.

Depozitimet Proluviale – janë prezent në formë të zonave të vogla të parregullta dhe të izoluara sikur në rastin e fshatit Gjonaj. Janë të përfaqësuar nga pjesët e rrumbullakëta dhe gjysmë të rrumbullakëta të shkëmbinjve të ndryshëm.

Terra Rosa është e zhvilluar në shkëmbinjtë e Kretakut në gropat e vogla të luginave karstike siç është rasti me fshatin Zym. Trashësia e tyre është 100 m.

Sedimentet aluviale – janë kryesisht të koncentruar në shtratin e Drinit të Bardhë dhe përfaqësohen nga materialet argjilore, rëra dhe zhavorri.

Tektonika

Sa i përket tektonikës së Prizrenit dhe regjionit, ekzistojnë disa mendime dhe hipoteza për shkak të mungesës së të dhënave stratigrafike si dhe komplikimeve me njësitë gjeotektonike. Kjo ka rezultuar me diskutimet e hapura dhe mos kompletimin e të dhënave tektonike të regjionit. Në nivel regjional, pjesa më e madhe e territorit është e ndërtuar nga formacionet eugeosinklinale që i përkasin njësive gjeotektonike të Korabit dhe Mirditës. Struktura më impozante është ajo e Pashtrikut e përbërë nga shkëmbinjtë e Kretakut të vendosura mbi shkëmbinjtë e Jurasikut që formojnë bazën e saj. Sinklinali i Pashtrikut zgjatet nga juglindja deri në veri lindje. Krahët e sinklinalit dallohen për nga pjerrësia e butë e shtresave (20-300) dhe strukturat e rrudhosura të nivelit të dytë në krahët e strukturës kryesore. Ky sinklinal ka shumë struktura të shkëputura në gati të gjitha drejtimet (gati 2km) (Harta 1.7).

*Burimet e mineraleve dhe mineralizimi*

Ndërtimi gjeologjik dhe tektonik i Komunës së Prizrenit është indikatori kryesor për pritjet e vendndodhjeve të burimeve të mineraleve. Ky territor është i njohur me burimet e mineraleve të dobishme në të kaluarën.

Burimet e mineraleve metalike.

Burimet e kromit lidhen me shkëmbinjtë bazike dhe ultra bazike të Korishës dhe Mushutishtit.

Mineralet magnetike të hekurit ndërlidhen me seritë e rreshpeve amfibolite që janë në kontakt të drejtpërdrejtë të serpentineve të Greikocit. Piriti dhe halkopiriti është gjetur në fshatin Lubizhdë. Bakri ndërlidhet me formacionet e kuarcit-porfirinës.




**Harta 1.7.** Harta tektonike

**Kromi** – terrenet kromatike të Kosovës gjenden në masivet e Brezovicës, Korishës, Mushtishtit etj. Regjioni i Brezovicës ka një numër të madh të shtresave serpentinë që kanë minerale të kromit. Lokacionet më të rëndësishme të këtyre xeheve janë:Ostrovica-Jezerina, Livadh, Shaldare dhe Ninika.

**Mangani** – hulumtimet gjeologjike janë kryer në regjionin e Sharrit dhe lokacionet tjera (Kobilica, Brod, Manastir, Restelica, Dragash, Krstac etj)

**Ari** – informatat e pamjaftueshme lidhur me formacionet diabazike silicore dhe diabazike-karetofire-sfilite përdoren vetëm si orientim për të dalluar regjionet potenciale që kanë minerale që përmbajnë ari (Sredska, Dragashi, Theranda etj).

**Bakri** – mineralizimi i bakrit nuk është hulumtuar sa duhet. Kosova ka pasur disa lokacione me xehe të bakrit. Në përgjithësi perëndimi i Kosovës (Bjeshkët e Nemuna, Juniku, Pashtriku dhe Sharri) kanë xehe bakri si rezultat i formacioneve vullkanike diabazike-sfilite-karetofire. Këto formacione kanë perspektivë potenciale në të ardhmen, duke pasur parasysh se Shqipëria fqinje ka prodhuar bakër nga këto formacione.

Burimet e mineraleve jo-metalike.

Gjeologjia e Kosovës përbëhet nga rezervat e mëdha të mineraleve jo-metalike. Sipas kërkimeve më të hershme gjeologjike të Kosovë, është konfirmuar ekzistimi i rezervave të mëdha të mineraleve jo-metalike.



Mineralet jo-metalike janë gjetur në gati të gjitha formacionet gjeologjike për dallim prej mineraleve metalike. Mermeri i Zhurit, Gjonajt dhe pjesëve afër kufirit me Maqedoninë kanë prejardhje nga formacionet Paleozoike. Sedimentet e Mezozoikut (triasiku i mesëm dhe i epërm) kanë karakteristika dhe veti teknike të mira dhe janë të përshtatshme për prodhimin e çimentos dhe shkëmbinjve për ndërtimtari në përgjithësi.

Kërkimet gjeologjike të mineraleve jo-metalike siç janë: duniti, diabaza, gabro etj duhet të vazhdojnë në veri të Prizrenit. Shkëmbinjtë e Kretakut formojnë seritë e gëlqerorëve dhe gëlqerorëve të frakturuara (Lugu i keq është i njohur). Sedimentet e Terciarit janë kryesisht argjilat për prodhimin e tullave (Landovica). Sedimentet e Kuaternarit janë aluvialet dhe teracat e lumenjve, materialet e frakturuara etj. Rëra dhe zhavorri gjendet në Piranë (2.000.000 $m^3$) dhe Krushë të Madhe (2.000.000 $m^3$) ndërsa argjila gjendet në Landovice (2.598.072 $m^3$).

Lokacionet e mineraleve jo-metalike

Burimet e mineraleve jo-metalike siç janë rëra, zhavorri dhe argjila kryesisht gjenden në kodrina. Mineralet tjera siç janë gëlqeret, rreshpet kristaline, shkëmbinjtë ndërtimor dhe

rreshpet e talkut gjenden në pjesët malore. Këto zona janë në regjionet e pazhvilluara dhe me qasje të vështirë.

*Karakteristikat hidro gjeologjike dhe gjeologjike inxhinierike*

Karakteristikat hidrogjeologjike

Sa i përket kushteve hidro gjeologjike, shkëmbinjtë e Komunës së Prizrenit mund të ndahen në

- Shkëmbinjtë me porozitet intergranular
- Shkëmbinjtë me çarje dhe fenomene karstike
- Shkëmbinjtë izolues

Shkëmbinjtë me porozitet intergranular

Ky grup i shkëmbinjve përfshin të gjitha depozitat e Pliocenit dhe Kuaternarit. Këto sedimente mund të vërehen në lindje të Drinit të Bardhë ose në jug të luginës së Dukagjinit. Ato formohen nga rëra, argjila dhe zhavorri. Të gjitha këto gjenden në maje të sedimenteve të kretakut.

Sedimentet e kuaternarit – përfaqësohen nga sedimentet e liqeve dhe sedimentet e teracave të lumenjve të Pleistocenit dhe nga depozitat proluviale të Tera Rosa dhe aluvialet e Holocenit. Këto sedimente janë të përhapura në gjatësi dhe janë të njohura si kolektorë të ujërave nëntokësore. Këto sedimente janë të përfaqësuara nga argjilat rërore dhe të zhavorrit me ngjyrë të verdhë në të kaftë. Vendndodhja e tyre është në fshatin Nashec, përgjatë shtratit të lumit Drini i bardhë, jugu i fshatit Gjonaj, perëndimi i fshatit Zym etj.



Shkëmbinjtë me çarje dhe fenomenet karstike

Ky grup i shkëmbinjve përfaqësohet nga sedimentet karbonate të triasikut të mesëm dhe të epërm si dhe të sedimentet karbonate të Kretakut. Këto shkëmbinj ndodhen në tërë regjionin. Ato formojnë malin e Koritnikut, Cvilenin dhe luginën e Lumëbardhit dhe janë të përfaqësuara nga shtresat masive të trasha të gurëve gëlqerorë, mermerit dhe dolomitit. Këto shkëmbij janë të rikristalizuara; dhe struktura e tyre është ksenoblastike të formuar kryesisht nga kalciti. Gurët gëlqeror janë kryesisht të përbërë nga $CaCO_3$ 60%-80 ndërsa pjesa tjetër është argjila pelite. Trashësia është 700 m.

Sedimentet janë në formë të thjerrëzave dhe ndodhen në pjesët lindore dhe verilindore të Prizrenit. Terrenet e maleve të larta përbëhen kryesisht nga gurët gëlqeror dhe shpesh formojnë fenomene karstike në sipërfaqe dhe në brendi të tyre. Këto terrene posedojnë burime të ujërave nëntokësore të cilësisë së lartë. Këtu ndodhen edhe shumë burime me kapacitet të lartë të ujit.

Shkëmbinjtë izolues

Shkëmbinjtë izolues datojnë nga Paleozoiku dhe janë të formuar nga rreshpet kristalore, granitit metamorfik, migmatitet e granitit etj dhe ndodhen në mes të majës së Kojushes së Madhe dhe pjerrinave të Lumëbardhit.

Shkëmbinjtë izolues po ashtu përmbajnë filitet e formuara nga sericiti, kuarci, koloriti, albiti, pigmentet organike dhe shkëmbinjtë acidik magmatik që janë metamorfik dhe radhë ruajnë reliktet e strukturës primare.

Planifikimi i analizave hidro gjeologjike

Planifikimi i analizave hidro gjeologjike është ngushtë i lidhur me planifikimin hidrogjeologjik të Kosovës. Zhvillimi i vendbanimeve urbane varet nga burimet e ujit. Bujqësia moderne mbështetet në konceptin e vaditjes. Hulumtimet kanë treguar se Komuna e Prizrenit është e pasur me ujëra nëntokësore që mund të përdoren si për pije, industri ashtu edhe për vaditje.

Hulumtimet hidrogjeologjike duhet të kryhen duke pasur parasysh se:

- Aluvialet akuifere përgjatë shtratit të lumenjve kanë potencial të lartë për ujë.
- Terrenet karstike janë kryesisht të formuar nga gëlqeret e Kretakut dhe Triasikut si dhe mermeri i Paleozoikut. Pjesa më e madhe e gëlqeres gjendet në malet e Pashtrikut dhe Korritnikut. Kompleksi karbonat i Triasikut vlen të përmendet sepse formon grumbulluesit e ujërave nëntokësor.
- Sedimentet e Neogjenit mbulojnë gati tërë sipërfaqen e rrafshët të terrenit dhe formojnë skajin jugor të luginës së Dukagjinit. Në këto sedimente është akumuluar një sasi e madhe e ujit nën presion..



Karakteristikat gjeologjike inxhinierike

Kosova ka ndërtim të komplikuar gjeologjik me marrëdhënie të komplikuara gjeologjike dhe tektonike që krijojnë kushte të përshtatshme për proceset gjeodinamike ekzogjene siç janë rrëshqitja e dheut, shembja, vërshimet etj të cilat procese prodhojnë jo-stabilitet të terrenit. Ky jo-stabilitet në anën tjetër, është i ndikuar nga dridhjet sizmike. Për më tepër, njerëzit me aktivitetet e veta të gabuara dhe destabilizuese, janë duke e shtuar këtë jo-stabilitet. Duke u bazuar në hulumtimet e kryera, zonat jo-stabile janë të ndërlidhura me ndërtimin gjeomorfologjik të terrenit ose më saktë:

- Segmentet anësore të luginave dhe lumenjve
- Thyerja dhe rrëzimi i pjesëve kodrinore në pellgjet terciare
- Shpatet e maleve të larta

Jo stabiliteti i terrenit po ashtu manifestohet me rrëshqitje, kolizion, erozion etj. Rrëshqitja është prezent në terrenet jo shkëmbore. Kolizionet ndodhin në terrenet shkëmbore, kryesisht të formuar nga serpentinet metamorfike dhe gëlqeret. Erozioni linear haset në përroska e lumenj dhe shihet në tërë komunën, sidomos në pjesët malore ku nuk ka vegjetacion ose në pjesët ku janë të dëmtuar pyjet.

Fushat e hulumtimit gjeologjik inxhinierik në Komunë

Hulumtimet e mëtejme gjeologjike dhe inxhinierike në Kosovë përfshijnë:

- Përpilimin e hartës gjeologjike inxhinierike të shkallës 1:1000000
- Përcaktimin e rrëshqitjeve dhe shpateve jo stabile
- Ndërtimi i bazës gjeologjike inxhinierike për qëllime të ndryshme
- Hulumtimet gjeologjike inxhinierike për eksploatimin e burimeve të mineraleve
- Hulumtimet gjeologjike inxhinierike për revitalizimin e zonave të rrezikuara.

Të gjitha këto karakteristika të formave gjeomorfologjke kanë një sërë faktorësh që kontribuojnë proceseve moderne ekzo-gjeodinamike siç janë:

- Sedimentet e zgjidhura kutarenare dhe sedimentet jo shkëmbore të zgjidhura.
- Sedimentet e lashtë shkëmbore gjysmë të lidhura në kushte intensive të ndryshimeve sipërfaqësore
- Shkëmbinjtë e lidhur mirë, kryesisht nga aktivitetet tektonike në zonat e shkatërruara



Ndërtimi i bazës gjeologjike inxhinierike për qëllime të ndryshme

Njohuritë gjeologjike të mjedisit kanë rëndësi të veçantë për planifikimin hapësinor në përgjithësi. Hulumtimet gjeologjike inxhinierike janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme për nga aspekti i planifikimit hapësinor të gjitha niveleve, duke filluar nga niveli i Kosovës, niveli komunal, pastaj për planifikimin e zonave me interes të posaçëm turistik, planifikimi urban i vendbanimeve si dhe objekteve me interes kapital.

Hulumtimet e parapara gjeologjike inxhinierike duhet të ofrojnë të dhëna për ndërtimin e bazës së të dhënave për zonat siç janë:

- Zonat e planifikuara urbane
- Zonat për nevojat e posaçme
- Zonat për strukturat kapitale

Duke i pasur parasysh problemet, hulumtimet e kryera në të kaluarën, nevojat dhe prioritetet, në të ardhmen parashihet përpilimi i:

- Hartës gjeologjike inxhinierike për planet hapësinore të zonave komunale të përshtatshme për urbanizimin e mëtejmë, zhvillimin e trafikut, ndërtim të strukturave me interes kapital, duke përfshirë edhe zonat jo-stabile apo zonat e rrezikuara nga proceset endo apo ekzo dinamike, si dhe regjionet me rezervat potenciale gjeologjike te mineraleve ndërtuese.
- Hartës gjeologjike inxhinierike për zonat me interes të posaçëm (zonat turistike dhe të tjera).
- Hartës gjeologjike inxhinierike për nevojat e planifikimit urban të zonave në shkallë 1:5.000 dhe 1:10.000 në pajtim me kornizën ekzistuese ligjore.

Dihet se Kosova në kontekst të gjerë i takon zonës Mesdhetare e cila karakterizohet me ndryshimet e shpejta gjeologjike si rezultat i aktiviteteve sizmike. Sipas Hartës regjionale sizmike të Serbisë të vitit 1973, territori i Kosovës ka aktivitet sizmik me intensitet prej kryesisht 70MCS. Është kërkesë ligjore që çdo objekt të ketë hartën e saj sizmikë që përmban parametrat sizmike me qëllim të optimalizimit të investimeve për projektimin e objekteve dhe për të parandaluar humbjen në njerëz në rast të tërmeteve katastrofike.

Procesi i mikro regjionalizimit sizmik është mjaft kompleks dhe përfshin të gjitha elementet e zhvillimit gjeologjik të terrenit sa i përket gjenezës, strukturës,aspektit tektonik, hidrogjeologjike, burimeve të energjisë sizmike dhe përhapjes së tyre në kohë dhe hapësirë etj.

Propozimet për hulumtimet e ardhshme për zgjidhjen e problemeve gjeologjike inxhinierike



Qëllimi i këtyre hulumtimeve është gjetja e trashësisë së shtresave bartëse, cilësisë së shkëmbinjve, niveli i thyerjeve, përcaktimi i shpejtësisë së zgjerimit të valëve elastike, moduli i elasticitetit, lagështia, shkalla e densiteti etj.

Këto hulumtime kanë të bëjnë me çështjet në vijim:

- Regjionalizimi dhe mikro regjinalizimi seizmik në zonat urbane dhe ato rurale. Meqë Kosova ndodhet në një zonë të rrezikshme sizmike ku takohen platformat e Azisë dhe Afrikës, me tërmetet prej 7-9 shkallëve (90 % i takon zonës urbane të Prishtinës, Pejës, Prizrenit Gjilanit dhe Lipjanit), është më se e nevojshme të kryhen këto hulumtime.
- Hulumtimet gjeofizike në zonat ku paraqiten rrëshqitjet me qëllim të planifikimit të rrugëve, tuneleve, urave etj., e cila do të mundësoj uljen e shpenzimeve të ndërtimit.
- Hulumtimet gjeofizike përgjatë gypave metalike (ujësjellësi, nafta, gazi natyror) në mënyrë që të definohet shkalla e korrozionit të dheut dhe të përcaktohen masat e duhura mbrojtëse për gypat.
- Hulumtimet gjeofizike në zonat e parapara për gurore, dhe eksploatim të zhavorrit dhe rërës etj

Hulumtimet gjeologjike inxhinierike në Prizren

Sipërfaqja e rrafshët ku ndodhet Prizreni në përgjithësi është i mbuluar me sedimentet e Pliocenit dhe aluvialin e Kuaternarit me karakteristika të dobëta fizike dhe mekanike. Prandaj është me rëndësi të bëhen studimet e fizibilitetit të terreneve, sidomos në ato zona ku parashihet ndërtimi  ndërtesave të larta, shkollave, objekteve industriale, rrugëve, objekteve sportive etj

Në këto zona, është me rëndësi që të studiohet:

- Lagështia natyrore
- Kapaciteti i peshës
- Pesha specifike
- Përbërja granulometrike
- Limitet e Atterbergut për konsistencë
- Parametrat e fortësisë
- Testi direkt i diseksionit
- Moduli i densitetit
- Kapaciteti bartës dhe limitet
- Niveli i ujërave nëntokësor etj.



*Përmbledhja dhe rekomandimet për strukturën gjeologjike*

- Territori i Prizrenit nuk është studiuar sa duhet sa i përket aspektit gjeologjik, tektonik, petrologjise, burimeve të mineraleve etj. Prizreni ka shkëmbinj të moshave dhe litologjisë së ndryshme. Shkëmbinjtë më të vjetër datojnë nga Paleozoiku, Permiani, Triasiku i hershëm dhe i vonshëm, Jurasik, Kretaku, Neogjeni dhe Kuaternari.
- Në nivel regjional, pjesa më e madhe e territorit është e ndërtuar nga formacionet eugeosinklinale që i përkasin njësive gjeotektonike të Korabit dhe Mirditës..
- Pjesët malore të Maleve të Sharrit janë të pasur me minerale të kromit, hekurti, bakrit, arit, merkurit etj
- Mineralet jo-metalike janë gjetur në gati të gjitha formacionet gjeologjike për dallim prej mineraleve metalike.

Mermeri i Zhurit, Gjonajt dhe pjesëve afër kufirit me Maqedoninë kanë prejardhje nga formacionet Paleozoike. Sedimentet e Mezozoikut (triasiku i mesëm dhe i epërm) kanë karakteristika dhe veti teknike të mira dhe janë të përshtatshme për prodhimin e çimentos dhe shkëmbinjve për ndërtimtari në përgjithësi. Kërkimet gjeologjike të mineraleve jo-metalike siç janë: duniti, diabaza, gabro etj duhet të vazhdojnë në veri të Prizrenit.

Hulumtimet hidrogjeologjike duhet të kryhen më:

- Aluvialet akuifere përgjatë shtratit të lumenjve kanë.
- Terrenet karstike.
- Sedimentet e Neogjenit që mbulojnë gati tërë sipërfaqen e rrafshët të terrenit dhe formojnë skajin jugor të luginës së Dukagjinit. Në këto sedimente është akumuluar një sasi e madhe e ujit nën presion..

Duke u bazuar në hulumtimet e kryera, zonat jo-stabile janë të ndërlidhura me ndërtimin gjeomorfologjik të terrenit ose më saktë:

- Segmentet anësore të luginave dhe lumenjve
- Thyerja dhe rrëzimi i pjesëve kodrinore në pellgjet terciare
- Shpatet e maleve të larta

Jo stabiliteti i terrenit po ashtu manifestohet me rrëshqitje, kolizion, erozion etj. Rrëshqitja është prezent në terrenet jo shkëmbore. Kolizionet ndodhin në terrenet shkëmbore, kryesisht të formuar nga serpentinet metamorfik dhe gëlqeret. Erozioni linear haset në përroska e lumenjë dhe shihet në tërë komunën, sidomos në pjesët malore ku nuk ka vegjetacion ose në pjesët ku janë të dëmtuar pyjet. Njohuritë gjeologjike të mjedisit kanë rëndësi të veçantë për planifikimin hapësinor në përgjithësi.



Hulumtimet e parapara gjeologjike inxhinierike duhet të ofrojnë të dhëna për ndërtimin e bazës së të dhënave për zonat siç janë:

- Zonat e planifikuara urbane
- Zonat për nevojat e posaçme
- Zonat për strukturat kapitale

Sipas Hartës regjionale sizmike të Serbisë të vitit 1973, territori i Kosovës ka aktivitet sizmik me intensitet prej kryesisht 70MCS. Është kërkesë ligjore që çdo objekt të ketë hartën e saj sizmikë që përmban parametrat sizmike me qëllim të optimalizimit të investimeve për projektimin e objekteve dhe për të parandaluar humbjen në njerëz në rast të tërmeteve katastrofike.

Procesi i mikro regjionalizimit sizmik është mjaft kompleks dhe përfshin të gjitha elementet e zhvillimit gjeologjik të terrenit sa i përket gjenezës, strukturës, aspektit tektonik, hidrogjeologjike, burimeve të energjisë sizmike dhe përhapjes së tyre në kohë dhe hapësirë etj.

Sipërfaqja e rrafshët ku ndodhet Prizreni në përgjithësi është i mbuluar me sedimentet e Pliocenit dhe aluvialin e Kuaternarit me karakteristika të dobëta fizike dhe mekanike. Prandaj është me rëndësi të bëhen studimet e fizibilitetit të terreneve, sidomos në ato zona ku parashihet ndërtimi ndërtesave të larta, shkollave, objekteve industriale, rrugëve, objekteve sportive etj

**Struktura klimatike**

Klima e Prizrenit ka karakter kontinental me një ndikim të lehtë të klimës mesdhetare ne lartësistë më të ulta, ndërsa në male dominon klima e ashpër alpine. (Tabela 1.3). Klima mesdhetare vjen nga deti Adriatik nëpërmes të kanionit të Drinit të Bardhë. Karakteristikat e buta klimatike janë arsye e resurseve të pasura natyrore. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit dhe frutave e perimeve tjera. Distanca nga deti prej 105 km është një tregues i rëndësishëm për kushtet klimatike. Siç është theksuar në PZHU (2003), temperatura mesatare vegjetuese është 19.1ºC. Në verë, kushtet klimatike janë mjaft konsistente dhe precipitimi ndodh herë pas herë ndërsa në dimër kemi të reshura ekstensive. Në vjeshtë vërehen temperaturat më të larta se në pranverë. Mesatarja në vjeshtë është 17.6ºC. Në 60% të vitit, temperatura është me e lartë se 0ºC pra nuk ka ngrica gjatë 229 ditëve.



**Tabela 1.3:** Temperatura mesatare

| **Temperatura mesatare (ºC)** | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator |
| 12.2 | 7.6 | 3.4 | 0.1 | 2.2 | 6.4 | 12.0 | 16.6 | 20.2 | 22.2 | 22.2 | 18.2 |

*PZHU, 2003*

Lagështia e ajrit

Lagështia e ajrit është shumë e rëndësishme për turizmin, shëndetin dhe potencialet bujqësore. Për njeriun lagështia e pranueshme është 40%-70%, ndërsa lagështia mesatare e ajrit në Prizren është 70.4%. Vlerat më të larta të lagështisë vërehen në vjeshtë dhe dimër (75.1%) për shkak të rrymimit të ajrit nga deti Adriatik në dimër. Në verë lagështia është dukshëm me e ultë se 70 % (Tabela 1.4).

**Tabela 1.4:** Lagështia mesatare e ajrit

| Lagështia mesatare e ajrit në Komunën e Prizrenit (%) | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Mesatare vjetore |
| Lagështia relative mesatare e ajrit | 82 | 76 | 69 | 64 | 64 | 61 | 59 | 59 | 67 | 74 | 80 | 83 | 70 |
| Lagështia relative mesatare në mesditë | 76 | 67 | 58 | 51 | 50 | 47 | 44 | 50 | 58 | 69 | 79 | 58 | 58 |
| Lagështia minimale relative | 28 | 21 | 15 | 14 | 20 | 17 | 16 | 18 | 20 | 16 | 20 | 28 | 14 |

*PZHU, 2003*

Precipitimi është po ashtu një nga komponentët e rëndësishme të strukturës klimatike dhe është esenciale për prodhimtarinë bujqësore të dihen periudhat e precipitimit. Në Prizren të reshurat janë më të larta në dimër. Zonat ku precipitimi është më i vogël se 300 mm nuk janë të përshtatshme për vreshtari për arsye ekonomike. Në anën tjetër zonat me precipitim më të lartë se 900 mm kanë tendencë të zhvillojnë sëmundje kërpudhore të prodhimeve bujqësore. Për vreshtari zonat më të përshtatshme janë ato ku mesatarja e precipitimit është rreth 600 mm. Në këto zona rrushi ritet edhe pa vaditje. Mesatarja e të reshurave në Prizren është 686 mm duke krijuar kështu kushte ideale për vreshtari.



Së bashku me sasinë e reshjeve, shpërndarjen e reshjeve brenda vitit reshjet ndikojnë në nivelin e përfitimit të rrushit në vreshtari. Reshjet në dimër depërtojnë thellë në tokë duke mundësuar më shumë ujë të depozituara në nën-shtresa të tokës. Ujërat e dëborës së shkrirë dhe ujërat e reshjeve depozitohen brenda një thellësie të caktuar të tokës, ku rrënjët e rrushit mundë të arrijnë dhe janë jashtëzakonisht të rëndësishëm në aspektin e përmbushjes së nevojës së ujit për vreshtari sidomos pas një vere të thatë. Në Prizren, sasia e reshjeve është më e lartë në dimër dhe në përputhje me shpërndarjen e reshjeve është i përshtatshëm për vreshtari (Tabela 1.5 dhe Harta 1.8)

**Tabela 1.5**: Mesataret mujore dhe vjetore të precipitimit në territorin e Prizrenit

| Mesataret mujore dhe vjetore të precipitimit në territorin e Prizrenit në **mm (R) (1951-1980)** | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Mesatare vjetore |
| R | 71 | 57 | 59 | 60 | 75 | 59 | 59 | 41 | 60 | 65 | 88 | 77 | 769 |
| h>0.1mm | 12 | 11 | 12 | 12 | 14 | 11 | 12 | 7 | 9 | 8 | 13 | 13 | 134 |
| h>10.0mm | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 1 | 2 | 2 | 3 | 3 | 25 |

*PZHU, 2003*

## Klasifikimi i tokave

Klasifikimi i tokave në bazë të kapacitetit të plantacionit është analizuar në pesë fusha si: mbjellja e perimeve, mbjellja e drithërave, mbjellja e frutave, pyjet dhe tokat barishte. Llojet e tokave që janë të përshtatshme për këto lloje të plantacioneve janë: (Harta 1.9):

- Toka e përshtatshme për mbjelljen e perimeve: smonica e kaftë, aluvioni argjilor, aluvioni i shkrifët dhe aluvioni i kaftë.
- Toka e përshtatshme për mbjelljen e frutave dhe për vreshtat: tokë e shkrifët e livadheve, aluvion i shkrifët ranor, kompakt gëlqeror dhe aluvion argjilor
- Toka e përshtatshme për mbjelljen e drithërave: smonica e kaftë, aluvioni argjilor, aluvioni i shkrifët dhe aluvioni i kaftë.
- Toka e përshtatshme për pyje: rërë e shkrifët e kaftë në të kuqe të zbehtë në sediment (fundërrinë) me ngjyrë të kuqe të zbehtë, kompakt gëlqeror.
- Toka e përshtatshme për barishte: rërë e shkrifët e kaftë në të kuqe të zbehtë në sediment (fundërrinë) me ngjyrë të kuqe të zbehtë, kompakt gëlqeror, livadh argjilor dhe toka e cekët e kaftë



Duke pasur parasysh këtë ndarje, regjioni i Prizrenit është i përshtatshëm për kultivimin e perimeve siç janë: domatet, speci, lakra, karota, trangujt, spinaqi dhe kultivimi i perimeve në sera. Toka është po ashtu e përshtatshme për kultivimin e drithërave si luledielli, misri, elbi, tërshëra dhe thekra. Kushtet janë të volitshme për themelimin e parkut botanik dhe kopshtit zoologjik.

Cilësia e tokës në regjionin e Kabashit është e lartë dhe e përshtatshme për kultivimin e domateve, specit, patates, misrit, mollëve, dardhave, kumbullave etj, Anadrinia, Vërini dhe Hasi janë po ashtu të përshtatshme për perime. Në regjionin e Kabashit mund të kultivohen edhe bimët mjekuese si kamomili, menta lule Elbasani etj. Regjioni i Anadrinisë është i përshtatshëm për kultivimin e rrushit. Lloji i tokës në Regjionin e Lumës e bën këtë regjion të përshtatshëm për kultivimin e drithërave dhe bimëve mjekuese si dhe të perimeve siç janë speci, domatja, kungulli, patatja, fasulja, bizelja, qepët etj. Në regjonin e Zhupës, posaçërisht në lartësinë mbi detare deri në 1000 m mund të kultivohen manaferrat, mjedrat dhe bimët mjekuese si menta, lule Elbasani dhe kamomili.

### Erozioni

Parandalimi i erozionit është një detyrë e cila del nga Plani Hapësinor i Kosovës me qëllim të parandalimit të veprimeve erozive. Në këtë aspekt masat konkrete që duhet të ndërmerren janë:

- Parandalimi i degradimit të pyjeve
- Parandalimi i mbi kullotjes
- Parandalimi i masave materiale që shkaktojnë erozionin

Profili Komunal i Prizrenit (2007) thekson se zonat e mëposhtme janë shpallur si zona erozive:

1. Seria e përroskave të Cvilenit
2. Seria e përroskave të Oshlakut;
3. Përroi Jaglenica, Lumi Lubizhda dhe Lumi Korishë.
4. Përroskat e lumenjve të Landovicës.

Një pjesë e madhe e tokës së Komunës së Prizrenit është në rrezik të erozionit. Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 23 % ej Komunës së Prizrenit i takojnë zonën me rrezikshmëri të lartë për erozion (Tabela 1.6). Sidomos regijoni i Hasit, Kabashit, Lumës, Vërinit dhe Zhupës kanë vlera të larta të erozionit (Harta 1.10). Regjioni i Prizrenit dhe Anadrinisë nuk janë në rrezik të erozionit sepse ndodhen në rrafshinë dhe kanë kushte ideale për aktivitete bujqësore.



Kur analizohet modeli i përdorimit të tokës, shihet se qendra e qytetit që ka një densitet më të lartë të popullatës, shtrihet në dy zona erozive që kanë rrezik të ultë dhe mesatar. Erozioni ritet në strukturat topografike me pjerrësi të theksuar, prandaj vendbanimet në zonat malore janë në rrezik të erozionit dhe masat e nevojshme duhet të ndërmerren.

**Tabela 1.6:** Klasifikimi i erozionit në Komunën e Prizrenit

| Kategoria e erozionit | Sipërfaqja (ha) | përqindja (%) |
|---|---|---|
| I | 6562 | 10,29 |
| II | 7935 | 12,44 |
| III | 20333 | 31,88 |
| IV | 13524 | 21,20 |
| V | 10509 | 16,48 |
| Nuk ka vlerë | 4919 | 7,71 |

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*

### Trashëgimia natyrore

Trashëgimia natyrore ka një rëndësi të madhe ekonomike, me mundësi të zhvillimit të turizmit që është një faktor kyç për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajonit.

Ruajtja e trashëgimisë kombëtare në shtetet evropiane ka ndodhur që nga shekulli i 19-të, ndërsa në Kosovë, termi i trashëgimisë ka fituar rëndësi vetëm pas Luftës së Dytë botërore.

Figura 1.3 tregon zonat, monumentet dhe vlerat tjera natyrore në Kosovë që janë nën mbrojtje. Humbja e trashëgimisë natyrore është çështje e rëndësisë jetike për të gjithë. Shkaktarët janë të ndryshëm si: ndërtimet kaotike në afërsi të zonave me trashëgimi natyrore, prerjet e pakontrolluara të pyjeve, erozioni, shkatërrimi i monumenteve të natyrës me vlera, ndotja e zonave kryesisht turistike, e të gjitha këto si pasojë e mos efikasitetit të organeve menaxhuese për mbrojtje të trashëgimisë natyrore në pajtim me kriteret ndërkombëtare dhe vendore, si dhe vetëdija e ulët e popullatës për ruajtjen e zonave të mbrojtura si potencial i zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë së vendit.(Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$).

Duke konsideruar ruajtjen e resurseve dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore si qëllim të zhvillimit hapësinor të Kosovës, ky aspekt ka për qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, të zhvillimit të kontrolluar hapësinor, mbrojtjen dhe respektimin e resurseve, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe duke u bazuar në gjendjen ekzistuese e cila thekson çështjet e



- humbjes së tokës kualitative bujqësore;
- shkallën e lartë të ndotjes mjedisore;
- shfrytëzimin joracional të resurseve dhe zgjerimin e pakontrolluar të vendbanimeve
- Rritja e pakontrolluar e vendbanimeve është alarmante.
- Qasja ndaj zgjidhjeve të ardhshme duhet të përbëhet nga veprimet e koncentruar për ruajtjen e burimeve natyrore dhe ambientale.




*Plani Hapesinor i Kosoves* 2010-2020$^{+}$,

**Figura 1.3:** Trashëgimia natyrore në Kosovë

Trashëgimia natyrore në Prizren

Rezervatet natyrore janë hapësirat origjinale të natyrës me forma karakteristike të bimëve, kafshëve si pjesë integrale e ekosistemeve të dizajnuara kryesisht për ruajtjen e stoqeve gjenetike. Rezervatet natyrore janë ruajtur in sitū (në vend) me nën klasifikimin e bimëve, kafshëve ose rezervateve speciale. Në Kosovë ndodhen 75 zona të mbrojtura natyrore me 46.437 ha (4.25% e territorit të Kosovës). Në Prizren ndodhen tre rezervate natyrore: Maja e Arnetit, Oshlaku dhe Pisha e madhe me përbërje të pastër të munikës-arnenit (Pinus Heldreichi);

Hapësira më e madhe e mbrojtur është Parku Nacional “Malet e Sharrit” që ndodhet në Komunën e Prizrenit (Tabela 1.7). Malet e Sharrit ndodhen në Kosovë dhe Maqedoni dhe ka

një sipërfaqe prej 1600 $km^2$. Pjesa veriore e Maleve të Sharrit i takon Kosovës me një sipërfaqe prej 1100 $km^2$.

Në vitin 1986, nga Kuvendi i Kosovës, Parku Nacional i Maleve të Sharrit ka fituar statusin e regjistrimit si trashëgimi natyrore, i klasifikuar si Park natyror.

Parku Nacional ka planin e tij zhvillimor të përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në pajtim me rregullat ndërkombëtare për parqet nacionale.

Me karakteristikat e saja të pasura natyrore, si sipërfaqja topografike, klima dhe vetitë hidrologjike si dhe biodiversiteti i florës dhe faunës, parku nacional është shpallur si qendër e hulumtimit shkencor dhe edukativ në shkencat natyrore dhe zhvillimin ekonomik rural dhe ekoturizmin. Por parku është në rrezik të madh të nga ndotja dhe degradimi i mjedisit si rezultat i përdorimit joracional të burimeve natyrore, si dhe prerja ilegale e pyjeve dhe niveli i lartë i erozionit (Plani Hapësinor – Parku Nacional “Mali Sharr”).

Parku Nacional “Malet e Sharrit” dallojnë me vlera botanike, shtazore, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore. Parku është aq i pasur me biodiversitet jo vetëm në Kosovë por edhe në regjionin e Gadishullit Ballkanik, dhe përfaqëson një thesar të llojeve bimore ku disa prej tyre janë endemike, të rralla ose të rrezikuara nga shfarosja. Në Parkun Nacional “Malet e Sharrit” ndodhen 4 rezervate të mbrojtura natyrore. Tre prej tyre ndodhen në Komunën e Prizrenit si rezervat natyror si: Maja e Arnetit, Oshlaku dhe Pisha e madhe. I katërti është Rusenica në e cila ndodhet në komunën e Therandës ku jeton rrëqebulli i Ballkanit.



**Tabela 1.7** Zonat e mbrojtura natyrore në Kosovë dhe Prizren
(Plani Hapësinor i Kosovës, 2010-2020+)

| | Kosova | | Prizreni | |
|---|---|---|---|---|
| Emri | Nr i hapësirave | Sipërfaqja - ha | Nr i hapësirave | Sipërfaqja - ha |
| Rezervat natyror | 11 | 698,4 | 3 | 65 |
| Park Nacional | 1 | 39 000 | 1 | 19 500 (*) |
| Monument natyror | 38 | 4 867,9 | 3 | |
| Peizazhi i mbrojtur | 2 | 1 681 | 0 | |

*(*)Parku Nacional “Mali Sharr” ndodhet në pesë komuna: Prizren, Suharekë, Kaçanik, Dragash dhe Shtërpce.*




**Harta 1.8.** Harta e reshjeve

45




**Harta 1.9.** Aftësia e tokës për përpunim




Harta 1.10. Erozioni

#### 1.1.1.2. STRUKTURA FIZIKE

Ky seksion mëton të prezantojë situatën ekzistuese fizike në Komunën e Prizrenit. Ajo përbëhet nga analiza në hollësi e strukturës natyrore dhe resurseve mjedisore, modelet e shfrytëzimit të tokës, transporti dhe infrastruktura si dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore. Të dhënat kryesore janë marrë drejtpërdrejtë nga Ministritë përkatëse të Qeverisë së Kosovës. Të dhënat dytësore janë marrë nga vizitat në teren të kryera në mars dhe prill të vitit 2009. Të gjitha të dhënat e grumbulluara janë aplikuar në hartat digjitale duke përdorur Sistemin Informativ Gjeografik (GIS) nga ekipi projektues.

**Modeli i Shfrytëzimit të Tokës**

Në PZHKP 2025, analiza e shfrytëzimit të tokës përbëhet nga të dhënat e marra nga institucionet dhe nga analizat studimore në terren (Tabela 1.8). Të dhënat për hartën e tokës bujqësore, hartën e klasifikimit të tokës, sipërfaqet ujore dhe zonat pyjore janë nga studimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të datës 2004, ndërsa të dhënat si vendbanimet, mjediset e punës etj. janë prodhuar nga mbivendosja e rezultateve të hulumtimit dhe anketimeve në teren.

**Tabela 1.8**: Përmbledhja e shfrytëzimit të tokës.



| Shfrytëzimi i tokës | SIPËRFAQJA (ha) | PËRQINDJA (%) |
|---|---|---|
| Banimi i densitetit të ultë | 777.47 | 1.22 |
| Banimi i densitetit të lartë | 26.79 | 0.04 |
| Vendbanimet rurale | 1,698.25 | 2.66 |
| **Sipërfaqet Banuese Sub totali** | **2,502.52** | **3.92** |
| Banimi i densitetit të lartë + tregtia + shërbimet | 282.51 | 0.44 |
| Industria + depot + tregtia | 57.60 | 0.09 |
| **Sipërfaqet Komerciale+ Shërbim+ Përdorim i përzier Sub Totali** | **340.11** | **0.53** |
| Parku i qytetit | 4.46 | 0.01 |
| Park | 3.33 | 0.01 |
| Sipërfaqe sportive | 1.03 | 0.00 |
| Kishat | 1.44 | 0.00 |
| Xhamitë | 3.40 | 0.01 |
| Shkollat fillore | 18.00 | 0.03 |
| Shkollat e mesme | 13.05 | 0.02 |
| Posta | 0.01 | 0.00 |
| Spitali | 10.27 | 0.02 |
| Objektet shëndetësore | 1.75 | 0.00 |
| Pompat e karburanteve | 3.45 | 0.01 |
| Varrezat | 104.14 | 0.16 |
| **Objektet Urbane Sub Totali** | **164.33** | **0.26** |

**Tabela 1.8**: *vazhdon nga faqja paraprake*

| Shfrytëzimi i tokës | SIPËRFAQJA (ha) | PËRQINDJA (%) |
|---|---|---|
| Prodhimtaria | 142.29 | 0.22 |
| Industria | 22.70 | 0.04 |
| Industria bujqësore | 13.81 | 0.02 |
| **Industria Sub Totali** | **178.79** | **0.28** |
| Hekurudha | 14.91 | 0.02 |
| Rrugët | 16.83 | 0.03 |
| Rrugët e rendit të parë | 10.78 | 0.02 |
| Rrugët e rendit të dytë | 11.73 | 0.02 |
| Rrugët private | 18,51 | 0.03 |
| Rrugë e pakategorizuar | 1,029.65 | 1.61 |
| Terminali i autobusëve | 1.69 | 0.00 |
| Stacion transformues | 0.91 | 0.00 |
| Deponi | 0.24 | 0.00 |
| **Infrastruktura Sub Totali** | **1,105.25** | **1.73** |
| **Sipërfaqe ushtarake Sub Totali** | **95.34** | **0.15** |
| Toke e pëlleshme | 16,398.83 | 25.71 |
| Kopshtet | 72.50 | 0.11 |
| Pemishtet | 726.66 | 1.14 |
| Vreshtat | 1,297.11 | 2.03 |
| Barishtet | 4,795.46 | 7.52 |
| Kullotat | 14,096.83 | 22.10 |
| Pyjet | 20,046.71 | 31.43 |
| **Sipërfaqet Bujqësore Sub Totali** | **57,434.10** | **90.05** |
| Gurore | 194.46 | 0.30 |
| Zhavorr | 9.57 | 0.02 |
| Tokë gurore | 367.02 | 0.58 |
| Moçale | 5.27 | 0.01 |
| Lumenjtë | 649.41 | 1.02 |
| Përroskat | 106.86 | 0.17 |
| Kanalet | 126.35 | 0.20 |
| Bazenë | 0.05 | 0.00 |
| Joprodhuese | 501.25 | 0.79 |
| **Sipërfaqet Tjera Sub Total** | **1,960.24** | **3.07** |
| **TOTAL** | **63,780.67** | **100.00** |

*Ministria e bujqësisë, 2005; Vizita në teren, 2009*

Sipërfaqja totale e Komunës së Prizrenit është 63,780.67 që e bën atë komunë më të madhe në Kosovë. Ajo përfshin 5.94% të territorit të Kosovës (Profili i komunës së Prizrenit, 2007). Modelet e shfrytëzimit të tokës tregojnë se karakteri rural është mbizotërues. Sipërfaqja totale e banuar është 3,392,72 ha apo 5.3% e sipërfaqes totale të komunës. Zonat bujqësore dhe pyjore përfshijnë 90.05% të komunës me një sipërfaqe prej 57,434.1 ha (Tabela 1.8) (Harta 1.11).






**Harta 1.11.** Përdorimi i tokës

## Vendbanimet

Me qëllim të vlerësimit të shpërndarjes së vendbanimeve për 25 vjet, është bërë krahasimi me të dhënat e vitit 1981 dhe ortofotot e vitit 2009 (Tabela 1.9) (Harta 1.12).

Siç është përmendur më herët, Komuna e Prizrenit ka 3,392.72 ha me vendbanime ku pjesa me e madhe është përqendruar në qendrën e qytetit. Ekspansioni i vendbanimeve vazhdon përgjatë veriut dhe arterieve kryesore rrugore ato janë aksi rrugor Prizren-Gjakovë dhe aksi rrugor Prizren-Prishtinë. Tabela 1.9 tregon se madhësia e vendbanimeve për këtë periudhe është dyfishuar. Kjo mund të vërehet nga vendbanimet e reja në tokën bujqësore përreth qytetit dhe ndërtimet shumëkatëshe në qendër. Kjo sipërfaqe është 777.47 ha ku densiteti mesatar është 190 b/ha. Një ekspansion tjetër është në Lubizhdë dhe Korishë. Sidomos ekspansioni i Lubizhdës është aq evident sa që ky fshat është bërë si para lagje e qytetit. Ky ekspansion është rezultat i mungesës së projekteve planifikuese për vendbanimet që është një pasoj e fluksit të madh të migrimit të popullatës gjatë periudhës së pasluftës nga zonat e vendbanimeve rurale në qendër, si dhe rritja natyrore e popullatës.

Vendbanimet rurale, në anën tjetër përbëjnë 2.66% të sipërfaqes totale me 1698.25 ha. Densiteti i popullatës në vendbanimet rurale është 50 b/ha. Shpërndarja e vendbanimeve tregon një imazh relativisht të dendur në rrafshinën e Prizrenit përderisa në pjesët malore këto vendbanime reduktohen.



**Tabela 1.9:** Madhësia e vendbanimeve

| Vendbanimet | Sipërfaqja totale e banuar (ha) | Qyteti I Prizrenit (ha) |
|---|---|---|
| Ortofoto (2009) | 3393.72 | 1495.74 |
| 1/25000 Hartat themelore (1980) | 1572.17 | 719.05 |

*PZHKP 2025, 2009*

## Vendbanimet joformale

Sipas Ligjit (Nr.03/L-106/2008) për ndryshimin në Ligjin për Planifikim Hapësinorë (Nr.2003/14); "Vendbanimet joformale" janë vendbanime njerëzore të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, në veçanti banim të përshtatshëm. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të kenë këto karakteristika si në vijim:

a) Zotërim joformal i pronësisë;

b) Qasje joadekuate ose privim në shërbime elementare;

c) Pjesëmarrje joadekuate ose mos pjesëmarrje në qeverisje dhe

d) Rrezikshmëri e lartë (Ligji (Nr.03/L-106/2008) për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr.2003/14)) .

Siç kemi përmendur më herët, qendra e qytetit ka përjetuar një ekspansion të pakontrolluar sidomos kah rrugët kryesore arteriale. Zgjerimi dhe shtrirja e shpejtë i vendbanimeve joformale paraqet një rrezik për tokën bujqësore. Sipas vizitës në terren si dhe studimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me MMPH dhe UN-HABITATIT për vendbanime joformale, del se zonat kryesore të vendbanimeve joformale paraqiten në këto lagje: lagjja Arbanë, lagjja Jeta e Re, lagjja Bajër (Kurillë), lagjja Petrovë dhe lagjja Zahir Pajaziti, ku pjesa më e madhe e tokës është tokë bujqësore e shkallës së tretë (Harta 1.13). Sipas studimit mbi vendbanimet joformale dalin këto rezultate mbi shtrirjen e këtyre vendbanimeve, sipërfaqes, numrit të objekteve dhe numrit të banorëve.

| Vendbanimi/emërtimi | S=ha | Nr. i shtëpve | Nr. i banorëve |
|---|---|---|---|
| Lagjja Arbanë | 3 | 40 | 210 |
| Lagjja Jeta e Re | 7 | 50 | 250 |
| Lagjja Bajër (Kurillë) | 10 | 50 | 200 |
| Lagjja Petrovë | 2 | 20 | 86 |
| Lagjja Zahir Pajaziti | 1.7 | 60 | 300 |

Ndërtimi ilegal po ashtu vërehet në këto lagje pos në Arbanë. Edhe pse ndërtimet ilegale nuk përkrahen nga Qeveria, këto vendbanime joformale kanë infrastrukturë të duhur dhe shumica e rrugëve janë të asfaltuara. Është me rrëndësi të veçant dhe në interes të komunës të bëhet trajtimi i vendbanimeve joformale me plane përkatëse me qëllim të rregullimit të tyre ashtu siq parashifet sipas ligjit (Nr.03/L-106/2008)



Sipërfaqet punuese

Qyteti i Prizrenit dallohet nga fshatrat e saja me një strukturë historike, tregti të zhvilluar, shërbime dhe aktivitetet prodhuese. Regjioni i Shatërvanit dhe Kalasë karakterizohen me funksione shërbyese ndërsa në pjesën veriore të Lumëbardhit kemi tregti me pakicë, prodhimtari dhe funksione shërbyese. Zona industriale që ka qenë afër hekurudhës tani është në qendër të qytetit. Shumica e këtyre objekteve të zonës industriale tani janë shndërruar në depo.

Sot, ky regjion dhe rrethina e ngushtë ballafaqohet me kërkesat për transformim funksional. Me këtë përqendrim në qendër të qytetit dhe rrethinë, objektet ekzistuese urbane mbesin prapa nevojave të popullatës prandaj nevoja për godina të reja është rritur shumë. Veçanërisht, mosekzistimi i fushave të hapura siç janë sheshet e lojërave për fëmijë, fushat sportive dhe parqet, mund të paraqesin problem për gjeneratat e ardhshme. Mungesa e objekteve kulturore dhe sociale është një çështje tjetër që duhet të merret parasysh.




**Harta 1.12.** Vendbanimet




Harta 1.13. Shfrytëzimi i tokës në Qendër të Qytetit

*Zonat bujqësore*

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë ndarjen e tokës në tetë kategori në bazë të lokacionit, pjerrësisë, thellësisë, cilësisë dhe reaksionit të tokës.

Në Prizren (Tabela 1.10 dhe Harta 1.14), nuk ka tokë të klasit të parë. 30% e sipërfaqes totale i takon klasit të dytë, tretë dhe katërt të cilat ndodhen në rrafshinën e Prizrenit. Këto sipërfaqe janë të pëlleshme dhe kufizimi i përdorimit të tyre si dhe nevoja për masat mbrojtëse ritet nga shkalla e parë deri te shkalla e katërt. Rrafshina e Prizrenit është e rrethuar me tokën e klasit të gjashtë në lindje dhe klasit të shtatë në jug. Toka e klasit të tetë shtrihen mbi Malet e Sharrit dhe Pashtrikut dhe nuk janë për tu përdorur për tokë bujqësore, por përdoren si kullota, për rritjen e kafshëve të egra, pyje, rekreacion dhe për qëllime estetike.

**Tabela 1.10** Klasifikimi i tokës bujqësore

| Klasa bujqësore | Sipërfaqja (ha) | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| II | 6,621 | 10.37 |
| III | 4,973 | 7.79 |
| IV | 8,099 | 12.68 |
| V | 1,108 | 1.73 |
| VI | 15,881 | 24.86 |
| VII | 15,372 | 24.06 |
| VIII | 11,823 | 18.51 |
| Total | 63,877 | 100.00 |

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*






**Harta 1.14.** Klasifikimi i tokës bujqësore

## *Zonat Pyjore*

Pyjet në Prizren kanë sipërfaqe prej 8,500 ha ku hyjnë pyjet e dendura dhe ato me intensitet më të ulët që janë vetëm 13 % e komunës (Tabela 1.11). Regjioni i Hasit ka më së shumti pyje në Komunën e Prizrenit. Një sasi e madhe e pyjeve të dendura gjendet në veri të Maleve të Pashtrikut në kufi të Kushninin dhe të Lubizhdës së Hasit. Pjesa tjetër e Hasit është e mbuluar me shkurre. Në jug, zona të dendura pyjore janë vërejtur në regjionin e Lumës në kufi me Shqipërinë. Në malet e Sharrit, gjenden pyjet e densitetit të ultë ndërsa pyjet më të dendura janë në pjesët më të larta malore. (Harta 1.15).

Tabela 1.11: Sipërfaqet pyjore

| **Lloji** | **Sipërfaqja (ha)** | **Përqindja (%)** |
|---|---|---|
| Shkurret | 11,578 | 18.15 |
| E dendur | 4,473 | 7.01 |
| Dendësia e ultë | 3,995 | 6.26 |
| Totali | 20,047 | 31.43 |

*PZHKP 2025, 2009*

Si një nga pasuritë e Prizrenit, Parku Nacional “Malet e Sharrit” e cila mbulon një sipërfaqe prej 19.500 ha është e veçantë me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës dhe faunës. Pastaj kemi rezervatet e natyrës si: 57

- Popovo Prase – e cila mbulon një sipërfaqe prej 30 ha, është vendi ku rritet Pinus Heldreichi;
- Oshlaku - e cila mbulon një sipërfaqe prej 20 ha, është vendi ku rritet Pinus Heldreichi dhe i disa bimë tjera endemike;
- Golemi Bor – e cila mbulon një sipërfaqe prej 35 ha, është rezervat bimor i llojit të Molikës dhe i disa shpendëve këngëtarë;
- Gryka e Lumëbardhit – e cila mbulon një sipërfaqe prej 200 ha, është një monument natyror me karakter hidrologjik dhe peizazhor;
- Rrapi në Marash (Platanus Orientalis) - është një monument natyre me karakter botanik, edukativ dhe me vlerë shkencor;
- Vidhi fushor (Ulmus Campestris) në fshatin Lukinaj - ish monumenti natyror me karakter botanik.

## *Gurore të rërës dhe gurëthyesit*

Aktivitetet e nxjerrjes së zhavorrit dhe gurëthyesve, kryesisht ndodhen në regjionin e Hasit dhe regjionin e Anadrinisë përgjatë aksit rrugor Prizren-Gjakovë. Aktivitetet, e lidhura me nxjerrjen e zhavorrit janë titulluar si bazë asfalti, depo, separimi i gurëve dhe rërës etj. Aktivitetet e paligjshme të guroreve-zhavorr nxjerrësve në veri të fshatrave Lukinaj, Breg Drini mund të klasifikohen si gërmime ilegale. Përveç kësaj, ka edhe dy njësi të guroreve dhe të reparacionit, të cilat ndodhen në regjionin e Lumës, në fshatin Zhur (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2011; Harta 1.16)




**Harta 1.15**. Pyjet




**Harta 1.16.** Aktivitetet e Gurëthyesve dhe Zhavorr Nxjerrësve

## Transporti dhe infrastruktura

### *Rrjeti rrugor*

Kosova nuk shtrihet në asnjë nga rrjetet Trans Evropiane (TEN) por kryqzohet me dy rrugë në Observatorin e Europës Juglindore të Transportit (SEETO) si rrugë kryesore e rrjetit.

Këto dy rrugë SEETO janë korridori (rruga) 6 që është kalimi Ribarevina (Mali i Zi) – Ribarice (Sërbi) – Prishtinë (Kosovë) – Shkup (Maqedoni) dhe rruga 7 kalimi Lezhë (Shqipëri) - Prishtinë (Kosovë) – Doljevac (Sërbi) (Figura 1.4).Ndërtimi i rrugës 7, është parë si prioritet i menjëhershëm me rëndësi kombëtare, ku punimet e kësaj rruge të seksionit jugor në mes të Morinës dhe Prizrenit kanë përfunduar në tërsi përgjatë tër teritorit të komunës së Prizrenit nëpër të cilën kalon traseja rrugore e autostradës ku edhe është i hapur për shfrytëzim,dhe lidhet me autostradën e re posa të ndërtuar midis Milotit dhe Morinës në Shqipëri (Dokument Teknik, Sektori i Transportit).






(*www.seetoint.org*)

**Figura 1.4:** Kosova në rrjetin transportues të Evropës Juglindore

Pjesa më e madhe e rrugëve në Kosovë është ndërtuar apo rindërtuar në vitet 1960. Për momentin, gjatësia e rrjetit rrugor të Kosovës është 8,522 km. Rrjeti kryesor përfshin rrugën M2 që fillon në Veri nga Serbia kalon nëpër Prishtinë dhe mbaron në Jug në kufi me Maqedoninë. Kjo rrugë lidh Prishtinën më Korridorin Evropian X. Rruga M25 që vjen nga Nishi deri në kufirin veri lindor me Serbinë, kalon nëpër Prishtine dhe Prizren dhe mbaron në

kufi me Shqipërinë. (Raporti nacional për transportin në Kosovë 2009) (Figure 1.5). Edhe pse Prizreni nuk është pjesë e korridoreve kryesore të Evropës juglindore, Prizreni është udhëkryq i rëndësishëm që lidh pjesën më të madhe të Ballkanit me detin Adriatik. Rruga M25, po bëhet gjithnjë më e rëndësishme për pjesën e saj (Kosovës) Jugore që lidh Kosovën me Shqipërinë, ku si rrugë kalon brenda kufijve të Komunës së Prizrenit dhe Qyteti i Prizrenit do të ketë një rol të rëndësishëm. Këtu janë dikur rreth 550 km të rrugëve lokale, rajonale, dhe magjistrale (Profili Komunal i Prizrenit, 2007). (Harta 1.16).




*PZHKP 2025, 2009*

**Figura 1.5:** Prizreni në rrejtin transportues te Kosovës

Analizat e infrastrukturës transportuese tregojnë se rrugët e dizajnuar për zhvillim të densitetit të ultë, janë joefikas për nevojat e popullatës ekzistuese dhe nevojat e ndërtimit të tanishëm.

Sipas Entit Statistikor të Kosovës, numri i automjeteve të regjistruara në Kosovë në vitin 2002 ishte 215,504. Numri i parashikuar për vitin 2005 është 272,500 me një rritje prej afro 60.000 automjetesh për tre vite. (Raporti nacional për transportin në Kosovë 2009) Duke e pasur parasysh këtë, rrjeti ekzistues rrugor del që është i pamjaftueshëm prandaj edhe investimet për ndërtimin e rrugëve të reja apo rehabilitimi i rrugëve ekzistuese ka një rol të posaçëm në Kosovë.

Qyteti ndodhet në udhëkryqin e boshteve transportuese të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë dhe ndikohet negativisht nga transporti masiv në mes të këtyre shteteve. Një nga projektet për tejkalimin e problemeve të transportit është rruga transite e ndërtuar nga KFOR-i. Ndërtimi i autostradës së propozuar Shqipëri- Kosovë, do të lehtësojë trafikun rrugor të qendrës së Prizrenit.

Sa i përket transportit të brendshëm situata është e mirë në qytet, por fshatrat nuk kanë lidhje të duhura me vendbanimet fqinjë. Sipas hulumtimeve në teren dhe rezultateve të dala nga anketimet me kryetarët e fshatrave, shumica e fshatrave kanë probleme të transportit sidomos me rrugët e lagjeve. Shumica e rrugëve në fshatra nuk janë të asfaltuar por rrugët kryesore që lidhin fshatrat me qytetin janë ose të asfaltuar ose në ndërtim e sipër. Disa fshatra në rajonet malore një ndër ta edhe fshati Kabash janë të zbrazur për shkak të mos qasjes rrugore. Fshatrat në regjionin e Vërrinit dhe Zhupës kanë nevojë për rehabilitimin e rrugëve sidomos në viset malore, në mënyrë që të arrijnë te tokat e tyre bujqësore apo të kullosin bagëtinë. Rehabilitimi i rrugëve është një proces i vazhdueshëm dhe investimet vijnë nga Kuvendi Komunal dhe organizatat ndërkombëtare.

### *Transporti Hekurudhor dhe Aeroportet*

Ndërmarrja e cila merret me menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore në Kosove si dhe ofron shërbime komerciale të transportit të pasagjereve dhe mallrave quhet Hekurudhat e Kosovës. Rrejti hekurudhor i Kosovës është i gjatë 333 km, e cila shfrytëzohet për transport publik si dhe transportimin e mallrave industriale (Tabela 1.12). Në përgjithësi, rrjeti hekurudhor nuk është në gjendje të mirë.



Burime të kufizuara janë duke u dhënë për mirëmbajtjen dhe investimet në rrjetin hekurudhor, kryesisht për shkak të humbjeve të qëndrueshme financiare që rrjedhin nga nivelet ulëta të trafikut në rrjet (Raporti i Sfondit Kombëtar mbi Transportin për Kosovën, 2009).

Linja hekurudhore Veri-Jug, e cila kalon përgjatë Kosovës nga kufiri me Serbinë deri në kufirin me Maqedoninë prej një gjatësie në total prej 148 km është linje e vetme hekurudhore operacionale për bartjen e mallrave dhe shërbime të pasagjerëve. Linja hekurudhore Verilindje-Perëndim përbëhet nga tri degë, ku linja hekurudhore nga Klina në Prizren themelon degën e Jug- Perëndimit dhe ka një gjatësi prej 58 km.

Hekurudha fillon nga Prizreni dhe shkon drejt Gjakovës. Ajo lidh hekurudhën Pejë – Prishtinë në komunën e Klinës. Hekurudha është pasive që nga viti 1999. Kjo ka pamundësuar që Prizreni të jetë qendër rajonale për transportin e mallrave dhe pasagjerëve.

Siç thuhet në Planin Hapësinor të Kosovës. Ministria e transportit dhe Post Telekomunikacionit ka zhvilluar një projekt për të përmirësuar sistemin hekurudhor në

Kosovë. Ky projekt përfshin rehabilitimin e linjës ekzistuese dhe elektrifikimin e saj si dhe ndërtimin e hekurudhës së re Prizren Rrëshen në Shqipëri.

**Tabela 1.12:** Lokacioni dhe gjatësia e linjave hekurudhore në Kosovë.

| Linja | Seksioni | | Gjatësia | Gjendja |
|---|---|---|---|---|
| Jugu | Hani i Elezit | Fushe Kosove | 62,8 | I hapur për mallra dhe pasagjerë |
| Veriu | Fushe Kosove | Lersak | 78,5 | I hapur për mallra dhe pasagjerë |
| Perendim | Fushe Kosove | Peja | 81,2 | I hapur për mallra dhe pasagjerë |
| | Kline | Prizen | 58,3 | Nuk funksionon |
| Lindje | Fushe Kosovë | Bardhosh | 14,2 | I hapur për mallra |
| | Bardhosh | Medare | 38 | Nuk funksionon |
| Total | | | 333 | |

*Raporti teknik, sektori i transportit (2008)*

Pos intervenimit në sistemin hekurudhor, investimet janë planifikuar për aeroportin e Prishtinës dhe Gjakovës. Me aktivizimin e hekurudhës, Prizreni do të përfitojë nga aeroporti i Gjakovës dhe do të bëhet një linjë e rëndësishme tregtare.

Kosova ka një aeroport ndërkombëtar civil. Pista e aeroportit është e gjatë 2500 m dhe 45 m e gjerë. Platforma e aeroportit ka një sipërfaqe prej 24,700 m$^2$, dhe mund të pranojë 5 aeroplanë të madhësisë së mesme në të njëjtën kohë. ANP shërben si për nevoja civile ashtu edhe për ato ushtarake, ndërsa në Gjakovë gjendet aeroporti i cili përdoret nga Aviacioni Ushtarak Italian. Edhe aeroporti në Gjakovë parashihet të shndërrohet në aeroport ndërkombëtar civil. Me aktivizimin e hekurudhës, Prizreni do të përfitojë nga aeroporti i Gjakovës dhe do të behet një linjë e rëndësishme tregtare meqë hekurudha do të jetë lidhja më e rëndësishme transportuese me Shqipërinë.




Harta 1.17: Infrastruktura e transportit

*Ujësjellësi*

Sipërfaqja totale e mbuluar me ujësjellës është 13.5 $km^2$ dhe konsumi mesatar i ujit për banor për ditë është 150 L (Profili Komunal i Prizrenit, 2007 ). Pjesa më e madhe e rrjetit është e vjetër më shumë se 40 vjet dhe punimet ende vazhdojnë në përmirësimin e sistemit të ujësjellësit dhe atij të kanalizimit. (Harta 1.18).

Edhe pse resurset e ujit në komunë janë të pasura sidomos pas shkrirjes së borës në pranverë, niveli i ujit bie në verë dhe vjeshtë. 60% e komunës gjendet në pjesët e ulëta ky furnizimi me ujë bëhet me gravitacion. 40 % e komunës furnizohet nëpërmjet pompave që paraqesin problem në veti për shkak të reduktimit të rrymës.

Ndërmarrja komunale Cvileni menaxhon ujësjellësin dhe kanalizimin në pjesën më të madhe të komunës. Kontrolli i cilësisë së ujit bëhet çdo ditë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë. Me instalimin e stacioneve për klorizim afër bunarëve, cilësia e ujit është përmirësuar viteve të kaluara.

Sipas të dhënave në terren, shumica e fshatrave kanë resurse të mjaftueshme ujore por ka nevojë për një rrjet adekuat të rrjetit të ujësjellësit. Regjioni Podrimës dhe i Prizrenit janë në pozitë më të favorshme sa i përket ujit të pijshëm. Prizreni dhe fshatrat në rrethinë furnizohen me ujë nga katër burime të ujit të pijshëm dhe nga Lumi Lumëbardhi pas filtrimit të duhur. Gravitacioni është duke u përdorur në mënyrë efikase për furnizim me ujë. Në disa fshatra të Hasit përdoret uji nga sistemi i Radoniqit i cili është shumë i vjetër dhe ka nevojë për rehabilitim. Në Landovicë, ka një gravitacion të fortë që mundëson furnizimin me ujë të freskët në nivelin e tokës. Burrimet tjera të rrëndësishëm me kapacitet të lartë të ujit ndodhen në fshatin Poslisht (burrimi Gura) dhe burrimi i ujit në afërsi të fshatit Vërmic, të cilat burrime mundë të shfrytëzohen për furnizim me ujë të pishëm. Megjithatë, burimet e ujit në Landovicë janë në rrezik të ndotjes nga ujërat e zeza që dalin nga deponia e re regjionale që ndodhet brenda kufijve të këtij fshati (Figura 1.6).

Rajoni i Lumës është me më pak ujë. Vërrini përdor një sistem të vjetër 30 vjeçar. Gypat janë të azbestit dhe sipas kryetarit të Hoçës së Vogël janë paraqitur edhe sëmundje epidemike nga këto gypa.



*PZHKP 2025, 2009*

**Figura 1.6:** Ujërat e ndotur në Landovicë

*Kanalizimi*

Sipas profilit komunal të Prizrenit, rrjeti i kanalizimit përfshin 136,493 km dhe mbulon pjesën më të madhe të Komunës. Pas luftës janë zbatuar shumë projekte për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit por derdhja bëhet drejtpërdrejt në lumenj dhe në disa raste në fusha të hapura pa trajtim paraprak.



Duke u bazuar nga të dhënat e marra nga hulumtimet në terren dhe intervistave me kryetarët e fshatrave, Krusha e Vogël dhe Atmaxha kanë kanalizim adekuat dhe janë të lidhura me rrjetin kryesor të kanalizimit. Mamusha, Zojzi dhe Zhuri kanë sistem të precipitimit para shkarkimit të ujërave të zeza (Harta 1.19).

*Trajtimi i mbeturinave*

Një kompani publike dhe gjashtë private ofrojnë shërbime për grumbullimin e mbeturinave. Menaxhimi i mbeturinave nuk është i kënaqshëm dhe mungon kapaciteti për mbulimin e fshatrave rrethuese që rezulton në ndotjen e lumenjve. Deponia e vjetër në Korishë është mbyllur që nga viti 2005 dhe deponia e re rajonale është ndërtuar në Landovicë (Figura 1.7) që ofron shërbime për komunën e Suharekës, Gjakovës, Rahovecit dhe komunës e Prizrenit. Deponia është e dizajnuar për 500,000 banorë dhe ka kapacitet prej 2,500,000m3. Koha e planifikuar e shfrytëzimit të deponisë është 18-20 vite (PZHU, 2003; (Komuna e Prizrenit Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 2009).



**Figura 1.7:** Deponia e plehut në Landovicë

Edhe pse zona qendrore ka shërbim të mirë për grumbullimin e mbeturinave, hedhja e tyre bëhet në kushte jashtëzakonisht të pafavorshme. Për shembull, shumica e fshatrave të Zhupës i gjuajnë mbeturinat jashtë vendbanimeve (Figura 1.8). Fshatrat që u ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave janë: Atmaxha, Billusha, Breg Drini, Caparci, Dedaj, Dobrushta, Gjonaj, Hoca e Qytetit, Karashengjergji, Kobaj, Korisha, Krajku, Krusha e Vogel, Kushnini, Lubizhda, Lubizhda e Hasit, Lukinaj, Lutogllava, Mamusha, Medveci, Mushnikova, Novaka, Petrovasella, Pirana, Poslishti, Reçana, Romaja, Serbica e Eperme, Serbica e Poshtme, Shkoze, Shpinadia, Skorobishti, Smaçi, Randobrava, Trepetnica, Tupeci, Velezha, Vermica, Vlashnja, Zhuri, Zojzi dhe Zymi.





**Figura 1.8:** Deponimi në natyrë, Nepergoshti

*Furnizimi me Energji Elektrike*

Sipas Profilit Komunal të Prizrenit, 2007, rrjeti elektrik gati se ishte në kolaps për shkak të mungesës së investimeve kapitale sidomos gjatë viteve të 90'ta. Në raport theksohet ekzistimi i fytit të ngushtë si një nga problemet kyçe të furnizimit me energji elektrike.

Strategjia e Kosovës për Energji (2005) prezanton një parashikim të kërkesave për energji elektrike për periudhën 2005-2020 (Tabela 1.13) e cila është përpiluar në bazë të dy skenarëve alternative: skenarin e rritjes mesatare dhe atë të rritjes së lartë.

Në Prizren, elektriciteti shpërndahet nëpërmes 3 transformatorëve 110Kv si dhe 12 transformatorëve me nga 35Kv (Profili Komunal i Prizrenit, 2007 ). Për momentin, rrjeti elektrik nuk është efiçient.

**Tabela 1.13:** Parashikimi i kërkesave për energji elektrike për periudhën 2005-2020 në Kosovë

| **Viti** | | **2005** | **2010** | **2015** | **2020** |
|---|---|---|---|---|---|
| Skenari i rritjes së lartë – rritja vjetore 5.5% | | | | | |
| Kërkesa vjetore | GWh | 3,769 | 4,988 | 6,519 | 8,353 |
| Kërkesa maksimale | MW | 796 | 1,061 | 1,424 | 1,960 |
| Skenari i rritjes mesatare – rritja vjetore 3.9% | | | | | |
| Kërkesa vjetore | GWh | 3,586 | 4,272 | 5,137 | 6,168 |
| Kërkesa maksimale | MW | 749 | 890 | 1,081 | 1,296 |

*Strategjia e Kosovës për Energji*



Strategjia e Kosovës për Energji (2005) parasheh ndërtimin e unazës 400 kV rreth katër nënstacioneve kryesore në Prishtine, Pejë, Prizren dhe Ferizaj. Raporti po ashtu thekson rëndësinë e gjenerimit dhe shpërndarjes së rrymës elektrike si dhe nevojën për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit.




**Harta 1.18.** Rrjeti i ujësjellësit në Komunën e Prizrenit






**Harta 1.19.** Rrjeti i kanalizimit

**Trashëgimia kulturore**

Territori i Kosovës ka një rezervë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të shumë shekujve dhe Prizreni me siguri është qyteti më i pasur sa i përket trashëgimisë kulturore. Prizreni ka qenë gjithnjë udhëkryq i kulturave dhe grupeve të ndryshme etnike. Gjatë tërë historisë, Shqiptarët, Boshnjakët, Turqit, Serbët, Goranët, Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët kanë jetuar bashkë në Prizren. Këto civilizime kanë lënë mbrapa një numër të konsiderueshëm të monumenteve sidomos nga koha e perandorisë Osmane, kur Prizreni është bërë qytet i rëndësishëm tregtar për shkak të pozicionit të tij strategjik.

Kosova ka një trashëgimi të begatshme arkitektonike dhe arkeologjike, që datojnë nga periudha Neolitike, koha Parahistorike, lashtësia Romake Mesjeta e hershme dhe e vonshme. Si në pjesën tjetër të Kosovës, ashtu edhe në Prizren trashëgimia kulturore mund të klasifikohet në tre grupe: Bizantine/Ortodokse, Monumente Islamike dhe arkitektura vendore (lokacionet tradicionale, tregjet dhe qendrat urbane historike) (Europa Nostra Forum 2006).

Islami ka pasur ndikim të madh në zhvillimin e kulturës Shqiptare sa që krijimtaria e saj letrare shprehej në gjuhën Turke, Arabe dhe Persishte në shekujt e parë të sundimit Osman. (Bieber, 2000). Në qendër të qytetit, në bregun e lumit Lumëbardhi, është organizuar Lidhja e Prizrenit si kuvend i përfaqësuesve të Shqiptarëve nga regjionet e banuara me Shqiptar. Sot kompleksi është Muze Kombëtar dhe ruan shumë dokumente që kanë të bëjnë me Lidhjen e Prizrenit.



Trashëgimia kulturore si nocion është relativisht i ri në Kosovë në krahasim me termin monument që definon objektet arkitektonike dhe arkeologjike si në aspektin e vlerave historike ashtu edhe në aspektin e vlerave kulturore.

Përpjekja e parë e identifikimit të trashëgimisë në Kosovë është bërë në vitin 1947, kur është shpallur për herë të parë Kosova si regjion. Prej këtij viti, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, ka bërë identifikime dhe studime të vazhdueshme. Këto studime kryesisht përqendrohen në monumente dhe objekte fetare, duke anashkaluar fatkeqësisht monumentet arkeologjike dhe monumentet kombëtare.

Viti 1947 është vit i rëndësishëm sa i përket trashëgimisë sepse në këtë vit është themeluar Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve që gjendej në shtëpinë e mëhershme të familjes Koqbashliu. Në vitin 1954 kjo ndërtesë i është dhënë Entit të sapoformuar të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

*Trashëgimia kulturore në Kosovë*

Trashëgimia kulturore dhe natyrore ka një rëndësi të madhe ekonomike, me mundësi të zhvillimit të turizmit që është një faktor kyç për zhvillimin e vendit dhe të rajonit, njëkohësisht konsiderohet potencial për zhvillime dhe integrim të qëndrueshëm shoqëror ekonomik, në vend, rajon dhe me gjerë. Objektet dhe tërësitë e trashëgimisë kulturore datojnë nga periudha të ndryshme kohore dhe paraqesin identitetin e popujve që kanë jetuar në Kosovë. Momentalisht nuk kemi pasqyrë reale të gjendjes së objekteve dhe tërësive me trashëgimi kulturore, në mungesë të inventarizimit, shumë tërësi dhe objekte i janë nënshtruar rrezikut të dëmtimit por edhe të zhdukjes në tërësi. (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$).

Kushtet e objekteve dhe komplekseve të trashëgimisë kulturore janë paraqitur në Figurën 1.9. Shënimet e deritashme tregojnë vetëm për objektet dhe tërësitë në pjesën jug-perëndimore të Kosovës, ndërkohë që për pjesët tjera shënimet janë minimale. Disa nga këto zona dhe objekte apo monumente të trashëgimisë kulturore kanë status të mbrojtjes, deri në vitin 1982. Me rrathë janë të paraqitura zonat me numër më të madh të tyre. Situata rreth këtyre përmbajtjeve është alarmante, një pjesë e madhe e tyre i janë nënshtruar rrezikut nga zhdukja e tërësishme. Vetëm disa iniciativa të pakta të ndërmarra nga bashkëpunimi publiko- privat po ngjallin ndjenjën për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Fluksi i madh i ndërtimeve të pakontrolluara i ka mbuluar këto përmbajtje, dhe po i rrezikon zhdukjen e objekteve me vlera të mëdha të trashëgimisë. Në Prishtinë është i vogël numri i objekteve që dëshmojnë të kaluarën e qytetit, edhe ato pak objekte ekzistuese janë të ngulfatur nga ndërtimet dhe zhvillimet që po ndodhin përreth tyre (Plani Hapësinor i Kosovës2010-2020$^{+}$).



Përkujdesja në promovimin edukativ të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, mundëson zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e tokës kualitative bujqësore dhe promovimit të prodhimeve kualitative vendore, mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të resurseve minerale dhe kontrollit të rritjes së vendbanimeve.

*Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Prizren*

Enti për mbrojtjen e monumenteve ka inventarizuar gjithsej 291 monumente kulturore në Komunë e Prizrenit. Qyteti ka më së shumti monumente dhe lokacione që përfaqësojnë sfondin historik të territorit të saj.

Enti për mbrojtjen e monumenteve ka inventarizuar gjithsej 291 monumente kulturore në Komunë e Prizrenit. Qyteti ka më së shumti monumente dhe lokacione që përfaqësojnë sfondin historik të territorit të saj.

Kalaja e Prizrenit është lokacioni më i rëndësishëm arkeologjik në Komunë dhe përcakton karakteristikat monumentale të Prizrenit sidomos nga shekujt 11-14.

Në fshatin Romajë dhe Kushnin ndodhen grumbuj gurësh që datojnë nga periudha parahistorike. Edhe në fshatin Korishë, Nashec dhe Vlashnje gjenden mbetjet arkeologjike të fortifikatave. Numri i përgjithshëm i lokacioneve arkeologjike në Prizren është 24 dhe ato paraqesin shembujt e monumenteve antike dhe trashëgimisë arkeologjike që datojnë nga shekulli 1 deri në shekullin 14 të erës sonë.




*Plani Hapësinor i Kosovës* 2010-2020+

**Figura 1.9:** Trashëgimia Kulturore në Kosovë





*Prill 2009*

**Figura 1.10:** Prizreni dhe Kalaja

Sipas klasifikimit të monumenteve arkitektonike, në Komunën e Prizrenit ndodhen 50 objekte publike që shfrytëzohen ose janë pronë publike shtetërore e Komunës së Prizrenit. (Tabela 1.14). Këtu hyjnë 5 objekte arsimore, 3 objekte të ambasadave, dhe një objekt shëndetësor që njihen si monumente arkitektonike në Prizren. Objektet tjera publike përfshijnë mullinjtë, krojet publike dhe objektet administrative. Si monumente të trashëgimisë industriale janë regjistruar edhe hidrocentrali dhe fabrika e lëkurës, me vlerë arkitektonike ndërtesa e vjetër e postës dhe ura e gurit në qendër të qytetit. Në pjesën rurale të Komunës së Prizrenit, ka 24 objekte të listuara civile si shembuj të trashëgimisë rurale si burime, mullinj dhe kulla. Qyteti i Prizrenit ka 66 objekte civile që shfaqin karakteristika tradicionale arkitektonike që

shfrytëzohen nga banorët e saj, pos këtyre objekteve civile janë edhe 14 të tjera që ndodhen në fshatrat e Prizrenit ku gjithsej numri i objekteve të mbrojtura civile është 80 (Tabela 1.15 dhe Harta 1.20).

Të gjitha lokacionet urbane dhe komplekset që janë regjistruar si tërësi e objekteve ndodhen në qytetin e Prizrenit. Thelbi i zonës së mbrojtur urbane të Prizrenit, që ka planin e konservimit (e përfunduar më 2007 dhe aprovuar më 2008) ka lokacione të ndryshme në listën e saj si p.sh. Muzeu i Lidhjes së Prizrenit, Sheshi i Shatërvanit dhe rrethi i ngushtë, Marashi dhe kompleksi i Nënkalasë. Duhet cekur edhe lokacionet tjera urbane te mbrojtura si kompleksi i Karabashit, i gjimnazit Gjon Buzuku, dhe kompleksi i teqesë Dervish Sinani. Kufijtë e Qendrës Historike të Prizrenit, janë ndryshuar për shkak të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr. 04/L-066/2012) qëllimi i së cilës është krijimi dhe menaxhimi i Qendrës Historike të Prizrenit (Harta 1.21).

**Tabela 1.14** Inventari i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit

| Nr. | Objekti | Prizren | Theranda | Sharri | Rahoveci | Malisheva | Shtime | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Xhami | 46 | 9 | 25 | 11 | 5 | 11 | 107 |
| 2. | Namazxhah | 1 | | 1 | | | | 2 |
| 3. | Medrese | 6 | | | | | | 6 |
| 4. | Ruzhdije | 1 | | | | | | 1 |
| 5. | Bibliotekë | 1 | | | | | | 1 |
| 6. | Nishan | 2 | | | | | | 2 |
| 7. | Teqe | 12 | | | 3 | | | 15 |
| 8. | Tyrbe | 19 | 2 | 6 | 2 | 1 | 1 | 31 |
| 9. | Kisha ortodokse | 36 | 7 | | 14 | | 1 | 58 |
| 10. | Manastire | 2 | 1 | | | | | 3 |
| 11. | Kisha katolike | 5 | 1 | | | 1 | | 7 |
| 12. | Varreza | 5 | | | | | | 5 |
| 13. | Ark. e banimit | 118 | 27 | 47 | 33 | 23 | 7 | 255 |
| 14. | Objektet publike | 41 | 3 | 2 | 6 | 2 | 2 | 56 |
| 15. | Mulli | 4 | 7 | 7 | | 8 | 6 | 32 |
| 16. | Valavicë | | | 1 | | | | 1 |
| 17. | Hambar | 1 | | | | 2 | 1 | 4 |
| 18. | Lok. Arkeologjike | 30 | 34 | 8 | 28 | 27 | 6 | 133 |
| | Gjithsej: | 330 | 91 | 97 | 97 | 69 | 35 | 719 |




**Harta 1.20:** Objektet e Trashëgimisë Kulturore në Prizren

75




**Harta 1.21.** Kufijtë e Qendrës Historike të Prizrenit në përputhje me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr. 04/L-066/2012)

**Tabela 1.15:** Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore në Prizren

| | Objektet civile | Objektet publike | Objektet fetare | Komplekset dhe zonat urbane | Lokacionet arkeologjike | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 66 | 26 | 44 | 7 | 2 | 145 |
| Fshatrat | 14 | 24 | 86 | 0 | 22 | 146 |
| Totali | 80 | 50 | 130 | 7 | 24 | 291 |

Nga të gjitha objektet fetare, në qytetin e Prizrenit gjenden 44 monumente fetare. Ku 6 nga ato monumente gjenden në Kabash dhe 5 në Lubizhdë. Sa i përket monumenteve fetare islame, Prizreni ka 55 xhami, 15 tyrbe dhe 8 teqe. Nga të gjitha, 20 xhami, 5 teqe, dhe 7 tyrbe gjinden në Qytetin e Prizrenit. Nga xhamitë më të njohura janë Xhamia e Sinan Pashës (1615), Xhamia Gazi Mehmet Pasha (1573), Xhamia Emin Pasha etj. Xhamia e Arastës është shkatërruar dhe nga ajo ka mbetur vetëm minarja që gjendet përballë Hotelit Theranda.



*Plani për konservimin dhe zhvillimin e zonës historike të Prizrenit, 2008*

**Figura 1.11:** Hamami Gazi Mehmet Pasha dhe rrethina e saj






*Prill 2009*

**Figura 1.12:** Xhamia e Sinan Pashës

Sa i përket monumenteve fetare krishtere, Enti për Mbrojtjen e Monumenteve ka të regjistruar 47 kisha dhe 4 manastire prej nga 39 kisha gjenden në qytetin e Prizrenit. Kisha e Shën Premtes, Manastiri i Shën Gabrielit dhe Kisha Bogorodica Ljevishka (Shën Premtes) janë vetëm disa nga to.



*Prill 2009*

**Figura 1.13:** Kisha e Shën Premtes



*Prill 2009*

**Figura 1.14:** Kisha e Shën Shpëtimtarit



*Prill 2009*

**Figura 1.15:** Katedralja e Shën Gjonit



KEP (Programi Kosovar për Ndërmarrje) ka filluar si një projekt i organizatës ndërkombëtare ICMC (International Catholic Migration Center), që u licencua nga Autoriteti i Pagesave Bankare në Kosovë (Bank Payment in Kosovo) si një agjenci financiare. Në vitin 1999, projekti KEP-i i ICMC operonte me anë të dy degëve, me një kapital qarkullues prej 180.000 euro. Në atë kohë kishte të punësuar vetëm 18 persona. KEP-i ka një zyrë kryesore në Prishtinë dhe dy degë në Pejë e Prizren. Ndërsa ka hapur edhe nëndegët e tjera në Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan dhe Dragash. KEP-i jep kredi komerciale, dhe konsulenca ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), grupeve solidare nëpër fshatra e qytete, si dhe individëve. Kreditë jepen në kushte pothuaj të njëjta me ato të FINCA (Profili Komunal i Prizrenit, 2007).

Aktivitetet tjera shërbyese

Në sektorin ekonomik të Prizrenit, janë aktive disa shoqata dhe institucione që merren me veprimtari në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, të cilat janë: Klubi i Afaristëve të Prizrenit, Shoqata e Zejtarëve, Shoqata e biznesmenëve boshnjakë “Sofra”, Oda Ekonomike. Në vazhdim japim disa të dhëna më të rëndësishme për këto shoqata.

Klubi i Afaristëve të Prizrenit,

Ky klub u formua në korrik të vitit 1991 me iniciativën e rreth 60 ndërmarrjeve private. Në vitin 1993 pushoi së funksionuari si rezultat i masave të dhunshme të qeverisë serbe, dhe në vitin 1997 u riorganizua në kuadër të Shoqatës së Afaristëve të Kosovës-Dega në Prizren. Pas luftës së vitit 1999, Klubi i Afaristëve të Prizrenit u regjistrua nga UNMIK-u Si një OJQ më vete me 30 anëtarë si themeluesit e saj. Sot kjo shoqatë ka 80 anëtarë. Aktiviteti i saj bazohet në kontributet e anëtarëve të vet si dhe projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm. Në vitin 2002 me ndihmën e Agjencisë Regjionale të Ndërmarrësisë në Prizren (Projekt i Bashkimit Evropian), krijoi një qendër këshillimore për asistencë dhe nxitje të veprimtarisë së Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NVM), këshillime për biznese fillestare, shkëmbim informacioni lidhur me tregjet, institucionet kreditore financiare, kornizat ligjore në fuqi lidhur me bizneset, etj.

Aktivitetet kryesore të Klubi i Afaristëve të Prizrenit deri më sot janë:

- Disa seminare për biznesmenë ku ka prezantuar mundësitë që ekzistojnë për dhënie kredish nga institucione vetë financiare si bankat dhe organizatat e përmendura më lart;
- Trajnime të ndryshme lidhur me NVM dhe menaxhimin e një biznesi (‘hartimi i planeve të bizneseve, marketingu, llogari mbajtja, etj.);
- Organizimi i panairit në Slloveni për anëtarët e vetë biznesmenë; si dhe dy panaire të tjera në Gjakovë e Prishtinë;
- Hartimi i strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal (Programi i Bankës Botërore DELTA ) për komunën e Prizrenit;
- Një numër të madh trajnimesh të organizuara së bashku me OJQ të tjera që përfaqësojnë shoqërinë civile në Prizren e më gjerë;
- Sponsorizuar edhe shumë aktivitete kulturore e sportive në komunën e Prizrenit si dhe është një ndër aksionarët kryesorë të TV- Prizrenit.



Shoqata e zejtarëve

Kjo shoqatë është themeluar në vitin 1946 si iniciativë vendore. U krijua me qëllim të mbështetjes se veprimtarisë së zejtarëve dhe mbrojtjes juridike dhe interesave të zejtarëve. Ka pasur dhe ruan statusin e një organizate joqeveritare (jo profitabile). Deri në vitet 90-ta ka bashkëpunuar me Kuvendin Komunal (1% të vlerës së përgjithshme të tatimeve Komuna i mblidhte nëpërmjet zejtarëve vendas). Shoqata ka pasur bashkëpunim me ICMC (programi KEP), në rolin e ndërmjetësuesit dhe garantuesit për dhënien e kredive rreth 150 zejtarëve Prizrenas. Kohët e fundit është krijuar një konsorcium i tri shoqatave të Prizrenit me përbërje multietnike, përkatësisht “Zejtarët” (shoqatë shqiptare), “Esnaf” (turke) dhe “Sofra” (boshnjakë).

Shoqata e biznesmenëve boshnjakë “Sofra”

Është një shoqatë e themeluar nga biznesmenë boshnjakë. Ka për qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik, në veçanti në fushën e ndërtimtarisë. Është themeluar në vitin 2000 me seli në Prizren. Ka anëtarë intelektualë të profileve të ndryshme si avokatë, juristë, ekonomistë, inxhinierë të ndërtimtarisë, elektronikës, arkitektë si dhe biznesmenë. Aktivitetet janë të shumëllojshme si:

- Në bashkëpunim me disa firma ndërtimore të specializuara organizon dhe përgatit dokumente tenderësh për ndërtim objektesh të ndryshme, si dhe kur fiton këto tenderë i zbaton së bashku punimet nën menaxhimin e “Sofrës”.
- Organizon seminare për anëtarët e vet në drejtim të menaxhimit të bizneseve, kontabiliteti i ndërmarrjeve, etj.
- Shpërndan informacion për ligjet në fuqi në Kosovë lidhur me zhvillimin e aktiviteteve të bizneseve të ndryshme prodhuese, tregtare, shërbyese, etj. sipas nevojave të anëtarëve të vet.
- Ofron qasje për internet anëtarëve të vet (uebsajti:).
- Ka participuar në aksione humanitare dhe seminare të zhvilluara në nivel të Kosovës për menaxhimin, avokimin, barazia gjinore, kontabiliteti dhe kontrolli financiar (auditim).
- Bashkëpunon me shoqatat e tjera të Zejtarëve dhe Esnafëve

Oda Ekonomike



Oda Ekonomike e Kosovës për momentin është i vetmi institucion shtetëror që lufton për interesat e tregtarëve afaristë. Oda Ekonomike ka selinë e vet në Prishtinë, ndërsa në Prizren ka një degë. Aktiviteti i këtij institucioni në nivel lokal është për momentin shumë i kufizuar. Oda ka organizuar trajnime për biznesmenët me mbështetjen e Agjencisë Evropiane, ATK-në dhe BPK-në. Ka organizuar vizita të afaristëve të huaj nëpërmjet dhomave të tregtisë, Malajzisë, Kroacisë dhe Italisë. Një ndër prioritetet e Odës së Prizrenit është forcimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit ndërkufitar, me Shqipërinë dhe Maqedoninë, si dhe shtetet e tjera të rajonit si Slloveni, Kroaci. etj.

Qendra Rajonale e Ndërmarrësisë (QRN)

Qendra Rajonale e Ndërrmarrësisë (Regional Enterprise Agency), ka filluar aktivitetin në vitin 2000, si një projekt i Bashkësisë Evropiane për të mbështetur zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme në rajonin e Prizrenit. Në vitin 2002, QRN u regjistrua si një organizatë joqeveritare. Kjo OJQ synon të jetë partner kryesor i NVM, si dhe grupeve ekonomike-sociale të cenuara për futjen e tyre në rrjedhat kryesore të zhvillimit ekonomik lokal. Shërbimet kryesore që ofron qendra: trajnimet në tema të ndryshme si: menaxhimi i biznesit të vogël, menaxhimi financiar, marketingu, përgatitja e planit të bizneseve dhe trajnime të tjera që bëhen në bazë të kërkesave të klientëve (Profili Komunal i Prizrenit).

## 1.2. Vlerësimi i gjendjes në Komunë

Pjesa e dytë e këtij raporti është vlerësimi i gjendjes së Komunës. Vlerësimi përfshin një vlerësim në detaje të çdo regjioni gjeografik, Regjionet gjeografike janë: Prizreni, Zhupa, Luma, Anadrini, Hasi, Kabashi dhe Vërrini (Figura 1.21). Vlerësimi përfshin mundësitë dhe sfidat duke marrë parasysh strukturën natyrore, strukturën fizike, strukturën socio-ekonomike. Përveç këtyre të dhënave të cilat janë përfshi në vlerësim, këtu janë përfshi edhe analiza e lidhjeve ndërmjet çështjeve të ndryshme, politikave dhe programeve zhvillimore.




*PZHKP 2025 Vizita ne teren,Prill 2009*

**Figura 1.21:** Regjionet gjeografike të Komunës së Prizrenit

### 1.2.1. ANALIZA E PROFILIT DUKE U BAZUAR NË PËRPARËSITË, DOBËSITË, MUNDËSITË DHE KËRCËNIMET

#### 1.2.1.1. REGJIONI I ZHUPËS

Regjioni i Zhupës ndodhet në juglindje të Prizrenit përgjatë luginës së lumit Lumëbardhit. Ajo përbëhet nga 13 fshatra ku fshati Reçan dhe Mushnikova janë qendra administrative (Figura 1.22). Fshatrat tjerë janë Drajçiqi, Gornjasella, Lubinja e Epërme, Lubinja e Poshtme, Llokvica, Manastirica, Nëpërgoshti, Pllanjani, Srecka, Struzha dhe Zhivinjani.

Numri i banorëve është përafërsisht 10.000 banorë. Migrimi këtu ende vazhdon. Afro 8000 banorë banojnë jashtë vendit për shkak të luftës dhe konditave ekonomike. 50% e popullatës është ne moshën 20 – 30 vjet. Në Zhupë ka edhe fshatra të zbrazëta siç është Sredska (Figura 1.24).

Regjioni i Zhupës, është një regjion malor ku gjeografia e këtij regjioni ka një potencial të jashtëzakonshëm për blegtori, pylltari dhe zhvillim të turizmit ku këto potenciale mundësojnë zhvillimin ekonomik të këtij regjioni. Ekonomia e regjionit është kryesisht e bazuar në blegtori. Këtu hyn kultivimi i gjellëve, deleve dhe dhive si dhe bletaria. Turizmi është sektor sekondar dhe kjo kryesisht bëhet në Malet e Sharrit. Turizmi është një nga potencialet kryesore ku mund të zhvillohen turizmi dimëror dhe turizmi shëndetësor. Në këtë regjion ndodhet edhe Parku Nacional "Sharri" si një pasuri e rëndësishme natyrore dhe si potencial i rëndësishëm për turizëm. Në Reçanë gjenden restorantet më të mëdha që e shërbejnë tërë Prizrenin. (Figura 1.23).



Toka është shumë e pëlleshme dhe mund të rriten shumë lloje të frutave dhe perimeve. Ky regjion ka resurse të shumta natyrore e cila mund të shfrytëzohet në prodhimtari. Veç këtyre, Zhupa është e njohur me mjeshtrit e ndërtimit. TIKA është një nga ndihmësit kryesor për zhvillimin e blegtorisë. Edhe pse ka potencial të lartë për blegtori, aktivitete mbështetëse për pylltari dhe blegtori, papunësia mbetet një nga problemet kyçe të regjionit. Për shembull, në Reçan punojnë vetëm 20% nga 1300 banorët e saj. Banorët kryesisht varen nga të hyrat e kushërinjve që punojnë jashtë vendit. Pra, Zhupa ka potencial, por mungojnë infrastruktura dhe investimet për prodhimtari. Aktivitetet e prodhimtarisë janë vetëm për nevojat e veta familjare.

Vizitat dhe analizat tregojnë se nuk ka ndonjë problem të theksuar sa i përket objekteve urbane. Çdo fshat ka shkollë fillore dhe ambulantë. Por në përgjithësi shërbimet shëndetësore ofrohen dy herë në javë. Fshatrat qendrore, Reçani dhe Mushnikova kanë shkolla të mesme. Mirëpo nxënësit për shkollim të lartë duhet të shkojnë në Prizren apo në vende tjera. Megjithatë, vërehet mungesa e objekteve shoqërore, por në krahasim me

regjionet tjera është një ndër regjionet e favorshme sa i përket objekteve sociale dhe kulturore. Përpjekje të mëdha janë duke u bërë nga grupet lokale të shoqërisë civile, megjithatë ato nuk janë të mjaftueshme.

Problemi parësor në regjionin e Zhupës është transporti dhe infrastruktura. Edhe pse secili fshat ka rrugë, rrjeti rrugor nuk është cilësor. Problemi i transportit sidomos vërehet në fshatrat malore siç është Manastirica (Figura 1.25). Kjo ndikon edhe në zhvillim të turizmit dhe të blegtorisë. Shumica e fshatrave malore nuk kanë qasje të plotë në tokat e tyre malore.

Po ashtu duhet përmendur problemet e furnizimit me ujë, kanalizimin, menaxhimin e plehut dhe aktiviteteve riparuese (Figura 1.26). Ekziston sistemi i kanalizimit, por regjioni nuk ka një objekt për trajtimin e ujërave të kanalizimit. Shfrytëzimi i lumit për largimin e ujërave të zeza (kanalizimit) është një problem i rëndësishëm mjedisor që rezulton në degradimin e saj. Infrastruktura jo e volitshme po ashtu rezulton në rrezikun nga vërshimet në fshatrat përgjatë lumit, si p.sh në fshatin Lubinje e Epërme. Në fshatrat qendrore nuk ka problem me mbeturina, por fshatrat tjera ballafaqohen me mungesën e sistemit për menaxhim të mbeturinave. Në disa fshatra si në Nebregoshte fshatarët mundohen të zgjedhin problemin duke i hedhur mbeturinat në hyrje të fshatit (Figura 1.27). Lumenjtë në këtë regjion përballen me një kërcënim të ndotjes nga ujërat e zeza të kanalizimit pasi që ato shfrytëzohen për largim të ujërave të zeza.









*Vizita ne teren Prill 2009*

Figura 1.22: Regjioni i Zhupës dhe qendrat e saj: Reçani dhe Mushnikova



*Prill 2009*

**Figura 1.23:** Reçani, Regjioni i Zhupës



*Prill 2009*

**Figura 1.24:** Sredska



*Prill 2009*

**Figura 1.25:** Manastrica





*Prill 2009*

**Figura 1.26:** Infrastruktura e Reçanit



*Prill 2009*

**Figura 1.27:** Nepergoshti

**Tabela 1.78:** Regjioni i Zhupës – Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | — Ndotja e Mjedisit dhe degradimi i strukturës natyrore<br>+ Resurset natyrore |
| **Trashëgimia Natyrore** | — Ndotja e Mjedisit dhe degradimi i strukturës natyrore<br>+ E pasur me trashëgimi natyrore<br>+ Parku nacional Sharri dhe potencialet për turizmin dimëror |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | + Koncentrimi (përqendrimi) i objekteve urbane në fshatrat qendrore |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Lidhje të papërshtatshme rrugore dhe qasja në fshatra |
| **Trashëgimia Kulturore** | + Trashëgimi e pasur kulturore (30 objekte monumentale) |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | — Humbje e popullsisë bazuar hulumtimeve të PZHKP<br>+ Shkalla e ulët e popullsisë që jeton jashtë vendit<br>Shkalla e lartë e numrit të familjeve (2060; 16%)<br>+ Shkalla më e ulët e madhësisë së familjeve (mesatarja 4.22)<br>+ Diversiteti etnik (shumica Boshnjak)<br>+ Popullata e re (50% midis moshës 20-30)<br>+ Popullata e trajnuar dhe e kualifikuar<br>— Migrim-jashtë |
| **Profili i Punës** | + Punësimi ekzistues industrial (20; 7%)<br>+ Punësimi ekzistues në shërbime publike (73; 8%) |
| **Infrastruktura Sociale** | + 1 Qendër e Mjekësisë Familjare<br>+ 6 Qendrat e kujdesit shëndetësor<br>+ 2 Shërbimet mobile shëndetësore<br>+ 4 Çerdhe<br>+ 10 Shkolla fillore<br>+ 1 Shkolla e mesme<br>+ 1 Qendra për arsimim publik<br>+ 2 Shtëpi kulturore<br>+ 1 Librari<br>— 0 Librari mobile<br>+ 10 Xhami<br>+ 1 Mesxhit<br>+ 4 Kisha<br>+ Çdo fshat ka shkollë fillore dhe objekte shëndetësore<br>+ Asnjë strukturë e nevojshme<br>— Shërbime të shëndetësisë maksimum 2 ditë në javë<br>— Mbështetja ekzistuese, por përkrahja joadekuate e OJQ-ve për shërbimet sociale<br>— Shërbimi i dobët arsimor |
| **Struktura ekonomike** | |
| **Bujqësia** | + Bujqësia |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | + Materiali ndërtimor, pije |
| **Tregtia** | + Tregti me pakicë |
| **Turizmi** | — Nuk ka turizëm |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | — Pa aktivitet financiar dhe të sigurimit |

### 1.2.1.2. REGJIONI I LUMËS

Regjioni i Lumës ndodhet në jugperëndim të Prizrenit. Drini i Bardhë paraqet kufirin verior të regjionit. Regjioni përbëhet nga shtatë fshatra me Zhurin si qendër administrative (Figura 1.28 dhe Figura 1.29). Fshatrat tjerë janë Dobrushti, Kobaj, Muradem, Shkoza, Vërmica dhe Vlashna. Për dallim nga regjioni i Zhupës, topografia e regjionit të Lumës është e rrafshët dhe e pasur me burime të ujit.







*Vizita ne teren Prill 2009*

**Figura 1.28:** Regjioni i Lumës dhe qendra e saj Zhuri





*Prill 2009*

**Figura 1.29:** Zhuri

Numri i banorëve në regjionin e Lumës është përafërsisht 15,000, dhe afër 10% prej tyre jetojnë jashtë vendit. Në këtë trevë kryesisht jetojnë shqiptarët.. Zhuri me 8000 banorë është fshati më i madh i Prizrenit dhe fshat qendror i regjionit. Edhe regjioni i Lumës vuan nga migrimi masiv i popullatës.

Bujqësia, blegtoria, peshkataria dhe akuakultura kanë qenë aktivitetet kryesore industrialë në këtë regjion. Mirëpo, qysh nga vitet e 70-ta, prodhimi është limituar në prodhimtarinë shtëpiake. Toka e pëlleshme dhe burimet e pasura ujore paraqesin potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë, sidomos të kultivimit të pemëve. Edhe kapaciteti për blegtori dhe peshkatari është i madh por mungon zhvillimi i organizuar në këto sektorë. Në veçanti në Vërmicë (Figura 1.30) dhe Vlashnje gjenden restorantet kryesore të peshkut që i kontribuojnë si prodhimtarisë ashtu edhe turizmit. Një nga aktivitetet e rëndësishme industriale është edhe eksploatimi i zhavorrit dhe rërës nga shtrati i lumit dhe gurëthyesve. (Figura 1.31).



*Prill 2009*

**Figura 1.30:** Vërmica



*Prill 2009*

**Figura 1.31:** Gurëthyesit në regjionin e Lumës



Si në regjionin e Zhupës ashtu edhe në regjionin e Lumës, nuk ka probleme me objekte urbane. Çdo fshat ka shkollën fillore dhe ambulantë, përfshirë këtu edhe qendrat e mjekësisë familjare. Zhuri ka edhe shkollë të mesme e cila shërben edhe fshatrave tjerë të regjionit. Ka përpjekje nga popullata për ofrimin e shërbimeve shoqërore por ato janë të pamjaftueshme. (Tabela 1.79).

Nuk ka ndonjë problem të theksuar me infrastrukturën urbane përveç me problematikën e infrastrukturës së sistemit të vaditjes. Edhe pse lumi Drini i Bardhë është një nga potencialet më të rëndësishme natyrore e regjionit të Lumës, ajo nuk ka të parandaluar problemet me furnizim me ujë. Kjo rezulton me kufizimin e prodhimtarisë bujqësore. Kohëve të fundit është realizuar një investim për furnizim me ujë të pijshëm në fshatin Zhur, ku i përgjigjet vetëm

nevojave të këtij fshati. Megjithatë, fshati Dobrusht i cili i përket këtij regjioni i nënshtrohet thatësisë gjatë gjysmës së vitit.

Ministria e Energjisë ka planifikuar një hidrocentral që do të rigjeneron potencialet e bujqësisë në regjionin e Vrrinit dhe Lumës (Figura 1.32). Fshati Poslisht (burrimi Gura), fshati vërmicë (burrimi i vërmicës) dhe burrimet e ujit në fshatin Billusha janë tri fshatra që do të gjenerojnë potenciale të ujit në regjionin e Vërrinit dhe më gjerë. Po ashtu ka edhe projekte madhore të investuara nga TIKA në rrjetin e ujësjellësit (Figura 1.32).



*Prill 2009*

**Figura 1.32:** Sipërfaqja e planifikuar për ndërtimin e hidrocentralit në regjionin e Lumës






*Prill 2009*

**Figura 1.33:** TIKA Projekti i ujësjellësit në Zhur

**Tabela 1.79:** Regjioni i Lumës – Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | — Humbja e tokës bujqësore |
| **Trashëgimia Natyrore** | |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | — Zhvillimi i paplanifikuar dhe i pakontrolluar urban<br>— Kërcënimi i vendbanimeve joformale tokës bujqësore<br>+ Koncentrimi (përqendrimi) i objekteve urbane në fshatrat qendrore<br>+ Aktivitetet tregtare në fshatra të vendosura në rrugët kryesore |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Lidhje të papërshtatshme rrugore dhe qasja në fshatra Investimet në energji dhe resurseve të ujit në Zhur |
| **Trashëgimia Kulturore** | |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | — Humbje e popullsisë bazuar hulumtimeve të PZHKP<br>— Shkalla e lartë e popullsisë që jeton jashtë vendit<br>+ Popullata e trajnuar dhe e kualifikuar<br>— Migrim-jashtë (10% jashtë vendit) |
| **Profili i Punës** | + Punësimi ekzistues industrial (15; 5%)<br>+ Punësimi ekzistues në shërbime publike (71; 7%) |
| **Infrastruktura Sociale** | + 1 Qendër e Mjekësisë Familjare<br>+ 1 Qendrat e kujdesit shëndetësor<br>— 0 Shërbimet mobile shëndetësore<br>— 0 Çerdhe<br>+ 6 Shkolla fillore<br>+ 1 Shkolla e mesme<br>— 0 Qendra për arsimim publik<br>— 0 Shtëpi kulturore<br>— 0 Librari<br>— 0 Librari mobile<br>+ 3 Xhami<br>+ Çdo fshat ka shkollë fillore dhe objekte shëndetësore<br>+ Asnjë strukturë e nevojshme<br>— Mbështetja ekzistuese, porë përkrahja joadekuate e OJQ-ve për shërbimet sociale |
| **Struktura ekonomike** | |
| **Bujqësia** | — Më pak aktivitete bujqësore |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | + Materiali ndërtimor për kanalizime |
| **Tregtia** | — Më pak aktivitete bujqësisë |
| **Turizmi** | — Nuk ka turizëm |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | — Pa aktivitet financiar dhe të sigurimit |

### 1.2.1.3. REGJIONI I KABASHIT

Regjioni i Kabashit ndodhet në lindje të Prizrenit. Regjioni ka marrë emrin nga malet e Kabashit. Regjioni përbëhet nga 8 fshatra. Lubizhda është qendra administrative e regjionit (Figura 1.34 dhe 1.35). Fshatrat tjera janë Dojnica, Korisha, Kabashi, Lubizhda, Lutogllava, Malesia e Re dhe Skorobishti.

Regjioni i Kabashit ka afro 13,000 banorë. Korisha, një nga fshatrat më të banuara të Prizrenit me 6000 banorë, ndodhet në këtë regjion (Figura 1.36).







*Vizita ne teren Prill 2009*



**Figura 1.34:** Regjioni i Kabashit dhe qendra e saj Lubizhda



*Prill 2009*

**Figura 1.35:** Lubizhda

Duke pasur parasysh potencialet gjeografike të maleve, ky rajon ka potencial të lartë për blegtori, prodhimin e produkteve ushqimore, pijeve dhe turizmit. Shfrytëzimi i lumenjve në largimin e ujërave të zeza është një problem i rëndësishëm mjedisor që rezulton në degradimin e mjedisit. Një ndër veçoritë e regjionit të Kabashit është rruga Prizren – Prishtinë. Përgjatë kësaj rruge ka objekte të cilat ushtrojnë aktivitete të vogla prodhuese dhe auto-mekanikëve. Përveç vendndodhjes së saj strategjike, mjedisi natyror i regjionit të Kabashit mundëson zhvillimin e prodhimtarisë në regjion. Mali i Kabashit ka një potencial të madh në zhvillimin e pylltarisë. Përveç kësaj, lumi Korisha me burimet e saja ujore siguron burim të madh për peshkim, akuakulturë (Figura 1.37) dhe prodhimin e pijeve. Prodhimi bujqësor ekziston, por ajo është e pamjaftueshme për të gjeneruar të ardhura në rajon, sepse toka bujqësore është e kufizuar. Ka iniciativë qeveritare që në këtë regjion të zhvillohet bujqësia. 60% e familjeve, sidomos në pjesët malore punojnë në blegtori. Shumica e familjeve marrin ndihmë financiare nga të afërmit e tyre që jetojnë jashtë vendit. Në rrafshinat e këtij regjioni në një përqindje të vogël zhvillohet edhe vreshtaria. Ndryshe nga regjionet tjera, këtu ka prodhimtari, e cila përfshin produktet e qumështit, dhe shitjen e produkteve ushqimore. Qendrat tregtare ndër ta si ABI, janë një ndër klientët.



*Prill 2009*

**Figura 1.36:** Korisha



*Prill2009*

**Figura 1.37:** Korisha



Ka një potencial të madh në zhvillimin e sektorit të ndërtimtarisë, pasi që fshatrat janë të specializuara në punët e ndërtimtarisë. Në afërsi të fshatit Korishë ka firma të mëdha të ndërtimtarisë. Regjioni i Kabashit në krahasim me regjionet tjera ka nivelin më të lartë të punësuar në sektorin e shërbimeve publike dhe nivelin e lart të punësuarve në industri.

Në rajon, ka edhe minierë kromi që ishte aktive gjatë viteve 1950-1970. Po ashtu, nga ana e Qeverisë ka investime të rëndësishëm në aktivitete teknologjike, është bërë planifikimi i ndërtimit të Parkut të Biznesit sipas projektit i cili ndodhet në mes të fshatit Lubizhdë dhe Korishë.

Vizita në teren dhe analizat tregojnë se nuk ka ndonjë problem madhor sa i përket objekteve urbane në këtë regjion. Çdo fshat ka shkollën fillore, shumica e fshatrave kanë shërbime shëndetësore apo shërbime të mjekësisë familjare dy herë në javë, Vetëm Korisha ofron shërbime shëndetësore çdo ditë. (Tabela 1.80).

Problemi parësor në regjionin e Kabashit është transporti dhe infrastruktura. Edhe pse secili fshat ka rrugë, rrjeti rrugor nuk është cilësor. Mali i Kabashit, si një nga resurset kryesore natyrore dhe fizike të regjionit, ka vetëm një rrugë e cila është në kushte të mjerueshme. (Figura 1.38). Rëndësia e këtij regjioni është se ai gjeneron lidhjen malore me Maqedoninë përmes Komunës së Suharekës dhe Komunës së Shtërpcës. Kjo gjithashtu ndikon në shfrytëzimin e resurseve natyrore për zhvillimin e turizmit malor. Sot këtu nuk jeton askush.

Po ashtu duhet përmendur problemet e furnizimit me ujë, kanalizimin, menaxhimin e mbeturinave dhe aktiviteteve riparuese. Ekziston sistemi i kanalizimit, por regjioni nuk ka një objekt për trajtimin e ujërave të kanalizimit. Shfrytëzimi i lumit për kanalizim është një problem i rëndësishëm mjedisor që rezulton në degradimin e saj. Pos kësaj, rrjeti i ujësjellësit është i vjetër 30 vjet dhe kjo është e pamjaftueshme për t’iu përgjigj kërkesave të regjionit.





*Prill 2009*

**Figura 1.38:** Rruga për në Malin e Kabashit

**Tabela 1.80:** Regjioni i Kabashit – Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | — Humbja e tokës bujqësore<br>— Ndotja e lumenjve<br>+ Resurset ujore për peshkim dhe akuakulturë |
| **Trashëgimia Natyrore** | |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | — Zhvillimi i paplanifikuar dhe i pakontrolluar urban<br>— Kërcënimi i vendbanimeve joformale tokës bujqësore<br>+ Koncentrimi (përqendrimi) i objekteve urbane në fshatrat qendrore<br>+ Aktivitetet tregtare në fshatra të vendosura në rrugët kryesore |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Lidhje të papërshtatshme rrugore dhe qasja në fshatra |
| **Trashëgimia Kulturore** | — Pamjaftueshmëri e programeve e cila adreson trashëgiminë natyrore dhe kulturore<br>+ Trashëgimi e pasur kulturore (16 objekte religjioze monumentale) |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | + Shkalla e ulët e popullsisë që jeton jashtë vendit<br>+ Shkalla e ulët e madhësisë së familjeve (mesatarja 5.57)<br>+ Popullata e trajnuar dhe e kualifikuar<br>— Migrim-jashtë |
| **Profili i Punës** | + Niveli i lartë i të punësuarve në industri (75; 25%)<br>+ Niveli i lartë i të punësuarve në shërbime publike (402; 41%) |
| **Infrastruktura Sociale** | + 1 Qendër e Mjekësisë Familjare<br>+ 2 Qendrat e kujdesit shëndetësor<br>— 0 Shërbimet mobile shëndetësore<br>+ 4 Çerdhe<br>+ 4 Shkolla fillore<br>— 0 Shkolla e mesme<br>— 0 Qendra për arsimim publik<br>— 0 Shtëpi kulturore<br>— 0 Librari<br>+ 1 Librari mobile<br>+ 3 Xhami<br>+ Çdo fshat ka shkollë fillore dhe objekte shëndetësore<br>— Shërbime të shëndetësisë maksimum 2 ditë në javë<br>— Shërbimi i dobët arsimor |
| **Struktura ekonomike** | |
| **Bujqësia** | S) Më pak aktivitete bujqësore |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | P) Servis të automjeteve, material ndërtimor, prodhimtaria e ushqimit, material ndërtimore për kanalizim |
| **Tregtia** | S) Më pak aktivitete tregtare |
| **Turizmi** | S) Nuk ka turizëm |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | S) Pa aktivitet financiar dhe të sigurimit |

### 1.2.1.4. REGJIONI I ANADRINISË

Regjioni i Anadrinisë ndodhet në veri të Prizrenit përgjatë rrafshinës së Prizrenit. Velezha dhe Pirana janë qendrat administrative (Figura 1.38). Fshatrat tjera janë Caparci, Krusha e Vogël, Landovica, Medveci, Novaka, Randobrava, Serbica e Epërme, Serbica e Poshtme, Smaqi, Shpinadia, Trepetnica dhe Zojzi. Mamusha rishtazi është shndërruar në Komunë dhe i mban të dhënat e veta. Regjioni i Anadrinisë ka afro 15,000 banorë. Migrimi është në vazhdim e sipër.







*PZHKP Vizita ne teren Prill 2009*

**Figura 1.39:** Regjioni i Anadrinisë dhe qendrat e saja Pirana, Mamusha dhe Velezha

Toka e regjionit të Anadrinisë është aq e pëlleshme sa që burimet kryesore të hyrave vijnë nga vreshtaria dhe kultivimi i bimëve shumë vjeçare (Figura 1.40). Por, familjet prapë së prapë varen nga ndihma financiare e të afërmve që jetojnë jashtë. Potencialet ekzistojnë, por mungon infrastruktura, sistemi i vaditjes apo investimet për prodhimtari. Një nga problemet kryesore të regjionit është papunësia. Për shembull, vetëm 10% nga 1200 banorë të Velezhës punojnë. Por në anën tjetër, statusi i tyre ekonomik është më i mirë në krahasim me regjionet tjera. Prodhimtaria e verës dhe rakisë është e kufizuar për nevojat e amvisërive. Në të kaluarën Krusha e Vogël ishte nikoqire e ndërmarrjes më të madhe për prodhimin e verës në Ballkan. Degradimi i tokës bujqësore pas luftës është faktori kryesore që ndikoi në prodhimtari. Një faktor tjetër është se vreshtat janë pronë e Komunës. Për shkak të vaditjes së pamjaftueshme, shihet një tendencë e prodhimit të patateve. Një problem tjetër i regjionit të Anadrinisë është shfrytëzimi i tokës bujqësore për vendbanime joformale (Figura 1.41). Në veçanti, ky regjion është i specializuar në punimet e filigranit. Shumica e mjeshtërve të filigranit sot jetojnë në Kroaci.



*Prill 2009*

**Figura 1.40:** Vreshtat afër Landovices



*Prill 2009*

**Figura 1.41:** Vendbanimet joformale ne fushën e Anadrinisë



Regjioni i Anadrinisë ka probleme të mëdha me objektet urbane. Pos Velezhës, shumica e fshatrave nuk kanë objekte arsimore dhe shëndetësore (Figura 1.42). Shërbimet mobile shëndetësore dhe libërbusi mobil janë tentime të rëndësishme për tejkalimin e këtyre problemeve.

Infrastruktura urbane është një nga problemet parësore. Duhet përmendur problemet e furnizimit me ujë, kanalizimin, menaxhimin e mbeturinave dhe aktiviteteve riparuese. Ekziston sistemi i kanalizimit, por regjioni nuk ka një objekt për trajtimin e ujërave të kanalizimit. Banorët marrin ujë nga bunarët qe i kanë ndërtuar vetë në kopshtet e tyre. Rrjeti i dobët i ujësjellës dhe sistemi i dobët i vaditjes rezultojnë në zhvillimin e dobët të vreshtarisë, që është potenciali më i madh i regjionit. Ka qenë një projekt i rëndësishëm i një OJQ-je, për marrjen e ujit nga fshati Novakë, megjithatë projekti është anuluar. Kohët e fundit komuna e Prizrenit ka përgatitur një projekt me vlerë prej 50,000 euro. Në fshatrat qendrore nuk ka

problem me grumbullimin e mbeturinave. Në Landovicë gjendet qendra për trajtimin e mbeturinave që është pronë private. (Figura 1.43).

Megjithatë, ky rajon përballet me ndotjen e mjedisit dhe degradimin e strukturës natyrore.

Komuna e Mamushës ka një rol të rëndësishëm në rajonin e Anadrinisë në investimet e infrastrukturës sociale dhe urbane.



*Prill 2009*

**Figura 1.42:** Velezha





*Prill 2009*

**Figura 1.43:** Deponia e mbeturinave në Landovicë

**Tabela 1.81:** Regjioni i Anadrinisë – Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | — Ndotja e mjedisit dhe degradimi i strukturës natyrore<br>+ Tokë pjellore bujqësore dhe burimet natyrore<br>+ Vreshtat |
| **Trashëgimia Natyrore** | — Ndotja e mjedisit dhe degradimi i strukturës natyrore |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | — Kërcënimi i vendbanimeve joformale tokës bujqësore<br>+ Koncentrimi (përqendrimi) i objekteve urbane në fshatrat qendrore |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Lidheje të papërshtatshme rrugore dhe qasja në fshatra<br>— Fshatrat me infrastrukturë teknike joadekuate |
| **Trashëgimia Kulturore** | + Trashëgimi e pasur kulturore (10 objekte religjioze monumentale) |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | + Densiteti i lartë (23.090, 20%)<br>Rritja e lartë e popullsisë<br>Shkalla e larët e numrit të familjeve (2323, 19%)<br>— Shkalla e larët e madhësisë së familjes (mesatare 8.84)<br>+ Diversiteti etnik ( shqiptarë katolik, shqiptarë myslimanë, serbë)<br>+ Popullata e trajnuar dhe e kualifikuar<br>— Migrim-jashtë |
| **Profili i Punës** | + Niveli i lartë i të punësuarve në industri (190; 63%)<br>+ Niveli i lartë i të punësuarve në shërbime publike (124; 41%) |
| **Infrastruktura Sociale** | + 1 Qendër e Mjekësisë Familjare<br>+ 1 Qendrat e kujdesit shëndetësor<br>+ 1 Shërbimet mobile shëndetësore<br>+ 5 Çerdhe<br>+ 12 Shkolla fillore<br>+ 2 Shkolla e mesme<br>+ 1 Qendra për arsimim publik<br>— 0 Shtëpi kulturore<br>+ 1 Librari<br>+ 1 Librari mobile<br>+ 5 Xhami<br>+ 4 Kisha<br>— Nuk ka qasje në shërbime të arsimit dhe shëndetësi në përjashtim të fshatit Velezh<br>— Shërbime të shëndetësisë mobile dhe bibliotekës mobile I pamjaftueshëm<br>— Shërbimi i dobët arsimor |
| **Struktura ekonomike** | |
| **Bujqësia** | + Aktivitete bujqësore, vreshtari, bletari |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | + Servis të automjeteve, material ndërtimor, prodhimtaria e ushqimit, material ndërtimore për kanalizim, argjendari |
| **Tregtia** | — Më pak aktivitete tregtare |
| **Turizmi** | — Nuk ka turizëm |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | — Pa aktivitet financiar dhe të sigurimit |

### 1.2.1.5. REGJIONI I HASIT

Regjioni i Hasit  është regjion malor në perëndim të Prizrenit. Ky regjion mbulon edhe Malet e Pashtrikut të cilat male konsiderohen të dytë me lartësi brenda kufijve të Komunës. Regjioni gjeografik i Hasit, përveç kufijve kombëtare dhe rajonale ajo gjeografikisht shtrihet edhe në Shqipëri. Brenda kufijve administrative të komunës së Prizrenit, regjioni i Hasit ka 16 fshatra të cilat janë: Dedaj, Gjonaj, Gorozhup, Kabashi i Hasit, Karashengjergji, Kojush, Krajku, Kushnini, Lubizhda e Hasit, Lukinaj, Mazreku, Milaj, Planeja, Romaja, Tupeci dhe fshati Zym. Fshatrat Gjonaj, Romaja dhe Zym janë qendrat administrative. (Figura 1.44).

Regjioni i Hasit ka afro 25,000 banorë ku 20% e këtij numri të banorëve jeton jashtë Kosovës. Gjonaj është fshati i tretë në Komunën e Prizrenit për kah madhësia me 5,300 banorë. Ekziston edhe një fshat i cili  është i zbrazët nuk ka banorë dhe fshat është fshati Milaj.






*Vizita ne teren Prill 2009*

**Figura 1.44:** Regjioni i Hasit dhe qendrat e saj: Romaja, Zym dhe Gjonaj

Banorët e Hasit kryesisht varen nga të hyrat e të afërmve që jetojnë jashtë. Regjioni i Hasit është i njohur me mjeshtërinë e bukëpjekësve. Shumica e familjeve (hasjanëve) që punojnë jashtë, punojnë në këtë sektor. Struktura gjeografike e rajonit ofron potenciale në aktivitetet tjera ekonomike që përfshinë bujqësinë dhe blegtorinë. Mirëpo Hasi është një regjion, ku prodhimtaria është e kufizuar në vetë-prodhim për shkak të mungesës së sistemit të vaditjes. Për më tepër, pjesa më e madhe e tokës është degraduar për shkak të eksploatimit jo formal të zhavorrit përgjatë lumenjve (Figura 1.45). Në pjesët malore të regjionit ka potencial për zhvillimin e pylltarisë.



*Prill 2009*

**Figura 1.45:** Eksploatimi i zhavorrit në Gjonaj

Objektet urbane janë të përqendruara në fshatrat qendrore dhe pasi që në këtë rajoni i Hasit ka tri fshatra qendrore, objektet urbane paraqesin një shpërndarje relativisht të ekuilibruar. Lidhur me arsimim, regjioni i Hasit nuk ka ndonjë problem të veçantë me shkolla. Janë tre shkolla të mesme në regjion dhe secili fshat pos fshatit Milaj, Kojush dhe Karashëngjergj kanë shkollat e tyre fillore. Por shërbimet shëndetësore paraqesin problem të madh. Në shumicën e fshatrave nuk ka shërbime shëndetësore (ambulantë). Fshatrat që kanë qendra shëndetësore ofrojnë këto shërbime një ose dy herë në javë.

Infrastruktura urbane në Regjionin e Hasit duke përfshirë ujësjellësin, kanalizimin, menaxhimi i plehut, elektriciteti paraqesin problem të madh për këtë rajon. Në pjesët malore të regjionit, fshatarët furnizohen me ujë nga burimet ndërsa në pjesën e rrafshët nuk janë të rralla thatësirat sidomos në stinën e verës. Një problem tjetër është transporti. Sidomos rrugët e brendshme janë në gjendje të keqe. Për shkak të aktiviteteve joformale të eksploatimit të zhavorrit paraqitet rreziku i erozionit. (Tabela 1.82).





*Prill 2009*

**Figura 1.46:** Zymi

**Tabela 1.82:** Regjioni i Hasit – Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | — Ndotja e mjedisit dhe degradimi i strukturës natyrore<br>+ Tokë pjellore bujqësore dhe burimet natyrore |
| **Trashëgimia Natyrore** | |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | — Kërcënimi i vendbanimeve joformale tokës bujqësore<br>+ Koncentrimi (përqendrimi) i objekteve urbane në fshatrat qendrore |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Lidhje të papërshtatshme rrugore dhe qasja në fshatra<br>— Fshatrat me infrastrukturë teknike joadekuate |
| **Trashëgimia Kulturore** | — Pamjaftueshmëri e programeve e cila adreson trashëgiminë natyrore dhe kulturore<br>+ Trashëgimi e pasur kulturore (30 objekte monumentale dhe 9 lokacione arkeologjike) |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | — Humbje e popullsisë bazuar hulumtimeve të PZHKP<br>+ Rritja e lartë e popullsisë (26,460; 23%)<br>— Shkalla e ulët e madhësisë së familjeve (mesatarja 9.68)<br>+ Popullata e trajnuar dhe e kualifikuar<br>— Migrim-jashtë (20% jashtë vendit) |
| **Profili i Punës** | — Mungesa e punësimit industrial<br>+ Punësimi ekzistues në shërbime publike (89; 9%) |
| **Infrastruktura Sociale** | + 2 Qendër e Mjekësisë Familjare<br>+ 3 Qendrat e kujdesit shëndetësor<br>+ 1 Shërbimet mobile shëndetësore<br>— 0 Çerdhe<br>+ 14 Shkolla fillore<br>+ 3 Shkolla e mesme<br>— 0 Qendra për arsimim publik<br>+ 2 Shtëpi kulturore<br>+ 2 Librari<br>— 0 Librari mobile<br>+ 2 Xhami<br>+ 9 Teqe<br>+ 2 Kisha<br>— Mungesë e Shërbime e shërbimeve shëndetësore në shumicën e fshatrave; Mjek në dispozicion 1- 2 ditë në javë në objektet ekzistuese shëndetësore<br>— Shërbimi i dobët arsimor |
| **Struktura ekonomike** | |
| **Bujqësia** | P) Aktivitete bujqësore |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | S) Nuk ka prodhimtari |
| **Tregtia** | S) Më pak aktivitete tregtare |
| **Turizmi** | S) Nuk ka turizëm |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | S) Pa aktivitet financiar dhe të sigurimit |

### 1.2.1.6. REGJIONI I VËRRINIT

Regjioni i Vërrinit ndodhet në jug të Prizrenit përgjatë Komunës së Dragashit dhe ka strukturë malore. Ky regjion ka 8 fshatra ku Hoça e Qytetit është qendër administrative (Fig 1.47 dhe 1.48). Fshatrat tjera janë Poslishti, Jeshkova, Leskoveci, Lezi, Bilusha, Lybeqeva dhe Kushtendili. Lezi dhe Kushtendil janë fshatra të zbrazëta.

Regjioni i Vërrinit ka një popullatë prej 12,000 banorëve, prej të cilëve 25% jetojnë jashtë vendit.







*Vizita ne teren Prill 2009*



**Figura 1.47:** Regjioni i Vërrinit dhe qendra e saj Hoça e Qytetit



*Prill 2009*

**Figura 1.48:** Regjioni i Vërrinit

Ekonomia e këtij regjioni është bazuar në prodhimtari bujqësore. Produktet bujqësore i përmbushin kërkesat e komunës së Dragashit dhe qytetit të Prizrenit. Një pjesë e vogël e

popullatës merret me blegtori. Mirëpo për mungesë të tregut, prodhimtaria është vetëm për nevoja personale. Bletaria është një aktivitet i rëndësishëm në Lubeqevë. Një sektor tjetër i rëndësishëm i këtij regjioni është edhe pylltaria. Mirëpo për shkak të prerjes ilegale të drunjve, shihet një rrezik serioz i humbjes së pyjeve. Regjioni ka potencial për zhvillimin e serave. Fshati Poslisht ka filluar të shfrytëzojë këtë mundësi. Në këtë regjion ndodhen tre ndërmarrje të specializuara për prodhimin e produkteve të betonit.

Sa i përket objekteve urbane, çdo fshat pos Leskovecit ka shkollë fillore. Regjioni nuk ka shkollë të lartë. Edhe pse ka qendra të mjekësisë familjare, nuk ka stabilitet të ofrimit të shërbimit shëndetësor.

Arsyeja kryesore për strukturë të pa volitshme urbane është vetë gjeografia e Regjionit të Vërrinit. Rrjeti rrugor është aq i dëmtuar sa që fshatarët nuk kanë qasje në tokat e tyre që gjenden në pjesët malore të regjionit. Po ashtu regjioni ballafaqohet me problemin e kanalizimit, rrymës elektrike, ujin e pijshëm dhe trajtimin e mbeturinave. Rrjeti i ujësjellësit është aq i vjetër sa që ka shkaktuar sëmundje epidemike. Momentalisht, nuk ekziston rrjeti i kanalizimit, për largimin e ujerave të zeza shfrytëzohen lumenjtë. Për shkak të shfrytëzimit të lumenjve për largimin e ujërave të zeza, ka një ndotje dhe degradim vital të mjedisit sidomos në verë kur ulet niveli i ujit (Tabela 1.83).



Ministria e Energjisë planifikon të ndërtojë një hidrocentral për regjionin e Lumës dhe Vërrinit që do të ringjallte potencialet bujqësore. Në fshatin Poslisht (burrimi Gura), fshati Vërmicë (burrimi i Vërmicës) dhe burrimet në fshatin Billusha janë tri fshatrat ku burojnë ujërat dhe janë potencialet e mëdha për furnizim me ujë të pishëm për regjionin e Vërrinit dhe regjionet e afërta.



*Prill 2009*

**Figura 1.49:** Hoça e Qytetit



*Prill 2009*

**Figura 1.50:** Poslishti

**Tabela 1.83:** Regjioni i Vërrinit– Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | + Vreshtaria<br>— Ndotja e mjedisit |
| **Trashëgimia Natyrore** | |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | + Koncentrimi (përqendrimi) i objekteve urbane në fshatrat qendrore |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Lidhje të papërshtatshme rrugore dhe qasja në fshatra |
| **Trashëgimia Kulturore** | — Pamjaftueshmëri e programeve e cila adreson trashëgiminë natyrore dhe kulturore<br>+ Trashëgimi e pasur kulturore (11 objekte religjioze monumentale) |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | — Humbje e popullsisë bazuar hulumtimeve të PZHKP<br>— Humbje e përgjithshme e popullsisë<br>+ Numër I vogël I popullatës që jeton jashtë vendit<br>+ Shkalla e ulët e numrit të familjeve (317; 4%)<br>+ Popullata e trajnuar dhe e kualifikuar<br>— Migrim-jashtë (25% jashtë vendit) |
| **Profili i Punës** | — Mungesa e punësimit industrial<br>+ Punësimi ekzistues në shërbime publike (65; 7%) |
| **Infrastruktura Sociale** | + 1 Qendër e Mjekësisë Familjare<br>+ 1 Qendrat e kujdesit shëndetësor<br>— 0 Shërbimet mobile shëndetësore<br>+ 1 Çerdhe<br>+ 6 Shkolla fillore<br>— 0 Shkolla e mesme<br>— 0 Qendra për arsimim publik<br>— 0 Shtëpi kulturore<br>— 0 Librari<br>— 0 Librari mobile<br>+ 5 Xhami<br>+ 9 Teqe<br>+ 2 Kisha<br>+ Çdo fshat ka shkollë fillore në përjashtim të fshatit Leskovec<br>— Mjek në dispozicion ndonjë ditë në javë në objektet shëndetësore<br>— Shërbimi i dobët arsimor |
| **Struktura ekonomike** | |
| **Bujqësia** | P) Aktivitete bujqësore, vreshtari, bletari |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | P) Materiale ndërtimore |
| **Tregtia** | S) Më pak aktivitete tregtare |
| **Turizmi** | S) Nuk ka turizëm |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | S) Pa aktivitet financiar dhe të sigurimit |

### 1.2.1.7. REGJIONI I PRIZRENIT

Regjioni i Prizrenit është pjesa qendrore e Komunës së Prizrenit, që ndodhet në fushën e Prizrenit e rrethuar me qytetin e Prizrenit. (Figura 1.51). Qyteti i Prizrenit si qendër urbane e komunës nuk është futur në vlerësimin e regjionit me qëllim që të analizohet karakteri i tij urban në veçanti.

Regjioni i Prizrenit shtrihet në pjesën qendrore të komunës, në tokat e pëlleshme të rrafshinës së Prizrenit. Struktura gjeografike e regjionit të Prizrenit është e rrafshët në pjesën veriore dhe perëndimore të saj, përderisa struktura gjeografike me karakter malorë vërehet në pjesën jugore dhe juglindore. Lumëbardhi rrjedh përgjatë regjionit. Klima Mediterane dhe kontinentale janë klimat e këtij regjioni.

Regjioni përbëhet nga 9 fshatra: Atmaxha, Gërnqari, Grazhdaniku, Jabllanica, Nasheci, Novosella, Petrovasella, Pousko dhe Vrbiçane. Edhe përkundër afërsisë me qytetin e Prizrenit, fshatrat e këtij regjioni nuk kanë karakteristika urbane. Për këtë arsye, qyteti i Prizrenit është përmendur si qendër urbane e Komunës ndërsa regjioni i Prizrenit me 9 fshatrat e përmendura është klasifikuar si një nga 7 regjione rurale sa ka në përgjithësi Komuna e Prizrenit.






*Vizita ne teren Prill 2009*

**Figura 1.51:** Prizreni

Në krahasim me ndarjen e regjioneve tjera, regjioni i Prizrenit është formuar vetëm në saje të lidhjeve administrative. Kufijtë e regjioneve tjera janë vendosur në bazë të modeleve të caktuara gjeografike dhe karakteristikave tjera të përbashkëta siç janë përkatësia kombëtare, resurset natyrore, përvoja profesionale, potencialet, problemet etj. Vlerësimi i regjionit të Prizrenit ka treguar që fshatrat kanë karakteristika me regjionet tjera më të afërta.

Numri i banorëve në pjesën rurale është përafërsisht 10,000 prej nga 30% jetojnë jashtë Kosovës. Fshati Vrbican nuk ka banorë. Diversiteti etnik i regjionit është një potencial në aspektin e strukturës sociale.

Në të gjitha fshatrat e regjionit ka aktivitete bujqësore dhe blegtorale. Një pjesë e madhe e popullatës jeton jashtë. Novosella është e njohur me resurset e saja profesionale për ndërtimtari si në disa fshatra të regjionit të Zhupës.

Në këtë regjion ka edhe potencial turistik. Në fshatin Nashec, mbizotëron si klima mediterane ashtu edhe ajo alpine (kontinentale) sepse fshati është në udhëkryq të këtyre dy klimave. Me këtë karakteristikë, fshati Nashec është atraktive për ata vizitor që kanë probleme me sëmundjen e mushkërive. Në fshatin Nashec, ekziston zhvillimi i banimit dytësor, respektivisht vikend shtëpizave (Figura 1.52). Në anën tjetër, fshati Novosella që ndodhet në 900m të lartësisë mbidetare është e njohur për ajër të pastër dhe potencialin e saj për turizëm dimëror.

Të gjitha fshatrat pos Grazhdanikut kanë shkolla fillore, por asnjë nga fshatrat nuk ka shkollë të mesme. Në Jabllanicë dhe Gërnçare gjenden qendrat e mjekësisë familjare ku ofrohet shërbimi shëndetësor në ditët e caktuara të javës, ndërsa Nasheci ka ekip mobil shëndetësor. Në fshatin Pousko ndodhet një bibliotekë ndërsa në Jabllanicë ndodhet shtëpia e Kulturës. Edhe pse fshatrat janë mjaft afër qytetit, nevoja për godina shëndetësore është prioritare. Regjioni i Prizrenit, nuk është i prekur nga përhapja e gjerë e zhvillimit të pakontrolluar të vendbanimeve në qytetin e Prizrenit. Arsyeja kryesore buron nga vet fakti i shpërbërjes hapësinore ndërmjet qendrës së qytetit dhe fshatrave përreth për shkak kufijve topografike të rajonit. Infrastruktura dhe transporti është problematik sikurse në fshatrat tjera të komunës. Në shumicën e fshatrave nuk ekziston rrjeti i kanalizimit ose rrjeti i kanalizimit shkarkohet direkt në natyrë. Vetëm fshati i Atmaxhës është i lidhur me rrjetin e kanalizimit të qytetit (Figura 1.53). Uji zakonisht merret nga rrjeti i ujësjellësit i Prizrenit dhe nuk paraqet ndonjë problem të veçantë pos reduktimeve në stinën e verës. Atmaxha dhe Petrovasella kanë grumbullim të rregullt të mbeturinave. Fshatrat tjera i gjuajnë mbeturinat në natyrë, jashtë vendbanimeve. (Tabela 1.84). 



*Prill 2009*

Figura 1.52: Ndërtimi sekondar në Nashec



*Prill 2009*

Figura 1.53: Atmaxha

**Tabela 1.84:** Regjioni i Prizrenit – Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | + Klima<br>+ Vreshtaria<br>+ Ajri i pastër në rrafshnalta<br>+ Vreshtaria<br>— Humbja e tokës bujqësore |
| **Trashëgimia Natyrore** | |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | — Kërcënimi I vendbanimeve joformale ndaj tokës bujqësore<br>+ Koncentrimi (përqendrimi) i objekteve urbane në fshatrat qendrore<br>+ Aktivitetet tregtare në fshatra të vendosura në rrugët kryesore |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Lidhje të papërshtatshme rrugore dhe qasja në fshatra |
| **Trashëgimia Kulturore** | — Pamjaftueshmëri e programeve e cila adreson trashëgiminë natyrore dhe kulturore<br>+ Trashëgimi e pasur kulturore (8 objekte religjioze monumentale) |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | + Numër i vogël i popullatës që jeton jashtë vendit<br>+ Diversiteti etnik (shumica boshnjakë)<br>+ Popullata e trajnuar dhe e kualifikuar<br>— Migrim-jashtë (30% jashtë vendit)<br>— Migrim në vazhdueshmëri në qytetin e Prizrenit |
| **Profili i Punës** | — Mungesa e punësimit industrial<br>+ Shkalla e lartë e punësimit në shërbime publike (146; 15%)<br>+ Burimet njerëzore profesionale |
| **Infrastruktura Sociale** | — 0 Qendër e Mjekësisë Familjare<br>+ 2 Qendrat e kujdesit shëndetësor<br>+1 Shërbimet mobile shëndetësore<br>— 0 Çerdhe<br>+ 7 Shkolla fillore<br>— 0 Shkolla e mesme<br>— 0 Qendra për arsimim publik<br>+1 Shtëpi kulturore<br>+1 Librari<br>— 0 Librari mobile<br>+ 5 Xhami<br>+ 1 Kisha<br>+ Çdo fshat ka shkollë fillore në përjashtim të fshatit Grazhdanik<br>— Mjek në dispozicion ndonjë ditë në javë në objektet shëndetësore<br>— Domosdoshmëria për institucione shëndetësore të emergjencës<br>— Shërbimi i dobët arsimor |
| **Struktura ekonomike** | |
| **Bujqësia** | P) Aktivitete bujqësore, vreshtari, bletari |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | P) Prodhimi I lëngjeve, Auto mekanik, Materiale ndërtimore, Metal Nikel |
| **Tregtia** | S) Më pak aktivitete tregtare |
| **Turizmi** | S) Nuk ka turizëm |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | S) Pa aktivitet financiar dhe të sigurimit |

### 1.2.1.8. QYTETI I PRIZRENIT

Qyteti i Prizrenit është qendra administrative e Komunës. Ajo gjendet në pjesën qendrore të komunës, në fushën e Prizrenit (Figura 1.53). Qyteti ka lartësi më të ulët (400 m) në mesin e të gjitha regjioneve të komunës. Lumëbardhi përgjatë luginës së Zhupës rrjedh në mes të qendrës së qytetit të Prizrenit.

Meqë nuk ka regjistrim zyrtar që nga viti 1991, popullata e Prizrenit bazohet në studimet e fundit të Zyrës Komunale për Komunitete të vitit 2009 e cila kalkulohet të jetë përafërsisht afro 150,000 banorë. Kjo popullatë është e shpërndarë në vendbanimet ilegale rrethuese në fushën e Prizrenit. Për shkak te kushteve ekonomike. Prizreni ballafaqohet me një migrim konstant nga pjesët rurale kah qendra.







*Vizita ne teren Prill 2009*

**Figura 1.54:** Qyteti i Prizrenit

Qyteti i Prizrenit dallon nga fshatrat e saj jo vetëm për nga historia por edhe nga tregtia, shërbimet dhe aktivitetet prodhuese. Qendra e qytetit (Shatërvani) karakterizohet me shërbime ndërsa aktivitetet prodhuese janë kryesisht në veri të lumit Lumëbardhi. Po ashtu Prizreni dallon nga fshatrat për shkak të aktiviteteve të sigurimit dhe ato financiare, shërbime këto që ofrohen vetëm në Prizren, në nivelin komunal.

Sa i përket infrastrukturës urbane, Prizreni ka objekte më moderne arsimore dhe shëndetësore. Spitali, shkollat e mesme dhe universiteti shpesh përdoren nga banorët e viseve rurale të Komunës. Mirëpo edhe Prizreni si qytet lëngon nga mungesa e objekteve kulturore dhe sociale. Duke e pasur parasysh rritjen e popullatës si dhe densitetin e saj, objektet ekzistuese kulturore dhe sociale nuk përmbushin nevojat e popullatës. Objektet ekzistuese urbane nuk i plotësojnë nevojat sociale të banorëve, në pikëpamje të popullsisë në rritje dhe dendësisë së popullsisë që është e dukshme nga numri në rritje i qendrave tregtare dhe aktivitetit të ndërtimit në zonat ku ato zhvillohen si qendra të banimit me dendësi të lartë.

Problemi i humbjes së tokës bujqësore për shkak të zgjerimit të pakontrolluar të vendbanimeve është më i theksuari në qytetin e Prizrenit në krahasim me regjionet tjera. Zgjerimi i vendbanimeve përgjatë aksit rrugor Prizren-Gjakovë dhe Prizren-Prishtinë është tregues i defektit në përgjigjet ndaj kërkesave të mëdha të krijuara nga migrimi sidomos në përudhen e pas luftës nga viset rurale krahas rritjes natyrore të popullatës (Figura 1.55). Në anën tjetër shohim stoqe të pashfrytëzuara të ndërtimeve siç janë fshatrat e zbrazëta që mund të përmbushin nevojat për vendbanime (Figura 1.56). Shumica e objekteve industriale janë ose të braktisura ose të shndërruara në depo (Figura 1.57). Objektet ekzistuese industriale të zbrazëta krijojnë një potencial për përdorime të shumta që mund të risin aktivitetin ekonomik.



*Prill 2009*

**Figura 1.55:** Ndërtimet e reja në qendrën e Prizrenit



*Prill 2009*

**Figura 1.56:** Stoqet e pashfrytëzuara te ndërtimit



Infrastruktura e tanishme rrugore në qendrën e qytetit nuk mund të përballojë rritjen e vazhdueshme të komunikacionit, rritjen e popullatës dhe shtimin e numrit të zonave ndërtimore. Qendra e qytetit është pastruar nga qarkullimi i automjeteve të mëdha dhe maunave, me ndërtimin e transitit nga KFOR-i. Edhe autostrada Morine-Merdarë (Shqipëri-Kosovë-Serbi) pritet të ndikojë në shkarkimin e trafikut të automjeteve në qytetin e Prizrenit.

Potencial kryesor i Prizrenit sa i përket trashëgimisë natyrore dhe kulturore është ndjeshmëria e administratës lokale dhe popullatës së Prizrenit (Figura 1.61). Plani për konservimin dhe zhvillimin e zonës historike të Prizrenit ofron garanci për mbrojtjen e trashëgimisë së pasur të qytetit. Mirëpo, zhvillimet që janë në kundërshtim me këtë plan, janë identifikuar si një nga problemet. (Figura 1.58) (Tabela 1.85).



*Prill 2009*

**Figura 1.57:** Godinat e pashfrytëzuara industriale



*Prill 2009*

**Figura 1.58:** Zhvillimi përkundër planit te konservimit



*Prill 2009*

**Figura 1.59:** Shfrytëzimi jo i rregullt i tokës



*Prill 2009*

**Figura 1.60:** Humbja e tokës bujqësore në fushën e Prizrenit



*Prill 2009*

**Figura 1.61:** Trashëgimia kulturore në Prizren

**Tabela 1.85:** Qyteti i Prizrenit – Struktura Fizike, Sociale dhe Struktura Ekonomike: Problemet dhe Potencialet (mundësitë)

| | |
|---|---|
| **Struktura Natyrore** | |
| **Struktura Natyrore dhe Resurset Mjedisore** | — Humbja e tokës bujqësore |
| **Trashëgimia Natyrore** | |
| **Struktura fizike** | |
| **Modeli i Shfrytëzimit të Tokës** | — Zhvillimi i paplanifikuar dhe i pakontrolluar urban<br>+ Stoqet e ndërtimit në qytetin e Prizrenit mundësojnë propozime të reja funksionale dhe të zbatueshme |
| **Transporti dhe Infrastruktura** | — Pamjaftueshmëria e rrjetit rrugor ekzistues ndaj kërkesës në rritje në qendër<br>+ Rruga transite e ndërtuar nga KFOR-i |
| **Trashëgimia Kulturore** | — Ndërtimet në kundërshtim me planin e konservimit<br>— Praktikat jo adekuate në konservimin dhe restaurimin e objekteve<br>+ Plani i mbrojtjes së zonës historike të Prizrenit – plani i konservimit dhe Plani zhvillimor<br>+ Trashëgimi e pasur kulturore |
| **Struktura Sociale** | |
| **Profili Demografik** | — Mbipopullimi për shkak të migrimit të madh |
| **Profili i Punës** | |
| **STRUKTURA EKONOMIKE** | |
| **Bujqësia** | S) Nuk ka bujqësi |
| **Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria** | P) Auto mekanik, Prodhimtaria ushqimore, Materiale ndërtimore, Argjendari, Prodhimtaria e tekstilit |
| **Tregtia** | P) Aktivitete tregtare |
| **Turizmi** | P) Turizmi kulturor |
| **Aktivitetet financiare dhe sigurimi** | P) Aktivitete financiare dhe të sigurimit |

## 1.2.2. VLERËSIMI I SITUATES NË KOMUNË BAZUAR NË STRUKTURAT FIZIKE, EKONOMIKE, NATYRORE DHE SOCIALE

### 1.2.2.1. STRUKTURA NATYRORE

Sinteza e strukturës natyrore merr në konsideratë dy tema dhe ato janë struktura gjeografike dhe trashëgimia natyrore. Analizat e PZHKP-së përbëjnë bazën e këtij studimi dhe problemet në lidhje me strukturën fizike dhe potencialet përkatëse janë përcaktuar me anë të vlerësimit të këtyre analizave.

**Struktura gjeografike**

Prizreni në përgjithësi ka një topografi të valëzuar, topografia kodrinore vërehet pjesërisht në drejtim të perëndimit në regjionin e Hasit, dhe i dallueshëm në anët lindore duke përfshirë regjionin e Zhupës dhe Kabashit. Këto regjione janë të pasura me pyje që kanë rezerva të llojeve endemike siç është Pisha Boshnjake, zonat pyjore në brendi të Parkut Nacional "Mali Sharr" mundëson zhvillimin e turizmit natyror. Llojllojshmëria e madhe e faktorëve natyrorë sigurojnë bazën e zhvillimit ekonomik.

Në regjionet tjera, Anadrini, Luma dhe Vërrini që përbëhen nga sipërfaqet e rrafshëta ku ndodhen lumenjtë Lumëbardhi, Drini i Bardhë dhe Toplluha, kushtet për prodhimtarinë bujqësore janë mjaft të mira; por në të njëjtën kohë në këto regjione shohim rrezik më të madh nga vërshimet. Hedhja e drejtpërdrejtë e plehut organik dhe ujërave të zeza në këto lume shkaktojnë ndotjen e tyre. Në Planin Hapësinor të Kosovës theksohet se Drini i Bardhë ka prioritet te shkallës së tretë në vend për reduktimin e ndotjes së ujit. Pos karakteristikave topografike, klima e butë që mbizotëron ndihmon kultivimin e rrushit, pemëve dhe perimeve. Të reshurat vjetore në Prizren krijojnë kushte ideale për vreshtari. 198

Problemet më të mëdha ambientale në Prizren janë erozioni dhe rreziku nga vërshimet, që paraqet rrezik imediat për 23 % të territorit të përgjithshëm të Prizrenit si dhe përdorimi i pamjaftueshëm dhe degradimi i burimeve natyrore si në tokat bujqësore ashtu edhe në tokat pyjore (Tabela 1.86 dhe Harta 1.41).

**Trashëgimia natyrore**

Lidhur me zonat e mbrojtura natyrore, Parku Nacional "Malet e Sharrit" është zona më e madhe dhe më e rëndësishme e mbrojtur jo vetëm në Prizren por edhe më gjerë. Parku Nacional "Malet e Sharrit" i themeluar në vitin 1986 është i vetmi park nacional në Kosovë. Parku Nacional "Malet e Sharrit" dallon me vlera botanike, shtazore, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore. Parku është aq i pasur me biodiversitet jo

vetëm në Kosovë por edhe në gadishullin Ballkanik, dhe përfaqëson një thesar të llojeve bimore ku disa prej tyre janë endemike, të rralla ose të rrezikuara nga shfarosja.

**Tabela 1.86:** Struktura natyrore: Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Keqpërdorimi i tokës bujqësore për ndërtim<br>Humbja e tokës bujqësore<br>Përdorimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore | Toka e pëlleshme bujqësore dhe<br>Burimet e pasura natyrore |
| Rreziku nga erozioni<br>Rreziku nga vërshimet | |
| Ndotja ambientale dhe degradimi i strukturës natyrore | Trashëgimia e pasur natyrore<br>Parku Nacional “Malet e Sharrit” si potencial për turizmin dimëror<br>Bio-diversiteti dhe llojet endemike |
| Papërshtatshmëria e rregulloreve ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore | Ekzistimi i instruksioneve ligjore për trashëgimi natyrore dhe kulturore |
| Vendbanimet joformale dhe ilegale që rrezikojnë zonat bujqësore | |






**Harta 1.41:** Struktura natyrore –Problemet

### 1.2.2.2. STRUKTURA FIZIKE

Sinteza e strukturës fizike merr në konsideratë tri çështje: modelin e shfrytëzimit të tokës, transporti e infrastruktura dhe trashëgimia kulturore. Problemet dhe potencialet në lidhje me strukturën fizike janë të bazuara në analizat e PZHKP.

**Shfrytëzimi i tokës**

Komuna e Prizrenit është një ndër komunat më të mëdha në Kosovë. Sipërfaqja totale e Komunës së Prizrenit është 63,780.67 ha që e bën atë komunën më të madhe në Kosovë. Modelet e shfrytëzimit të tokës tregojnë se karakteri rural është dominant. Sipërfaqet totale të banuara duke përfshirë vendbanimet urbane dhe ato rurale janë përafërsisht 3.92% apo 3,502.52 ha e sipërfaqes totale të komunës. Zonat bujqësore dhe pyjore përfshijnë 90.05% të komunës me një sipërfaqe prej 57,434.1 ha (Tabela 1.87).

**Tabela 1.87:** Përmbledhja e Shfrytëzimit të Tokës në Komunën e Prizrenit

| Shfrytëzimi i Tokës | Sipërfaqja (ha) | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| Vendbanimet | 2502.52 | **3.92** |
| Tregtia + Shërbimet + Përdorimi Miks | 340.11 | 0.53 |
| Objektet urbane | 164.33 | 0.26 |
| Industria | 178.79 | 0.28 |
| Infrastruktura | 1105.25 | 1.73 |
| Zona ushtarake | 95.34 | 0.15 |
| Zonat bujqësore | 57434.10 | **90.05** |
| Zonat tjera | 1960.24 | 3.07 |
| TOTAL | 63780.67 | 100.00 |



Në pjesën rurale të Prizrenit ndodhen 28 objekte shëndetësore, 59 shkolla fillore, 7 shkolla të mesme, 14 objekte kulturore dhe 54 objekte fetare. Shpërndarja gjeografike e objekteve shoqërore tregon se numri i këtyre objekteve është më i madh në pjesën verilindore të komunës dhe janë të përqendruara kryesisht në fshatra qendrore.

Ekspansioni i Prizrenit vazhdon përgjatë arterieve kryesore rrugore Prizren-Gjakovë dhe Prizren-Prishtinë. Vendbanimet e kanë një sipërfaqe prej 777 ha ku densiteti mesatar është 190 b/ha. Një ekspansion tjetër është në Lubizhdë dhe Korishë përgjatë aksit rrugor Prizren-Prishtinë. Vendbanimet janë shpërndarë në fushën e Prizrenit mjaft dendur në krahasim me pjesët malore ku shohim një densitet më të vogël të vendbanimeve.

Bazuar në madhësinë e vendbanimeve që rrjedhin nga ortofotot e vitit 2009, del se qyteti i Prizrenit është vendbanimi më i madh në komunë me sipërfaqe prej 1495 ha.

Trendët e rritjes së vendbanimeve mund të vërehen me rritjen e madhësisë së vendbanimeve në zonat rurale. Regjioni i Kabashit është kllasteri i dytë e banuar me fshatrat Lubizhdë dhe Korishë. Ne vitin 1980, regjioni i Hasit dhe Anadrinit ishte më i madh në krahasim me regjionin e Kabashit. Me shpalljen e Mamushës komunë, ka ndryshuar edhe madhësia e regjionit të Anadrinit (Tabela 1.88).

**Tabela 1.88:** Madhësia e vendbanimeve

| Regjioni | Harta themelore 1/25000 (1980) | Ortofoto (2009) |
|---|---|---|
| PRIZRENI | 719 ha | 1495 ha |
| Prizreni | 65.71 | 147.08 |
| Has | 177.45 | 412.71 |
| Kabashi | 156.54 | 458.03 |
| Luma | 90.76 | 116.85 |
| Anadrini | 179.01 | 441.84 |
| Vërrini | 48.95 | 157.17 |
| Zhupa | 134.69 | 163.31 |
| Totali | 1572 ha | 3393 ha |

Një ekspansion i pakontrolluar dhe i paplanifikuar vërehet sidomos kah rrugët kryesore arteriale. Formacionet kryesore të vendbanimeve joformale paraqiten në lagjet Arbanë, Jeta e Re dhe Lakuriqin Verior – Petrovë në veri dhe lagjet Tusuz (Zahir Pajaziti), Bajram Curri në juglindje dhe lagjja Kurillë në verilindje, ku pjesa më e madhe e tokës është tokë bujqësore e shkallës së tretë (Figure 1.61). Sidomos rritja përgjatë pjesës veriperëndimore paraqet rrezik për tokën bujqësore ku ekziston infrastruktura për vaditje, që do të thotë anashkalimin e potencialit të madh për prodhimtarinë bujqësore.






**Figura 1.62:** Vendbanimet me rritje të paplanifikuar dhe të pakontrolluar në qytetin e Prizrenit

Vlerësimi i problemeve dhe potencialeve të Komunës së Prizrenit sa i përket shfrytëzimit të tokës tregon se problemi më i madh është rritja e pakontrolluar dhe e paplanifikuar. (Tabela 1.89). Keqpërdorimi i tokës bujqësore për ndërtim ka shkaktuar degradimin e burimeve natyrore dhe zhvillim të paqëndrueshëm. Një pjesë e madhe e tokës bujqësore është humbur si rezultat i aktiviteteve ilegale të eksploatimit të zhavorrit dhe guroreve. Toka është duke u okupuar vazhdimisht me objektet për eksploatimin e gurëve që në anën tjetër shkakton formimin e vendbanimeve joformale në tokat rrethuese bujqësore. Prandaj ekziston një nevojë imediate për veprim të organizuar për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore, degradimit ambiental dhe sigurimin e kontrollit ndaj zhvillimit.

**Tabela 1.89:** Shfrytëzimi i tokës – problemet dhe potencialet

<table>
<tr><th>Problemet</th><th>Potencialet</th></tr>
<tr><td>Ekspansioni i paplanifikuar dhe i pakontrolluar</td><td rowspan="7">Plani zhvillimor urban<br>Stoku i ndërtimeve në qytetin e Prizrenit që mundëson propozime të reja funksionale dhe implementime</td></tr>
<tr><td>Vendbanimet joformale dhe ilegale që kërcënojnë zonat bujqësore</td></tr>
<tr><td>Keqpërdorimi i tokës bujqësore për ndërtim</td></tr>
<tr><td>Stoku i pashfrytëzuar i ndërtesave (fshatrat dhe lagjet e zbrazëta)</td></tr>
<tr><td>Shpërndarja e pakontrolluar e densitetit në zonat urbane e shkaktuar nga mungesa e përdorimit efikas të mjeteve për planifikim dhe implementim</td></tr>
<tr><td>Mungesa e karakterit tradicional në ndërtime të reja</td></tr>
<tr><td>Rrugët e ngushta, mungesa e gjelbërimit</td></tr>
<tr><td>Regjionet me objektet e pamjaftueshme urbane</td><td>Përqendrimi i objekteve urbane në fshatrat qendrore.</td></tr>
<tr><td>Pamjaftueshmëria e aktiviteteve komerciale në fshatra, pos fshatrave qendrore, që do të rriste ekonominë lokale</td><td>Aktivitetet komerciale në fshatra gjenden në arteriet kryesore rrugore</td></tr>
<tr><td>Lokacioni i industrisë<br>Objektet e pashfrytëzuar industriale</td><td>Objektet ekzistuese industriale të zbrazëta që paraqesin potencial për përdorime të ndryshme.</td></tr>
</table>



Stoku i pashfrytëzuar ndërtimor në fshatrat dhe lagjet e zbrazëta të braktisura sidomos pas luftës është po ashtu problem i rëndësishëm. Mirëpo, potenciali i këtyre zonave për funksione të reja nuk duhet të nënvlerësohet. Shpërndarja e pakontrolluar e densitetit në zonat urbane e shkaktuar nga mungesa e përdorimit efikas të mjeteve për planifikim dhe implementim është edhe një problem në këtë fushë. Ndërtimi i ndërtesave me etazhitet të lartë sidomos në qendrën e qytetit nuk është në pajtim me karakterin ekzistues historik të qytetit. Trendi zhvillimor ekzistues i densitetit të ultë në periferi të qytetit me ndërtimet dykatëshe në anën tjetër është përdorimi joracional i tokës bujqësore.

Pos faktit që shumica e fshatrave nuk kanë objekte të mjaftueshme urbane, shumica e fshatrave po ashtu ballafaqohet me mungesën e aktiviteteve komerciale që do të rriste ekonominë lokale.

Sa i përket lokacioneve të objekteve industriale, në tërë komunën vërehet një strukturë e paorganizuar. Pos kësaj, në qytet ende ekzistojnë ndërtesat e pashfrytëzuara industriale të cilat mund të përdoren për aktivitete të ndryshme.

**Transporti dhe infrastruktura**

Prizreni ka lidhje të mira transporti më pjesët tjera të Kosovës dhe vendeve fqinje. Mirëpo sa i përket lidhjeve të brendshme, nevojitet sigurimi i lidhjeve të fshatrave me vendbanimet fqinje gjë që është shumë me rëndësi për regjionin e Zhupës dhe Kabashit. (Tabela 1.90). Për momentin, çdo fshat ka rrugë, por rrjeti rrugor nuk është e kategorizuar. Hekurudha pasive paraqet një mangësi prej të cilës do të përfitonte Prizreni si për transportin e mallrave ashtu edhe të udhëtarëve. Problemet më të mëdha lidhur me shërbimet e transportit janë mungesa e transportit publik dhe trafiku i ngjeshur në qendrën e qytetit. (Tabela 1.91).

Prizreni ka probleme vitale me infrastrukturën urbane. Nuk ka shërbim të mjaftueshëm lidhur me furnizimin me ujë, kanalizimin dhe plehun. Vetëm dy të tretat e tokës bujqësore kanë sistem të ujitjes dhe pjesa më e madhe e rrjetit ka nevojë për riparim. Në fshatrat qendrore nuk ka probleme me mbeturinat por fshatrat tjera lëngojnë nga mungesa e sistemit për menaxhimin e mbeturinave. Në regjion në përgjithësi nuk ka stabilimente për trajtim të ujërave të zeza. Regjionet e Anadrinisë dhe të Prizrenit janë regjione më me avantazh në komunë sa i përket ujit të pijshëm. Në regjionin e Lumës në anën tjetër, regjioni që ka më së paku burime të ujit, në verë shumë fshatra vuajnë nga thatësia. Arsyeja themelore e papërshtatshmërisë së strukturës urbane në disa regjione është topografia e tyre.



Rrjeti i dobët i ujësjellësit dhe i ujitjes rezultojnë në pamundësinë e zhvillimit të bujqësisë që është shtytësi kryesor i regjioneve. Për më tepër, shfrytëzimi i lumenjve për kanalizim është po ashtu një problem serioz mjedisor që rezulton me degradimin ambiental. Sistemi jo i volitshëm infrastrukturor po ashtu paraqet rrezik nga vërshimet në disa fshatra që ndodhen përgjatë lumenjve (Harta 1.42 dhe 1.43).

Sa i përket rrymës elektrike, vlen të përmendet se ndërtimi i Hidrocentralit të Zhurit është projekti më i rëndësishëm i cili është i rëndësishëm jo vetëm për Prizrenin por edhe për Kosovën në përgjithësi.

Raporti i fizibilitetit të Hidrocentralit të Zhurit përmbledh të gjitha efektet favorizuese gjatë operimit të projektit siç është më shumë rend në zonën e planifikuar për projekt; sasi të mjaftueshme të ujit për ujitje; rritje të lagështisë së ajrit dhe rritjes së precipitimit që me siguri do të ketë ndikim favorizues në rritjen e zonave dhe produkteve pyjore.

**Tabela 1.90:** Vlerësimi i Transportit dhe infrastrukturës sipas regjioneve

| Regjioni | Numri i Fshatrave | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Totali | Fshatra të pabanuara | Nuk ka rrjet për furnizim me ujë | Problemet me rrjetin e furnizimit me ujë | Nuk ka rrjet të kanalizimit | Rrjeti i papërshtatshëm i kanalizimit | Rrugët e brendshme në gjendje të keqe | Problemet në qasje në rrugë kryesore |
| Prizreni | 9 | 1 | 2 | 4 | 1 | 4 | 7 | 4 |
| Hasi | 17 | 1 | 1 | 10 | 8 | 7 | 14 | 6 |
| Kabashi | 7 | 2 | 1 | 4 | 0 | 4 | 5 | 0 |
| Luma | 7 | 0 | 0 | 5 | 1 | 4 | 6 | 2 |
| Anadrini | 15 | 0 | 6 | 5 | 2 | 7 | 12 | 7 |
| Vërrini | 8 | 2 | 0 | 4 | 1 | 3 | 6 | 3 |
| Zhupa | 13 | 2 | 3 | 6 | 0 | 4 | 7 | 4 |
| Total | 76 | 8 | 13 | 38 | 13 | 33 | 57 | 26 |

**Tabela 1.91:** Transporti dhe infrastruktura - Problemet dhe potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Trafiku i ngjeshur në qendrën e qytetit<br>Rrugët lokale të cilësisë së ultë<br>Lidhjet e papërshtatshme në pjesët malore | Lidhjet efektive me pjesët tjera te Kosovës dhe vendet fqinje<br>(Projekti i autostradës Shqipëri-Kosovë-Serbia) |
| Papërshtatshmëria e rrjetit rrugor krahas kërkesës së shtuar në qendër | Rruga transite e ndërtuar nga KFOR-i |
| Hekurudha pasive | Projektet e rehabilitimit të sistemit ekzistues hekurudhor në mes të Prizrenit dhe Shqipërisë |
| Buxheti i pamjaftueshëm për investimet kapitale në infrastrukturë | |
| Mungesa e transportit publik | |
| Fshatrat pa sistem të furnizimit me ujë të pijshëm në regjionin e Podrimës dhe Zhupës<br>Fshatrat pa sistem të kanalizimit (në veçanti në regjionin e Hasit)<br>Fshatrat pa infrastrukturë adekuate (në regjionin e Hasit dhe Anadrinisë) | Projektet për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të plehut dhe vaditjes.<br>Investimet në burimet e ujit dhe energjisë (projekti i ujësjellësit në Zhur) |
| Menaxhimi i dobët i infrastrukturës. | |



### Trashëgimia kulturore

Pozita e mirë rajonale dhe gjeografike si dhe resurset e pasura natyrore, begatia me ndërtesa kulturore dhe historike, folklori i pasur paraqesin bazën e zhvillimit të turizmit në Prizren. Prizreni është qyteti më i vizituar i Kosovës dhe ka potencial për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit. Numri i madh i monumenteve historike e bëjnë Prizrenit një lokacion shumë atraktiv për vizitorët si nga Kosova ashtu edhe nga jashtë. Prizreni ka 24 lokacione arkeologjike që dëshmojnë se qyteti dhe rrethina e saj datojnë nga koha e neolitit. Krahas këtyre lokacioneve, janë 39 objekte kulti të krishtera dhe 46 objekte sakrale islame. Mirëpo, trashëgimia kulturore në Prizren është në degradim e sipër. Mungesa e përpjekjeve

për konservim, ndërtimet e reja përkundër planeve konservuese dhe stoku i pashfrytëzuar i ndërtimit rezultojnë në probleme të mëdha fizike.

Enti për mbrojtjen e monumenteve ka inventarizuar gjithsej 291 monumente kulturore në Komunë e Prizrenit (2009) (Tabela 1.92).

Kalaja e Prizrenit është lokacioni më i rëndësishëm arkeologjik në Komunë. Ne Romajë dhe Kushnin ndodhen grumbuj gurësh që datojnë nga periudha parahistorike. Edhe në Korishë, Nashec dhe Vlashnje gjenden mbetjet arkeologjike të fortifikatave. Hasi është regjioni më i pasur me trashëgimi natyrore dhe kulturore me lokacionet arkeologjike në Romajë, Kushnin, Gjonaj, Karashengjergji, Mazrek, Milaj dhe Tupec (Tabela 1.92).

Në qendrën e Prizrenit ka 5 objekte arsimore, 3 objekte të ambasadave, dhe një objekt shëndetësor që njihen si monumente arkitektonike në Prizren. Si monumente me vlerë të trashëgimisë industriale dhe si trashëgimi monumentale arkitektonike janë regjistruar edhe hidrocentrali, fabrika e lëkurës, ndërtesa e vjetër e postës dhe ura e gurit në qendër të qytetit. Regjioni i Hasit është më i pasur me numrin e objekteve publike monumentale ndërsa regjioni i Zhupës është më i pasur me objekte monumentale fetare. (Tabela 1.92).

Qyteti i Prizrenit është zona më e rëndësishme e trashëgimisë me gjithsej 145 asete të trashëgimisë kulturore ku hyjnë 66 objekte civile dhe 7 lokacione komplekse dhe urbane.. Më poshtë janë asetet e definuar si zonat e konservimit historik dhe komplekset: 

- Muzeu i Lidhjes së Prizrenit,
- Sheshi i Shatërvanit,
- Marashi dhe kompleksi i Nënkalasë
- Sheshi i Karabashit, i gjimnazit Gjon Buzuku, dhe kompleksi i teqesë Sinani.

Edhe pse Republika e Kosovës ka instruksione ligjore për ruajtjen dhe përdorimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ato nuk definojnë kushtet e ruajtjes dhe të përdorimit. Pos kësaj, Kosova nuk ka programe të përshtatshme të trajnimit apo reklamimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

**Tabela 1.92:** Numri i aseteve të trashëgimisë kulturore sipas regjioneve

| | Ndërtesat civile | Ndërtesat publike | Ndërtesat fetare | Zonat urbane dhe komplekset | Zonat arkeologjike | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| PRIZREN | 66 | 26 | 44 | 7 | 2 | **145** |
| Prizren | 2 | 1 | 8 | 0 | 1 | 12 |
| Has | 2 | **15** | 13 | 0 | **9** | **39** |
| Kabash | 0 | 2 | 16 | 0 | 3 | 21 |
| Luma | 5 | 4 | 4 | 0 | 4 | 17 |
| Anadrini | 1 | 1 | 10 | 0 | 2 | 14 |
| Vërrini | 0 | 0 | 11 | 0 | 2 | 13 |
| Zhupa | 4 | 1 | **25** | 0 | 0 | **30** |
| **Total** | **80** | **50** | **131** | **7** | **23** | **291** |

Ekzistimi i OJQ-ve që punojnë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore siç është Cultural Heritage Without Borders (CHWB) paraqet një potencial të rëndësishëm për regjionin. Plani për Konservimin e zonës Historike të Prizrenit i përpiluar nga ekipi nga Universiteti Teknik i Stambollit që menaxhohet nga CHWB është një aset fondamental për ruajtjen e qëndrueshmërisë së trashëgimisë kulturore. Mirëpo zhvillimet që kundërshtojnë planin e konservimit mund të vërehen qartë në qendrën historike të qytetit që rezulton me degradimin e karakterit historik (Tabela 1.93).



**Tabela 1.93:** Trashëgimia kulturore - Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Papërshtatshmëria e rregulloreve ligjore për mbrojtjen dhe përdorimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. | Ekzistimi i instruksioneve ligjore për trashëgimi kulturore dhe natyrore |
| Papërshtatshmëria e trajnimit dhe programeve reklamuese për trashëgiminë natyrore dhe kulturore | Ekzistimi i OJQ-ve që punojnë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore (CHWB) |
| Mungesa e vetëdijes dhe interesimit për trashëgiminë ekzistuese dhe reale | Prizreni, qytet atraktiv për vizitorët me historinë dhe kulturën e saj |
| Zhvillimet në kundërshtim me planin e konservimit | Plani për Konservimin e zonës historike të Prizrenit |
| Mirëmbajtja, restaurimi dhe praktikat e papërshtatshme të ruajtjes.<br>Objektet e shkatërruara dhe të zhvlerësuara historike. | Trashëgimia e pasur kulturore<br>Lokacionet e rëndësishme arkeologjike: Kalaja e Prizrenit, mbetjet arkeologjike të fortifikatave në Korishë, Nashec dhe Vlashnje.<br>Zonat dhe komplekset urbane ne qytetin e Prizrenit Muzeu i Lidhjes së Prizrenit, Sheshi i Shatërvanit, Marashi dhe kompleksi i Nënklasë Sheshi i Karabashit, i gjimnazit Gjon Buzuku, dhe kompleksi i teqesë Sinani.<br>Objektet monumentale sidomos në Prizreni dhe regjionin e Hasit<br>Objektet monumentale fetare gati në secilin fshat<br>Monumenti i trashëgimisë industriale hidrocentrali dhe fabrika e lëkurës |






**Harta 1.42.** Struktura fizike – Problemet I






**Harta 1.43.** Struktura fizike – Problemet II

### 1.2.2.3. STRUKTURA SOCIALE

**Profili demografik**

Që nga regjistrimi i fundit i vitit 1991, nuk ka të dhëna zyrtare për popullatën e Kosovës, prandaj edhe mungesa e të dhënave të sakta dhe të besueshme demografike është problemi kryesor për definimin e strukturës sociale të Prizrenit. Në vitet e kaluara është parë një lëvizje më e madhe nga zonat rurale në ato urbane, sidomos kah qendrat më të mëdha. Kjo lëvizje rezulton nga mungesa e forcës së re punëtore të pakualifikuar në zonat rurale që shkakton mbipopullimin në zonat urbane.

Rrjedhja e popullatës kah qendra e Prizrenit rezulton me përqendrimin e saj në qendër të qytetit. E njëjta arsye çon kah humbja e popullsisë në pjesët rurale sa që disa fshatra janë plotësisht të zbrazëta. Mirëpo, në zonat rurale rritja e popullatës është në trend pozitiv edhe përkundër një shkalle më të ulët.

Problemet dhe potencialet e Prizrenit sa i përket profilit demografik të Prizrenit që janë rezultatet e vizitave dhe analizave të kryera në terren në kuadër të PZHKP 2025, punëtorisë së parë të mbajtur me 16 prill, 2009, Vizionit të Integruar të Prizrenit të vitit 2008 si dhe Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ janë përmbledhur në Tabelën e 1.94. Potenciali më i rëndësishëm i Komunës në aspektin e strukturës demografike është popullate re dhe e trajnuar për dinamizmin që ata prodhojnë. Diversiteti etnik i Prizrenit është një tjetër potencial i rëndësishëm sepse në mënyrë ideore ajo gjeneron aftësi dhe kreativitet që mundëson përparim pozitiv në aspektin social dhe ekonomik. 

**Tabela 1.94:** Profili demografik - Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Mungesa e të dhënave statistikore sa i përket demografisë | |
| Përqendrimi i popullatës në qytetin e Prizrenit si rezultat i migrimit | Diversiteti etnik demografik<br>Toleranca ndëretnike |
| Rritja e madhësisë së popullatës dhe densitetit në qytetin  e Prizrenit | Rritja natyrore e popullatës në zonat rurale |
| Humbja e popullatës për shkak të migrimit të të rinjve për punësim | Shkalla e lartë e të rinjve |
| Përqendrimi i popullsisë për shkak të rrjedhës së popullsisë drejt qytetit të Prizrenit | Rrjedhja e popullatës kah lokacionet qendrore në vitet e kaluara |

**Profili i punësimit**

Është e ditur se shkalla e punësimit të paregjistruar është shumë e lartë në Prizren, ashtu edhe në Kosovë. Punësimi i paregjistruar përfshin punonjësit e përditshëm dhe punonjësit sezonal siç janë punëtorët e ndërtimtarisë, shitësit e rrugëve, zanatlinjtë etj. Faktorët më të rëndësishëm të rritjes së punësimit të paregjistruar janë pagat dhe taksat e larta.

Punësimi i paregjistruar është efektive në rritje të lartë të shkallës së papunësisë në Kosovë.

Jostabiliteti politik në periudhën e pas luftës po ashtu ka rezultuar me zhvillim të dobët ekonomik që në anën tjetër ka si pasojë papunësinë. Një arsye tjetër e papunësisë është se tregu i punës ka një shumicë të madhe të të rinjve prej moshës 16-24.

Në regjionin e Prizrenit, Hasit dhe Vërrinit shohim edhe një mungesë të madhe të punësimit industrial ndërsa punësimi në shërbimet publike është prezent në të gjitha regjionet. Në perspektivën gjeografike, punësimi industrial është i përqendruar në pjesët veriore ndërsa shpërndarja e punësimit në shërbime publike është homogjen.

Problemet dhe potencialet në profilin e punësimit në Prizren janë dhënë në Tabelën 1.95. Shkalla e lartë e papunësisë, mungesa e mundësive të punësimit dhe të papunët e paregjistruar janë problemet kyçe në profilin e punësimit në Prizren, ndërsa sa i përket potencialeve ato janë dinamizmi i popullatës së re dhe të kualifikuar si dhe mundësitë aktuale të punësimit në pjesët rurale. Një nga arsyet kryesore për mundësitë e kufizuara të punësimit për popullatën e re është mosha e lartë e pensionimit. Ndihma financiare e kushërinjve që jetojnë në diasporë po ashtu shkakton papunësinë, sidomos në pjesët rurale.



**Tabela 1.95:** Profili i Punësimit – Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Mungesa e mundësive të punësimit për popullatën dhe banorët e paaftë<br>Shkalla e lartë e papunësisë | |
| Humbja e fuqisë së kualifikuar punëtore në zonat rurale për shkak të migrimit kah qendra e qytetit | |
| Mungesa e mundësive të punësimit për popullatën e re për shkak të moshës së lartë të pensionimit. | Shkalla e lartë e të rinjve |
| Shkalla e lartë e papunësisë në zonat rurale<br>Ndikimi negativ i diasporës në punësimin rural | Ekzistimi i punësimit industrial dhe në shërbime publike në zonat rurale |
| | Pjesa më e madhe e të punësuarve janë të kualifikuar |
| Ekzistimi i punëtorëve ilegal dhe sezonal | |

**Infrastruktura sociale**

Siç është raportuar edhe në Profilin e Komunës së Prizrenit, shihet mungesa e objekteve arsimore dhe shëndetësore në Prizren, objektet e infrastrukturës sociale janë të përqendruar në pjesët veriperëndimore të Komunës dhe numri më i madh i tyre është në fshatrat qendrore. (Hartat 1.29, 1.30 dhe 1.35).

Sipas anketimeve, regjionet e Hasit dhe Zhupës vuajnë më së tepërmi sa i përket numrit të objekteve shëndetësore. Mirëpo, numri i objekteve shëndetësore nuk është tregues për mungesën e shërbimeve shëndetësore, meqë jo të gjitha objektet ekzistuese punojnë shtatë ditë në javë.

Sa i përket shkollave, shohim se gati të gjitha fshatrat kanë së paku një shkollë fillore. Mirëpo ka edhe fshatra pa shkollë fillore si dhe ka nga ato fshatra ku kapaciteti i ultë i shkollës i shtyn nxënësit të udhëtojnë në fshatrat fqinje, që paraqet problem për këto fshatra. Nevoja për ndërtimin e shkollave të reja fillore në fshatrat që nuk kanë ndërtesat shkollore del, si nevojë për përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve në shkollat ekzistuese.

Sa i përket shkollave të mesme, përqendrimi i tyre më i madh i tyre vërehet në fshatrat qendrore. Nxënësit duhet që të shkojnë në shkolla te mesme ose në këto fshatrat qendrore ose në qytetin e Prizrenit. Mungesa e shkollave të mesme në fshatra, përfshirë këtu edhe 4 fshatra qendrore paraqet një problem të madh për sistemin arsimor.



Problemet dhe potencialet e infrastrukturës sociale në Prizren janë dhënë në Tabelën 1.96. Mungesa e objekteve sociale si dhe kapaciteti i ultë i objekteve ekzistuese, paraqet një nga problemet kryesore në Komunë. Mungesa e numrit të stafit dhe kushtet fizike të objekteve shëndetësore, janë një ndër arsyet të rëndësishme në shërbime të dobëta shëndetësore në vendbanimet rurale. Pamjaftueshmëria e numrit të objekteve shkollore shkakton një koncentrim të madh të nxënësve mbi ndërtesat ekzistuese që është e mbingarkuar në krahasim me kapacitetet e tyre. Megjithatë, ndërgjegjësimi i banorëve (publikut) për mungesën e objekteve arsimore, kulturore dhe shëndetësore veçanërisht në zonat rurale, përbën një potencial për përmirësimin e infrastrukturës sociale.

**Tabela 1.96:** Infrastruktura Sociale - Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Mungesa e objekteve arsimore, kulturore dhe shëndetësore në zonat urbane dhe rurale | Ekzistimi i objekteve të shkallës së lartë arsimore dhe shëndetësore në fshatrat qendrore<br>Vetëdija lokale për nevojat për objekte sociale në zonat rurale |
| Mungesa e menaxhimit komunal dhe programeve për ripërtëritje të objekteve urbane | |
| Mungesa e stafit dhe objekteve shëndetësore | |
| Mungesa e kapaciteteve fizike të objekteve arsimore<br>Mbipopullimi i shkollave me nxënës<br>Mungesat në reformat arsimore | |
| Mungesa e objekteve sociale dhe kulturore në shumë pjesë të komunës | |
| Mungesa në qasje dhe standardeve ndërtimore të objekteve të sapo ndërtuara | |

### 1.2.2.4. STRUKTURA EKONOMIKE

Struktura ekonomike e Prizrenit përbëhet nga bujqësia, prodhimtaria, ndërtimtaria, tregtia, turizmi, dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit.



Edhe pse ka potencial të lartë për bujqësi dhe turizëm, papunësia mbetet njëri prej problemeve kyçe të regjioneve si dhe të Kosovës. Papunësia e të rinjve sot është problem vital në Kosovë. Shkalla e papunësisë është prej 35% deri 60% që e bën Kosovën shtet me papunësi më të lartë në Evropën Juglindore. Banorët kryesisht varen nga të hyrat e kushërinjve që punojnë jashtë. Për kundër potencialit për prodhimtari; ajo është e kufizuar për shkak të pamjaftueshmërisë së infrastrukturës apo investimeve në prodhimtari. Sikurse në Kosovë, ekonomia karakterizohet me një trend dramatik të deindustrializimit. Mbyllja e aktiviteteve industriale, shfrytëzimi i pamjaftueshëm i resurseve natyrore dhe humbja e tokës bujqësore rezulton në rritjen e papunësisë, e cila mundëson migrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me përvojë.

#### Bujqësia

Sa i përket sektorit të Bujqësisë, bujqësia mbetet si një ndër burimet më të rëndësishme të punësimit dhe gjenerimit të ardhurave (Plani Hapësinorë i Kosovës dhe Profili Komunal i Prizrenit), dhe është e pasur me resurse natyrore si tokë të pëlleshme, kullota dhe livadhe, resurse të ujit dhe klimë të butë kontinentale mesdhetare. Toka e pëlleshme dhe resurset e ujit paraqesin potencial të lartë për zhvillimin e bujqësisë në kultivimin e bimëve njëvjeçare dhe shumëvjeçare.

Meqë ekziston një pjesë e madhe e Komunës që ka tokë të pëlleshme bujqësore, prodhimtaria bujqësore bazohet në kultivimin e bimëve njëvjeçare. Mirëpo, jo të gjitha fshatrat kanë tokë të pëlleshme bujqësore të mjaftueshëm për këtë aktivitet. Fshatrat që kanë tokë pjellore por nuk shfrytëzohen për aktivitetet bujqësore, duhen të inkurajohen me projekte të cilat ofrojnë programe të prodhimit bujqësorë. Më pas, fshatrat të cilat kanë topografi malore dhe problemet me qasje të rrugëve, prodhimtaria bujqësore duhet të bazohet në blegtori, aktivitetet pyjore dhe vreshtari. Sipas raporteve kryesore sektoriale dhe vizita në teren (2009) ka treguar se blegtoria është aktivitet i rëndësishëm në fshatrat malore.

Sipas Profilit Komunal të Prizrenit, vreshtaria ka qenë dhe ende mbetet një aktivitet i rëndësishëm i Komunës së Prizrenit. Edhe pse kushtet klimatike për këtë aktivitet janë të shkëlqyeshme dhe Prizreni ka një traditë të lashtë në kultivimin e rrushit, mungon asistenca dhe investimet e duhura. Ndonëse, vreshtaria ka qenë dhe ende mbetet një potencial i rëndësishëm në prodhimtarinë bujqësore, nuk ka prodhimtari në 900 ha të vreshtave në pronësi shoqërore. Kjo lidhet me migrimin e popullatës nga fshatrat në qytete, mungesën e infrastrukturës rurale (rrugët fushore, investimet, pajisjeve bujqësore etj.) dhe mungesës së kapitalit fillestar për të filluar aktivitetet bujqësore (Tabela 1.97).



Posaçërisht Fusha e Prizrenit që ka një pjerrësi prej 0-5% ka kushte të volitshme për prodhimin e kulturave siç janë: domatet, speci, lakra, karota, trangujt, spinaqi dhe drithërat si luledielli, misri, elbi, tërshëra dhe thekra. Cilësia e tokës në regjionin e Kabashit është e lartë dhe e përshtatshme për kultivimin e domateve, specit, patates, misrit, mollëve, dardhave, kumbullave etj, dhe përveç kësaj, ka shumë llojshmëri (kategori) të tokës bujqësore për prodhimin e perimeve edhe në rajonet e Anadrinisë, Vërrinit dhe rajonit të Hasit. Në regjionin e Kabashit mund të kultivohen edhe bimët mjekuese si kamomili, menta lule Elbasani etj. Njashtu edhe struktura e tokës bujqësore në regjionin e Lumës është e përshtatshme për kultivimin e perimeve si lakra, patate, karota, trangujt, lulelakër, qepë si dhe prodhimin e drithërave dhe bimëve mjekuese. Në lartësinë mbidetare mbi 1000m në regjonin e Zhupës ka kushte të përshtatshme në rritjen e bimëve mjekuese si menta, kamomili dhe bimët tjera mjekuese, dhe po ashtu mund të kultivohen manaferrat, mjedrat, borovnica që kanë vlera ekonomike.

**Tabela 1.97:** Bujqësia: Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Humbja e tokës bujqësore për qëllime ndërtimi<br>Humbja e tokës bujqësore për shkak të migrimit rural në vendbanimet urbane | |
| Jo kultivimi dhe mungesa e kujdesit në tokat bujqësore pronë publike<br>Sistemi joadekuat i vaditjes | Toka e pëlleshme për bujqësi<br>Kushtet e volitshme klimatike<br>Sistemi ekzistues i vaditjes |
| Mungesa e objekteve për përpunimin e prodhimeve lokale bujqësore | Prodhimet tradicionale (Djathi i Sharrit)<br>Cilësia e lartë e rrushit për verë.<br>Kultivimi i bimëve mjekuese |
| Sektori i pazhvilluar i tregut për prodhimet bujqësore dhe të blegtorisë | Prodhimet e njohura lokale dhe prodhimtaria ushqimore në Regjionin e Ballkanit |
| Problemet me transport | Zonat e përshtatshme për blegtori |
| Fermat e zbrazëta të shpezëve | Fermat ekzistuese të pulave |
| Ulja e numrit të shtazëve për shkak të lëvizjes së popullatës | |

### Prodhimtaria dhe Ndërtimtaria

Para vitit 1999, industria ka qenë funksioni më i rëndësishëm ekonomik për zhvillimin e komunës së Prizrenit. Industria ushqimore e bazuar në prodhimet bujqësore dhe blegtorale, industria tekstile, farmaceutike, prodhimi i këpucëve, përpunimi i duhanit, industria grafike librare (shtypshkronjat), industria e prodhimeve metalike dhe ndërtimtaria kanë qenë aktivitete kryesore industriale në atë periudhë.



Sot objektet industriale janë ose të mbyllura ose të privatizuar. Disa nga objektet e privatizuar e kanë ndërruar destinimin e mëhershëm.

Ndalimi i prodhimtarisë në kompanitë e privatizuara është problemi kryesor sa i përket aktiviteteve prodhuese. Industria e bazuar në prodhimtarinë bujqësore është një potencial i cili duhet të mbështetet me shërbime komplementare të cilat për momentin mungojnë. (Tabela 1.98).

**Tabela 1.98:** Prodhimtaria dhe ndërtimtaria – problemet dhe potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Ndalimi i prodhimit në fabrikat e privatizuar<br>Vendet e lira të punës për shkak të privatizimit | Ndërmarrjet shoqërore të pa privatizuar |
| Mos vlerësimi i prodhimeve bujqësore për shkak të defekteve në shërbimet logjistike. | Industria bujqësore |
| Fabrikat jofunksionale | Superstruktura e objekteve |
| Humbja e vlerës dhe profitit në artizanat<br>Mungesa e mbrojtjes së artizanateve tradicionale | Prodhimet tradicionale (rakia e rrushit) dhe artizanatet tradicionale (filigrani) |
| Sigurimi ilegal i materialit ndërtimor | Prodhimi i materialit ndërtimor |

**Tregtia**

Raporti i UNDP-së i vitit 2002 tregon se 40% e bizneseve të regjistruara janë bizneset që tregtojnë me produkte ushqimore, pije, duhan, tekstil konfeksion dhe punime dore. Tregtia në Prizren është sektor vital dhe renditet e dyta në Kosovë pas Prishtinës. Qendra e Qytetit të Prizrenit është në krye me numrin e njësive komerciale, aktivitetet tregtare me sasinë dhe cilësinë e saj. Sipas anketimeve në teren të PZHKP 2025 analizat kanë treguar se, në rrethinat rurale, regjioni i Zhupës ka numër më të madh të njësive komerciale, por ka edhe disa fshatra që nuk kanë fare njësi komerciale.

Edhe pse Prizreni është qytetit i dytë në Kosovë për nga tregtia, shkalla e eksportit është shumë e ultë në krahasim me nivelin e madh të importit. Për më tepër, aktivitetet ekonomike ilegale janë një problem tjetër për bizneset tregtare në Prizren. (Tabela 1.99).

**Tabela 1.99:** Tregtia – Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Shkalla e ultë e eksportit | Numri i madh i bizneseve të regjistruara |
| Shkalla e lartë e importit | |
| Mungesa e tregjeve | |
| Deficiti i marrëveshjeve tregtare. Platforma e papërshtatshme konkurruese. | Inspektimi shtetëror, marketingu më i mirë<br>Bashkëpunimi institucional<br>Mbikëqyrja e mekanizmave të lidhura |
| Hekurudha jo funksionale<br>Politikat fiskale | Tregtia e zhvilluar<br>Qendër rajonale për 5 komuna<br>Qyteti i dytë në Kosovë |



**Turizmi**

Ashtu si në Kosovë, edhe në Prizren, turizmi është potenciali i dytë ekonomik. Potenciali turistik i Kosovës është i lidhur ngushtë me pozitën gjeografike të vendit. Prizreni ka potencial për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, këtë e lehtëson trashëgimia domethënëse dhe e pasur që posedon qendra e qytetit të Prizrenit dhe Malet e Sharrit. Pozita e mirë rajonale dhe gjeografike si dhe resurset e pasura natyrore, begatia me objekte kulturore dhe historike, folklori i pasur paraqesin bazën e zhvillimit të turizmit në Prizren. Turizmi është një nga potencialet më të mëdha të regjionit ku ekziston një potencial i lartë për zhvillimin e turizmit malor dhe atij shëndetësor. Mirëpo mungojnë objektet hoteliere dhe shërbyese për një zhvillim të mirëfilltë të turizmit. Për më tepër, trashëgimia kulturore, sidomos në Prizren, është duke u shkatërruar si rezultat i mungesës së përpjekjeve konservuese, si dhe ndërtimeve të reja në kundërshtim me planet për konservim. Siç është cekur edhe më herët, mungesa e infrastrukturës teknike po ashtu ka implikime negative në sektorin e turizmit. (Tabela 1.100).

**Tabela 1.100:** Turizmi – Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Investimet e papërshtatshme në turizëm<br>Buxheti i limituar komunal | |
| Mungesa e restoranteve të kualitetit dhe kapacitetit të lartë | |
| Mungesa e objekteve hoteliere të kualitetit të lartë | Objektet ekzistuese hoteliere |
| | Parku nacional |
| Mungesa e mbrojtjes së trashëgimisë | Trashëgimia e pasur natyrore dhe kulturore |
| Mos përdorimi i burimeve natyrore për aktivitete sportive | Potenciali për turizmin dimëror dhe malor |
| Zhdukja e artizanateve tradicionale | Qëndrueshmëria e prodhimeve tradicionale |
| Promovimi dhe reklamimi i dobët | |

### Aktivitetet financiare dhe ato të sigurimit

Sa i përket sektorit ekonomik, në Prizren ekzistojnë organizata aktive afariste dhe profesionale. Edhe përkundër të gjitha defekteve dhe problemeve lidhur me aktivitetet ekonomike, këto organizata veprojnë ashtu që paraqesin një potencial të rëndësishëm për Prizrenin. Një nga problemet nacionale financiare, që natyrisht reflektohet edhe në Prizren, është mungesa e strategjive për zhvillim mikroekonomik që ka rezultuar me aktivitete ilegale ekonomike. Për të anashkaluar këtë situatë, duhet inkurajuar koordinimin e qeverisë lokale dhe komunitetit afarist për të mbështetur tregtinë dhe aktivitetet financiare (Tabela 1.101).



**Tabela 1.101:** Financat – Problemet dhe Potencialet

| Problemet | Potencialet |
|---|---|
| Mungesa e strategjive për zhvillim mikro ekonomik | Mbështetja e subjekteve tregtare |
| Aktivitetet ekonomike ilegale | Shërbimet këshilluese për bizneset e vogla dhe të mesme |
| Mungesa e koordinimit institucional në mes të komunitetit afarist dhe qeverisë lokale, dhe komunave fqinjë | Organizatat afariste dhe profesionale |






**Harta 1.44.** Struktura ekonomike – Mundësitë I






**Harta 1.45.** Struktura ekonomike – Mundesitë II






**Harta 1.46.** Struktura ekonomike – Problemet

## 1.2.3. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I MUNDËSIVE NË STRUKTURAT EKONOMIKE, NATYRORE, FIZIKE DHE SOCIALE

Tabela 1.102 në përgjithësi përmbledh mundësitë dhe potencialet ndërsa Tabela 1.103 përmbledh në përgjithësi problemet e Komunës së Prizrenit të vlerësuar në seksionet e mëparshme që përcaktojnë hapat e ardhshme të PZHKP 2025 dhe të ardhmërisë së regjionit. Ky vlerësim është dhënë po ashtu në Hartën 1.47 si një hartë e përgjithshme e sintezave.

**Tabela 1.102:** Vlerësimi i përgjithshëm i mundësive në Komunën e Prizrenit

| **Potencialet** | | **ZHUPA** | **LUMA** | **KABASH** | **PODRIMI** | **HAS** | **VRINI** | **PRIZREN** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mjedisi natyror** | * Trashëgimia natyrore | ● | | | | | | |
| | * Burimet të përshtatshme natyrore | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| **Mjedisi Fizik** | * Pozita gjeografike dhe klima e volitshme | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Trashëgimia kulturore | | | | | | | ● |
| | * Tokat e pëlleshme dhe lumenjtë | | ● | | ● | ● | ● | ● |
| | * Ekzistimi i rrugëve kryesore | ● | ● | ● | ● | | | ● |
| | *Lidhjet e mira transportuese për pjesët tjera të Kosovës dhe shtete fqinje | | ● | ● | ● | | | ● |
| **Mjedisi socio-kulturor** | * Diversiteti etnik | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Popullata e edukuar dhe e trajnuar | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Popullata e re | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| **Struktura ekonomike** | * Aktivitetet e vogla prodhuese | | | ● | | | | |
| | * Lidhjet komerciale me qendrat e mëdha tregtare | | | ● | | | | |
| | * Sektori i ndërtimtarisë | | ● | ● | | | ● | |
| | * Minierë | | | ● | | ● | | |
| **Mundësitë** | | | | | | | | |
| **Mjedisi natyror** | * Burimet e përshtatshme natyrore | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| **Mjedisi Fizik** | * Projektet për menaxhim të plehut dhe ujësjellësit | | | | ● | | | |
| | * Investimet në energji dhe ujësjellës | | ● | | | | ● | |
| **Struktura ekonomike** | * Potenciali i lartë për prodhimet bujqësore | | ● | | ● | ● | ● | ● |
| | * Toka e pëlleshme për vreshtari dhe kultivimin e pemëve | | | | ● | | | |
| | * Potenciali për prodhimtarinë blegtorale | ● | ● | ● | | ● | ● | |
| | * Peshkataria dhe akuakultura | | ● | ● | | | | |
| | * Pylltaria | ● | | ● | | ● | ● | |
| | * Serat | ● | ● | | | | ● | |
| | * Potenciali i lartë për prodhimin e pijeve | | ● | ● | ● | | | |
| | * Potenciali i lartë për prodhimtarinë blegtorale | ● | ● | ● | | ● | | |
| | * Potenciali i lartë për logjistikë dhe aktivitetet e prerjes dhe transportimit të trupave (drurit) | | | | | | | ● |
| | * Potenciali i lartë për prodhimin e stolive | | | | ● | | | |
| | * Potencial për turizëm | ● | | ● | ● | | | ● |
| | * Aktivitetet prodhuese të amvisërive – artizanatet | | | | ● | | | |

**Tabela 1.103:** Vlerësimi i përgjithshëm i dobësive dhe kërcënimeve në Komunën e Prizrenit

| Dobësitë | | ZHUPA | LUMA | KABASH | ANADRINI | HAS | VËRRINI | PRIZREN |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mjedisi natyror** | * Degradimi mjedisor, . | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i resurseve natyrore | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Rreziku nga humbja e pyjeve | | | | | | ● | |
| | * Ndotja e lumenjve | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| **Mjedisi fizik** | * Ndërtimet e reja përkundër planeve të konservimit | | | | | | | ● |
| | * Stoku i pashfrytëzuar ndërtimor | ● | | | ● | ● | ● | ● |
| | * Vendbanimet joformale | | ● | | ● | | | ● |
| | * Ndërtimet e reja të banimit me shumë etazhe | | | | | | | ● |
| | * Uzurpimi i tokës bujqësore për nevoja ndërtimore | | ● | | ● | | | ● |
| | * Rrugët me standarde të ultë | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Infrastruktura e dobët teknike (kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i plehut, elektriciteti) | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Ujitja e pamjaftueshme | | ● | | ● | ● | ● | |
| **Mjedisi socio-kulturor** | ∗Migrimi | ● | ● | ● | ● | | ● | |
| | ∗Edukimi i dobët | ● | ● | ● | ● | ● | ● | |
| | ∗Shërbimet e pamjaftueshme shëndetësore | ● | ● | ● | ● | ● | ● | |
| **Struktura ekonomike** | * Mungesa e prodhimit të organizuar bujqësor dhe industrial | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Humbja e tokës bujqësore | | ● | | ● | ● | | |
| | * Mungesa e tokës së përshtatshme bujqësore | | | ● | | | | |
| | * Niveli i lartë i papunësisë | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Mungesa e akomodimit dhe objekteve shërbyese ushqimore për zhvillimin e turizmit | ● | ● | ● | ● | | | |
| | * Aktivitetet joformale eksploatuese të zhavorrit dhe gurëthyesit | | ● | | | ● | | |
| | * Përpunimi jo formal i drurit | | | | | | ● | |
| **Kërcnimet** | | | | | | | | |
| **Mjedisi natyror** | * Rreziku nga përmbytjet | ● | | | | | | |
| | * Erozioni | | ● | | | ● | | |
| **Mjedisi socio-kulturor** | * Migrimi | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| **Struktura ekonomike** | * Humbja e tregut | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |
| | * Mungesa e investimeve | ● | ● | ● | ● | ● | ● | ● |




223

Harta 1.47. Vlerësimi i përgjithshëm

### 1.2.4. ANALIZA E LIDHJEVE NË VLERËSIMIN E GJENDJES NË KOMUNË BAZUAR NË REGJIONE GJEOGRAFIKE

Analiza e lidhjeve përbëhet nga krahasimet e ndryshimeve kushtimore dhe statistike të karakteristikave ekonomike, sociale dhe gjeografike të Prizrenit. Analiza e lidhjeve aplikon krahasimin në çifte të faktorëve siç janë madhësia demografike dhe densiteti (popullata dhe punësimi), efikasiteti i objekteve urbane (objektet arsimore, shëndetësore dhe kulturore), aktivitetet ekonomike ( aktivitete bujqësore dhe industriale) karakteristikat gjeografike (toka e pëlleshme për aktivitete bujqësore), trashëgimia kulturore, objektet turistike dhe problemet ambientale dhe infrastrukturore. Të gjitha këto krahasime janë bërë në mes të regjioneve siç janë Prizreni, Zhupa, Luma, Anadrini, Hasi, Kabashi dhe Vërrini.

Siç kemi sqaruar në (seksionin 1.1.1.3), kalkulimi i popullatës në qytetin e Prizrenit është bërë duke përdorur të dhënat nga vizita në terren dhe nga Zyra Komunale e Komuniteteve Lokale. Për qëllimet e analizës së lidhjeve kemi supozuar se popullata e përafërt e Prizrenit është 150.000 banorë.

#### 1.2.4.1. POPULLATA DHE EFIQIENCA E OBJEKTEVE URBANE



Gjatë analizës së efiqiencës së objekteve urbane, popullata është faktori kryesor që përcakton madhësinë e objektit në hierarkinë e ndërtesave. Në këtë pjesë është dhënë analiza e lidhjeve të objekteve kulturore, shëndetësore dhe atyre arsimore në krahasim me madhësinë e popullatës dhe faktorët e densitetit.

Objektet arsimore janë definuar në katër nivele si: objektet parashkollore, shkollat fillore, ato të mesme dhe të universitetit. Komuna e Prizrenit ballafaqohet me mungesë të objekteve parashkollore sa që në regjionin e Hasit dhe Lumës nuk ka fare aktivitete arsimore parashkollore (Tabela 1.104). Edhe pse në qytetin e Prizrenit ka 13 shkolla fillore, Prizreni ka vetëm një objekt parashkollor i cili nuk është i mjaftueshëm duke pasur parasysh popullatën (~150,000). Në regjionin e Kabashit dhe Zhupës ka 4 objekte parashkollore dhe 5 objekte parashkollore. Në regjionin e Anadrinisë. Indikatori i popullatës për objekte parashkollore në këto regjione sillet prej 2.603 deri 3.720 të cilat tregojnë një efiqiencë relativisht të mirë në krahasim me nivelet universale të efiqiencës. Në regjionin e Vërrinit me vetëm një objekt parashkollor ky indikator është 9.080 dhe nuk është efiqient në krahasim me zonat rurale të Komunës së Prizrenit.

**Tabela 1.104:** Krahasimi i objekteve Parashkollore me numrin e nxënësve dhe popullatën

| | Popullata | Densiteti b/km2 | Numri i objekteve | Popullatë për objekt | Numri i nxënësve | Shkalla e nxënësve në popullatë % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 150,000 | 4,038.10 | 1 | 150,000 | 254 | 0.17 |
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 162.01 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 149.77 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 158.10 | 4 | 2,603 | 163 | 1.57 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 213.40 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 235.67 | 5 | 3,720 | 260 | 1.40 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 218.01 | 1 | 9,080 | 45 | 0.50 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 74.90 | 4 | 2,995 | 91 | 0.76 |
| Gjithsej rural | 92,987 | 154.81 | 14 | 6,642 | 559 | 0.60 |
| Totali | 240,000 | 376.29 | 15 | 16,000 | 813 | 0.34 |

Në qytetin e Prizrenit ndodhen 13 shkolla fillore që shërbejnë popullatën prej 150,000 banorëve (Tabela 1.105). Indikatori i popullatës për shkolla fillore në qytetin e Prizrenit është 11,538, që në krahasim me standardet universale nuk është efiqient (5000 – 7000 nxënës për një shkollë fillore). Ky indikator në zonat rurale të Komunës së Prizrenit sillet prej 1.126 deri 2.603.



Por treguesi i raportit të nxënësve të shkollave fillore në popullsi ka vlera më të mprehta në komunën e Prizrenit. Vlera më e ulët e pjesëmarrjes së nxënësve në shkollat fillore është në të gjitha fshatrat e rajonit të Prizrenit me një pjesëmarrje prej 9.71 %, ndërkohë që regjioni i Hasit tregon vlerën më të lartë që është 22.42%. Këto janë indikatorë të karakteristikave të shkollimit në Komunën e Prizrenit.

**Tabela 1.105:** Krahasimi i shkollave fillore me nxënës dhe popullatën

| | Popullata | Densiteti b/km2 | Numri i objekteve | Popullatë për objekt | Numri i nxënësve | Shkalla e nxënësve në popullatë % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 150,000 | 4,038.10 | 13 | 11,538 | 15,884* | 10.59 |
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 162.01 | 7 | 1,126 | 765 | 9.71 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 149.77 | 15 | 1,388 | 4,668 | 22.42 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 158.10 | 4 | 2,603 | 1,876 | 18.02 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 213.40 | 6 | 2,368 | 2,400 | 16.89 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 235.67 | 12 | 1,550 | 3,286 | 17.67 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 218.01 | 6 | 1,513 | 1,551 | 17.08 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 74.90 | 10 | 1,198 | 1,537 | 12.83 |
| Gjithsej rural | 92,987 | 154.81 | 60 | 1,550 | 16,083 | 17.30 |
| Totali | 240,000 | 376.29 | 73 | 3,288 | 31,967 | 13.32 |

** Numri i nxënësve të shkollave fillore është marrë nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Prizrenit*

Në Prizren ka 6 shkolla të mesme që shërbejnë popullatën prej 150.000 banorëve (Tabela 1.106). Treguesi i popullsisë për shkollat e mesme tregon nivelin prej 25,000 nuk është efiqient duke pasur parasysh standard universale (si 15,000 – 21,000 banorë për një shkollë të mesme).

Në regjionin e Hasit ndodhen tre shkolla të mesme, dy në regjionin e Anadrinit dhe nga një në regjionin e Lumës dhe Zhupës. Indikatori i popullsisë për shkollat e mesme në këto regjione ndryshon prej 6,942 deri 14,210, që është relativisht efikas në krahasim me standardet universale. Në të kundërtën, në rrethinat e thella rurale të komunës së Prizrenit të regjionit të Kabashit, Vërrinit dhe Prizrenit nuk ka shkolla të mesme. Sipas karakteristikave të shkollimit, raporti i nxënësve të shkollave të mesme sipas popullsisë ka ngjashmëri të vlerave në rrethinat rurale të Komunës së Prizrenit. Vlera më e ulët është në regjionin e Vërrinit me 1.91%, por vlera më e lartë është në rajonin e Zhupës me 3.07%. Në qytetin e Prizrenit, treguesi i shkollimit ka vlerën më të lartë në kuadër të komunës me 5.14%. Mirëpo nuk duhet harruar se nxënësit e fshatrave vijojnë shkollimin e mesëm në qytet.

**Tabela 1.106:** Krahasimi i shkollave të Mesme me nxënës dhe popullatën

| | Popullata | Densiteti b/km2 | Numri i objekteve | Popullatë për objekt | Numri i nxënësve | Shkalla e nxënësve në popullatë % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 150,000 | 4,038.10 | 6 | 25,000 | 7,711* | 5.14 |
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 162.01 | 0 | 0 | 181 | 2.30 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 149.77 | 3 | 6,942 | 538 | 2.58 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 158.10 | 0 | 0 | 210 | 2.02 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 213.40 | 1 | 14,210 | 404 | 2.84 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 235.67 | 2 | 9,300 | 544 | 2.92 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 218.01 | 0 | 0 | 173 | 1.91 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 74.90 | 1 | 11,980 | 368 | 3.07 |
| Gjithsej rural | 92,987 | 154.81 | 7 | 13,284 | 2,418 | 2.60 |
| Totali | 240,000 | 376.29 | 13 | 18,462 | 10,129 | 4.22 |

** Numri i nxënësve të shkollave te mesme është marrë nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Prizrenit*

Në komunën e Prizrenit ndodhen tre universitete. Raporti i pjesëmarrjes së studentëve të universitetit në popullatë ka vlera shumë të ngjashme në rrethinat rurale të Komunës së Prizrenit. Përqindja e pjesëmarrjes së studentëve në regjionin e Lumës është më e ulët me 0.25% ndërsa me e larta është në regjionin e Zhupës me 0.73% (Tabela 1.107).

**Tabela 1.107:** Krahasimi i Universiteteve me Studentë dhe Popullatën

| | Popullata | Densiteti b/km2 | Numri i universiteteve | Popullatë për universitet | Numri i nxënësve | Shkalla e nxënësve në popullatë % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 150,000 | 4,038.10 | 3 | 58,333 | * | * |
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 162.01 | 0 | 0 | 50 | 0.63 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 149.77 | 0 | 0 | 116 | 0.56 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 158.10 | 0 | 0 | 70 | 0.67 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 213.40 | 0 | 0 | 36 | 0.25 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 235.67 | 0 | 0 | 92 | 0.49 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 218.01 | 0 | 0 | 36 | 0.40 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 74.90 | 0 | 0 | 88 | 0.73 |
| Gjithsej rural | 92,987 | 154.81 | 0 | 0 | 488 | 0.52 |

** Numri i studentëve universitar nuk ka pasë mundësi të sigurohet*

Komuna e Prizrenit në total ka 18 ambulanca dhe 7 qendra të mjekësisë familjare (Tabela 1.108). Duke marrë parasysh standardet e planifikimit (3,000 – 5,000 banorë për një qendër shëndetësore), raporti i popullsisë për një qendër shëndetësore është relativisht efiqient në vlerë mesatare e cila është 3,321 banorë për një qendër shëndetësore. Por në regjionin e Lumës dhe Podrimës, ky raport është mjaft i lartë respektivisht 7,105 dhe 6,200. Regjioni i Zhupës ka numër më të lartë të numrit të objekteve shëndetësore me 6 objekte shëndetësore dhe qendra të mjekësisë familjare, dhe vlerën më të lartë në krahasim me raportin në mes të kokë banori për objekt shëndetësor e cila është 1.711. Kërkesa për objektet shëndetësore në këtë regjion është mjaft e madhe për shkak të topografisë malore të regjionit dhe qasjes së dobët në fshatra.



**Tabela 1.108:** Krahasimi i objekteve Shëndetësore me Popullatën

| | Popullata | Densiteti b/km2 | Numri i qendrave shëndetësore | Numri i qendrave familjare shëndetësore | Popullata për qendrat shëndetësore | Numri i spitaleve |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 150,000 | 4,038.10 | 3 | 0 | 50,000 | 1 |
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 162.01 | 2 | 0 | 3,940 | 0 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 149.77 | 4 | 2 | 3,471 | 0 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 158.10 | 2 | 1 | 3,471 | 0 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 213.40 | 1 | 1 | | 0 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 235.67 | 2 | 1 | 6,200 | 0 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 218.01 | 1 | 1 | 4,540 | 0 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 74.90 | 6 | 1 | 1,711 | 0 |
| Gjithsej rural | 92,987 | 154.81 | 18 | 7 | 3,719 | 0 |
| Totali | 92,987 | 154.81 | 21 | 7 | 3,321 | 1 |

Në Prizren gjendet një bibliotekë, një shtëpi e kulturës dhe dy kinema ndërsa në zonat rurale gjenden 6 biblioteka, dy qendra publike të edukimit dhe 5 shtëpi të kulturës (Tabela 1.109). Regjioni i Lumës dhe Vërrinit nuk kanë objekte kulturore. Raporti i objekteve kulturore në regjionin e Zhupës për kokë banori është 2,995 banorë për një qendër kulturore. Kjo vlerë është e kënaqshme në krahasim më totalin e ruralit prej 7,153 banorë për objekt kulturor. Regjioni i Kabashit tregon mjaftueshmërinë më të ulët në drejtim të objekteve kulturore me 10,412 banorë, e cila është popullsia e vendosur në këtë rajon, në krahasim me objektet kulturore.

**Tabela 1.109:** Krahasimi i Objekteve Kulturore me Popullatën

| | Popullata | Densiteti b/km2 | Numri i objekteve * | | | | Popullatë për objekt |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Bibliotekë | Qendra publike edukative | Shtëpi e kulturës | Kinema | |
| Qyteti i Prizrenit | 150,000 | 4,038.10 | 1 | 0 | 1 | 2 | 37,500 |
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 162.01 | 0 | 0 | 1 | 0 | 7,880 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 149.77 | 2 | 0 | 2 | 0 | 5,206 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 158.10 | 1 | 0 | 0 | 0 | 10,412 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 213.40 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 235.67 | 2 | 1 | 0 | 0 | 6,200 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 218.01 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 74.90 | 1 | 1 | 2 | 0 | 2,995 |
| Gjithsej rural | 92,987 | 154.81 | 6 | 2 | 5 | 0 | 7,153 |

** Shifrat tregojnë numrin total të bibliotekave ky hyjnë edhe shërbimet mobile të bibliotekës të cilat janë prezentë vetëm në regjionin e Kabashit dhe Anadrinit*

### 1.2.4.2. POPULLATA, PUNËSIMI DHE AKTIVITETET EKONOMIKE

Aktivitetet bujqësore janë aktivitetet kryesore të ekonomisë rurale të Komunës së Prizrenit. Në vizitën e kryer në mars dhe prill të vitit 2009 të PZHKP 2025, përfaqësuesit e fshatrave janë pyetur për indikatorët ekonomik dhe social në shifra duke u bazuar në shënimet e regjistruara si dhe për sfidat dhe mundësitë në aktivitete ekonomike të fshatrave të tyre. Analiza e parë e lidhjeve është bërë për aktivitetet bujqësore dhe tokat e pëlleshme për këto aktivitete duke marrë në konsideratë madhësinë e popullatës në fshatra në sektorin e "Popullata, Punësimit të Popullatës dhe Aktiviteteve Ekonomike". Aktivitetet bujqësore dallojnë në kultivimin e të mbjellave shumëvjeçare (rrushi dhe frutat) si dhe ato njëvjeçare

(drithërat dhe perimet) në Komunën e Prizrenit. Toka bujqësore është klasifikuar si tokë e rendit të dytë (II) dhe tretë (III) sipas klasifikimit bujqësor të tokave.

Në komunën e Prizrenit ka fshatra të pabanuara që nuk kanë aktivitete bujqësore e as tokë bujqësore. Duke pas parasysh relativisht potencialet e larta të resurseve natyrore dhe bujqësore të Komunës së Prizrenit, fshatrat si Dojnica, Kabashi, Kushtendili, Lezi, Milaj, Vrbiqani dhe Zhivinjani të cilat nuk kanë tokë bujqësore të pëlleshme, janë fshatra të pabanuara (Tabela 1.110). Fshatrat si Jabllanica dhe Dobrushta, me 2.600 dhe 1.530 banorë, po ashtu nuk kanë tokë bujqësore. Dobrushta është në pozite të palakmueshme ekonomike sepse nuk ka të punësuar në sektorin publik apo industrial ndërsa në Jabllanicë ndodhet qendra kulturore, 12 banorë janë të punësuar në institucione publike dhe në fshat ndodhen tre njësi komerciale. Pastaj, resurset bujqësore janë kaq jetike për të krijuar një ekonomi të zhvilluar të bujqësisë rurale dhe për të ruajtur popullatën për të mbijetuar në ekonominë rurale të Komunës së Prizrenit.

Veprimtaria më e përhapur bujqësore në Komunën e Prizrenit është kultivimi i bimëve njëvjeçare. 40 nga 70 fshatrat (përcaktuar sipas kufijve administrative) kanë këtë lloj të aktivitetit. Në të gjitha rajonet e Prizrenit, ka aktivitete bujqësore të bazuara në rritje të kulturave njëvjeçare. Problemi është që jo të gjitha fshatrat kanë tokë të mjaftueshme bujqësore të pëlleshme për të ushtruar këto aktivitete. Në fshatrat e regjionit të Vërrinit ka veprimtari bujqësore por tokë të pamjaftueshme bujqësore të pëlleshme. Kjo do të thotë se aktiviteti bujqësor mund të jetë më pak e mundshme në këto fshatra për shkak të mungesës së tokës pjellore bujqësore. Por në rajonin e Zhupës ka fshatra që kanë tokë pjellore bujqësore por jo edhe veprimtari të mjaftueshme bujqësore, e cila duhet të inkurajohet me projekte dhe programe të prodhimit të produktit bujqësor. Përkundër topografisë malore dhe problemet e qasjes në këtë rajon, prodhimtaria bujqësore duhet të bëhet veçanërisht në afërsi të luginave-baseneve të lumenjve ku ekzistojnë tokat pjellore.

Veprimtaria e dytë bujqësore e cila mund të vërehet në fshatrat Gërnqar, Krusha e Vogël, Landovicë, Shpinadi, Jeshkovë dhe Leskovec është kultivimi i bimëve shumëvjeçare (rrushi dhe pemët të ndryshme). Të gjithë këto fshatra kanë tokë të mjaftueshme bujqësore përpos fshatit Jeshkovë dhe Leskovecit në regjionin e Vërrinit.

**Tabela 1.110:** Vlerësimi i aktiviteteve bujqësore dhe tokës bujqësore në zonat rurale në krahasim me popullatën

| | Aktiviteti bujqësor | Popullata | Toka e pëlleshme bujqësore ** | | Toke bujqësore për person ($m^2$/p) | Sipërfaqe totale (ha) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | size (ha) | % | | |
| Prizreni | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Jabllanica,Vrbiqan** | 980 | 0 | 0 | 0.00 | 1.946,5 |
| Prizreni | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Gerncari* | 1,400 | 21,9 | 4,01 | 156.43 | 546,2 |
| Prizreni | Kultivimi i bimëve shumëvjeçare<br>*Atmaxha, Grazhdaniku, Nasheci, Novosella, Petrovasella* | 5,500 | 387,1 | 17,4 | 703.82 | 2.229,4 |
| Hasi | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Gjonaj, Gorozhup, Karashengjergji, Kojusha, Planeja, Zymi, Milaj** | 9,185 | 246,5 | 3,5 | 268.37 | 7.061,3 |
| Hasi | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Dedaj, Kabashi i Hasit, Krajku, Kushnin, Lubizhda e Hasit, Lukinaj, Mazrreku, Romaja, Tupeci* | 11,640 | 1.104,90 | 15,7 | 949.23 | 7.054,1 |
| Kabashi | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Dojnica*, Kabashi** | 0 | 0 | 0 | - | 2.154,8 |
| Kabashi | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Korisha, Lubizhda, Lutogllava, Skorobishti* | 10,412 | 1.620,0 | 37,2 | 1,555.90 | 4.354,5 |
| Luma | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Dobrushta* | 2,070 | 0 | 0 | 0.00 | 1.720,6 |
| Luma | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Kobaj, Vlashnja, Zhuri* | 12,140 | 83,1 | 1,7 | 68.45 | 4.938,3 |
| Andrini | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Caparci, Mamusha, Medveci, Novaka, Pirana, Randobrava, Serbica e Eperme, Serbica e, Poshtme, Smaci, Trepetnica, Velezha, Zojzi* | 15,595 | 4.204,8 | 66,0 | 2,696.25 | 6.368,9 |
| Andrini | Kultivimi i bimëve njëvjeçare dhe shumëvjeçare<br>*Krusha e Vogel, Landovica, Shpinadia* | 3,005 | 1.058,7 | 56,3 | 3,523.13 | 1.880,6 |
| Vërrini | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Kushtendili*, Lezi** | 0 | 0 | 0 | - | 609,9 |
| Vërrini | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Billusha, Hoca e Qytetit, Lybeqeva, Poslishti* | 8,600 | 0 | 0 | 0.00 | 2.840,3 |
| Vërrini | Kultivimi i bimëve njëvjeçare dhe shumëvjeçare<br>*Jeshkova, Leskoveci* | 480 | 0 | 0 | 0.00 | 7.147,9 |
| Zhupa | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Drajciqi, Gornjasella, Llokvica, Lubinja e Eperme, Lubinja e Poshtme, Mushnikova, Nepergoshti, Pllanjani, Srecka*, Zhivinjani** | 8,280 | 1.158,9 | 8,9 | 1,399.64 | 12.977,6 |
| Zhupa | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Manastirica, Recana, Struzha* | 3,700 | 0 | 0 | 0.00 | 3.018,0 |
| | Gjithsej rural | 92,987 | 9.885,9 | 14,8 | 863 | 66.848,9 |

** Fshatrat e pabanuara, ** Toka bujqësore është klasifikuar si tokë e rendit të dytë dhe tretë sipas klasifikimit bujqësor të tokave.*

Aktivitetet industriale janë kryesisht të përqendruar në qytetin e Prizrenit të përfaqësuara nga prodhimtaria e prodhimeve ushqimore, prodhimeve nga tekstili, artikuj argjendarie, material ndërtimor dhe shërbime për riparimin e automjeteve. Regjioni i Anadrinit dhe Komuna e

Mamushës janë nën qendra të aktiviteteve industriale me llojllojshmëri të punësimit industrial me një numër relativisht të madh kur shikohet pjesa rurale e Komunës së Prizrenit. (Tabela 1.111).

**Tabela 1.111:** Vlerësimi i aktiviteteve industriale dhe punësimit në krahasim me popullatën

| | Aktivitetet industriale | Popullata | Punësimi industrial | Mungesa e punësimit |
|---|---|---|---|---|
| Qyteti | Prodhimi i produkteve ushqimore, tekstilit, materiali ndërtimor, shërbimet për riparimin e automjeteve | 150,000 | N/A | - |
| Regjioni i Prizrenit | Prodhimi i materialit ndërtimor dhe shërbimet e riparimit të automjeteve si dhe prodhimi i produkteve të metalit<br>*Petrovasella* | 1,000 | 0 | po |
| Kabashi | Prodhimi i materialit ndërtimor dhe shërbimet e riparimit të automjeteve<br>*Korisha* | 5,000 | - | po |
| | Prodhimi i materialit ndërtimor dhe shërbimet e riparimit të automjeteve<br>*Lubizhda* | 3,000 | - | po |
| | Prodhimi i produkteve ushqimore<br>*Lutogllava* | 1,112 | 5 | po |
| Luma | Prodhimi i produkteve të kanalizimit<br>*Vlashnja* | 1,300 | 0 | po |
| | Prodhimi i produkteve të kanalizimit<br>*Zhuri* | 9,540 | 15 | po |
| Anadrini | Prodhimi i produkteve ushqimore<br>*Landovica* | 1,500 | 0 | jo |
| | Prodhimi i produkteve ushqimore, materialit të kanalizimit dhe shërbimet e riparimit të automjeteve<br>*Mamusha* | 6,000 | 67 | po |
| | Prodhimi i produkteve të kanalizimit dhe pijeve<br>*Krusha e Vogel* | 705 | 18 | po |
| | Prodhimi i pijeve dhe bizhuterisë<br>*Velezha* | 1,200 | 0 | jo |
| | Prodhimi i materialit ndërtimor<br>*Pirana* | 2,500 | 75 | jo |
| | Prodhimi i produkteve të kanalizimit<br>*Medveci* | 1,000 | 30 | po |
| Vërrini | Prodhimi i materialit ndërtimor<br>*Poslishti* | 900 | - | jo |
| Zhupa | Prodhimi i materialit ndërtimor<br>*Mushnikova* | 1,200 | 20 | po |
| Gjithsej rural | | 92,987 | 230 | 50 fshatra |

Ka rreth 190 të punësuar në aktivitetet industriale (sipas deklaratave të kryetarëve të fshatrave dhe të dhënave të regjistruara). Fshati Petrovë në regjionin e Prizrenit, fshati

Korishë, Lubizhda dhe Lutogllava në regjionin e Kabashit, fshati Vlashne dhe Zhuri në regjionin e Lumës, fshati Poslisht në regjionin e Vrinit ka po ashtu aktivitete industriale. Të gjithë kryetarët e fshatrave në përjashtim të asaj të Landovicës, Velezhës, Piranës dhe Poslishtit u deklaruan se ka mungesë të punësimit.

Kur krahasohen nivelet e punësimit të regjioneve, del se Anadrini ka vlerën më të madhe (të punësimit industrial për normën e popullatës është 1.02) (Tabela 1.112). Zhupa ka 20, Luma ka 15 dhe Kabashi ka vetëm 5 të punësuar në aktivitete industriale prandaj edhe vlerat përkatëse prej 0.17, 0.11 dhe 0.05 janë mjaft të ulta. Sipas të dhënave nga vizita në terren të PZHKP del se fshatrat e regjionit të Prizrenit, Hasit dhe Vërrinit nuk kanë të punësuar industrial.

Punësimi në institucione publike është relativisht i lartë në krahasim me punësimin industrial. Në regjionin e Kabashit janë afro 400 të punësuar në këto institucione (punësimi për normën e popullatës është 3.84). 142 të punësuar janë në regjionin e Prizrenit, 124 në regjionin e Anadrinit, 89 në regjionin e Hasit, 73 në regjionin e Zhupës, 65 në regjionin e Vërrinit dhe 61 në atë të Lumës janë të punësuar në institucione publike. Në krahasim me shkallën e papunësisë, numrat e mësipërm janë mjaft të vogla dhe ndikojnë në zvogëlimin e të ardhurave dhe ngritjen e varfërisë.



**Tabela 1.112:** Vlerësimi i punësimit me popullatën

| | Popullata | Punësimi industrial | | Punësimi publik | | Njësite komerciale |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Numri i punëtorëve | Punësim për popullate | Numri i punëtoreve | Punësim për popullate | |
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 0 | 0 | 142 | 1.80 | 12 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 0 | 0 | 89 | 0.43 | 66 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 5 | 0.05 | 400 | 3.84 | 31 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 15 | 0.11 | 61 | 0.43 | 33 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 190 | 1.02 | 124 | 0.67 | 76 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 0 | 0 | 65 | 0.72 | 20 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 20 | 0.17 | 73 | 0.61 | 111 |
| Gjithsej rural | 92,987 | 230 | 0.25 | 954 | 1.03 | 349 |

### 1.2.4.3. PROBLEMET AMBIENTALE DHE AKTIVITETET BUJQËSORE

PZHKP vizita në terren ka dëshmuar se përgjigja më e shpeshtë në pyetjen se cili është problemi kryesor ambiental është mungesa e industrisë së organizuar bujqësore dhe sistemi joadekuat i ujitjes (Tabela 1.113). Ky problem është i përbashkët për tërë zonën rurale të Komunës. Në 40 fshatra ku kultivohen kulturat njëvjeçare, 25 prej tyre ballafaqohen me mungesë të aktiviteteve të organizuara bujqësore. Duke u bazuar në rezultatet e vizitave në terren, ky problem shfaqet në të gjitha zonat e thella të Komunës së Prizrenit.(Tabela 1.114).

Ndërsa prej fshatrave që merren me kultivimin e bimëve shumëvjeçare, 19 prej tyre nuk kanë sistem të përshtatshëm të ujitjes në të gjitha zonat e thella të Komunës së Prizrenit. Por problemi me pamjaftueshmërinë e sistemit të vaditjes është i theksuar më së shumti në fshatra që kanë prodhimin e kulturave njëvjeçare. Ujitja është një çështje shumë e rëndësishme dhe vitale për kultivimin e produkteve bujqësore, sa që prej 24 fshatrave ku nuk ka veprimtari bujqësore, 11 prej tyre kanë shprehur nevojën për sistem të ujitjes. Këto fshatra janë Jabllanica në regjionin e Prizrenit, Zymi, Gorozhupi, Karashengjergji, Kojusha, Planeja, Milaj në regjionin e Hasit, Dojnica në regjionin e Kabashit, Kushtendili në regjionin e Vërrinit, Gornjasella dhe Srecka në regjionin e Hasit.

Zymi në regjionin e Hasit, Dojnica në regjionin e Kabashit dhe Gornjesella në regjionin e Zhupës që nuk kanë aktivitet bujqësor vuajnë nga humbja e tokës bujqësore. Të njëjtin problem e kanë edhe Lutogllava në regjionin e Kabashit, Zhuri në regjionin e Lumës dhe Krusha e Vogël në regjionin e Podrimës. Një çështje tjetër ambientale që ndërlidhet me humbjen e tokës bujqësore është edhe përdorimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore. Fshatrat që kultivojnë kulturat njëvjeçare dhe që kanë shfrytëzim joefikas të burimeve natyrore janë Novosella në regjionin e Prizrenit, Dedaj dhe Kushnini në regjionin e Hasit, Mamusha dhe Medveci në regjionin e Podrimës, Poslishti, Jeshkova dhe Leskoveci në regjionin e Vrinit. Asnjë nga këto fshatra, pos Mamushës dhe Medvecit nuk kanë tokë të pëlleshme për bujqësi. Duhet të theksohet se regjioni i Prizrenit, Hasit dhe Vërrinit janë në situatë më të palakmueshme sa i përket rrezikut për burimet natyrore siç është paraqitur në Tabelën 1.110.



Bazuar në vlerësimin, problemet ambientale mund të përmblidhen në titujt e mëposhtëm:

P1- Mungesa e industrisë së organizuar bujqësore
P2- Vaditja e pamjaftueshme
P3- Uzurpimi i tokës bujqësore për ndërtim
P4- Përdorimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore
P5- Humbja e tokës bujqësore

**Tabela 1.113:** Aktivitetet bujqësore dhe Problemet Ambientale

| | Numri i fshatrave | P1 | P2 | P3 | P4 | P5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nuk ka aktivitet bujqësor | 24 | 17 | 11 | 2 | 7 | 3 |
| Kultivimi i bimëve njëvjeçare | 40 | 25 | 19 | 2 | 6 | 2 |
| Kultivimi i bimëve shumëvjeçare | 1 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| Kultivimi i bimëve shumëvjeçare dhe njëvjeçare | 5 | 3 | 2 | 2 | 2 | 1 |
| Gjithsej rural | 70 | 46 | 32 | 6 | 16 | 6 |

*Numrat tregojnë përgjigjet nga vizita në teren*

**Tabela 1.114:** Aktivitetet Bujqësore dhe Problemet Ambientale në Fshatra

| | Aktivitetet bujqësore | Numri i fshatrave | P1 | P2 | P3 | P4 | P5 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prizreni | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Jabllanica,Vrbiqan** | 2 | 2 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Gerncari* | 1 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| | Kultivimi i bimëve shumëvjeçare<br>*Atmaxha, Grazhdaniku, Nasheci, Novosella, Petrovasella* | 5 | 3 | 3 | 0 | 1 | 0 |
| Hasi | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Gjonaj, Gorozhup, Karashengjergji, Kojusha, Planeja, Zymi, Milaj** | 7 | 7 | 6 | 0 | 2 | 1 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Dedaj, Kabashi i Hasit, Krajku, Kushnin, Lubizhda e Hasit, Lukinaj, Mazrreku, Romaja, Tupeci* | 9 | 4 | 3 | 0 | 2 | 0 |
| Kabashi | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Dojnica*, Kabashi** | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Korisha, Lubizhda, Lutogllava, Skorobishti* | 4 | 4 | 2 | 1 | 0 | 1 |
| Luma | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Dobrushta* | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Kobaj, Vlashnja, Zhuri* | 3 | 2 | 2 | 1 | 0 | 1 |
| Anadrini | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Caparci, Mamusha, Medveci, Novaka, Pirana, Randobrava, Serbica e Eperme, Serbica e, Poshtme, Smaci, Trepetnica, Velezha, Zojzi* | 12 | 7 | 5 | 0 | 2 | 0 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare dhe shumëvjeçare<br>*Krusha e Vogel, Landovica, Shpinadia* | 3 | 1 | 1 | 2 | 0 | 1 |
| Vërrini | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Kushtendili*, Lezi** | 2 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Billusha, Hoca e Qytetit, Lybeqeva, Poslishti* | 4 | 4 | 4 | 0 | 1 | 0 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare dhe shumëvjeçare<br>*Jeshkova, Leskoveci* | 2 | 2 | 1 | 0 | 2 | 0 |
| Zhupa | Nuk ka aktivitet bujqësor<br>*Drajciqi, Gornjasella, Llokvica, Lubinja e Eperme, Lubinja e Poshtme, Mushnikova, Nepergoshti, Pllanjani, Srecka*, Zhivinjani** | 10 | 6 | 2 | 1 | 2 | 1 |
| | Kultivimi i bimëve njëvjeçare<br>*Manastirica, Recana, Struzha* | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjithsej rural | | 68 | 44 | 32 | 7 | 14 | 5 |

*Numrat rrjedhin nga përgjigjet e marra nga vizita në terren*

** Fshatrat e pabanuara*

### 1.2.4.4. POPULLATA, DENSITETI DHE PROBLEMET ME INFRASTRUKTURË

Kur të analizohet densiteti i popullatës në regjionet gjeografike, del se niveli i densitetit ka vlera të përafërta përpos në regjionin e Zhupës që ka karakteristika gjeografike malore (densiteti mesatar në Zhupë është 74.90 b/km$^2$). Në regjionet tjera ky numër ndryshon prej 149.77 b/km$^2$ deri 235.67 b/km$^2$. Nga 70 fshatra të Komunës së Prizrenit, gjysma e tyre ka probleme infrastrukturore (Tabela 1.115).

Hasi dhe Anadrini janë regjionet më të populluara. Në regjionin e Anadrinisë densiteti mesatar është 235.67 b/km$^2$ ku 5 fshatra (Krusha e Vogel, Mamusha, Medveci, Novaka dhe Serbica e Poshtme) ballafaqohen me sistem të dobët të kanalizimit, të ujësjellësit dhe atij elektrik. Si regjion gjeografik i dyti më i banuar në Komunën e Prizrenit, regjionin e Hasit ka 9 fshatra (Dedaj, Gjonaj, Gorozhup, Kojusha, Lukinaj, Planeja, Tupeci, Zymi dhe Milaj) që kanë probleme me kanalizim dhe ujësjellës.

Në krahasim me regjionin e Kabashit, Lumës dhe Vërrinit, regjioni i Anadrinisë ka më pak probleme infrastrukturore, regjioni i Lumës dhe Vërrinit kanë popullatë të banuar që ndryshon mes 9,080 dhe 14,210. Gati të gjitha fshatrat e Kabashit, Lumës dhe Vërrinit kanë probleme me kanalizimin, ujin e pijshëm dhe rrymën elektrike. Midis këtyre rajoneve, regjioni i Vërrinit ka densitet më të lartë të popullatës me 218.01 b/km$^2$. Të gjitha fshatrat e banuara me përjashtim të fshatrave të pabanuara në regjionin e Vërrinit (Kushtendili dhe Lezi), kanë probleme të theksuara në infrastrukturën e kanalizimit dhe rrjetit elektrik. Kjo tregon se rritja e popullatës dhe problemet e infrastrukturës theksojnë situatën urgjente në rajonin e Vërrinit. Pas Vërrinit vijnë për nga urgjenca e intervenimit në infrastrukturë teknike regjionet e Hasit, Kabashit dhe Lumës. Anadrini ka probleme më të pakta në krahasim me regjionet tjera.

Edhe pse regjioni i Zhupës ka karakteristika gjeografike malore, vetëm 5 fshatra (Gornjasella, Mushnikova, Pllanjani, Recana dhe Srecka) kanë probleme infrastrukturore. Këto fshatra ndodhen në arterien kryesore transportuese, por prapë se prapë kanë probleme me infrastrukturë.

**Tabela 1.115:** Densiteti i Popullatës dhe Problemet me Infrastrukturë

| | Popullata | Densiteti mesatar b/km2 | Numri i fshatrave | Sistemi i dobët i kanalizimit | Sistemi i dobët i ujit të pijshëm | Sistemi i dobët i rrymës elektrike |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Regjioni i Prizrenit | 7,880 | 162.01 | 8 | 4 | 6 | 3 |
| Regjioni i Hasit | 20,825 | 149.77 | 16 | 9 | 9 | 8 |
| Regjioni i Kabashit | 10,412 | 158.10 | 6 | 5 | 4 | 5 |
| Regjioni i Lumës | 14,210 | 213.40 | 4 | 3 | 2 | 3 |
| Regjioni i Anadrinit | 18,600 | 235.67 | 15 | 6 | 8 | 5 |
| Regjioni i Vërrinit | 9,080 | 218.01 | 8 | 7 | 6 | 7 |
| Regjioni i Zhupës | 11,980 | 74.90 | 13 | 4 | 2 | 4 |
| Gjithsej Rural | 92,987 | 154.81 | 70 | 38 | 37 | 35 |

*Numrat në tre kolonat e fundit rrjedhin nga vizita në teren*

### 1.2.4.5. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE AKTIVITET TURISTIKE

Në Komunën e Prizrenit, qendra e qytetit është nyja më e rëndësishme për trashëgiminë kulturore ku sidomos zona historike ka objektet më të rëndësishme turistike dhe kulturore qe tërheqin vizitorët (shiheni Trashëgiminë Kulturore në Prizren në seksionin 1.1.1.2). Regjioni i Hasit, Kabashit dhe Vërrinit kanë numër më të madh të aseteve të trashëgimisë kulturore sa i përket regjioneve gjeografike të Komunës së Prizrenit. Mirëpo vetëm në disa fshatra është cekur nevoja për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Vetëm kryetarët e Kojushës dhe Serbicës së Epërme kanë theksuar mundësinë e promovimit të trashëgimisë kulturore në fshatrat e tyre ndërsa asnjë nga këto nuk kanë të regjistruar ndonjë objekt të trashëgimisë kulturore nga autoritetet gjegjëse, por ndodhen në Has dhe Anadrini në afërsi të zonave me trashëgimi kulturore. Në anën tjetër, mundësitë për turizëm dhe akomodim janë përmendur më shumë në krahasim me trashëgiminë kulturore (Tabela 1.116).



Meqë numri më i madh i aseteve të regjistruara të trashëgimisë kulturore gjendet në regjionin e Hasit, Kabashit, Vërrinit dhe Zhupës (ku ndodhet Parku Nacional Malet e Sharrit), këto regjione janë bërë të rëndësishme me objektet e tyre hoteliere dhe mundësitë për zhvillimin e turizmit.

**Tabela 1.116:** Trashëgimia Kulturore dhe Aktivitetet Turistike

| Regjioni | Numri i fshatrave | Fshatrat | Objektet civile në trashëgimi kulturore | Objektet publike në trashëgimi kulturore | Objektet fetare në trashëgimi kulturore | Lokacionet urbane dhe komplekset në trashëgiminë kulturore | Lokacionet arkeologjike | Mundësitë për turizëm dhe akomodim | Mundësitë për trashëgiminë kulturore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | | | 66 | 26 | 44 | 7 | 2 | - | - |
| Prizren | 8 | Jabllanica | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| | | *Fshatrat tjera nuk kanë të regjistruar trashëgiminë kulturore* | | | | | | 2 | 0 |
| Hasi | 16 | Krajku | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| | | Kushnini | 0 | 3 | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| | | Lukinaj | 1 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | *Fshatrat tjera nuk kanë të regjistruar trashëgiminë kulturore* | | | | | | 7 | 1 |
| Kabashi | 6 | Kabashi* | 0 | 1 | 6 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| | | *Fshatrat tjera nuk kanë të regjistruar trashëgiminë kulturore.* | | | | | | 1 | 0 |
| Luma | 4 | *Asnjë fshat nuk ka të regjistruar trashëgiminë kulturore* | | | | | | 0 | 0 |
| Anadrini | 15 | Krusha e Vogël | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | *Fshatrat tjera nuk kanë të regjistruar trashëgiminë kulturore* | | | | | | 4 | 1 |
| Vërrini | 8 | Poslishti | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| | | Lezi* | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | *Fshatrat tjera nuk kanë të regjistruar trashëgiminë kulturore* | | | | | | 2 | 0 |
| Zhupa | 13 | *Në këtë regjion ndodhen 6 Zona të Veçanta të Mbrojtuna dhe Parku Nacional Malet e Sharrit* | | | | | | 2 | 0 |
| Totali | 70 | | 67 | 32 | 63 | 7 | 7 | 20 | 2 |

# 1.3. PRIZRENI NË KONTEKSTIN E GJERË HAPËSINOR DHE UDHËZIMET PËR PËRPILIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË PRIZRENIT

## 1.3.1. POZITA SPECIFIKE, RENDËSIA DHE ÇËSHTJET LIDHUR ME PRIZRENIN NË KONTEKSTIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR TË KOSOVËS

Dokumenti kryesor që identifikon pozitën specifike dhe rëndësinë e Prizrenit është Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^+$ (Figura 1.63). Plani Hapësinorë i Kosovës 2010-2020$^+$, e cila është rishtazi i miratuar në vitin 2010, është përdorur si dokument valid në rishikimin e Planit të paraqitur dhe Raportit të PZHKP 2025. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^+$ është një dokument që promovon interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim të përshpejtuar ekonomik, dhe njëkohësisht mbrojtjen e resurseve, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^+$ mbështet shpërndarjen hapësinore të zhvillimit, në nivel kombëtar, komunal dhe urban dhe gjithashtu hartimin e Strategjisë së Përgjithshme Zhvillimore të Kosovës.

Vizioni i Kosovës në bazë të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^+$, është sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë dhe forcë pune të kualifikuar; një Kosovë që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve, shoqëri e hapur që promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve duke respektuar të drejtat e të gjithëve (Tabela 1.117).



Strategjia e preferuar e zhvillimit hapësinor të Kosovës bazohet në zhvillimin e rrjetit të fuqishëm të qyteteve me zhvillim ekonomik, përmes resurseve njerëzore, ngritjes së bazës së njohurive, shfrytëzimit racional e të planifikuar të resurseve natyrore e kulturore, mundësi qasjeje në infrastrukturë fizike, sigurimit dhe ngritjes së kualitetit të jetës, barazisë sociale, duke synuar si qytete, konkurrencën në rajon, të gjitha këto të mbështetura nga kapacitetet organizative. Parimet kryesore të strategjisë së preferuar janë definuar në titujt vijues:

- Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban me zhvillim ekonomik
- Zhvillimi dhe konservimi i resurseve natyrore
- Zhvillimi i lidhjeve strategjike

Përveç kësaj, është parë nga plani i i miratuar rishtazi të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^+$, se plani paraqet një koncept hapësinor të zhvillimit që mbështet konceptin hapësinorë të zhvillimit të PZHKP 2025. Koncepti themelor i zhvillimit hapësinor, në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^+$, është definuar si koncept nyjore të zhvillimit me elemente të korridorit.

Koncepti nyjor i zhvillimit referohet përqendrimit të zhvillimit të ardhshëm në shtatë qendrat kryesore të Kosovës, dhe koncepti i korridoreve referohet zhvillimeve hapësinore përgjatë rrugëve, të cilat do të kontrollohen rreptësisht dhe nuk do të lejohen në tokat bujqësore të kategorive I deri IV. Ndryshe nga plani i më hershëm hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$ shton zhvillimin social, ruajtjen e trashëgimisë kulturore në mes të parimeve kryesore të strategjisë së zhvillimit hapësinorë.

**Tabela 1.117:** Vizioni dhe Qëllimet e Zhvillimit Hapësinor të Kosovës

**Kosova vend Sovran dhe i Integruar në Bashkësinë Evropiane**

- Kosova - Shtet demokratik dhe i pavarur,
- Vend i hapur dhe i integruar në rajon dhe më gjerë,
- Prishtina –kryeqytet - qendër administrative e politike,

**Arritja e zhvillimit social të balancuar me mundësi të barabarta të qasjes në shërbime për të gjithë**

- Hapësira adekuate për arsim, shëndetësi dhe kulturë,
- Arsimim cilësor dhe të vazhdueshëm për të gjithë,
- Sigurimi i banimit adekuat për të gjithë,
- Infrastrukturë dhe pajisje adekuate të teknologjisë informative,
- Sigurimi i mjedisit adekuat për zbatimin e reformave në arsim,
- Shpërndarje e barabartë e përmbajtjeve nëpër të gjitha trevat e Kosovës,
- Shpërndarje adekuate e arsimit profesional dhe arsimit të lartë,
- Shërbime mjekësore specialistike të decentralizuara,

**Zhvillim i qëndrueshëm dhe i balancuar hapësinor, ruajtja dhe respektimi i resurseve trashëgimisë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve'**

- Planifikimi i hapësirës për shfrytëzim racional të territorit,
- Mbrojtja e mjedisit,
- Zhvillim hapësinor i balancuar,
- Stimulimi i politikave të zhvillimit të zonave rurale,
- Shfrytëzimi i mineraleve për një zhvillim të qëndrueshëm,
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore,
- Rregullimi i ndërtimeve ilegale dhe vendbanimeve joformale,

**Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, i balancuar, i bazuar në resurse natyrore, njerëzore, teknologji moderne, konkurrencën e tregut dhe përmbushjes së standardeve për mbrojtjen e mjedisit**

- Krijimi i vendeve të reja të punës,
- Avancimi i teknologjisë prodhuese,
- Ngritja e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale,
- Krijimi i kushteve për konkurrencë në tregun rajonal,
- Arsimimi i vazhdueshëm i kuadrit profesional,
- Krijimi i mjedisit atraktiv për investitorë,

**Infrastruktura dhe komunikimi i integruar duke respektuar standardet e mbrojtjes së mjedisit**

- Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë,
- Përmirësimi i rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme,
- Shërbime publike cilësore,
- Kyçje në korridoret rajonale-evropiane,
- Bashkëpunim rajonal në zhvillimin e infrastrukturës,

Llojllojshmëri dhe cilësi të telekomunikimeve.

*Plani hapësinor i Kosovës* 2010-2020$^{+}$






*Plani hapësinor i Kosovës* 2010-2020+

**Figura 1.63:** Strategjia e Zhvillimit Hapësinor i Kosovës

Lidhur me strategjitë konceptet e zhvillimit hapësinor janë propozuar katër fusha ku Prizreni është qendra e “Kopshteve të Kosovës”. Regjioni ndodhet në jug të Kosovës, përfshirë këtu komunat e Suharekës, Dragashit dhe Prizrenit (Figura 1.64). Kjo zonë ka afro rreth 360.000 banorë, ku afër 65% të popullsisë jeton në vendbanime rurale ndërsa 35% në qytete (OSBE, 2000). Zona është e vendosur për turizmin kulturor, industrisë bujqësore, tregtisë dhe të shërbimeve, ku Prizreni ka një rol udhëheqës me vlerat e saja të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, potencialeve të turizmit rekreativë dhe turizmit kulturor (Figura 1.65).




*Plani Hapësinor i Kosovës* 2010-2020+

**Figura 1.64:** Zonat e veprimit strategjik






*Plani Hapësinor i Kosovës* 2010-2020+

**Figura 1.65:** Strategjia për Kopshtet e Kosovës

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, vizioni i Prizrenit është që të shndërrohet në zonë të zhvilluar kulturore e turistike, agro-industriale dhe tregtare ku Prizreni zhvillohet në rrënjët e traditës së lashtë, si qendër ekonomike moderne me qeveri lokale të përgjegjshme, aktivitete afariste private dhe zhvillim ekonomik lokal përmes shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe njerëzore si dhe krijimi i një mjedisi tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve afariste private dhe inkurajimin për shfrytëzimin më të mirë të potencialit ekonomik lokal dhe resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht në veprimtaritë e turizmit dhe bujqësisë.

Qëllimet e përgjithshme për Prizrenin në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ janë:

- Zhvillimi dhe përparimi i infrastrukturës fizike,
- Qeverisja efikase dhe administrata lokale që mbështet objektivat zhvillimore,
- Zhvillimi ekonomik lokal me promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
- Zhvillimi i pemëtarisë, vreshtarisë dhe blegtorisë,
- Zhvillimi i turizmit kulturor e malor, industrial shërbyes e tregtar, me mbrojtje të trashëgimisë natyrore kulturore.

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ në veçanti përshkruan një synim të përgjithshëm për zhvillimin e lidhjeve efektive brenda urbane, ndër-urbane me 5 hapësira të tjera dhe përtej saj nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës rajonale (rrugor, hekurudhor, të telekomunikacionit informativ etj.).



Ruajtja e burimeve natyrore është një nga parimet më të rëndësishme të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ duke marrë parasysh humbjen e cilësisë së tokës bujqësore; ndotjen e lartë ambientale; shfrytëzimin irracional te burimeve dhe rritja e pakontrolluar e vendbanimeve. Në veçanti konsiderata e trashëgimisë kulturore në Planin e miratuar rishtazi Hapësinorë të Kosovës 2010-2020+ është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e strategjive për mbrojtjen dhe zhvillimin e shtetit. Lidhur me këtë, Prizreni është një nyje e rëndësishme me trashëgimin e saj të pasur historike dhe kulturore si dhe me resurse mjedisore. Plani Hapësinor i Kosovës e përcakton rolin e Prizrenit si “Qytet Muze” për të kontribuar në krijimin e kushteve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillimin lokal ekonomik. Por duke u nisur nga strategjia, ka nevojë për një veprim të përqendruar në aspektin e mbrojtjes ambientale dhe të burimeve njerëzore, si dhe për promovim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, mbrojtjen e cilësisë së tokës bujqësore dhe promovimin e prodhimeve vendore, mbrojtje të resurseve minerale dhe përdorimin racional te tyre si dhe kontrollimin e rritjes së vendbanimeve.

Strategjia e dytë e planit fokusohet në zhvillimin e lidhjeve strategjike përfshirë këtu edhe integrimin me rrjetin transportues rajonal dhe evropian, përmirësimin e formave të transportit, furnizim të qëndrueshëm me rrymë elektrike për nevoja lokale dhe rajonale, si dhe ofrimin e

sasive të mjaftueshme të ujit për amvisëri dhe industri. Prizreni ka përparësitë e saja për ndërtimin e linjave strategjike sepse ka një popullatë të trajnuar dhe të edukuar, burime të mjaftueshme të ujit dhe lidhjet e mira transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet rrethuese. Po ashtu Prizreni posedon potencial të lartë për zhvillimin e lidhjeve strategjike të kualitetit të lartë në bazë të zhvillimit të orientuar kah turizmi dhe logjistika brenda Kosovës dhe Evropës. Siç pritet nga një strategji, ajo do ta udhëheqë Prizrenin kah reduktimi i papunësisë, do t'i kontribuojë zhvillimit më të barabartë, do të ofrojë cilësi më të lartë të zhvillimit në pjesët rurale, po ashtu do të jetë udhëzues për përdorimin e rrjetit të fortë urban të zhvillimit ekonomik në realizimin e qëllimeve për një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Plani në veçanti thekson zonat e interesit të veçantë brenda rajonit të cilat pikat e kufijve të këtyre zonave janë në Vërmicë, Parku Nacional (Malet e Sharrit), zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike, zonat e mbrojtura rreth lumenjve Drini i Bardhë, Lumëbardhi, akumulimi në fshatin Dragaqinë, zonat e kullosave në komunën e Dragashit dhe në korridorin e autostradës Merdare – Durrës. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$ gjithashtu thekson edhe zonat e veçanta të mbrojtura. Çështjet specifike që duhet të trajtohen në Prizren sa i përket Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$ janë mungesa e planifikimit urban, ndërtimet ilegale që shfrytëzojnë resurset në mënyrë të pakontrolluar, mungesa e koordinimit institucional në mes të qeverisë lokale dhe komunitetit afarist dhe komunave fqinje, administrate e dobët lokale, shkalla e lartë e papunësisë, prezenca e ekonomisë jo formale, humbja e tokës bujqësore, zgjerimi i vendbanimeve në tokat bujqësore, zgjerim horizontal i vendbanimeve dhe degradimi i trashëgimisë kulturore.



### 1.3.2. INFORMATAT KYQE TË RAPORTEVE EKZISTUESE SEKTORIALE DHE STRATEGJIVE

**Plani për Konservimin dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit**

Ka shumë programe dhe projekte që kanë të bëjnë me konservimin në Prizren. Një pjesë e rëndësishme e strategjisë zhvillimore dhe investimeve në infrastrukturën kulturore të qytetit është edhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore me qëllim të krijimit të kushteve normale për përdorimin e këtyre objekteve për aktivitetet kulturore. Në këtë aspekt ka aktivitete konstante si kontakte, vizita dhe forma të tjera të bashkëpunimit me qëllim të arritjes së përvojës së nevojshme për prezantimin e duhur dhe profesional të aktiviteteve kulturore. Disa nga këto aktivitete janë: ekspozita – trashëgimia arkitektonike dhe urbane e Prizrenit, konferenca ndërkombëtare "Politikat Kulturore të Qyteteve" në Selanik të Greqisë, punëtoria e ekspertëve të organizuar nga Kolping Kosova dhe Asociacioni Numizmatik "Demastion" – "ruajtja e qytetit të vjetër të Prizrenit", Perlat e kulturës kombëtarë të Prizrenit

etj. (Raporti mbi Profilin Zhvillimor Hapësinor të Prizrenit dhe vështrimi i Komunës së Prizrenit).

Në raportin mbi Profilin Zhvillimor Hapësinor të Komunës së Prizrenit thuhet se ka nevojë urgjente për veprim në aspektin e ruajtjes së karakteristikave historike të Prizrenit, nga ana e të gjitha institucioneve përfshirë këtu edhe Entin për Mbrojtjen e Monumenteve, drejtoritë komunale dhe Ministrinë e Kulturës. Duhet të bëhet çmos për të ndaluar ndërtimin ilegal e cila është jashtëzakonisht përbuzëse ndaj karakterit historik të qytetit. Paralelisht me angazhimin e ekspertëve për restaurim dhe ruajtje të trashëgimisë kulturore, duhet të shqyrtohen të gjitha mjetet e mundshme financiare për implementimin e këtyre objektivave.

Një nga organizatat më aktive në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë është Cultural Heritage Without Borders (CHWB) që vepron që nga viti 2001. CHWB-ja ka themeluar një zyrë lokale në Prishtinë për përkrahjen dhe mbikëqyrjen e projekteve që kanë të bëjnë me konservim. Kjo organizatë organizon seminare, ekspozita dhe punëtori jo vetëm në Prizren por edhe ne qytete tjera dhe përkrah shumë projekte si: trashëgimia kulturore e Dukagjinit, projektin e kullës së Isa Buletinit në Zveçan dhe restaurimin e xhamisë së Hadumit në Gjakovë.



Ne maj të vitit 2006, Komuna e Prizrenit ka nënshkruar me CHWB-në një memorandum të mirëkuptimit për implementimin e programit rehabilitues të Zonës Historike të Prizrenit. Ky program përfshin komponentë të ndryshëm e të rëndësishëm në aspektin e ruajtjes dhe zhvillimit të zonës historike. “Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit” është hapi i parë konkret kah planifikimi i ruajtjes së zonës historike. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikimin e zhvillimit urban është me rëndësi të madhe për ruajtjen dhe zhvillimin e zonave historike në qendrat urbane. Kjo është një nga iniciativat e para të këtij lloji në Komunat e Kosovës për përpilimin e Planit Konservues të Zonës Historike.

Plani për ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit është produkt i Programit Rehabilitues të Zonës Historike të Prizrenit. Si rezultat i protokollit të nënshkruar në mes të OJQ-së Suedeze CHWB dhe Qendrës Hulumtuese të Planifikimit Urban dhe Ambiental të Universitetit Teknik të Stambollit, është bërë një studim i Planit për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit (Figura 1.66).

Plani për ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit ka prodhuar propozime për planifikim në aspektin e çështjeve fizike, shfrytëzimit të tokës, transportit dhe të atyre që kanë të bëjnë me konservimin. Në propozimet e dizajnit, plani ka përmirësuar direktivat për dizajnin urban ku janë futur propozimet strukturale si për shembujt monumentale dhe arkitekturale ashtu edhe për aplikacionet në mes të ndërtesave. Sa i përket arkitekturës civile

dhe monumentale, intervenimet janë përcaktuar në kuadër të parimeve të konservimit dhe ruajtjes. Për aplikacionet në mes të ndërtesave, propozimet strukturale janë nënvizuar me llojet e propozuara të ndërtimi në harmoni me arkitekturën tradicionale. Sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit, duhet të zbatohen intervenimet në arkitekturën civile, në rastin e mbrojtjes, pastrimit dhe mirëmbajtjes, restaurimit, rindërtimit, renovimit të fasadave. Plani ekzaminon këto elemente në kapitujt e vëllimit, fasadës, detajet dhe ornamentet dhe propozimi i pamjes së rrugëve (Figura 1.66) (Gulersoy Zeren, et.al, 2008).

Sipas parimeve të përdorimit të tokës, zona urbane historike e Prizrenit është rirregulluar me lloj-lloj përdorime të tokës dhe aktivitetet që synojnë zhvillimin e cilësisë urbane me modelin urban tradicional. Akomodomi dhe shtëpitë, shërbime komerciale dhe kulturore-turistike në katet përdhes dhe tregtia me pakicë në harmoni me shkallën dhe madhësinë e përdorimit të zonës urbane të zonës urbane historike janë propozuar për nën zonat e përshtatshme. Në bazë të planit për konservim dhe zhvillim, veprimtaritë komerciale dhe prodhuese nuk janë në harmoni me modelin tradicional prandaj është propozuar decentralizimi i tyre jashtë zonës urbane historike. Ky plan po ashtu parasheh rrugët shërbyese, rrugë këmbësorie, segregimin e qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve në zonën bërthamore të pjesës historike (Gulersoy Zeren, et.al, 2008).






*Gulersoy Zeren, et.al, 2008*

**Figura 1.66:** Dizajni i Planit për Konservimin dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit




*Gulersoy Zeren, et.al, 2008*

**Figura 1.67:** Plani për Konservimin dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizreni

**Plani Hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr"**

Plani Hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr" rekomandon veprim të organizuar dhe të koordinuar të gjitha strukturave të involvuar dhe kërkon strategji dhe planifikim afatgjatë të bazuar në rezultatet e proceseve hulumtuese dhe planifikuese. Për të përballuar shfrytëzimin e pakontrolluar të vlerave natyrore dhe degradimin mjedisor në parkun nacional, plani propozon një kornizë në gjashtë sfidat e identifikuara në SWOT analizë.

Vizioni i planit është definuar në tre deklaratat e mëposhtme:

- Një Park i menaxhuar me kujdes për gjeneratat e ardhshme, me llojllojshmëri biologjike, peizazh karakteristik, vendbanime përreth, dhe kulturë të jetës tradicionale e cila vlerësohet, ruhet dhe zhvillohet
- Një park ku gjenerohet profit nga aktivitetet ekonomike dhe turistike në favor të komunitetit dhe mbrojtjes së ambientit
- Një park me qasje të lehtë që krijon mundësi dhe kënaqësi për turistët, rekreim, sport, aktivitete hulumtuese dhe kulturore në çdo kohë.

Në plan përcaktohen tri zona të mbrojtjes ambientale në kuadër të parkut nacional. Zona e parë definohet si rezervat strikt natyror ku nuk guxon të ketë aktivitete ekonomike por vetëm shtigje këmbësorie për vizitorët. Në zonën e dytë, parashihet një zhvillim i kufizuar ekonomik ku duhet të krijohet infrastruktura teknike vetëm për transportin e skiatorëve dhe aktivitete tjera turistike. Zhvillimi dhe aktivitetet ekonomike janë propozuar në zonën e trete duke respektuar kushtet dhe konceptin e qëndrueshmërisë. Këto aktivitetet përfshijnë turizmin sportiv, turizmi veror dhe dimëror, turizmi shëndetësor, ekoturizmin, turizmi rural dhe kulturor, turizmi hulumtues dhe shkencor, turizmi alpin dhe turizmi çiklistik etj.



**Raporti Nacional për Transportin në Kosovë (nën UNSCR 1244)**

Raporti i përpiluar për sektorin e transportit në Kosovë në Maj të vitit 2009, fillimisht ka për qëllim të jep një pasqyrë të përgjithshme për zhvillimet në sektorin e transportit në Kosovë e cila përbëhet nga rrugët, hekurudha dhe sektori ajror. Raporti përmban të dhëna për sistemin e transportit në Kosovë dhe jep një përshkrim të projekteve në këtë sektor që janë zbatuar pas luftës në Kosovë. Po ashtu përmban të dhëna për organizimin institucional, socio-ekonomik dhe financiar të këtij sektori. Po ashtu përmban SWOT analizën e sektorit të transportit duke saktësuar potencialet, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet si dhe në raportin në përputhje definon prioritetet e sektorit të transportit në Kosovë.

**Letra me Prapavijë Teknike të Sektorit të Transportit**

Raporti i vitit 2008 definon strategjitë dhe sfidat e sektorit të transportit sa i përket kufizimeve në infrastrukturë, papërshtatshmërinë e shpenzimeve, rritjen e kërkesës, jo efikasiteti i kornizës institucionale dhe dobësitë e organizimit të sektorit të transportit. Raporti jep një vizion për zhvillimin e sektorit dhe përshkruan strategjitë për arritjen e përmirësimit në rrjetin rrugor dhe sigurinë në rrugë. Raporti më tutje i rendit prioritetet në tre nën sektorë: transportin urban, hekurudhën dhe aviacionin. Më pastaj, përmenden shpenzimet e duhura dhe të ardhurat e parapara.

**Strategjia e Energjisë së Kosovës**

Strategjia e energjisë e Kosovës e përpiluar në Korrik të vitit 2005 është kornizë fondamentale e bazuar në objektivat dhe prioritetet zhvillimore të sektorit të energjisë. Raporti ka të bëjë me menaxhimin efektiv të burimeve aktuale energjetike dhe zhvillimin e burimeve të reja, duke siguruar një mbrojtje ambientale të bazuar në standardet e pranuara ndërkombëtare. Raporti përfshin analizën e ambientit institucional, situatën aktuale dhe parashikimet e kërkesës për energji. Vlerësimi i sektorit energjetik të Kosovës është bërë duke definuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Pas përcaktimit të objektivave strategjike, janë dhënë edhe masat dhe veprimet për realizimin e tyre.



**Rishqyrtimi i Studimit të Fizibilitetit të Hidro Centralit në Zhur duke përfshirë Përgatitjen e Vlerësimit Preliminar të Ndikimit Ambiental dhe Social**

Raporti i fizibilitetit të Hidrocentralit të Zhurit është vlerësimi i Hidrocentralit të Zhurit dhe efektet e tij në gjenerimin dhe furnizimin me rrymë elektrike. Hidrocentrali i Zhurit është një sistem i cili përbëhet nga dy impiante HC Zhur I dhe HC Zhur II. Ky hidrocentral gjendet në veriperëndim të qytetit të Prizrenit. HC Zhur I gjendet afër fshatit Zhur ndërsa HC Zhur II gjendet në lumin Drini i Bardhë.

Raporti i fizibilitetit të Hidrocentralit të Zhurit përmbledh të gjitha efektet favorizuese gjatë operimit të projektit siç është më shumë rend në zonën e planifikuar për projekt; sasi të mjaftueshme të ujit për ujitje; rritje të lagështisë së ajrit dhe rritjes së precipitimit që me siguri do të ketë ndikim favorizues në rritjen e zonave dhe produkteve pyjore. Në aspektin sociologjik dhe demografik, nëse ndërmerren masat parandaluese, projekti i planifikuar nuk do të rrezikojë jetën dhe kushtet e popullatës lokale, do të ndalojë migrimin, nuk do të rrezikojë jetën afariste dhe nuk do të kontaminojë burimet natyrore të zonës në fjalë. Në raport po ashtu thuhet se pas ndërtimit, toka mund të përdoret edhe për veprime turistike apo rekreacionale. Një efekt tjetër i projektit është edhe punësimi i përkohshëm apo permanent i fuqisë lokale punëtore gjatë implementimit të projektit.

## 1.3.3. ÇËSHTJET KRYESORE TË KONTEKSTIT TË GJERË HAPËSINOR, QË PËRFSHIJNË UDHËZIMET PËR PLANIFIKIM DHE OBLIGIMET LIDHUR ME KOMUNËN E PRIZRENIT

### 1.3.3.1. Vizioni i Integruar i Prizrenit

Udhëzimi me emrin “Vizioni i Integruar i Prizrenit”,i përgatitur nga Komuna e Prizrenit dhe UN HABITAT në mars të vitit 2008, i jep Prizrenit një rol të rëndësishëm si qendër e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me një ekonomi që krijon potenciale për zhvillimin e shoqërisë tolerante ku sundon ligji. Dokumenti është i strukturuar në pesë fusha kryesore të intervenimit në aspekt të zhvillimit komunal (Figura 1.68).

**PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS 2010-2020+**

**Zhvillim i ekuilibruar shoqëror, me mundësi të barabarta të qasjes në shërbimet për të gjithë**

**Zhvillim hapësinor i qëndrueshëm dhe i balancuar, mbrojtja dhe respektimi i burrimeve natyrore dhe kulturore**

**Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe i balancuar, ndërtuar mbi resurset natyrore dhe njerëzore, teknologji moderne, konkurrencën e tregut dhe zbatimin e standardve të mbrojtjes së mjedisit**

**Infrastruktura dhe komunikimi i integruar, duke respektuar standarted për mbrojtjes e mjedisit**

| zhvillimi i një rrjeti të forte urbane të zhvillimit ekonomik | zhvillimi dhe konservimi i resurseve natyrore | zhvillimi i lidhjeve strategjike |
| --- | --- | --- |

**Kopshtet e Kosovës: Prizreni, turizmi kulturor, industria bujqësore, tregëti dhe shërbime**

**Zhvillimi Urban dhe Rural dhe Planifikimi**
**Mjedisi ekonomik dhe Bujqësia**
**Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore**
**Lëvizshmëria dhe Transporti**
**Infrastruktura dhe Shërbimet Publike**

**VIZIONI I INTEGRUAR I PRIZRENIT**



**Figura 1.68:** Qëllimet e rekomanduara në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ dhe Vizionin e Integruar të Prizrenit

Këto janë:

- Zhvillimi Urban dhe Rural dhe Planifikimi
- Mjedisi ekonomik dhe Bujqësia
- Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore
- Lëvizshmëria dhe Transporti
- Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

Fusha e parë për intervenim është zhvillimi dhe planifikimi urban dhe ai rural. Qëllimi i parë është paraqitja e zhvillimit urban të organizuar dhe implementimi i përdorimit racional të tokës më qëllim të paraqitjes së organizmit të qëndrueshëm të vendbanimeve, përmirësimi i kushteve jetësore, përdorimi efikas i burimeve ekzistuese kryesisht toka dhe infrastruktura dhe përdorimi i duhur i tokës bujqësore. Qëllimi i dytë është themelimi dhe përkrahja e skemës së zhvillimit hapësinor policentrik në sipërfaqen e komunës së Prizrenit për përkrahjen e zhvillimit më të balancuar në mes të qendrës kryesore dhe qendrave më të vogla në zonën rurale, për ndërtimin e partneritetit të zhvillimit urban-rural dhe të ul shtypjen e urbanizimit në qytetin e Prizrenit. Fusha e dytë për intervenim është lëvizshmëria dhe Transporti. Synimi i saj është përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit regjional për përkrahjen e zhvillimit në pjesët rurale dhe zhvillimin policentrik përmes qasjes së lehtë në infrastrukturë dhe shërbime të ofruara në nën-qendra. Është sugjeruar zgjerimi dhe rregullimi i rrjetit të transportit ndërshtetëror me qëllim për ta lidhur komunën me vendet fqinje të regjionit dhe për ta lehtësuar shkëmbimin e mallrave. Pos kësaj, ky intervenim siguron përkrahjen e lëvizshmërisë private dhe publike  të sigurt dhe të përshtatshme në qendrën urbane dhe përmirësimin e trafikut urban dhe parkingut, kryesisht në qendrën historike. Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore janë fusha e tretë për intervenim. Synimi i saj është mbrojtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore në pjesët urbane dhe rurale po ashtu edhe i burimeve natyrore si tipare të rëndësishme të komunës. Mjedisi ekonomik dhe Bujqësia paraqesin fushën e katërt për intervenim. Synimi i saj është përgatitja e infrastrukturës së butë e të fortë për përkrahjen e aktiviteteve private dhe investimeve, përkrahja e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, zhvillimi i politikave bujqësore në nivelin regjional. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike është fusha e pestë për intervenim që synon përmirësimin e  kualitetit të shërbimeve publike, ngritjen e kapacitetit dhe kualitetit të infrastrukturës teknike dhe zgjerimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës.

### 1.3.3.2. PLANI ZHVILLIMOR URBAN I PRIZRENIT 2003-2013

Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit është përgatitur nga Komuna e Prizrenit më 2003 dhe paraqet një plan dhjetë vjeçar për zhvillimin e qëndrueshëm të qendrës së Prizrenit .

Qëllimet e planit janë:

- Sigurimi i zhvillimit social që do t'i përgjigjej nevojave të secilit.
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- Promovimi i zhvillimit lokal ekonomik
- Sigurimi i përdorimit të kujdesshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtja e ambientit.
- Mbështetja dhe koordinimi i moduleve të trafikut
- Ofrimi i cilësisë në ndërtimtari

Qëndrueshmëria është koncepti themelor i Planit Zhvillimor Urban. Qëndrueshmëria në rastin e Prizrenit do të thotë rehabilitimi i cilësisë së jetës, sigurimin e kushteve më të mira të jetës për fëmijët, promovimi i inkuadrimit social dhe integrimi i qëllimeve mjedisore në trendët socio ekonomike. Ruajtja e trashëgimisë kulturore përmendet si bazë për ruajtjen e qëndrueshmërisë sociale dhe ekonomike të Prizrenit. Plani sugjeron që parimet fondamentale të ruajtjes të trashëgimisë kulturore janë përdorimi i saj për zhvillime turistike. Zhvillimi lokal ekonomik është parësor për qëndrueshmëri në bazë të këtij plani. Për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duhet balancimi i zhvillimit në mirëqenien ekonomike dhe kualitetin e jetesës me perspektivat afatgjata ekonomike. Esenca e zhvillimit të qëndrueshëm urban të Prizrenit varet nga qeveria lokale. Plani nënvizon nevojën për informim dhe edukim të shoqërisë sidomos duke promovuar menaxhimin pjesëmarrës, përfaqësimin dhe koordinimin.



Sa i përket këtyre qëllimeve, plani propozon strategji të hollësishme për decentralizim strategjik, modelet e rritjes urbane, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, zhvillim social, vitalitet ekonomik, infrastrukturë publike, trafik të integruar, mbrojtje të ambientit, cilësi urbane dhe strategji zbatuese.

## 1.4. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTIVE KOMUNALE

Vlerësimi i Kapaciteteve Investive Komunale është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financim të zbatimit të Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe drejtimit të Investimeve Kapitale Publike nga sektori publik si dhe nga ana e sektorit privat.

Siç tregohet në Planin Hapësinor të Kosovës, në rrethanat e Kosovës vlerësimi i kapaciteteve investive (sektorët dhe burimet) ka rëndësi të veçantë duke pasur parasysh nevojën për mobilizimin e të gjitha burimeve të investimeve. Kjo sidomos ka rëndësi për të vlerësuar sidomos kapacitetet e investimeve publike. Vëllimi dhe burimet e investimeve sipas Planit Hapësinor të Kosovës janë dhënë në Tabelën 1.118.

**Tabela 1.118:** Vëllimi dhe burimet e investimeve (në miliona euro)

| | 2004 - 2015 |
|---|---|
| Investimet | 14,488 |
| Private | 8,596 |
| Qeveria | 3,662 |
| Donatorët | 961 |

*Plani Hapësinor i Kosovës*2010-2020+



Nga aspekti i burimeve, investimet kryesisht do të gjenerohen nga sektori privat. Gjatë kësaj periudhe ato do të kenë pjesëmarrje dominante (70%), ndërsa buxheti i Kosovës vlerësohet të ketë pjesëmarrje prej 30% në gjithsej investime. Është për tu pritur se komuniteti ndërkombëtar do ta reduktojë mbështetjen me ndihma në favor të mbështetjes me fonde strukturore.

Projeksionet e strukturës indikativë të investimeve për periudhën 2010-2020+ janë bërë duke u bazuar në tre faktorë (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+).

- Trendët ekonomike të pasluftës në Kosovë
- Planifikimet e bëra nga institucionet kosovare me theks të veçantë në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit
- Përvojat nga vendet tjera, sidomos ato to vendeve fqinje dhe vendeve në tranzicion,

Tabela 1.119 paraqet shumën e planifikuar për investime të ndara sipas sektorëve kryesor.

**Tabela 1.119:** Struktura e investimeve në miliona euro dhe shkalla

| Sektori i Investimeve | Shuma e planifikuar (milion euro) | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| Energjia | 1.85 | 12.7 % |
| Bujqësia | 0.72 | 5.0 % |
| Edukimi | 1.44 | 10.0 % |
| Ndërtimi/Banimi | 2.1 | 14.5 % |
| Industria | 3.85 | 26.5 % |
| Tregtia/Shërbimet | 2.65 | 18.3 % |
| Transporti | 0.65 | 4.5 % |
| Telekomunikimi | 0.65 | 4.5 % |
| Shëndetësia | 0.43 | 3.0 % |
| Totali | 14.346 | 100 % |

Komuna e Prizrenit sikurse shume qytete tjera të Kosovës doli nga lufta e shkatërruar, me infrastrukturë të papërshtatshme për punë dhe jetë. Si pasojë e luftës së vitit 1999, shumë objekte të ndërmarrjeve industriale u dëmtuan rëndë dhe një pjesë e tyre pushuan së funksionuari. Humbja e tregjeve të ndërmarrjeve që kanë ekzistuar para luftës, në ish republikat e Jugosllavisë, ka rezultuar në mungesën e investimeve direkte për rinovimin e infrastrukturës ekzistuese industriale dhe futjen e teknologjive te reja në prodhim



Siç është cekur në raportin e Profilit Komunal, potenciali buxhetor i Komunës sonë nuk mundet ti plotësojë nevojat më se imediate, andaj është e domosdoshme për të gjetur ende kapacitete te mundshme për financimin e projekteve kapitale me rëndësi të veçantë për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

## 1.5. SFIDAT KRYESORE ZHVILLIMORE

Prizreni ka një rol të rëndësishëm si qendër e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe udhëkryq në Kosovë dhe më gjerë me potencialet dhe burimet e saja sociale, ekonomike dhe natyrore që mund të përdoren për një zhvillim të qëndrueshëm. Për hir të ndryshimeve të theksuara politike, sociale dhe ekonomike gjatë periudhave të caktuara kohore, Prizreni ka pësuar fluktuacione të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe social. Sot Prizreni ballafaqohet me shume sfida në menaxhimin e territorit dhe burimeve të saja. Këtu hyjnë ndikimet e rënies ekonomike, shkalla e lartë e papunësisë, ekonomia jo e zhvilluar, mungesa e prodhimit industrial dhe bujqësor si dhe mungesa e investimeve për infrastrukturën urbane. Prizreni po ashtu lëngon nga degradimi ambiental, shpresat e vogla individuale si dhe migrimi i vazhdueshëm.

Kjo pjesë e raportit thekson sfidat kryesore zhvillimore të Komunës së Prizrenit duke pasur parasysh vërejtjet dhe gjetjet e Fazës së parë: Profili i Zhvillimit Hapësinor dhe Analiza e Gjendjes. Në pjesën e fundit të Profilit komunal janë theksuar një sërë sfidash të cilat duhet të zgjidhen në rrugëtimin kah vizioni i Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit. Strategjitë dhe propozimet zhvillimore duhet të përpilohen me një qasje të integruar duke kombinuar sfidat e definuar si me poshtë:



- Sfidat në aspektin ligjor
- Sfidat që kanë të bëjnë me ambientin fizik
- Sfidat në aspektet sociale
- Sfidat në aspektet ekonomike

### 1.5.1. SFIDAT NË ASPEKTET LIGJORE

Sfidat zhvillimore në aspektet ligjore janë kryesisht të lidhur me rregulloret dhe udhëzimet për çështjet e planifikimit dhe ato ambientale. Këto sfida janë:

- Mungesa e ligjeve dhe rregulloreve lidhur me çështjet e planifikimit dhe ato të mjedisit
- Mungesa e strategjive dhe politikave urbane të banimit
- Statusi i padefinuar i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare lidhur me çështjet e planifikimit dhe ato të mjedisit.
- Pamjaftueshmëria e dokumentacionit dhe arritjes së standardeve dhe normave në çështjet e planifikimit dhe çështjet ambientale.
- Pamjaftueshmëria e programeve që adresojnë planifikimin dhe çështjet mjedisore dhe sidomos trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

Si aspekte ligjore janë marrë në konsideratë legjislacioni i strukturave qeveritare dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës, ku ekziston një mungesë e ligjeve dhe rregulloreve në çështjet e planifikimit dhe mjedisit. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ po ashtu thekson disa nga këto sfida, sidomos mungesën e politikave dhe strategjive për çështjet e banimit. Edhe pse Kosova ka mjaft institucione qeveritare dhe joqeveritare për planifikim dhe çështje ambientale, statusi i tyre fatkeqësisht nuk është definuar në mënyrë efikase në proceset e menaxhimit dhe planifikimit që ka rezultuar në pamjaftueshmërinë e dokumentacionit dhe arritjes së standardeve dhe normave në çështjet e planifikimit dhe çështjet ambientale. Gjatë fazave të para të Planit Zhvillimor Komunal, grumbullimi i të dhënave ishte sfida kryesore në përpjekjet për vendosjen profilit zhvillimor hapësinor dhe analizën e gjendjes. Kjo sfidë është theksuar edhe në raportin për profilin zhvillimor të Komunës së Prizrenit. Pamjaftueshmëria e programeve që adresojnë çështjet e planifikimit dhe ato ambientale, sidomos të çështjeve që kanë të bëjnë me trashëgiminë natyrore dhe kulturore, kanë shkaktuar një ekspansion të pakontrolluar urban dhe ndryshim të ambientit fizik.

### 1.5.2. SFIDAT QË KANË TË BËJNË ME AMBIENTIN FIZIK

Sfidat zhvillimore në aspektet që kanë të bëjnë me ambientin fizik janë kryesisht të lidhur me ambientin natyror dhe degradimin e ambientit. Pos këtyre, sfidë tjetër që duhet marrë në konsideratë janë edhe vendbanimet që gjenden në infrastrukturë të dobët fizike. Sfidat zhvillimore në aspektet që kanë të bëjnë me ambientin fizik janë: 

- Ndotja dhe degradimi i ambientit
- Përdorimi i pamjaftueshëm dhe joracional i burimeve natyrore
- Uzurpimi i tokës bujqësore për qëllime ndërtimi
- Humbja e tokës bujqësore
- Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni
- Zgjerimi i pakontrolluar dhe i paplanifikuar urban
- Pamjaftueshmëria e objekteve urbane
- Papërshtatshmëria e rrjetit rrugor
- Infrastruktura e dobët teknike (kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i plehut, elektriciteti)

Sfida më madhe ambientale e Komunës së Prizrenit është përdorimi joracional i burimeve natyrore, që rezulton në ndotjen dhe degradimin e ambientit. Zhvillimi i paplanifikuar i tokës bujqësore që del nga përdorimi i tokës bujqësore për ndërtim të vendbanimeve përgjatë rrugëve kryesore regjionale, ka rezultuar në humbjen e tokës bujqësore.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E PRIZRENIT – ITU QENDRA HULUMTUESE E PLANIFIKIMIT URBAN DHE AMBIENTAL – URBAN DESIGN STUDIO – PLAN ART

Edhe pse Prizreni ka potencial të lartë të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, fatkeqësisht asetet e kësaj trashëgimie janë duke u degraduar po ashtu. Përdorimi i burimeve natyrore dhe kulturore si dhe asetet e trashëgimisë në mënyrë të kontrolluar do të rezultonte në faktin që edhe gjeneratat e ardhshme do të përfitonin nga kjo.

Ndërtimet ilegale në zonat urbane dhe ato rurale kanë si pasojë ekspansionin e pakontrolluar urban që duhet të parandalohet në mënyrë që të arrihet një zhvillim më i mirë. Ekspansioni i pakontrolluar urban ka bërë që sfidat lidhur me pamjaftueshmërinë e objekteve dhe infrastrukturës urbane të fitojnë në rëndësi si dhe të mendohet për zhvillimin e komunikimit optimal dhe përmirësimin e ambientit fizik. Infrastruktura e dobët teknike:kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i plehut, elektriciteti etj, ka rritur efektin e dëmshëm të cilësisë urbane dhe ambientale të zonave rurale.

### 1.5.3. SFIDAT NË ASPEKTET SOCIALE

Sfidat në aspektet sociale karakterizohen kryesisht me papunësinë dhe varfërinë si dhe mungesën e objekteve sociale në Komunën e Prizrenit. Këto sfida janë:

- Humbja e popullatës për shkak të migrimit në vendet e jashtme të popullsisë së re që shkojnë për të jetuar dhe punuar.
- Shkalla e lartë e papunësisë dhe mundësitë e kufizuara për punësim për të rinjtë si rezultat i moshës së lartë të pensionimit.
- Mungesa e shfrytëzimit të resurseve humane
- Pamjaftueshmëria e objekteve shëndetësore, arsimore dhe sociale në zonat urbane dhe rurale.



Për të arritur kontekstin social për zhvillim, duhet ballafaquar me papunësinë, sidomos të popullatës së re, që paraqet sfidën kryesore gjë që ndërlidhet me aspektet ekonomike. Kur të merren parasysh sfidat e aspekteve tjera, del në pah kërkesa relativisht e lartë për krijimin e qytetit të qëndrueshëm ekonomik dhe rritjen e mundësive për punësim me synim të ngritjes së prosperitetit të qytetarëve që jetojnë në Prizren. Menaxhimi adekuat i investimeve dhe ndërmarrjeve ekonomike do të rezultonte në tejkalimin e barrierave jo vetëm sa i përket rritjes së tregjeve por edhe për ngritjen e cilësisë së jetës dhe mirëqenies sociale në Prizren.

Në përgjithësi, niveli i objekteve shëndetësore, edukative dhe sociale është i ulët në Prizren, si rrjedhojë e saj ka zona urbane dhe fshatra që janë pa këto shërbime sociale e në disa raste as që kanë qasje ndaj tyre. Prandaj del se nevoja për përmirësimin e kushteve lidhur me këto shërbime sociale është imediate.

### 1.5.4. SFIDAT NË ASPEKTET EKONOMIKE

Sa i përket sfidave në aspektet ekonomike, humbja e tregjeve dhe mungesa e investimeve janë çështjet kryesore që ndikojnë në çështjet tjera lidhur me papunësinë dhe varfërinë. Prodhimi industrial dhe ai bujqësor si aktivitete primare ekonomike në Prizren, ballafaqohen me sfidat e mëposhtme:

- Mungesa e prodhimit të organizuar bujqësor dhe industrial,
- Humbja e tokës bujqësore
- Aktivitetet ilegale ekonomike
- Humbja e tregjeve dhe mungesa e investimeve
- Mungesa e akomodimit dhe objekteve shërbyese ushqimore për zhvillimin e turizmit
- Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë.

Edhe përkundër ekzistimit të potencialit për punimin e tokës bujqësore, aktivitetet mbështetëse për një prodhimtari të organizuar bujqësor në Komunën e Prizrenit nuk janë efikase. Problemi më i madh ekonomik me të cilën ballafaqohet Prizreni është papunësia dhe varfëria sidomos e të rinjve që karakterizohet me një trend spektakular të deindustrializimit, humbja e tregut dhe mungesa e investimeve. Mbyllja e aktiviteteve industriale dhe sfidat tjera ekonomike drejtpërdrejtë ndikojnë në kontekstin social të Prizrenit dhe rezultojnë me migrimin e fuqisë së kualifikuar punëtore.



Pos kësaj, Prizreni nuk ka infrastrukturë efiçiente për prodhimtari apo shërbime, akomodim, turizëm, shërbime të ushqimit etj. Edhe pse Prizreni ka potencial të lartë të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, sidomos në qendër të qytetit dhe në Malet e Sharrit, mungojnë programet që adresojnë zhvillimin e turizmit dhe trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Prandaj mund të thuhet se arsyeja për një ambient të pazhvilluar ekonomik është mungesa e programeve financiare dhe sociale që mund të shfrytëzojnë potencialet ekzistuese të Prizrenit.

# 2. VIZIONI, PARIMET DHE QËLLIMET

Kjo pjesë paraqet perspektivën e zhvillimit për Komunën e Prizrenit duke përfshirë vizionin, parimet e përgjithshme për zhvillim, qëllimet (synimet) afatgjate dhe prioritetet strategjike. Procesi i parashikuar i PZHKP 2025 përfshinë rolin dhe prioritetet e marra (vendosura) nga anketimet e bëra me 75 kryetarë të fshatrave në mars dhe prill të vitit 2009, PZHKP 2025 parasheh rezultatet e marra nga forumet (takimet) publike të mbajtura në qershor të vitit 2009, planet e mëparshme, raportet sektoriale dhe udhëzimet duke përfshirë Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$, Planin zhvillimor Urban 2003-2013 të Prizrenit dhe Vizioni i Integruar i Prizrenit +2015. Procesi i parashikuar është arritur duke përdorur teknika pjesëmarrëse planifikuese si studime analitike. Fillimisht problemet janë përcaktuar në një skedë kryqe duke përdorur teknikën "trungu problemor" së bashku me kontributin e fazës së parë të PZHKP 2025 dhe konsulentët sektorial. Në hapin e ardhshëm, qëllimet prioritare janë identifikuar për çdo problem tematike. Studimet paraprake në lidhje me zhvillimin e parashikimeve dhe qëllimeve janë paraqitur në forumin (takimin) publik që u mbajt në Prizren në Qershor 2009. Takimi publik i bazuar në pyetjen " si do të ishte Prizreni në vitin 2025" në rastin e realizimit të objektivave prioritare për çdo temë (sektor). Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$, e cila është miratuar në vitin 2010, gjithashtu është marrë në konsideratë për të vlerësuar vlefshmërinë e vendimeve të PZHKP 2025.



## 2.1. ARDHMËRIA E KOMUNËS SË PRIZRENIT NË KONTEKSTIN E PLANEVE, RAPORTEVE SEKTORIALE DHE UDHËRRËFYESVE

### 2.1.1 Ardhmëria e Komunës së Prizrenit në kontekstin e planeve, raporteve sektoriale dhe udhërrëfyesve

Planet ekzistuese, raportet e sektorëve si dhe udhëzimet siç janë Plani Hapësinor i Kosovës 2005-2015, Plani Zhvillimor Urbanistik 2003–2013 dhe Vizioni i integruar i Prizrenit +2015 paraqesin bazën e Vizionit të PZHKP 2025. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$, e cila është miratuar në vitin 2010, gjithashtu është marrë në konsideratë për të vlerësuar vlefshmërinë e vendimeve të PZHKP 2025.

**Vizioni i Planit Hapësinor të Kosovës dhe Ardhmëria e Komunës së Prizrenit**

Dokumenti kryesor që identifikon vizionin e PZHKP 2025 është Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$ i përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2010.

Vizioni i Kosovës, në bazë të këtij plani, është “të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastruktura dhe teknologjia moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë dhe forcë pune të kualifikuar, vend që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve, me një shoqëri të hapur që promovon llojllojshmërinë dhe këmbimin e ideve duke respektuar të drejtat e të gjithëve”.

Strategjia e zhvillimit hapësinor bazohet në zhvillimin e rrjetit të fuqishëm të qyteteve me ndikim ekonomik, nëpërmjet të burimeve njerëzore, avancimin e bazës së njohurive, shfrytëzimi i planifikuar dhe racional i resurseve natyrore dhe atyre kulturore, mundësive për qasje në infrastrukturën fizike, ofrimi dhe përmirësimi i cilësisë jetësore, barazia shoqërore, të gjitha këto të mbështetura nga kapacitetet organizative. Parimet kryesore të strategjisë së zhvillimit hapësinor janë zhvillimi i një rrjeti të fortë urban të zhvillimit ekonomik, zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore si dhe zhvillimin e lidhjeve strategjike.

Në bazë të këtyre strategjive zhvillimore hapësinore, janë propozuar katër zona/regjione ku Prizreni është qendër e Kopshteve të Kosovës. Kjo zonë është paraparë për turizmin kulturor, industrinë bujqësore dhe tregti dhe shërbime ku Prizreni ka një rol udhëheqës me potencialin e saj rekreativ dhe kulturor, si dhe vlerat natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore. Vizioni për Prizrenin në bazë të këtij plani është ndërtimi i qendrës në rrënjët tradicionale të kësaj treve antike, të shndërrohet në një qendër moderne kulturore-turistike të zhvilluar në një rrjet funksional duke krijuar lidhje më të forta me fshatrat rurale për të stimuluar aktivitetet e bazuara në potencialet natyrore, atraktive për të punuar dhe jetuar aty dhe hapësirë të mjaftueshme për kyçjen e sektorit privat në vreshtari, bujqësi dhe turizëm. Plani po ashtu sugjeron krijimin e ambientit tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve private afariste dhe inkurajon shfrytëzimin më të mirë të potencialeve lokale ekonomike si dhe të burimeve njerëzore e natyrore, sidomos në turizëm dhe bujqësi.



Qëllimet e përgjithshme për Prizrenin të caktuara në Plan janë:

- Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike,
- Qeverisja dhe administrata efikase që mbështet qëllimet zhvillimore
- Programi për zhvillimin lokal ekonomik përmes promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Zhvillimi i kultivimit të frutave, vreshtarisë dhe bujqësisë.
- Zhvillimi i turizmit malor dhe atij kulturor, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore.

Ruajtja e burimeve natyrore është një nga parimet më të rëndësishme të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$ duke marrë parasysh humbjen e cilësisë së tokës bujqësore; ndotjen e

lartë ambientale; shfrytëzimin irracional te burimeve dhe rritjen e pakontrolluar të vendbanimeve.

Sidomos konsiderata e trashëgimisë kulturore në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2015+ e cila është miratuar rishtazi është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm dhe strategjisë së konservimit (ruajtjes) të vendit. Në këtë aspekt, Prizreni është një nyje e rëndësishme me trashëgiminë e saj të pasur historike dhe kulturore si dhe me resurse mjedisore. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ e përcakton rolin e Prizrenit si "Qytet Muze" për të kontribuar në krijimin e kushteve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë për zhvillimin lokal ekonomik. Por duke u nisur nga strategjia, ka nevojë për një veprim të përqendruar në aspektin e mbrojtjes ambientale dhe të burimeve njerëzore, si dhe për promovim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, mbrojtjen e cilësisë së tokës bujqësore dhe promovimin e prodhimeve vendore, mbrojtje të resurseve minerale dhe përdorimin racional te tyre si dhe kontrollimin e rritjes së vendbanimeve.

Strategjia e dytë e planit përqendrohet në zhvillimin e lidhjeve strategjike përfshirë këtu edhe integrimin me rrjetin transportues rajonal dhe Evropian, përmirësimin e formave të transportit, furnizim të qëndrueshëm me rrymë elektrike për nevoja lokale dhe rajonale, si dhe ofrimin e sasive të mjaftueshme të ujit për amvisëri dhe industri. Prizreni ka përparësitë e saja për ndërtimin e linjave strategjike sepse ka një popullatë të trajnuar dhe të edukuar, burime të mjaftueshme të ujit dhe lidhjet e mira transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet fqinjë. Po ashtu Prizreni posedon potencial të lartë për zhvillimin e lidhjeve strategjike të kualitetit të lartë në bazë të zhvillimit të orientuar kah turizmi dhe logjistika brenda Kosovës dhe në Evropë. Siç pritet nga një strategji, ajo do ta udhëheqë Prizrenin kah reduktimi i papunësisë, do t'i kontribuojë zhvillimit më të barabartë, do të ofrojë cilësi më të lartë të zhvillimit në pjesët rurale. Po ashtu do të jetë udhëzues për përdorimin e rrjetit të fortë urban të zhvillimit ekonomik në realizimin e qëllimeve për një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.



Çështjet specifike që duhet të trajtohen në Prizren sa i përket Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ janë mungesa e planifikimit urban, ndërtimet ilegale që shfrytëzojnë resurset në mënyrë të pakontrolluar, mungesa e koordinimit institucional në mes të qeverisë lokale dhe komunitetit afarist dhe komunave fqinje, administrate e dobët lokale, shkalla e lartë e papunësisë, prezenca e ekonomisë jo formale, shtrirja e vendbanimeve në tokat bujqësore, zgjerimi horizontal i vendbanimeve, humbja e tokës bujqësore dhe degradimi i trashëgimisë kulturore. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, gjithashtu thekson zonat e veçanta të mbrojtura.

**Vizioni i Integruar i Prizrenit dhe ardhmëria e Komunës së Prizrenit.**

Dokumenti i dytë i rëndësishëm që përcakton vizionin e PZHKP 2025 është Vizioni i integruar i Prizrenit i përgatitur nga Komuna e Prizrenit dhe UN HABITAT në Mars të vitit 2008. Duke përcjellë vizionin e përcaktuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020[+], Prizreni definohet si: "qendra e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me një ekonomi që krijon potenciale për zhvillimin e shoqërisë si dhe udhëkryq i regjionit ku sundon toleranca dhe ligji"

Ajo është strukturuar në pesë fusha themelore të intervenimit sa i përket zhvillimit komunal. Këto fusha janë:

- Zhvillimi urban dhe rural dhe Planifikimi
- Lëvizshmëria dhe Transporti
- Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore
- Ambienti Ekonomik dhe Bujqësia
- Infrastruktura dhe Shërbimet Publike.

Fusha e parë e intervenimit është zhvillimi urban dhe rural dhe planifikimi. Detyra e parë është themelimi i zhvillimit të organizuar urban dhe zbatimi i shfrytëzimit racional të tokës në mënyrë që të arrihet organizimi i qëndrueshëm i vendbanimeve, përmirësimi i konditave jetësore, përdorimi efikas i resurseve ekzistuese sidomos të tokës dhe infrastrukturës si dhe përdorimi i drejtë i tokës bujqësore. Detyra e dytë është krijimi dhe mbështetja e skemës zhvillimore policentrike hapësinore në Komunën e Prizrenit me qëllim të mbështetjes së zhvillimit më të balancuar në mes të qendrës dhe pjesëve rurale, për të ndërtuar një partneritet të zhvillimit urban e rural dhe për të zvogëluar presionin e urbanizimit në qytetin e Prizrenit (Tabela 2.1).



**Tabela 2.1:** Synimet, fushat e intervenimit dhe rekomandimet që konsiderohen në PZHKP 2025: Zhvillimi urban dhe rural

| Synimet | Fushat e intervenimit | Rekomandimet për PZHK |
|---|---|---|
| Zhvillimi i organizuar urban | Formulimi i planeve rregulluese, rregullore për vendbanimet joformale. | • Jo vetëm qendra e qytetit por e tërë komuna duhet të jetë e inkuadruar në planin zhvillimor si dhe të merren parasysh trendët ekzistuese të shfrytëzimit të tokës,<br>• Nën qendrat duhet të definohen qartë si bazë për zbatimin e zhvillimit hapësinor policentrik dhe më të balancuar |
| Përmirësimi i kushteve të jetesës | Zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra në pjesët e zhvilluara. | |
| Përdorimi efikas dhe i duhur i burimeve ekzistuese dhe i tokës bujqësore | Identifikimi i lokacioneve për aktivitete ekonomike, sidomos për industrinë e lehtë, shërbime dhe tregti me pakicë. | |
| Zhvillimi policentrik hapësinor | Përpilimi i planeve zhvillimore të nën qendrave dhe të pjesëve nën urbane përgjatë akseve të rrugëve kryesore. | |
| Zhvillimi më i balancuar në mes të qendrës dhe qendrave të vogla në pjesët rurale | Përmirësimi i infrastrukturës sociale, kulturore dhe teknike në nën-qendra. | |

Fusha e dytë e intervenimit është lëvizshmëria dhe transporti. Në fillim synohet përmirësimi dhe zgjerimi i rrjeteve regjionale për të mbështetur zhvillimin e pjesëve rurale dhe zhvillimin policentrit duke lehtësuar qasjen në infrastrukturë dhe shërbime që i ofrohen nën qendrave. Preferohet zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit ndërkombëtar të transportit për të lidhur komunën me regjionet fqinje dhe për të lehtësuar shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Për më tepër, ky intervenim ofron mbështetje për një trafik publik dhe privat më të rehatshëm dhe më të sigurt në qendrën urbane, si dhe përmirësimin e trafikut urban dhe situatës së parkimit, sidomos në qendrën historike. (Tabela 2.2).

Fusha e tretë e intervenimit është trashëgimia kulturore dhe resurset natyrore ku synohet mbrojtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore në pjesët urbane dhe rurale si dhe të burimeve natyrore si pasuri kryesore të Komunës (Tabela 2.3).

Ambienti ekonomik dhe bujqësia paraqet fushën e katërt të intervenimit ku synohet sigurimi i infrastrukturës së lehtë dhe të rëndë për mbështetjen e aktiviteteve dhe investimeve private, mbështetje për aktivitete ekonomike në pjesët rurale dhe zhvillimin e politikave agrare në nivelin rajonal (Tabela 2.4).

Infrastruktura dhe shërbimet publike janë fusha e pestë e intervenimit ku synohet përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e kapacitetit dhe kualitetit të infrastrukturës teknike si dhe zgjerimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturës (Tabela 2.5).



**Tabela 2.2:** Synimet, fushat e intervenimit dhe rekomandimet të konsideruara në PZHKP 2025: Lëvizshmëria dhe Transporti.

<table>
<tr><th>Synimet</th><th>Fushat e intervenimit</th><th>Rekomandimet për PZHK</th></tr>
<tr><td>Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjeteve rajonale për të mbështetur zhvillimin e zonave rurale.</td><td>Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugëve që lidhin qendrën dhe nën qendrat.<br><br>Përmirësimi i sistemit të autobusëve lokalë që lidhin regjionin me qendrën urbane të Prizrenit.</td><td rowspan="3">• Rrjeti lokal i autobusëve duhet të lidhet me linjat regjionale.<br>• Shtrirja finale e autostradës do të përcaktojë në masë të madhe zhvillimin hapësinor të pjesës veriore të komunës.<br>• Fizibiliteti i rrugës alternative për lidhje më të mirë me jugun duhet të hulumtohet.</td></tr>
<tr><td>Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit ndërkombëtar të transportit për të lidhur komunën me regjionet fqinje dhe për të lehtësuar shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve</td><td>Realizimi i autostradës<br>Rehabilitimi i hekurudhës për transportin e udhëtarëve dhe mallrave.<br><br>Lidhja me e mirë me Maqedoninë përmes Reçanës-Lubinjë e Poshtme - Brodic</td></tr>
<tr><td>Mbështetja e trafikut publik dhe privat më të rehatshëm dhe më të sigurt në qendrën urbane</td><td></td></tr>
</table>

**Tabela 2.3:** Synimet, fushat e intervenimit dhe rekomandimet të konsideruara në PZHKP 2025: Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore

| Synimet | Fushat e intervenimit | Rekomandimet për PZHK |
|---|---|---|
| Mbrojtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore në pjesët urbane dhe rurale si dhe të burimeve natyrore si pasuri kryesore të komunës | Analiza dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore në zonat rurale | • Analiza dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore në zonat rurale duhet të integrohet në elaborimin e planit.<br>• Rekomandohet bashkëpunimi i ngushtë për elaborimin e zhvillimit të Maleve të Sharrit nën përgjegjësinë e Institutit për Planifikimin Hapësinor.<br>• Duhet të bëhet integrimi me planin ekzistues të ruajtjes të qendrës historike të Prizrenit sipas Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066) |
| | Valorizimi i burimeve natyrore sidomos të atyre në Parkun Nacional Malet e Sharrit | |
| | Elaborimi i mbrojtjes dhe plani zhvillimor si bazë për investime të jashtme | |
| | Plani i ruajtjes dhe integrimit për qendrën historike në shemën planifikuese urbane | |

**Tabela 2.4:** Synimet, fushat e intervenimit dhe rekomandimet të konsideruara në PZHKP 2025: Ambienti Ekonomik dhe Bujqësia

| Synimet | Fushat e intervenimit | Rekomandimet për PZHK |
|---|---|---|
| Sigurimi i infrastrukturës së lehtë dhe të rëndë për mbështetjen e aktiviteteve dhe investimeve private, | Mbështetja e rrjeteve lokale dhe atyre të jashtme afariste.<br>Marketingu dhe përmirësimi i kualitetit të prodhimeve lokale për shfrytëzimin e mundësive të eksportit.<br>Sigurimi i lokacioneve të reja për aktivitete ekonomike. | • Integrimi i planeve lokale të veprimit për zonat e zgjedhura siç janë Lugina e Zhupës, regjioni i Anadrinit, si dhe zona veriperëndimore bujqësore duhet të identifikohen në kornizën e Programit për Zhvillimin e Strategjive Lokale.<br>• Duhet të hulumtohen mundësitë e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndër regjional<br>• Duhet të merret parasysh bashkëpunimi ndërkufitar që është iniciuar nga Dragashi dhe Prizreni si dhe komunat fqinje të Shqipërisë. |
| Mbështetja e aktiviteteve ekonomike në pjesët rurale dhe zhvillimin e politikave agrare në nivelin rajonal | Përmirësimi i infrastrukturës rurale në pajtim me zhvillimet dhe aktivitetet bujqësore dhe prodhimtarinë ushqimore.<br>Mbështetja e prodhimeve ekologjike dhe kultivimit të bimëve mjekësore<br>Futja e menaxhimit dhe strukturës financuese për rehabilitimin e sistemit të ujitjes.<br>Zhvillimi i potencialit ekonomik të burimeve natyrore dhe zonave kulturore për turizëm dhe rekreacion. | |

**Tabela 2.5:** Synimet**,** fushat e intervenimit dhe rekomandimet të konsideruara në PZHKP 2025: Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

<table>
<tr><th>Synimet</th><th>Fushat e intervenimit</th><th>Rekomandimet për PZHK</th></tr>
<tr><td>Përmirësimi i Shërbimeve Publike</td><td>Përmirësimi i kualitetit të edukimit<br>Rehabilitimi dhe ndërtimi i objekteve shkollore<br>Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore</td><td rowspan="3">• PZHK duhet të identifikojë prioritetet e investimeve në infrastrukturë në relacion me konceptin e planifikimit për zonat urbane dhe nën qendrat.<br>• Një kujdes i veçantë duhet t'i epet zhvillimit të popullsisë sidomos në zonat rurale të largëta<br>• Duhet të hulumtohen masat e përshtatshme për t'u ballafaquar me zvogëlimin e popullatës.</td></tr>
<tr><td>Rritja e kapacitetit dhe kualitetit të infrastrukturës teknike</td><td>Menaxhimi dhe riciklimi i mbeturinave<br>Përmirësimi i furnizimit me ujë<br>Ndërtimi i fabrikës për pastrimin e ujit dhe për përpunimin e ujërave të zeza<br>Shërbimet e telekomunikacionit dhe furnizimi me ujë duhet të jetë i standardeve Evropiane.<br>Mundësitë e burimeve të energjisë alternative si uji dhe mullinjtë e erës.<br>Ndërtimi i hidrocentralit të Zhurit</td></tr>
<tr><td>Zgjerimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturës</td><td>Krijimi i qendrave për mjekësi familjare<br>Ndërtimi i qendrës për arte pamore-kulturore –teatri, kinemaja<br>Themelimi i një Universiteti të ri, jashta asaj egzistuese Univeristetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"<br>Ndërtimi i objekteve të banimit social</td></tr>
</table>

Vizioni i integruar i Prizrenit po ashtu përmban edhe prioritetet strategjike që bazohen në Punëtorinë e Parashikimit të Vizionit të Prizrenit (Tabela 2.6). Punëtoria e parë ka përfunduar me parëzimin e veprimeve dhe masave të ndryshme si dhe me propozime të përgjithshme rregulluese. Një listë prej 50 propozimeve është shkëputur nga Deklarata e Vizionimit dhe është strukturuar në nëntë sektorë, që më vonë janë vlerësuar nga pjesëmarrësit. Çdo pjesëmarrës ka vlerësuar dhe ka parëzuar veprimet duke klasifikuar prej 0-15. Pjesëmarrësit kanë qenë përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe anëtarët nga administrata komunale si dhe nga Këshilli i Ekspertëve. Vlerësimet janë bërë ndaras, me qëllim të analizimit se a janë dhënë të njëjtat prioritete nga grupe të ndryshme.

Duke u referuar rezultateve të përgjigjeve, rezultatet e prioriteteve janë të renditura në bazë të vlerësimeve më të larta të dhëna nga pjesëmarrësit.

**Tabela 2.6:** Nevojat e parapara dhe parashikimet në qytetin e Prizrenit të dhëna nga të anketuarit sipas Vizionit të Integruar të Prizrenit

| Sektori | Përcaktimi i veprimeve | Numri i përgjigjeve: Shoqëria civile | Numri i përgjigjeve: Ekipi Planifikues Komunal | Numri total i përgjigjeve |
|---|---|---|---|---|
| Struktura sociale/kulturore/ arsimore | Ndërtimi i qendrës për arte pamore dhe kulturore | 70 | 136 | 206 |
| | Përmirësimi i kualitetit të edukimit | 152 | 122 | 274 |
| | Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore | 131 | 115 | 246 |
| | Ri destinimi i ndërmarrjeve shoqërore | - | 85 | 85 |
| | Trajnimi i profesionistëve | 25 | 74 | 99 |
| | Ndërtimi i universitetit në kampin e KFOR –it | 85 | 120 | 205 |
| | Krijimi i hapësirave për njerëzit me aftësi të kufizuara | 117 | 130 | 247 |
| | Lokacionet për sport dhe rekreacion | 105 | 97 | 202 |
| Vendbanimet dhe pjesët publike urbane | Mbrojtja e vendbanimeve ekzistuese | 86 | 136 | 222 |
| | Krijimi i hapësirave të gjelbra | 137 | 119 | 256 |
| | Krijimi i hapësirave të reja publike | 101 | 82 | 183 |
| Infrastruktura teknike | Furnizimi me ujë | 92 | 136 | 228 |
| | Ndërtimi i impiantit në Tupec – Vërmicë | 98 | 145 | 243 |
| | Fabrikat për përpunimin e ujërave të zeza | 74 | 126 | 200 |



**Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit dhe Ardhmëria e Komunës së Prizrenit.**

Dokumenti i tretë me rëndësi për identifikimin e vizionit të PZHKP 2025 është PZHU i Prizrenit që është përgatitur nga Komuna e Prizrenit më 2003 dhe paraqet një plan dhjetë vjeçar për zhvillimin e qëndrueshëm të qendrës së Prizrenit. Ky plan nuk ka një vizion të qartë për ardhmërinë e Komunës së Prizrenit.

Plani nënvizon rëndësinë e madhe të trashëgimisë kulturore dhe historike të Prizrenit. Ruajtja dhe integrimi i ndërtesave dhe komplekseve ndërtimore me vlera historike dhe kulturore në zhvillimet bashkëkohore kanë rolin e madh në zhvillimin e përhershëm. Trashëgimia e mbrojtur do të paraqesë një përbërës të rëndësishëm të pamjes së përgjithshme të qytetit. Të gjitha vlerat trashëgimore duhet të rigjenerohen. Qëllimi i këtij

regjenerimi është arritja e vlerave që do të ballafaqohet me ndryshimet kohore. Trashëgimia kulturore dhe historike janë potencial për zhvillimin ekonomik. Promovimi i këtyre vlerave paraqet trendin zhvillimor të sektorit të turizmit.

Plani propozon integrimin e të gjitha shërbimeve për promovimin e funksionalitetit të cilësisë së lartë për vendbanimet e reja, që supozohet të ketë ndikim në rritje të bizneseve të vogla. Kjo mund të arrihet me përdorimet mikse përgjatë arterieve kryesore të trafikut. Këto regjione parashihen të kenë kapacitetin optimal që do të korrespondojë me nevojat e vendbanimeve të reja dhe do të ulë presionin për qytetin e Prizrenit. Kjo është po ashtu parakusht për vendbanim cilësor në zonat e konservuara.

Modulet transportuese parashihen të shërbejnë të gjithë qytetarëve si dhe rrjeti ekzistues transportues duhet të integrohet në modulet tjera transportuese. Ky integrim do ti sjellë Prizrenit lidhje të reja dhe cilësi më të lartë të jetës.

Infrastruktura ekzistuese planifikohet të përmirësohet me metoda racionale dhe bashkëkohore me ç'rast respektohet ruajtja e burimeve natyrore. Plani propozon një sistem të ri të infrastrukturës së integruar që kërkon ristrukturim.

Objektet kulturore dhe ato rekreative po ashtu propozohen për t'u zhvilluar. Ky proces i zhvillimit duhet të bëhet jo vetëm në vendbanimet ekzistuese por edhe në ato të reja me qëllim të tërheqjes së investimeve. Parashihet që këto objekte të ndikojnë në përmirësimin e ekonomisë si dhe duhet të bazohen në traditat dhe potencialet e Prizrenit. Në sheshe, ndërtesa dhe në pamjen e tërësishme të qytetit planifikohet qasja me vlerë artistike. Plani synon një strukturë autentike, edukative, të shëndetshme dhe artistike.



Duke i pasur parasysh këto pohime, mund të konstatohet se PZHU përcakton vizionin e Prizrenit si një shpërndarje të zhvillimit të qëndrueshëm urban përmes ruajtjes të trashëgimisë kulturore, përmirësimit të cilësisë së ambientit urban dhe përdorimin e objekteve themelore urbane. Edhe pse vizioni këtu nuk është i qartë, perspektiva e planit bëhet më e qartë me përcaktimin e qëllimeve siç janë:

- Sigurimi i zhvillimit social që do t'i përgjigjej nevojave të secilit.
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- Promovimi i zhvillimit lokal ekonomik
- Sigurimi i përdorimit të kujdesshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtja e ambientit.
- Mbështetja dhe koordinimi i moduleve të trafikut
- Ofrimi i cilësisë në ndërtimtari

Qëndrueshmëria është koncepti themelor i Planit Zhvillimor Urban. Qëndrueshmëria në rastin e Prizrenit do të thotë rehabilitimin e cilësisë së jetës, sigurimin e kushteve më të mira të jetës për fëmijët, promovimi i inkuadrimit social dhe integrimi i qëllimeve mjedisore në trendët socio ekonomike. Ruajtja e trashëgimisë kulturore përmendet si bazë për ruajtjen e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Prizrenit. Plani sugjeron që bazat kryesore në ruajtjen e trashëgimisë kulturore janë përdorimi i trashëgimisë kulturore për zhvillimin e turizmit me praktikat bashkëkohore dhe krijimin e qendrave atraktive brenda kontekstit rajonal. Zhvillimi lokal ekonomik është parësor për qëndrueshmëri në bazë të këtij plani. Për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duhet balancimi i zhvillimit në mirëqenien ekonomike dhe kualitetit të jetës me perspektivat afatgjata ekonomike. Esenca e zhvillimit të qëndrueshëm urban të Prizrenit është se ajo varet nga qeveria lokale. Plani nënvizon nevojën për informim dhe edukim të shoqërisë sidomos duke promovuar menaxhimin pjesëmarrës, përfaqësimin dhe koordinimin. Sa i përket këtyre qëllimeve, plani propozon strategji të hollësishme për decentralizim strategjik, modelet e rritjes urbane, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, zhvillim social, vitalitet ekonomik, infrastrukturë publike, trafik të integruar, mbrojtje të ambientit, cilësi urbane dhe strategjitë zbatuese.

Dokumentet tjera për përcaktimin e vizionit 2025, parimeve dhe synimeve për komunën e Prizrenit janë 

- Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Pjesës Historike të Prizrenit
- Plani Hapësinor i Parkut Nacional “Mali Sharr”
- Raporti Nacional mbi Transportin në Kosovë (nën rezolutën 1244)
- Prapavija Teknike e Sektorit të Transportit
- Strategjia Energjetike e Kosovës.

## 2.2. VIZIONI PËR ARDHMËRINË E KOMUNËS SË PRIZRENIT

Siç është prezantuar në pjesën 2.1, parashikimet për Prizrenin 2025 në bazë të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Vizionit të integruar të Prizrenit dhe raporteve tjera sektoriale përqendrohen në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik, teknologji dhe infrastrukturë moderne, mundësitë për arsimim, respekti për ambient, trashëgimia natyrore dhe kulturore si dhe shoqëria diverse dhe e barabartë. Pos këtyre planeve, udhërrëfyesve dhe raporteve sektoriale, Vizioni i PZHKP 2025 inkorporon rolin dhe prioritetet e përcaktuara nga intervistat individuale të 75 kryetarëve të fshatrave të mbajtur në Mars dhe Prill të vitit 2009 dhe Debati publik i mbajtur në Qershor të vitit 2009.

### 2.2.1. Ardhmëria e Komunës së Prizrenit në kontekstin e Debatit Publik për PZHK 2025

Procesi i parashikimit është menaxhuar duke përdorur teknikat planifikuese pjesëmarrëse në frymën e studimit analitik. Vizioni PZHKP 2025, parimet, qëllimet afatgjata dhe prioritetet strategjike janë përcaktuar nga intervistat individuale të 75 kryetarëve të fshatrave të mbajtur në Mars të vitit 2009 dhe Debati publik i mbajtur në Qershor të vitit 2009. Ato kanë përcaktuar drejtimin e PZHKP 2025 në bazë të aspiratave të pjesëmarrësve dhe nevojave.



Në fillim problemet janë definuar duke përdorur teknikën “trungu i problemeve” duke u bazuar në raportin e fazës së parë të PZHKP 2025 dhe këshilltarët e sektorëve të ndryshëm. Në fazën e parë, janë identifikuar qëllimet parësore në çdo fushë tematike. Studimet paraprake të parashikimit dhe zhvillimit të qëllimeve janë prezantuar në debatin publik të mbajtur në Qershor të vitit 2009 në Prizren. Pyetja kryesore e Debatit publik ishte “si do të jetë Prizreni në vitin 2025” nëse realizohen qëllimet parësore në çdo fushë tematike.

Në debat publik të muajit qershor, 2009 kanë marrë pjesë 22 përfaqësues të partive politike, administratës komunale dhe shoqërisë civile. (Tabela 2.7). Ata u pyetën për të pasqyruar nevojat dhe pritshmërinë për zhvillim në Qytetin e Prizrenit dhe Komunën e Prizrenit si një tërësi.

**Tabela 2.7:** Parashikimet e Pjesëmarrësve në Debatin Publik të PZHKP 2025

| Sektori | Numri i pjesëmarrësve |
|---|---|
| Komuna e Prizrenit | 4 |
| Hoca e Qytetit | 2 |
| Partia e drejtësisë (PD) | 2 |
| Institucionet shkollore | 1 |
| Burak Otomotiv | 1 |
| Shoqata "Dogru Yol" | 1 |
| Publiku | 11 |
| **Gjithsej** | **22** |

Rezultatet e pyetësorit theksojnë ardhmërinë e Prizrenit si një "qytet historik", si "qytet muze" dhe "qendër kulturore" (Tabela 2.8). Forca primare shtytëse ekonomike parashihet të jetë turizmi (Tabela 2.9), e pastaj industria, tregtia dhe bujqësia.

**Tabela 2.8:** Përshkrimi i Prizrenit i dhënë gjatë debatit publik të PZHKP 2025

| | Numri I përgjigjeve | % |
|---|---|---|
| **Qytet historik** | **6** | **31,6** |
| **Qytet muze** | **2** | **10,5** |
| **Qendra kulturore e Kosovës** | **2** | **10,5** |
| Qytet i gjelbër | 1 | 5,3 |
| Tjera | 8 | 42,1 |
| | 19 | 100 |



**Tabela 2.9:** Roli i ardhshëm i Prizrenit në bazë të përgjigjeve të debatit publik të PZHKP 2025

| | Numri I përgjigjeve | % |
|---|---|---|
| **Qytet turistik** | **19** | **54** |
| Qytet industrial | 8 | 23 |
| Qytet tregtar | 5 | 14 |
| Qytet bujqësor | 3 | 9 |
| | **35** | **100** |

Rezultatet e pyetësorit për nevojat e paramenduara dhe shpresat në Komunën e Prizrenit lejojnë klasifikimin në pesë sektorë: ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, inkuadrimi social dhe cilësia e jetesës, integriteti hapësinor, qëndrueshmëria ambientale dhe vitaliteti ekonomik.

Sipas rezultateve del se ekziston një qasje e integruar për veprimet vijuese në komunën e Prizrenit (Tabela 2.10):

- Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Përmirësimi i cilësisë jetësore përmes ambientit të pastër, të shëndetshëm dhe të sigurt.
- Përdorimi i objekteve urbane siç janë ato arsimore, kulturore dhe infrastruktura rekreative.
- Përmirësimi I linjave transportuese dhe përmirësimet e infrastrukturës urbane (furnizimi me ujë, elektriciteti, menaxhimi i mbeturinave)

Konsideratat më të gjera të zhvillimit ekonomik dhe social nuk janë përfaqësuar si një pritje në debatin publik.

**Tabela 2.10:** Nevojat e Perceptuara dhe Parashikimet për Komunën e Prizrenit dhe Parashikimet e dhëna gjatë Debatit Publik të PZHKP 2025

| Përcaktimi i Veprimeve | Sektori | Numri I përgjigjeve | % |
|---|---|---|---|
| Ruajtja dhe rehabilitimi i strukturës dhe aseteve historike (8) | Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore | 8 | 32 |
| Kinemaja (2) | Inkuadrimi social dhe cilësia e jetesës | 6 | 24 |
| Arsimi dhe shëndetësia (1) | | | |
| Sigurimi (1) | | | |
| Objektet sportive (1) | | | |
| Hapësira publike (1) | | | |
| Planet zhvillimore | Integriteti hapësinor | 5 | 20 |
| Zhvillimi i qyteti | | | |
| Ndërtesat e larta | | | |
| Mjedisi i pastër (3) | Qëndrueshmëria ambientale | 4 | 16 |
| Peizazhi i bukur (1) | | | |
| Zhvillimi I turizmit (2) | Vitaliteti ekonomik | 2 | 8 |
| | | **25** | **100** |

### 2.2.2. Vizioni për komunën e Prizrenit

Prizreni pritet të ketë pozitë qendrore si qendër moderne kulturore turistike përmes rrjetit funksional që krijon lidhje më të forta me fshatrat rurale. Rezultatet e pyetësorit nga debati publik PZHKP 2025 po ashtu sugjerojnë rolin e ardhshëm të Prizrenit si qendër kulturore që përdor trashëgiminë e saj të pasur kulturore dhe natyrore.

Komuna e Prizrenit posedon një sërë forcash shtytëse siç është prezantuar në fazën e parë të PZHKP 2025. Ato janë:

- Trashëgimia e pasur kulturore dhe natyrore.
- Resurset e pasura / të volitshme mjedisore
- Diversiteti socio- kulturor
- Fuqia punëtore e re dhe e edukuar dhe e kualifikuar
- Potenciali i lartë bujqësor dhe prodhues
- Linja të mira transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet fqinjë

Duke i integruar rolet dhe prioritetet e caktuara më planet dhe udhërrëfyesit paraprak, pastaj rezultatet e debatit publik të mbajtur në Qershor, 2009, si dhe duke i bashkuar ato me potencialet/forcat shtytëse, del që



Vizioni për ardhmërinë e Komunës së Prizrenit është:

***"Të zhvillohet Prizreni si një qendër e qëndrueshme kulturore në Kosovë dhe Ballkan, duke promovuar potencialin e tij sa i përket aseteve historike, resurset natyrore dhe ambientale, diversitet social dhe vitalitet ekonomik "***

## 2.3. PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT

Parimet e përgjithshme të zhvillimit për Komunën e Prizrenit që inkorporojnë rolin dhe prioritetet rezultojnë nga planet paraprake dhe udhërrëfyesit, si dhe analizat analitike të kryera në fazën e parë të PKZHP 2025.

Siç është përmendur edhe në kapitullin 2.2, parimet e përgjithshme duhet të marrin në konsideratë:

- Zhvillimin dhe ruajtjen e resurseve natyrore dhe kulturore
- Përmirësimin e kushteve jetësore me zhvillimin e shërbimeve publike
- Promovimi i zhvillimit të balancuar dhe të organizuar urban
- Zhvillimi i rrjetit të fortë urban të zhvillimit ekonomik
- Zhvillimi i linjave strategjike transportuese dhe të infrastrukturës

Duke i kombinuar këto parime së bashku me PZHKP 2025, del se parimet kyçe të Zhvillimit të Komunës së Prizrenit mund të klasifikohen në pesë grupe tematike përfshirë këtu: trashëgiminë natyrore dhe kulturore, ambienti natyrore, mjedisi social, mjedisi ekonomik dhe ai hapësinor.



Parimet kyçe të PZHKP 2025 janë :

- **Parimi 1: Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore**
- **Parimi 2: Qëndrueshmëria ambientale**
- **Parimi 3: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore.**
- **Parimi 4: Vitaliteti ekonomik**
- **Parimi 5: Integriteti hapësinor**

Tabela 2.11 Tregon rekomandimet e studimit të Vizionit të Integruar të Prizrenit të kryer për nevojat e PZHKP 2025 në relacion me qëllimet e Vizionin e Integruar dhe parimet e përgjithshme të Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit.

**Tabela 2.11:** Rekomandimet e studimit të Vizionit të Integruar të Prizrenit të kryer për nevojat e PZHKP 2025 në relacion me qëllimet e Vizionin e Integruar dhe parimet e përgjithshme të Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit.

| | Synimet | Rekomandimet e Vizionit të integruar të Prizrenit për PZHKP |
|---|---|---|
| Ruajtja e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore | Mbrojtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore në pjesët urbane dhe rurale si dhe të burimeve natyrore si pasuri kryesore të Komunës | • Analiza dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore në zonat rurale duhet të integrohet në elaborimin e planit<br>• Rekomandohet bashkëpunimi i ngushtë për elaborimin e planit zhvillimor të Maleve të Sharrit nënë mbikëqyrjen e Institutit për Planifikim Hapësinor<br>• Duhet të ofrohet integrimi me planin ekzistues për ruajtjen e pjesës historike të qytetit |
| Qëndrueshmëria ambientale | • | • |
| Inkuadrimi Social, barazia sociale dhe Cilësia e lartë jetësore | • Përmirësimi i shërbimeve publike | • Një qasje e posaçme duhet t'i jepet zhvillimit të popullatës sidomos në zonat rurale.<br>• Duhet të hulumtohet mënyra e qasjes ndaj zvogëlimit të popullatës. |
| Vitaliteti Ekonomik | • Sigurimi i infrastrukturës së lehtë dhe të rëndë për mbështetjen e aktiviteteve dhe investimeve private,<br>• Mbështetja e aktiviteteve ekonomike në pjesët rurale dhe zhvillimin e politikave agrare në nivelin rajonal | • Integrimi i planeve lokale të veprimit për zonat e posaçme siç është Lugina e Zhupës apo regjioni i Anadrinit me zonën verilindore bujqësore me Programin për strategjinë e zhvillimit lokal.<br>• Duhet të hulumtohen mundësitë për bashkëpunim ndër regjional dhe ndër komunal.<br>• Bashkëpunimi ndërkufitar sikur ai i iniciuar nga Dragashi me Shqipërinë duhet te merret në konsiderate. |
| Integriteti Hapësinor | • Zhvillimi i organizuar urban<br>• Përmirësimi i kushteve jetësore Përdorimi efikas i burimeve ekzistuese dhe i tokës bujqësore<br>• Zhvillimi policentrik hapësinor<br>• Zhvillimi më i balancuar në mes të qendrës dhe qendrave të vogla në pjesët rurale<br>• Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjeteve rajonale për të mbështetur zhvillimin e zonave rurale.<br>• Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit ndërkombëtar të transportit për të lidhur komunën me regjionet fqinje dhe për të lehtësuar shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve<br>• Mbështetja e trafikut publik dhe privat më të rehatshëm dhe më të sigurt në qendrën urbane<br>• Ngritja e kapacitetit dhe cilësisë së infrastrukturës teknike<br>• Zgjerimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturës. | • Jo vetëm qendra e qytetit, por e tërë komuna duhet të jetë në kuadër të planit zhvillimor si dhe duhet të konsiderohen trendët ekzistuese të përdorimit të tokës.<br>• Nën qendrat duhet të definohen qartë si bazë për zbatimin e zhvillimit hapësinor policentrik dhe më të balancuar<br>• Rrjeti lokal i autobusëve duhet të lidhet me linjat regjionale.<br>• Shtrirja finale e autostradës do të përcaktojë në masë të madhe zhvillimin hapësinor të pjesës veriore të komunës.<br>• Fizibiliteti i rrugës alternative për lidhje më të mirë me jugun duhet të hulumtohet. |

## 2.4. QËLLIMET AFATGJATA TË ZHVILLIMIT

Duke pasur parasysh studimet analitike të PZHKP dhe procesit të parashikimit, synimet afatgjata të zhvillimit dhe prioritetet strategjike janë përcaktuar si parimet e përgjithshme të zhvillimit. Për të realizuar vizionin e PZHKP 2025, në këtë studim janë caktuar qëllimet strategjike për zhvillimin afatgjatë si dhe objektivat që kanë të bëjnë me to. Pastaj, qëllimet dhe objektivat janë shoqëruar me sfidat e definuar në fazën e parë të PZHKP 2025 që është ”Profili i Zhvillimit Hapësinor dhe Analiza e gjendjes (situatës)”. Objektivat dhe qëllimet strategjike janë prezantuar në vijim në varshmëri nga parimet relevante. (Tabela 2.12).

**Tabela 2.12:** Parimet, sfidat, qëllimet strategjike dhe objektivat e PZHKP 2025

**Parimi 1. Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore**

**Përgjigje në sfida**

- Pamjaftueshmëria e programeve që adresojnë trashëgimin natyrore dhe kulturore

**Qëllimi 1.1:** Trashëgimia kulturore do të konservohet dhe përmirësohet

*Synimet*

**1.1.1.** Trashëgimia kulturore në tërë Komunën e Prizrenit do të konservohet.

**1.1.2.** Bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar do të përmirësohet në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

**1.1.3.** Ruajtja e trashëgimisë kulturore do të integrohet me anë të programeve turistike dhe sociale.

**1.1.4.** Vetëdija për ruajtjen e trashëgimisë kulturore do të shtohet.

**Qëllimi 1.2:** Trashëgimia natyrore do të konservohet dhe përmirësohet

*Synimet*

**1.2.1.** Trashëgimia natyrore do të ruhet së bashku me asetet dhe resurset mjedisore.

**1.2.2.** Bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar do të përmirësohet në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë natyrore.

**1.2.3.** Ruajtja e trashëgimisë natyrore do të integrohet në programet turistike dhe ato shoqërore (sociale).

**1.2.4.** Vetëdija për ruajtjen e trashëgimisë natyrore do të shtohet.

**Parimi 2: Qëndrueshmëria ambientale**

**Përgjigje në sfida**

- Ndotja dhe degradimi i mjedisit
- Përdorimi I pamjaftueshëm i resurseve natyrore
- Uzurpimi i tokës bujqësore për qëllime të ndërtimit
- Humbja e tokës bujqësore

**Qëllimi 2.1: Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i resurseve ambientale**

*Synimet*

**2.1.1.** Resurset ambientale do të mbrohen dhe zmadhohen duke ofruar përdorim potencial ekologjik dhe të qëndrueshëm.

**2.1.2.** Do të parandalohet ndotja dhe degradimi i ambientit.

**2.1.3.** Një mjedis i sigurt urban i ndjeshëm ndaj zonave me reziqe mjedisore do t'i ofrohet komunitetit

**Tabela 2.12:** *Vazhdimi nga faqja e mëparshme*

**2.1.4.** Zonat pyjore dhe zonat tjera të rëndësishme natyrore do të mbrohen me një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

**2.1.5.** Tokat e pëlleshme të Prizrenit do të përdoren për aktivitete bujqësore.

**Parimi 3. Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore**

**Përgjigje në sfida**

- Mangësitë në shëndetësi, objektet sociale dhe arsimore në zonat urbane dhe rurale
- Humbja e popullsisë për shkak të popullsisë së re migrimi-jashtë për jetesë dhe punësim
- Shkalla e lartë e papunësisë dhe mundësisë për tu punësuar popullata e re për shkak të moshës së lartë të daljes në pension
- Mungesa e përdorimit të burimeve njerëzore

**Qëllimi 3.1:** Do të sigurohen objektet publike të balancuara me qasje të lehtë

*Synimet*

**3.1.1.** Të gjitha llojet e objekteve urbane do të zgjerohen dhe modernizohen si nga cilësia ashtu edhe nga sasia.

**3.1.2.** Defektet në vendbanimet rurale si p.sh në aspektin e objekteve shkollore si çerdhet, parashkollore dhe shkollat fillore do të furnizohen.

**3.1.3.** Në të gjitha fshatrat qendrore do të sigurohen ndërtimi i shkollave të mesme, objektet shëndetësore, objektet sociale-kulturore, objektet sportive si dhe shtëpitë e pleqve.

**3.1.4.** Objektet urbane në qytetin e Prizrenit do të përmirësohen duke qenë në shërbim të të gjithë banorëve të Komunës.



**Qëllimi 3.2:** Do të sigurohen mundësi të reja për punësim dhe shkalla e papunësisë do të ulet

*Synimet*

**3.2.1.** Do të sigurohet mbështetja për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të edukuar.

**3.2.2.** Do të inkurajohen mundësitë për punësim në sektorin e shërbimeve në qytetin e Prizrenit.

**3.2.3.** Në viset rurale do të krijohen mundësitë për punësim në turizëm, agro industri dhe bujqësi

**Qëllimi 3.3:** Do të inkurajohet pjesëmarrja në vendimmarrje

*Synimet*

**3.3.1.** Gjatë tërë procesit të planifikimit do të ofrohet pjesëmarrja.

**3.3.2.** Do të ngrihet vetëdija publike për jetën urbane dhe rurale.

**Parimi 4. Vitaliteti Ekonomi**

**Përgjigje në sfida**

- Mungesa e prodhimit të organizuar industrial dhe bujqësor
- Aktivitetet ilegale ekonomike
- Mungesa e objekteve të akomodimit dhe shërbimeve ushqimore
- Humbja e tregut dhe mungesa e investimeve

**Qëllimi 4.1:** Do të sigurohet zhvillimi i balancuar dhe i menaxhuar rural

*Synimet*

**4.1.1.** Do të mbështeten mundësitë e ndryshme për punësim në fshatrat qendrore.

**Tabela 2.12:** *Vazhdimi nga faqja e mëparshme*

**Qëllimi 4.2:** Do të mbështetet prodhimtaria bujqësore

*Synimet*

**4.2.1.** Do të zhvillohet prodhimtaria bujqësore dhe blegtorale.
**4.2.2.** Do të mbështetet prodhimi dhe shitja e prodhimeve të reja bujqësore.
**4.2.3.** Do të ketë nxitje për prodhimtarinë e venës.
**4.2.4.** Toka e pëlleshme e Prizrenit do të përdoret për aktivitete bujqësore.

**Qëllimi 4.3:** Organizimi dhe nxitja e aktiviteteve prodhuese

*Synimet*

**4.3.1.** Gjenerimi i vlerës së shtuar nga prodhimet bujqësore do të mbështetet.
**4.3.2.** Do të ofrohet mbështetja dhe reklamimi i prodhimeve tradicionale.

**Qëllimi 4.4:** Aktivitetet komerciale dhe financiare do të vitalizohen

*Synimet*

**4.4.1.** Do të rritet efikasiteti i aktiviteteve tregtare.
**4.4.2.** Do të mbështetet logjistika

**Qëllimi 4.5:** Aktivitetet turistike në Prizren do të zhvillohen dhe përmirësohen.

*Synimet*

**4.5.1.** Prizreni do të reklamohet si një destinacion turistik.
**4.5.2.** Do të inkurajohen aktivitetet turistike dhe ato kulturore në pjesën historike të qytetit dhe zonat përreth.
**4.5.3.** Do të përcaktohen dhe zhvillohen aktivitetet e përshtatshme turistike si turizmi dimëror, turizmi shëndetësor dhe eko turizmi.



**Parimi 5. Integriteti Hapësinor**

**Përgjigje në sfida**

- Zgjerimi i paplanifikuar dhe i pakontrolluar urban
- Pamjaftueshmëria e rrjetit rrugor
- Infrastruktura e dobët teknike (kanalizimi, furnizim me ujë, menaxhimi i mbeturinave, energjia elektrike)
- Pamjaftueshmëria në objektet urbane

**Qëllimi 5.1:** Do të krijohen ambientet atraktive për jetesë

*Synimet*

**5.1.1.** Do të zhvillohen lokacione të reja për banim dhe do të përcaktohen sipërfaqet për regjenerim/dizajn urban.
**5.1.2.** Nevojat për banim të popullatës së tanishme dhe të paraparë do të koordinohen me bashkëpunim me investitorët.
**5.1.3.** Do të sigurohet niveli i barabartë i banimit social për shtresat me të ardhura të vogla dhe mesatare.
**5.1.4.** Do të rriten standardet për cilësinë e ambientit në vendbanime.

**Tabela 2.12:** *Vazhdimi nga faqja e mëparshme*

**Qëllimi 5.2:** Do të sigurohet transporti dhe infrastruktura efektive dhe e integruar hapësinore

*Synimet*

- **5.2.1.** Rrjeti dhe infrastruktura transportuese do të zhvillohen asisoj që të shërbejnë në mënyrë efikase për të gjitha vendbanimet e Komunës.
- **5.2.2.** Transporti lokal do të integrohet në rrjetin nacional të transportit.
- **5.2.3.** Do të sigurohet trafiku i sigurt urban.
- **5.2.4.** Do të zhvillohet sistemi efikas i transportit publik.
- **5.2.5.** Do të përmirësohet infrastruktura teknike dhe do të ofrohet infrastruktura e re teknike aty ku mungon.

Tabela 2.13 paraqet vizionin e PZHKP 2025, parimet dhe qëllimet afatgjata të zhvillimit në krahasim me Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Vizionin e integruar të Prizrenit dhe Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit.

**Tabela 2.13:** Vizioni i PZHKP 2025, parimet dhe qëllimet afatgjata të zhvillimit në krahasim me Planin Hapësinor të Kosovës, Vizionin e integruar të Prizrenit dhe Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit.

| Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ | Vizionin i integruar i Prizrenit 2015+ | PZHU 2003-2013 | PZHKP 2025 |
|---|---|---|---|
| **VIZIONI** | | | |
| Të sigurohet zhvillimi qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastruktura dhe teknologjia moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë dhe forcë pune të kualifikuar, vend që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve, me një shoqëri të hapur që promovon llojllojshmërinë dhe këmbimin e ideve duke respektuar të drejtat e të gjithëve. | Prizreni si qendër e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me një ekonomi që krijon potenciale për zhvillimin e shoqërisë dhe udhëkryq i rajonit ku mbizotëron toleranca dhe ligji. | Nuk është e qartë | Të zhvillohet Prizreni si një qendër e qëndrueshme kulturore në Kosovë dhe Ballkan, duke promovuar potencialin e tij sa i përket aseteve historike, resurset natyrore dhe ambientale, diversitet social dhe vitalitet ekonomik |
| **PARIMET** | | | |
| | • Trashëgimia kulturore dhe burimet natyrore | • Ruajtja e trashëgimisë kulturore | • Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore |
| • Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore | | • Qëndrueshmëria<br>• Mbrojtja ambientale | • Qëndrueshmëria ambientale |
| | | • Zhvillimi social<br>• Cilësia urbane<br>• Pushtetit lokal | • Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore |
| • Zhvillimi i rrjetit të fortë urban dhe zhvillimi ekonomik | • Ambienti ekonomik dhe Bujqësia | • Zhvillimi i balancuar i mirëqenies ekonomike dhe cilësia e jetës | • Vitaliteti ekonomik |
| • Zhvillimi i linjave strategjike | • Planifikimi dhe zhvillimi urban dhe rural<br>• Lëvizshmëria dhe Transporti<br>• Infrastruktura dhe Shërbimet Publike | • Trafiku i integruar | • Integriteti hapësinor |
| **QËLLIMET AFAT GJATA** | | | |
| • Mbrojtja dhe respektimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve | • Mbrojtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore | • Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore<br>• Sigurimi i kualitetit në ndërtimtari | • Trashëgimia kulturore do të konservohet dhe përmirësohet<br>• Trashëgimia natyrore do të konservohet dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | përmirësohet |
| • Mbrojtja dhe respektimi i resurseve të territorit të vet dhe të fqinjëve | • Përdorimi efikas i burimeve ekzistuese dhe i tokës bujqësore | • Përdorimi i kujdesshëm i burimeve natyrore dhe mbrojtja e ambientit | • Do të sigurohet mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore |
| Arritja e zhvillimit social të balancuar me mundësi të barabarta të qasjes në shërbime për të gjithë | • Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve publike<br>• Përmirësimi i kushteve jetësore | • Ofrimi i zhvillimit social për nevojat e secilit individ | • Do të sigurohen objektet publike të balancuara me qasje të lehtë<br>• Do të sigurohen mundësi të reja për punësim dhe shkalla e papunësisë do të ulet<br>• Do të inkurajohet pjesëmarrja në vendimmarrje. |
| • Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, i balancuar, i bazuar në resurse natyrore, njerëzore, teknologji moderne, konkurrencën e tregut dhe përmbushjes së standardeve për mbrojtjen e mjedisit | • Sigurimi i infrastrukturës së "lehtë dhe të rëndë" për mbështetjen e aktiviteteve dhe investimeve private<br>• Mbështetja e aktiviteteve ekonomike ne pjesët rurale | • Promovimi i zhvillimit lokal ekonomik | • Do të sigurohet zhvillimi i balancuar dhe i menaxhuar rural<br>• Do të mbështetet prodhimtaria bujqësore<br>• Aktivitetet prodhuese do të jenë më të organizuara<br>• Aktivitetet komerciale dhe financiare do të vitalizohen<br>• Aktivitetet turistike në Prizren do të zhvillohen dhe përmirësohen |
| • zhvillim i balancuar hapësinor,<br>• Infrastruktura dhe komunikimi i integruar duke respektuar standardet e mbrojtjes së mjedisit | • Zhvillimi i organizuar urban<br>• Zhvillimi policentrik hapësinor<br>• Zhvillimi më i balancuar<br>• Ngritja e kapacitetit dhe cilësisë së infrastrukturës teknike<br>• Zgjerimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturës.<br>• Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjeteve rajonale për të mbështetur zhvillimin e pjesëve rurale.<br>• Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit ndërkombëtar të transportit.<br>• Ofrimi i trafikut të rehatshëm dhe të sigurt në qendrën urbane. | • Mbështetja dhe koordinimi i të gjitha moduleve të trafikut për inkuadrim dhe siguri. | • Do të krijohen ambientet atraktive për jetesë<br>• Do të sigurohet transporti dhe infrastruktura efektive dhe e integruar hapësinore |

## 2.5. PRIORITET STRATEGJIKE

Prioritetet strategjike janë përcaktuar gjatë intervistave individuale më kryetarët e fshatrave të mbajtura në mars të vitit 2009 si dhe në debatin publik të qershorit të vitit 2009. Ato kanë përcaktuar drejtimin e PZHKP 2025 në bazë të aspiratave të pjesëmarrësve dhe nevojave. Prioritetet janë shkallëzuar prej 1-5 ku "1" ishin prioritetet më larta ndërsa "5" prioritetet më të ultë.

Qëllimi i intervistave individuale ishte marrja e informatave për fushat prioritare ku duhet të intervenohet. Tabela 2.14 përmban përgjigjet më të shpeshta të kryetarëve të fshatrave.

**Tabela 2.14:** Fushat problematike të përcaktuara nga kryetarët e fshatrave gjatë intervistave individuale.

| Përgjigjet | | Nr. i përgjigjeve |
|---|---|---|
| Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore | | 0 |
| Qëndrueshmëria ambientale | Vërshimi | 2 |
| | Transformimi i tokës bujqësore | 7 |
| | Eksploatimi ilegal i gurit natyror | 9 |
| | Përdorimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore | 18 |
| Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore | Edukimi i dobët | 45 |
| | Shërbimet shëndetësore | 51 |
| | Infrastruktura sociale | 51 |
| | Papunësia | 59 |
| | Migrimi | 60 |
| Vitaliteti ekonomik | Mungesa e investimeve | 55 |
| Integriteti hapësinor | Menaxhimi i plehut | 38 |
| | Sistemi i ujitjes | 41 |
| | Furnizimi me ujë | 43 |
| | Elektriciteti | 44 |
| | Transporti | 45 |
| | Kanalizimi | 46 |



Intervistat individuale kanë reflektuar problemet dhe nevojat e popullatës në pjesët rurale të Komunës së Prizrenit. Sipas intervistave, integriteti hapësinor është problemi më i theksuar përfshirë këtu edhe infrastrukturën teknike dhe atë të transportit. Numri mesatar i përgjigjeve e vë integritetin hapësinor në rend të tretë. Inkuadrimi social dhe kualiteti i jetës janë theksuar po ashtu nga ana e kryetarëve të fshatrave me problemet siç janë objektet e dobëta urbane, papunësia dhe migrimi. 53 nga 75 kryetarë të fshatrave kanë theksuar se inkuadrimi

social dhe kualiteti i jetës paraqesin një fushë problematike. Inkuadrimi social dhe kualiteti i jetës është i dyti me rrallë sipas prioritetit. Vitaliteti ekonomik ka vetëm një problem direkt të definuar e ajo është mungesa e investimeve, dhe paraqet prioritetin e parë. Edhe pse papunësia dhe migrimi, që janë përmendur nën fushën e inkuadrimit social dhe kualitetit të jetës, janë përmendur më shumë se mungesa e investimeve, zhvillimi ekonomik duhet të jetë faktori kyç për tejkalimin e papunësisë, që në fakt do të ndikojë në zvogëlimin e migrimit.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore nuk perceptohet si çështje problematike në pjesët rurale të komunës së Prizrenit. Asnjë nga kryetarët nuk ka përmendur ruajtjen e trashëgimisë si fushë prioritare të intervenimit. Arsyeja e mundshme për këtë se viset rurale ballafaqohen me probleme më serioze siç janë mungesa e objekteve urbane ose problemet e infrastrukturës. Qëndrueshmëria ambientale sipas intervistave radhitet si e dyta për nga rëndësia.

Si pasojë, renditja e prioriteteve duke u bazuar në anketat e drejtpërdrejta me kryetarët të fshatrave tregohet në Tabelën 2.15..

**Tabela 2.15:** Radhitja e prioriteteve të përcaktuara nga kryetarët e fshatrave gjatë intervistave individuale

| Prioriteti | Pozita |
|---|---|
| Vitaliteti ekonomik | 1 |
| Integriteti hapësinor | 2 |
| Inkuadrimi social dhe kualitetit i jetës | 3 |
| Qëndrueshmëria ambientale | 4 |
| Rruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore | 5 |



Faktori i dytë që ndikon në parëzimin e përgjithshëm rrjedh nga debati publik i mbajtur në qershor të vitit 2009. Siç shihet nga Tabela 2.7, vetëm 2 nga 22 pjesëmarrësit PZHKP 2025 e debatit publik janë përfaqësuesit nga viset rurale të Prizrenit ndërsa pjesëmarrësit tjerë ishin nga institucionet private dhe shoqërore si dhe nga OJQ-të, të gjitha me seli në qytet. Prandaj, mund të konstatojmë se debati publik reflekton mendimet e qytetarëve nga qendra e qytetit. Ky pohim mund të argumentohet edhe me faktin se debati ka vlerësuar lartë rruajtjen e trashëgimisë.

Tabela 2.10 përmban numrin e përgjigjeve për nevojat dhe parashikimet e debatit publik. Rezultatet theksojnë rëndësinë e rruajtjes dhe rehabilitimit të pronës/aseteve historike me 32%. Çështja e dytë me rëndësi sipas pjesëmarrësve të debatit publik është mungesa e objekteve urbane siç janë objektet arsimore dhe të shëndetësisë, pastaj kinemaja dhe objektet sportive. Pjesëmarrësit kanë theksuar po ashtu dëshirën e tyre për një ambient më

të sigurt si dhe nevojën për më tepër hapësirë publike. Këto përgjigje janë kategorizuar nën kategorinë e inkuadrimit shoqëror dhe cilësisë së jetës.

Integriteti hapësinor, i definuar nga kërkesat për plane zhvillimore, zhvillimi i qytetit dhe dëshira për ndërtime të larta, radhiten në vendin e tretë sipas debatit publik. 16 % të pjesëmarrësve kanë potencuar nevojën për një ambient të pastër dhe bukuritë natyrore. Këto cilësi janë radhitur nën parimin e qëndrueshmërisë ambientale dhe janë në pozitën e katërt sipas rëndësisë. Pjesëmarrësit e debatit publik janë deklaruar se vitaliteti ekonomik i cili definohet vetëm nga zhvillimi i turizmit të jetë prioritet i pestë me radhë.

Klasifikimi i këtyre përgjigjeve nën 5 tituj jep një renditje të parimeve bazë të PZHKP 2025 që parashikon forumi publik e cila është dhënë në Tabelën 2.16.

**Tabela 2.16:** Radhitja e prioriteteve të përcaktuara nga pjesëmarrësit e debatit publik për PZHKP 2025

| Prioriteti | Rëndësia |
|---|---|
| Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore | 1 |
| Inkuadrimi social dhe cilësia e lartë jetësore | 2 |
| Integriteti hapësinor | 3 |
| Qëndrueshmëria ambientale | 4 |
| Vitaliteti ekonomik | 5 |



Një radhitje e përgjithshme që ka rezultuar nga intervistat e drejtpërdrejta me kryetarët e fshatrave, e që mund të themi se përfaqëson mendimin e banorëve rurale dhe nga debati publik ku 90 % te pjesëmarrësve kanë qenë nga institucionet private dhe shtetërore si dhe nga OJQ-të është kombinuar dhe mesatarja është paraqitur në tabelën e mëposhtme (Tabela 2.17).

**Tabela 2.17:** Radhitja e përgjithshme e prioriteteve në bazë PZHKP të intervistave dhe debatit publik

| Prioriteti | Intervistat individuale të PZHKP 2025 | Debati publik PZHKP 2025 | Mesatarja |
|---|---|---|---|
| Inkuadrimi social dhe cilësia e lartë jetësore | 2 | 2 | 2 |
| Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore | 5 | 1 | 3 |
| Integriteti hapësinor | 3 | 3 | 3 |
| Vitaliteti ekonomik | 1 | 5 | 3 |
| Qëndrueshmëria ambientale | 4 | 4 | 4 |

Sipas kësaj tabele del se prioriteti më i madh i është dhënë inkuadrimit social dhe kualitetit të jetës ku hyn sigurimi i objekteve të balancuara dhe me qasje të lehtë siç janë objektet arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive etj. Ky parim po ashtu i referohet ofrimit të mundësive të reja të punësimit dhe zvogëlimit të shkallës së papunësisë.

Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, integriteti hapësinor dhe vitaliteti ekonomik ndajnë vendin e dytë bashkërisht. Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore synon ruajtjen në tërë komunën e Prizrenit duke rritur bashkëpunimin e sektorit profesional dhe atij qeveritar sa i përket menaxhimit të trashëgimisë, të integrojë ruajtjen me ekonominë e bazuar në turizëm dhe të ngrit vetëdijesimin publik për ruajtjen. Integriteti hapësinorë përfshin ofrimin e rrjetit të integruar hapësinor infrastrukturor dhe të transportit. Vitaliteti ekonomik varet nga zhvillimi i balancuar dhe i menaxhuar rural që sigurohen nga vazhdimi i prodhimtarisë bujqësore dhe aktivitetet prodhuese si dhe nga vitalizimi i aktiviteteve komerciale dhe financiare përfshirë këtu edhe zhvillimin e fuqishëm të turizmit.

Sipas radhitjes mesatare të prioriteteve, qëndrueshmëria ambientale zë pozitën më të ultë. Ky parim parasheh mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ambientale, për të reduktuar degradimin dhe ndotjen e ambientit si dhe të parandalojë humbjen e tokës së pëlleshme bujqësore.



Nuk duhet harruar se kjo radhitje paraqet prioritetet e PZHKP 2025 në bazë të intervistave direkte dhe debatit publik dhe se natyrisht ato do të merren parasysh. Por kjo radhitje nuk mund të merret si bazë për procesin e planifikimit. Kjo radhitje është bërë për të kontrolluar opinion publik në mënyrë analitike. Ekipi planifikues mendon se secila nga këto pesë parime janë komponentët e domosdoshme të Zhvillimit Komunal të Prizrenit. Rezultatet e këtij kontrollimi do të konsiderohen gjatë përcaktimit të qëllimeve dhe objektivave strategjike në fazën e ardhshme të studimit.

# 3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

Kjo pjesë paraqet strategjinë e përgjithshme të zhvillimit hapësinorë dhe komponentët e zhvillimit strategjik hapësinor duke iu referuar vizionimit, parimeve dhe qëllimeve zhvillimore afatgjate të përcaktuara në fazën e dytë të PZHKP 2025. Korniza e zhvillimit hapësinor shpreh perspektivën e dëshiruar hapësinore për Komunën e Prizrenit, në suaza të kontekstit hapësinor për zbatim, planeve të veprimit dhe vendimmarrjes. Kjo pjesë është e strukturuar në pesë seksione. Seksioni i parë paraqet konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor të PZHKP 2025. Seksioni i dytë informon në lidhje me strukturën dhe lokacionin hapësinor për organizimin dhe zhvillimin e tij për të ardhmen. Ajo trajton çështjet e zhvillimit ekonomik, infrastrukturës, popullatës, strehimit, vendbanimit, çështjet sociale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisit. Seksioni i tretë tregon sipërfaqet ekzistuese urbane dhe ato të propozuara për të ardhmen dhe zonat e ndërtimit jashtë zonës urbane. Seksioni i katërt tregon projektet e rëndësishme strategjike dhe zonat e veçanta të cilat janë miratuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$ dhe planet tjera për zonat të veçanta. Së fundi seksioni i pestë paraqet vlerësimin socio-ekonomik dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis në kuadër të kornizës së propozuar të PZHKP 2025.

## 3.1. KONCEPTET KRYESORE TE ZHVİLLİMİT HAPËSİNOR

Strategjia e zhvillimit hapësinor i PZHKP 2025 bazohet në zhvillimin e balancuar urban dhe rural të kualitetit të lartë që siguron komunikim optimal, në respektimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve mjedisore, integritetit të trashëgimisë kulturor, ekonominë diverse dhe të vetë qëndrueshme dhe të kualifikuar si dhe në veçanti popullsi të balancuar në aspektin hapësinor të fuqizuar nga inkuadrimi dhe pjesëmarrja e mbështetur nga objektet publike të standardit të lartë. 

Parimet kryesore të strategjisë për zhvillimin hapësinor të PZHKP 2025 jepen në temat vijuese të cekura në fazën e dytë të PKZHP 2025:

- Rruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Qëndrueshmëria ambientale
- Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë e jetës
- Vitaliteti ekonomik
- Integriteti hapësinor

Për ti përshtatur këto parime në PZHKP 2025, është ekzaminuar struktura e vendbanimeve të Prizrenit duke marrë parasysh popullsinë dhe madhësinë e amvisërive, ekzistimin e objekteve urbane, qasjen, infrastrukturën urbane duke përfshirë furnizimin me ujë, elektricitetin dhe menaxhimin e mbeturinave, modelet e përdorimit të tokës, si dhe trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

### 3.1.1. Parashikimi i Popullsisë

Sipas regjistrimit të vitit 1991, popullsia e Komunës së Prizrenit ishte 178.723 ndërsa në bazë të regjistrimit të popullatës së vitit 2001 ky numër ishte 220.776. Duke iu referuar PZHKP 2025 në studimet në terren të kryera në vitin 2009, del se numri i përafërt i popullatës është 240.000. Kjo do të thotë se rritja e popullsisë në 18 vitet e kaluara ishte 60.000. Përderisa shkalla e rritjes së popullsisë në vendet rurale është 7%, kjo përqindje në vendet urbane është 37%.

Regjistrimet zyrtare të popullsisë të viteve 1971, 1981 dhe 1991 si dhe analiza e popullsisë së viteve 2001 dhe 2008 janë përdorur për të vlerësuar rritjen e popullsisë në Komunën e Prizrenit si dhe për llogaritjen e popullsisë së përafërt në vitin 2025.

Shkalla mesatare vjetore e rritjes së popullsisë gjatë periudhës 1971 - 2008 është 2.3 % (Tabela 3.1). Kjo shkallë është e përafërt me shkallën mesatare vjetore të rritjes së popullsisë në Kosovë gjatë periudhës së njëjte (2,5% në 1981 dhe 2.1% në 1991). Zvogëlimi i rritjes së popullsisë prej 1.1 % gjatë periudhës 2001 - 2008 mund të sqarohet me rritjen e shkallës së migrimit pas luftës në Kosovë.

Në bazë të shifrave të përafërta, del se në vitin 2025 popullsia e Komunës së Prizrenit do të jetë 428,235 që do të thotë një rritje prej 188,000 njerëzish.



**Tabela 3.1**: Shtimi i Popullatës në Komunën e Prizrenit

| Vitet | Popullsia | Indeksi | Rritja e Popullsisë | Rritja Mesatare Vjetore e Popullsisë | Shkalla Mesatare Vjetore e Rritjes së Popullsisë |
|---|---|---|---|---|---|
| **1971** | 97.714 | 100 | | | |
| **1981** | 134.526 | 138 | 36.812 | 3681 | 0,03248 |
| **1991** | 178.723 | 183 | 44.197 | 4420 | 0,02881 |
| **2001** | 220.776 | 226 | 42.053 | 4205 | 0,02135 |
| **2008** | 240.000 | 246 | 19.224 | 2746 | 0,01199 |
| | | | | **Mesatarja** | **0,02366** |

**Parashikimi i Popullsisë sipas Projeksionit të Popullsisë**

Popullsia e parashikuar në PKZHP 2025 është llogaritur në bazë të katër teknikave matematikore: eksponenciale (exponential technique), metodën regresive (least squares), interesi i përbërë (compound interest) dhe teknikën aritmetike (arithmetic techniques), dhe në fund janë krahasuar të gjitha rezultatet e gjetura. Rezultatet e parashikimeve tregojnë se trendi aktual i rritjes së popullatës do të vazhdojë deri në vitin 2025.

Formula për kalkulimin e popullatës së parashikuar sipas **Teknikës Eksponenciale** është
$p = p_0 \times e^{rt}$ .

$P_0$ = popullata fillestare
T = koha
R = rritja mesatare vjetore e popullsisë
$p_t$ = popullsia e parashikuar

Sipas kalkulimeve del se në vitin 2025 popullsia e Komunës së Prizrenit to të jetë 358.861 me një rritje prej 107.229 (Tabela 3.2).

**Tabela 3.2:** Popullata e Projektuar sipas Teknikës Eksponenciale

| Vitet | Popullsia e parashikuar |
|---|---|
| **2010** | 251.632 |
| **2015** | 283.239 |
| **2020** | 318.815 |
| **2025** | 358.861 |

Teknika e dytë për parashikimin e popullsisë është metoda regresive (**Least Squares)** ku formula është

$Y = a + bx$
$a = yn$
$b = xy/x^2$

x: popullsia e parë
y: popullsia e fundit
n: intervali kohor
Y: Popullata e projektuar

Sipas këtaj teknike, popullsia e parashikuar në Komunën e Prizrenit në vitin 2025 është 471.005 (Tabela 3.3 dhe 3.4).



**Tabela 3.3:** Shkalla e Rritjes së Popullatës sipas metodës regresive (Least Square)

| Vitet | Popullsia (y) | (x) | $x^2$ | xy | $y^2$ |
|---|---|---|---|---|---|
| **1971** | 97.714 | -2 | 4 | -195.428 | 9.548.025.796 |
| **1981** | 134.526 | -1 | 1 | -134.526 | 18.097.244.676 |
| **1991** | 178.723 | 0 | 0 | 0 | 31.941.910.729 |
| **2001** | 220.776 | 1 | 1 | 220.776 | 48.742.042.176 |
| **2008** | 240.000 | 2 | 4 | 480.000 | 57.600.000.000 |
| **Totali** | **871.739** | **0** | **10** | **370.822** | **165.929.223.377** |

**Tabela 3.4:** Popullata e Projektuar sipas metodës regresive (Least Square)

| Vitet | Popullsia e Parashikuar |
|---|---|
| **2010** | 359.759 |
| **2015** | 396.841 |
| **2020** | 433.923 |
| **2025** | 471.005 |

Formula e metodës Interesi i Përbërë (**Compound Interest)** është

$P_t = P_0(1+r)^t$
$P_0$ = popullsia e fundit
r = rritja mesatare vjetore e popullsisë
$P_t$ = popullsia e parashikuar

Sipas këtij kalkulimi, del se popullata e Komunës së Prizrenit në vitin 2025 do të jetë 461.981 (Tabela 3.5).

**Tabela 3.5:** Popullata e Projektuar sipas Teknikës Interesi i Përbërë (**Compound Interest)**

| Vitet | Popullsia e parashikuar |
|---|---|
| **2010** | 325.282 |
| **2015** | 365.635 |
| **2020** | 410.995 |
| **2025** | 461.981 |

Formula e përdorur në **Teknikën Aritmetike** (arithmetic technique) është

$P_t = p_0 + bn$
$b = (P_{t1} – P_0) / n$
$P_t$ = popullsia e parashikuar
$P_0$ = popullsia fillestare
n = intervali i popullsisë
b = rritja mesatare aritmetike e popullsisë
$P_{t1}$ = popullsia e fundit

Kjo teknikë jep shifrën prej 421.091 banorëve të Komunës së Prizrenit në vitin 2025 (Tabela 3.6).

**Tabela 3.6:** Popullata e Projektuar sipas Teknikës Aritmetike



| Vitet | Popullsia e parashikuar |
|---|---|
| **2010** | 324.078 |
| **2015** | 356.416 |
| **2020** | 388.754 |
| **2025** | 421.091 |

**Mesatarja** e nxjerrë nga këto katër teknika të kalkulimit të popullatës së projektuar është 428.235 e cila është popullsia e parashikuar e Komunës së Prizrenit në vitin 2025 (Tabela 3.7).

Tabela 3.7: Popullata e Projektuar - Krahasimi

| Vitet | Exponential (Eksponenciale) | Least Squares (Metoda regresive) | Compound Interest (Interes i Përbërë) | Arithmetic (Aritmetike) | Mesatarja |
|---|---|---|---|---|---|
| **2010** | 251.632 | 359.759 | 325.282 | 324.078 | **315.188** |
| **2015** | 283.239 | 396.841 | 365.635 | 356.416 | **350.533** |
| **2020** | 318.815 | 433.923 | 410.995 | 388.754 | **388.122** |
| **2025** | 358.861 | 471.005 | 461.981 | 421.091 | **428.235** |

**Parashikimi i Popullsisë sipas Analizës së Kapaciteteve**

Përpos llogaritjeve për parashikimin e popullsisë, është kryer edhe analiza e kapaciteteve për të përcaktuar presionin e popullsisë në zhvillimin urban. Qëllimi i analizës së kapaciteteve është të llogaris shkallën e popullsisë të cilën mund të absorbojnë zonat e reja të vendbanimit si dhe të përcaktojë problemet që rezultojnë nga popullsia e shtuar. Mirëpo kjo analizë nuk jep rezultate përfundimtare; ajo përcakton vetëm atë që është e mundshme.

Analiza e kapaciteteve kërkon fillimisht të definohen disa çështje. Së pari duhet të pranohet vazhdimësia e modelit të tashëm të zonimit që përcakton kornizën e shkallës së popullsisë të cilën mund ta absorbojë ai vend. E dyta ka të bëjë me sipërfaqet e përshtatshme për vendbanime, të cilat definohen duke përjashtuar rrugët, rezervuarët e ujit, tokat e lagshta dhe sipërfaqet me pjerrësi më të madhe se 20 %. Çështja e tretë ka ta bëjë me densitetin e popullsisë me ç'rast analiza parasheh një numër prej 175 personave për ha.

Gjatë analizës së përshtatshmërisë, janë mbivendosur të dhënat mbi topografinë (pjerrësia, aspekti, ujëmbledhësi etj), klasifikimin e tokës, klasifikimin e tokës bujqësore, erozionin, pyjet dhe gjeologjinë. Për të përcaktuar rëndësinë e faktorëve të identifikuar në analizë është përdorur Procesi Hierarkik Analitik. Kriteri për sintezë është përcaktimi dhe shkallëzimi i sipërfaqeve të reja për vendbanime që do të rruajnë resurset natyrore dhe zonat potenciale bujqësore duke marrë në konsideratë zonat me rrezik potencial natyror. Zonat me rreziqe natyrore si dhe zonat prioritare janë definuar si "veto zonat apo zonat e pa aprovuara". Veto zonat përbëhen nga regjionet me rrezik të madh të erozionit, pyjet, zonat me dhe të butë dhe të përshkueshme. Sipërfaqet tjera vlerësohen për përshtatshmëri në bazë të hierarkisë. Sipas rezultateve të analizës, zonat e përshtatshme për vendbanim të shkallës së parë janë 3738,23 ha, zonat e përshtatshme për vendbanim të shkallës së dytë 8760,38 ha, dhe zonat e përshtatshme për vendbanim të shkallës së tretë janë 12453,91 ha. Sipërfaqja jo e përshtatshme për vendbanime është 38424,92 ha.

Në analizën e kapaciteteve është përdorur sistemi hierarkik me ç'rast si indikator kryesor është marrë afërsia me qendrën e qytetit (Figura 3.1). Kapacitetet e popullsisë janë llogaritur për zonat e përshtatshme për vendbanim  të shkallës së parë, shkallës së dytë dhe të shkallës së tretë (Tabela 3.8) me rrethet e afërsisë me radius prej 3 km, 3-4 km dhe 4-5 km.




**Figura 3.1:** Afërsia dhe Vlerësimi i Përshtatshmërisë së Vendbanimeve për Analizën e Kapaciteteve



**Tabela 3.8.** Analiza e Kapaciteteve

| Afërsia me qendrën e qytetit | Sipërfaqe e përshtatshme e shkallës së parë | | Sipërfaqe e përshtatshme e shkallës së dytë | | Sipërfaqe e përshtatshme e shkallës së tretë | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sipërfaqja (Ha) | Kap. Pop.* | Sipërfaqja (Ha) | Kap. Pop.* | Sipërfaqja (Ha) | Kap. Pop.* | Sipërfaqja (Ha) | Kap. Pop.* |
| **a.** <3 km | 16,8 | 3.360 | 301,6 | 60.320 | 359,5 | 71.900 | 677,9 | 135.580 |
| **b. Sub-total (=a)** | **16,8** | **3.360** | **301,6** | **60.320** | **359,5** | **71.900** | **677,9** | **135.580** |
| **c.** 3 – 4 km | 195,8 | 39.160 | 514,7 | 102.940 | 49,8 | 9.960 | 760,3 | 152.060 |
| **d. Sub-total (a+c)** | **212,6** | **42.520** | **816,3** | **163.260** | **409,3** | **81.860** | **1438,2** | **287.640** |
| **e.** 4 – 5 km | 370,1 | 74.020 | 350,4 | 70.080 | 26,0 | 5.200 | 746,5 | 149.300 |
| **f. Sub-total (d+e)** | **582,7** | **116.540** | **1166,7** | **233.340** | **453,3** | **87.060** | **2184,7** | **436.940** |
| **Gjithsej sipërfaqe** | **2610,6** | **522.120** | **3443,2** | **688.640** | **435,4** | **87.080** | **6489,2** | **1.297.840** |

*(*) Densiteti 175 person/Ha*

Rezultati i analizës së kapaciteteve tregon se nëse vetëm sipërfaqet e shkallës së parë shfrytëzohet, del se tejkalohet popullata e parashikuar e vitit 2025.

Si rezultat i dy analizave del se numri i popullsisë së parashikuar do të jetë 428.235 në vitin 2025 prej nga 29% popullatë rurale dhe 71% popullatë urbane.

### 3.1.2 Konceptet e Zhvillimit Hapësinor

#### Trendët Ekzistuese Urbane dhe Rurale

Trendi i rritjes së popullsisë na tregon se qyteti i Prizrenit është në rritje të vazhdueshme dhe zgjerohet në periferi. Nëse nuk menaxhohet ashtu si duhet, kjo rritje do të shndërrohet në një kërcënim për sipërfaqet e pasura ekologjike që ndodhen në mes të qendrës së qytetit dhe vendbanimeve periferike. Zhvillimi i balancuar hapësinor në Komunën e Prizrenit imponon marrjen në konsideratë të zhvillimit hapësinor rural dhe atij urban. Këto sipërfaqe janë (Figura 3.2):

- Qyteti i Prizrenit dhe regjioni rrethues i Prizrenit [A]
- Korridoret transportuese në drejtim të Prishtinë në verilindje dhe në drejtim të Gjakovës në veriperëndim me potencial të lartë zhvillimor [B1-B2]
- Regjioni i Lumës përgjatë aksit të lumit Drini i bardhë kah kufiri me Shqipërinë në perëndim [C]
- Lugina e Zhupës përgjatë aksit të lumit Lumëbardhi në lindje [D]
- Zonat rurale (Hasi, Anadrini, Kabashi, Luma, Vërrini dhe Zhupa) mbi fushat në veri dhe zonave rurale me lartësi të lartë në lindje, perëndim dhe jug të qytetit [E1/Has-E2/Anadrini-E3/Kabashi-E4/Zhupa-E5/Vërrini dhe Luma]






**Figura 3.2.** Zonat e Zhvillimit Hapësinor të PZHKP 2025

**Komponentët Themelore Strategjike për Zhvillimin Hapësinor të PZHKP 2025**

**Komponenti Strategjik 1:** Krijimi i Qendrës Rajonale

Ky komponent strategjik fokusohet në inkurajimin e zhvillimit të Regjionit të Prizrenit si qytet qendër që do t'i shërbente regjionit më të gjerë duke reflektuar potencialin e saj për zhvillimin ekonomik dhe social.




**Figura 3.3.** PZHKP 2025 Komponenti Strategjik 1

**Komponenti Strategjik 2: Zhvillimi Policentrik i Zonave Rurale**



Ky komponent strategjik promovon zhvillimin policentrik në zonat rurale përmes rrjetit të nën qendrave me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social si dhe popullatë të balancuar në aspektin hapësinor, të zvogëlojë presionin në zonat bujqësore përreth qytetit të Prizreni dhe të parandalojë zhvillimin e pabarabartë në Komunën e Prizrenit.




**Figura 3.4.** PZHKP 2025 Komponenti Strategjik 2

**Komponenti Strategjik 3: Transporti Rajonal dhe Rrjeti Infrastrukturor**

Komponenti strategjik i tretë bazohet në ofrimin e transportit efikas rajonal dhe të integruar në aspektin hapësinor si dhe rrjetin infrastrukturor për të mbështetur zhvillimin policentrik.




**Figura 3.5.** PZHKP 2025 Komponenti Strategjik 3

**Komponenti Strategjik 4:** Integrimi me Korridoret Zhvillimore



Këtu fokusimi bie mbi ri-orientimin e zhvillimit të ri hapësinor me integrimin e korridoreve zhvillimore ekonomike dhe të transportit siç janë autostrada Kukës – Prizren – Prishtinë dhe hekurudha Prizren-Prishtinë.




**Figura 3.6.** PZHKP 2025 Komponenti Strategjik 4

**Komponenti Strategjik 5:** Mbrojtja e Komuniteteve të Lëndueshme Rurale

Kjo strategji bazohet në mbrojtjen dhe forcimin e rolit të komuniteteve të lëndueshme rurale si sisteme të vetë-qëndrueshme socio-ekonomike përmes përdorimit të potencialeve të tyre autentike dhe diverse si dhe më përmirësimin e objekteve themelore urbane për të parandaluar derdhjen e popullsisë në aglomeratet primare të qytetit.




**Figura 3.7.** PZHKP 2025 Komponenti Strategjik 5

**Komponenti Strategjik 6:** Konservimi i Trashëgimisë Kulturore dhe Ekologjike



Ideja kryesore e këtij komponenti strategjik është mbrojtja dhe integrimi i rajoneve me trashëgimi kulturore dhe ekologjike në kornizën për zhvillimin hapësinor duke siguruar përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve për mirëmbajtjen e integritetit të tyre për cilësinë e jetës përmes intervenimeve turistike dhe rekreative.




**Figura 3.8.** PZHKP 2025 Komponenti Strategjik 6

## Konceptet e Zhvillimit Hapësinor të PZHKP 2025

Konceptet e zhvillimit hapësinor të PZHKP 2025 janë zhvilluar në bazë të qasjes së "skenarëve" duke u fokusuar në strategjitë dhe rekomandimet e dokumenteve udhërrëfyese të nivelit me të lartë si dhe vlerësimet analitike të PZHKP 2025 të bazuar në kushtet ekzistuese hapësinore, sociale dhe ekonomike.

Qëllimi i skenarit të bazuar në propozimet konceptuale është të prezantojë një vlerësim krahasues te rolit të paraparë dhe modelit zhvillimor të Komunës së Prizrenit të bazuar në perspektiva të ndryshme. Për skenat zhvillimore racionale dhe të aplikueshme, duhet të merret parasysh konteksti ekzistues ligjor, menaxherial, social, ekonomik dhe hapësinor. Zgjedhja e skenarit më të përshtatshëm mund të bazohet në vendimin për një skenar të caktuar ose për integrimin e komponentëve të ndryshme të skenarëve.

Duke i pasur parasysh këto, PZHKP 2025 definon tri koncepte të zhvillimit hapësinor.

Ato janë:

- Koncepti 1 i Zhvillimit Hapësinor: Zhvillimi i Shpërndarë/Shpërhapur
- Koncepti 2 i Zhvillimit Hapësinor: Zhvillimi i Kontrolluar
- Koncepti 3 i Zhvillimit Hapësinor: Zhvillimi Poli-Centrik



## Koncepti 1 i Zhvillimit Hapësinor: Zhvillimi i Shpërndarë/Shpërhapur

Karakteristikat:

Në zhvillimin e shpërhapur, korniza e zhvillimit hapësinor dhe zgjedhja e lokacionit përcaktohet nga forcat e tregut. Problemi kryesor është tërheqja e investimeve dhe sigurimi i vitalitetit ekonomik. Masat për mbrojtjen ambientale janë të nënvlerësuara. Procesi i planifikimit dhe zhvillimit nuk bazohet në kornizë gjithëpërfshirëse dhe është i menaxhuar nga trendët e pavarura të orientuara kah veprimi.

Sfidat:

Ndaj qytetit të Prizrenit ushtrohet një presion i madh. Tendenca e zhvillimit vërehet përgjatë boshteve në veri, lindje dhe perëndim. Po ashtu vërehet zhvillimi i pakontrolluar i vendbanimeve të vogla. Zonat ekologjike dhe toka bujqësore janë cak i invadimit.

Në konceptin e zhvillimit të shpërhapur, ashtu siç shihet edhe në Figurën 3.9 vërehet krijimi i vendbanimeve të dobëta rurale. Shpërndarja e vendbanimeve të reja në këtë mënyrë të pakontrolluar do të shkaktojë zhvillim të pa balancuar dhe të dobët në zonat rurale. Po ashtu vërehen mjaft shtëpi në zonat pyjore, tokat bujqësore dhe zonat me minerale.




**Figura 3.9.** PZHKP 2025 Koncepti 1 për Zhvillimin Hapësinor

**Koncepti 2 i Zhvillimit Hapësinor: Zhvillimi i Kontrolluar**

Karakteristikat:

Në këtë koncept behet fjalë për një qendër me primat të fortë me përqendrimin e objekteve themelore urbane dhe forcave shtytëse ekonomike që i shërbejnë komunës. Zhvillimi është i kontrolluar me rrjetin e vendbanimeve rurale të balancuar dhe të integruar në aspektin hapësinor, social dhe ekonomik. Këtu ekziston kontrolli absolut i zhvillimit jashtë vendbanimeve qendrore dhe mbrojtje e ashpër ambientale. Popullsia rurale është e mbrojtur dhe e zhvilluar. Është siguruar mbrojtja e zonave ekologjike që janë të përqendruar në juglindje. Vendbanimet, infrastruktura dhe objektet janë përqendruar në verilindje, veriperëndim dhe korridoret qendrore perëndimore. Figura 3.10 ilustron zgjerimin e kontrolluar të vendbanimeve qendrore me qasje të rritjes kompakte.



Sfidat:

Megjithatë, ky koncept ushtron presion të lartë ndaj qytetit të Prizrenit, tendenca e zhvillimit shkon kah veriu, jugu dhe perëndimi i akseve rrugore regjionale. Në anën tjetër, paraqitet varësia ekonomike dhe sociale e vendbanimeve rurale.




**Figura 3.10.** PZHKP 2025 Koncepti 2 për Zhvillimin Hapësinor

**Koncepti 3 i Zhvillimit Hapësinor: Zhvillimi poli-centrik**

Karakteristikat:

Ideja kryesore e këtij koncepti është sigurimi i zhvillimit policentrik i bazuar në nën qendrat e forta të vetë qëndrueshme që u shërbejnë zonave rurale. Ekspansioni është i kontrolluar dhe ka model hierarkik të rritjes hapësinore. Objektet bazike urbane si dhe forcat shtytëse ekonomike janë të decentralizuar dhe u shërbejnë nën regjioneve. Këtu kemi një mbështetje të zonave rurale përmes zhvillimit të vetë-qëndrueshëm ekonomik të bazuar në bujqësi dhe ndërmarrjet rurale të bazuara në shërbime. Figura 3.11 ilustron zhvillimin e balancuar rural ku inkurajohen nën qendrat në zonat rurale.






**Figura 3.11.** PZHKP 2025 Koncepti 3 për Zhvillimin Hapësinor

Sfidat:

Në këtë koncept tregu nuk ka ndikim në zhvillim prandaj edhe paraqiten vështirësitë në tërheqjen e investimeve.

**Koncept i Zgjedhur të Zhvillimit Hapësinor të PZHKP 2025**

Aktualisht ka një presion të fortë të zhvillimit në Qytetin të Prizrenit që kërcënon tokat bujqësore me vlerë në afërsi të saj. Trendi aktual i zhvillimit të Qytetit të Prizrenit ka një tendencë për tu përhapur në drejtim të zonave rurale. Ky zhvillim ka gjasa të mundshme të absorbimit të zonave rurale, duke shkaktuar një rënie në tokat bujqësore, edhe në qoftë se kontrollohet. Qëndrueshmëria e mjedisit është një nga parimet kryesore të qasjes së PZHKP 2025, e cila përfshin mbrojtjen e karakteristikeve rurale. Prandaj, studimi merr parasysh zhvillimin poli-cenrik si koncept themelor të zhvillimit, që propozon një rritje hierarkike hapësinore, i cili pritet të reduktojë presionin mbi dy zonat: urbane dhe atë rurale.

Kjo është parë në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$ e cila rishtazi është miratuar, ku plani për herë të parë paraqet një koncept hapësinor të zhvillimit që mbështet konceptin e zhvillimit hapësinor të PZHKP 2025. Siç u tha në f. 124, propozimi i zhvillimit policentrik është bazuar në strukturën ekzistuese dhe shpërndarjen e vendbanimeve, të karakterizuar nga përmbajtja e tyre dhe aktiviteteve në funksion përmes një rrjeti të zgjidhjes. Koncepti bazë i zhvillimit hapësinor, në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$, është definuar si koncept i zhvillimit nyjore me elemente të korridorit. Koncept i zhvillimit nyjore i referohet përqendrimit të zhvillimit të ardhshëm në shtatë qendrat kryesore të Kosovës, dhe koncepti i korridoreve referohet zhvillimeve hapësinore përgjatë rrugëve, të cilat do të kontrollohen rreptësisht dhe nuk do të lejohet në tokat bujqësore të kategorive I deri IV. Sipas Planit të ri Hapësinor, Prizreni është përcaktuar si një nga "qendrat më të mëdha" së bashku me Prishtinën, Mitrovicën, Pejën, Gjakovën, Gjilanin dhe Ferizajn. Këto qendra janë deklaruar (paraqitur) për të vazhduar zhvillimin e tyre dhe zhvillimet e tyre do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të mjaftueshme dhe të barabartë në pjesë të tjera, që do të thotë ofrimin e shërbimit për banorët që nuk kanë nevojë për të lëvizur nga mjediset e tyre. Plani gjithashtu sugjeron se zhvillimi i vendbanimeve të mesme (qytetet me 10.000 – 20.000 banorë) dhe atyre të vogla (nën 10.000 banorë dhe fshatrat) do të bëhet e mundur nga politikat e investimeve në përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore të brendshme dhe një lidhje më funksionale me infrastrukturën e nivelit të lartë, ndërtimi i infrastrukturës së ujit në të gjitha vendbanimet, ndërtimi dhe furnizimi me energji elektrike dhe linjave të reja të telekomunikacionit, sigurimin dhe rritjen e cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve arsimore, në mënyrë që të mundësoj zhvillimin e mjaftueshëm dhe të barabartë me zonat tjera.

## 3.2. STRUKTURA HAPËSINORE DHE LOKACIONI PËR ZHVILLIMIN DHE ORGANIZIMIN E ARDHSHËM

Në këtë pjesë bëhet fjalë për strukturën hapësinore dhe lokacionin e zhvillimit dhe organizimit të ardhshëm. Këtu adresohen çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, infrastrukturën, popullsinë, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgiminë kulturore dhe ambientin.

### 3.2.1. Zhvillimi ekonomik, rigjenerimi, duke përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë

Zhvillimi ekonomik i Prizrenit bazohet në strategjinë e qendrës së fortë të qytetit duke mbrojtur zonat rurale. Sipas zhvillimit ekonomik vendbanimi qendror është pikë qendrore e vendbanimeve rurale.

Vitaliteti ekonomik dhe zhvillimi i balancuar rural janë dy synimet e PZHKP 2025. Rritja e vitalitetit ekonomik dhe sigurimi i zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm rural arrihen përmes aktiviteteve të mëposhtme.

Në fushën e bujqësisë, do të përkrahet prodhimi i drithërave; prodhimtaria e pemëve dhe perimeve si dhe aktivitetet e vreshtarisë do të përmirësohen dhe zgjerohen në regjionin e Prizrenit, Anadrinit dhe Vërrinit, të cilat dallohen me aktivitete të shtuara bujqësore. Zonat e vreshtarisë në Gërnçare në regjionin e Prizrenit, Krushë të Vogël në regjionin e Anadrinit, fshatrat Jeshkovë dhe Leskovec në regjionin e Vërrinit do të rehabilitohen dhe do të aktivizohen me ç'rast do të mbështeten politikat ekonomike që inkurajojnë vreshtarinë.

Po ashtu do të mbështeten edhe aktivitetet blegtorale që janë më evidente ne regjionin e Prizrenit dhe Anadrinit. Në anën tjetër do të zhvillohet prodhimtaria blegtorale në regjionin e Zhupës dhe Vërrinit ku nuk favorizohet blegtoria.

Prodhimet qumështore nga fshatrat rrethuese do të grumbullohen dhe do të përpunohen në fshatin Velezhë që është fshati qendror i regjionit të Anadrinit. Po ashtu do të punohet në rritjen e prodhimtarisë së djathit të Sharrit si një prodhim tradicional.

Aktivitetet prodhuese të cilat ishin karakteristikë e Prizrenit në të kaluarën po ashtu do të zhvillohen. Do të zhvillohen politika të reja për të evituar problemin e papunësisë që u shkaktua nga politikat ekzistuese të privatizimit. Krahas kësaj do të krijohet në pjesën veri perëndimore të Prizrenit një zonë e re industriale e bazuar në bujqësi. Në këtë kontekst, do të përkrahen sidomos prodhimtaria e verës. Krahas aktiviteteve bujqësore në zonat rurale ku papunësia është në rritje e sipër, do të mbështetet prodhimtaria e rakisë dhe verës si prodhime tradicionale familjare. Në anën tjetër, si një nga aktivitetet tradicionale të Prizrenit që kanë të bëjnë me turizmin, do të promovohet filigrani.

Pos njësive komerciale në qendrën e Prizrenit, do të zhvillohen dhe përmirësohen aktivitetet komerciale me pakicë në fshatrat qendrore.

Meqë turizmi është një nga degët më të rëndësishme ekonomike në Prizren, fillimisht do të themelohet Zyra e Turizmit, që do të promovojë dhe reklamojë komunën. Në Planin për Konservimin dhe Zhvillimin e Prizrenit thuhet se aktivitetet turistike paraqesin potencial për një zhvillim të qëndrueshëm sidomos në qendrën historike të Prizrenit. Në zonat rurale do të zhvillohen llojet tjera të turizmit siç janë turizmi dimëror, turizmi shëndetësor dhe eko turizmi. Në këtë kontekst, duke u bazuar pozitës gjeografike dhe kushteve klimatike të regjionit të Prizrenit dhe Zhupës, këtu do të favorizohet turizmi shëndetësor ndërsa në pajtim me aktivitetet bujqësore të regjionit të Hasit, aty do të favorizohet eko-turizmi dhe agro-turizmi. Në mbështetje të aktiviteteve të turizmit, do të përmirësohen objektet ekzistuese turistike përgjatë rrugës së Reçanës dhe në regjionin e Lumës. Pos kësaj, pjesët malore për skijim dhe ngjitje malore në Prevallë dhe Malet e Sharrit do të përmirësohen në pajtim me strukturën natyrore të kësaj ane si dhe do të përpilohen projekte të reja të akomodimit turistik.

Për të realizuar aktivitetet e mësipërme ekonomike, do të sigurohen veprime për tërheqjen e fondeve financiare për investitorë individual apo institucional, prandaj edhe sugjerohet të formohet struktura institucionale.

### 3.2.2. Infrastruktura – transporti komunal, trafiku

Infrastruktura, në kontekstin e saj të gjerë nënkupton rrugët, transportin publik, shërbimet e ujësjellësit, kanalizimin, menaxhimin e mbeturinave, telekomunikacionin dhe rrjetin energjetik. Vizioni i Planit Zhvillimor të Komunës së Prizrenit parasheh realizimin e linjave të fuqishme transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet rrethuese. Duke synuar një komunikim optimal, qëllimi është krijimi i transportit të integruar hapësinor dhe rrjetit infrastrukturor në Prizren. Investimi në infrastrukturë paraqet një nevojë fondamentale për bashkërenditjen e cilësisë dhe sasisë së aktiviteteve dhe shërbimeve të ndryshme ekonomike për një rritje dhe shpërndarje të popullsisë siç është përcaktuar në Vizionin, Parimet dhe Synimet e Planit Zhvillimor të Komunës së Prizrenit. 

#### Transporti

Prizreni, për shkak të pozitës dhe rrethit që ka, sa i përket transporti varet shumë nga rrjeti publik i transportit. Janë propozuar disa rrugë nacionale të reja si p.sh autostrada Morinë-Merdare, e cila do të kalojë përmes Prizrenit (tani më autostradë e përfunduar dhe është në shfrytëzim) dhe paraqet boshtin më të rëndësishëm transportues që do të jetë korridori strategjik ekonomik i trafikut i shkallës rajonale.

Rrugët e propozuara që do të sigurojnë lidhje më të mira të Prizrenit me rrjetin trans nacional, do të zvogëlojnë ngarkesën në trafik dhe do të përmirësojnë nivelet e sigurisë në të gjitha rrugët publike në veçanti rrugëve të brendshme të qytetit.

Një nga përmirësimet e sistemit transportues do të jenë rrugët rrethore të cilat do të lidhin rrugët rajonale me autostradën. Si përmirësim i dytë vlen të përmendet se rrugët rajonale janë ri rregulluar në shpërndarje të balancuar për t'i shërbyer qendrës së qytetit e sidomos fshatrave qendrore të Prizrenit.

Në sistemin e transportit, sistemi i rrugëve lokale ka përparësi për përmirësimin në aspektin e zhvillimit infrastrukturor, për të hyrë në fshatrat dhe lagjet sidomos në rajonin e Zhupës, ku ka dobësi të mëdha në rrjetin e transportit. Si në nivelin lokal ashtu edhe në atë rajonal, përmirësimet e transportit duhet të synojnë një përdorim efikas të menaxhimit të trafikut ashtu që njerëzit mund të udhëtojnë me mjete të ndryshme që do të minimizon ndikimin ambiental dhe do të reduktojë ngarkesën e trafikut. Propozimet për rregullat e parkimit në një fazë më të avancuar për tërë Prizrenin po ashtu do të reduktojë trafikun dhe do të përmirësojë lidhjen me pjesët e ndryshme të Komunës.

Prizreni ka një rrjet të limituar të transportit publik, prandaj Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit rekomandon rrjetin e transportit që kalon përmes rrugëve rajonale në mënyrë që të promovohet dhe inkurajohet qarkullimi i këmbësorëve dhe modelet e lëvizshmërisë në qendrën e Prizrenit dhe në fshatra.

**Uji, mbeturinat, energjia dhe shërbimet e Telekomunikacionit**



Edhe pse Prizreni ka një bazë të mirë për sistemin infrastrukturor, ekziston mungesë e madhe e përdorimit të kapaciteteve si dhe kërcënime të mëdha në aspektin e kontrollit ambiental. Prandaj Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit ofron unifikimin dhe kompletimin e sistemit infrastrukturor në shpërndarje të balancuar për tërë Komunën dhe zonat e thella të saja.

Sipas të dhënave për rrjedhën e ujërave dhe bazeneve të ujit nga Zyra Rajonale e Prizrenit të Institutit Hidrogjeologjik, uji që vjen nga Prevalla është i pastër, por ajo ndotet përgjatë rrjedhës së lumit. Për të përdorur në mënyrë efikase burimet ujore, duhet të ndërtohen objektet për pastrimin e ujit për të parandaluar ndotjen e ujit në zonën e afërt buferik të pellgjeve të lumenjve.

Aktualisht 21 nga fshatrat e Prizrenit marrin shërbim nga institucioni dhe zona e shërbimit duhet të zgjerohet për të përfshirë të gjitha fshatrat. Sipas zyrës rajonale, burimet e ujit janë të mjaftueshme, por ka humbje të ujit prej 40-45% që rezulton nga gypat e asbestit, të cilët duhen menjëherë të zëvendësohen.

Duke pasur parasysh ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike si dhe kërkesën e madhe për rrymë, sistemi i rrymës elektrike duhet të rinovohet si në aspektin e linjave ashtu edhe në aspektin e njësive shpërndarëse.

### 3.2.3. Popullata, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgimia kulturore

Zhvillimi i vendbanimeve është vlerësuar në bazë të popullsisë së tanishme dhe të asaj të projektuar në pajtim me parimet e planifikimit të mirëfilltë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjitë që kanë të bëjnë me këtë aspekt synojnë të ofrojnë një nivel të barabartë social dhe vendbanime të përshtatshme.

Zhvillimi i ri në Qytetin e Prizrenit përfshin boshtin verior ku janë analizuar ambienti natyror dhe faktori i qasjes. Duke pasur parasysh madhësinë e parashikuar të popullsisë në qytetin e Prizrenit (216,346), del se Qyteti i Prizrenit ka nevojë për 380 ha për vendbanime të reja (Tabela 3.9). Për të siguruar një cilësi ambientale, vendbanimet e reja duhet të bashkërenditen në pajtim me parimet urbane në planet zhvillimore zbatuese të shkallës së ultë.

Zhvillimi i vendbanimeve të reja në fshatra qendrore është paraparë po ashtu me qëllim të arritjes së ambientit më të balancuar urban dhe rural në tërë Komunën e Prizrenit. Vendbanimet e reja veçanërisht në Zhur, Hoçë të Qytetit dhe Mamushë janë respektivisht në madhësi prej 161.65, 133.42, dhe 128.78 ha.

Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit inkurajon dhe mbështet rolin kyç të zonave urbane, qyteteve dhe fshatrave për të siguruar kushte atraktive jetësore me qasje të përshtatshme ndaj objekteve dhe shërbimeve të nivelit të lartë. Sidomos në qytetin e Prizrenit, objektet urbane duhet të rregullohen asisoj që t'i shërbejnë jo vetëm banorët që jetojnë aty por edhe ata që jetojnë në pjesët rurale të komunës.



Si parim i përgjithshëm, zhvillimi i vendbanimeve në fshatrat qendrore duhet të bëhet me integrimin e vendbanimeve ekzistuese përmes procesit të planit zhvillimor për ndarjen e shërbimeve kulturore dhe sociale në politikat për zhvillimin e qëndrueshëm. Bashkërenditja e re e objekteve sociale, kulturore e sidomos të atyre shëndetësore është elementi kyç në krijimin e hierarkisë se vendbanimeve në pjesën rurale të komunës.

Fshatrat tjera kanë po ashtu rol të rëndësishëm në mbrojtjen e karakteristikave rurale të Prizrenit. Duhet të vihet baraspesha në mes të zhvillimit të përshtatshëm rezidencial në fshatrat qendrore dhe të vogla dhe sigurimit të ambientit hapësinor atraktiv dhe të qëndrueshëm me një dizajn, karakter dhe shkallë që do t'i përshtatet qytetit apo fshatit të përfshirë.

**Tabela 3.9:** Madhësia e Paraparë për Zhvillimin e Ri të Vendbanimeve në krahasim me Popullsinë e Projektuar

| Vendbanimet | Popullsia në 2008 | Popullsia e parashikuar në 2025 | Madhësia e tanishme e vendbanimit (ha) | Madhësia e parashikuar për zhvillim të vendbanimit të ri (ha) |
|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 150000 | 216346 | 1495.74 | **379.12** |
| Zhur | 9000 | 25165 | 82.49 | **161.65** |
| Hoçë e Qytetit | 5000 | 18342 | 66.07 | **133.42** |
| Mamushë | 6000 | 18878 | 59.63 | **128.78** |
| Piranë | 2500 | 4865 | 57.13 | **23.65** |
| Romajë | 2200 | 4036 | 52.43 | **18.36** |
| Reçanë | 1300 | 2311 | 19.00 | **10.11** |
| Gjonaj | 4000 | 4982 | 114.89 | **9.82** |
| Velezhë | 1200 | 2108 | 33.05 | **9.08** |
| Zym | 2500 | 3339 | 36.76 | **8.39** |
| Lubizhdë | 3000 | 3778 | 198.73 | **7.78** |
| Mushnikovë | 1200 | 1345 | 31.11 | **1.45** |
| **Gjithsej Sipërfaqja për Zhvillim të Ri të Vendbanimeve** | | | | **891.61** |

### 3.2.4. Ambienti duke përfshirë trashëgiminë natyrore dhe resurset, peizazhi

Resurset mjedisore kanë rol kyç në zhvillimin e Komunës së Prizrenit si në aspektin natyror ashtu edhe ekonomik. Mbrojtja e zonave pyjore e sidomos e Parkut Nacional të Sharrit është e domosdoshme për një përdorim efikas të resurseve natyrore dhe mundësive turistike. Parku Nacional është prona më e rëndësishme natyrore në Kosovë që karakterizohet me llojllojshmëri të llojeve endemike. Prandaj mbrojtja e parkut nacional bëhet me ruajtjen e zonës së parkut në pajtim me planin për Parkun Nacional të Sharrit si dhe me promovimin e turizmit dimëror, skijimit dhe aktiviteteve të ngjitjes në male. Zonat pyjore në dhe jashtë parkut janë po ashtu të rëndësishme për shkak të mundësive të pylltarisë që gjenerojnë. Për më tepër, do të kryhet kontrolli më i thuktë i prerjes së drunjve për të evituar humbjen e zonave pyjore.



Prizreni është i pasur sa i përket tokave të pëlleshme. Parandalimi i aktiviteteve ekzistuese ilegale të eksploatimit të zhavorrit që paraqesin një kërcënim për tokat bujqësore, do të mundësohet me futjen e përdorimit të përshtatshëm dhe të organizuar të zonave. Janë identifikuar tokat e pëlleshme në Prizren të cilat posedojnë edhe sistemin e ujitjes të përshtatshme për aktivitetet bujqësore ku do të promovohet industria e bazuar në bujqësi. Një pjesë e madhe e tokave bujqësore do të mbrohen me aktivitetet ekzistuese bujqësore me qëllim të mirëmbajtjes së karakterit bujqësor që kanë, ndërsa në rrafshin e Anadrinit do të zhvillohet agro turizmi.

## 3.3. ZONIMI: [SIPËRFAQET EKZISTUESE URBANE SI DHE ATO TË PROPOZUARA PËR TË ARDHMEN DHE ZONAT NDËRTIMORE JASHTË SIPËRFAQEVE URBANE]

Në këtë pjesë bëhet fjalë për zonat ekzistuese urbane si dhe për vlerësimin e zonave të përshtatshme dhe të zonave të propozuara për zhvillim të ardhshëm dhe ndërtimit brenda zonave të thella urbane. Duke pasur parasysh kushtet e profilit të zhvillimit hapësinor dhe analizën e situatës, janë vlerësuar të dhënat aktuale me qëllimi të propozimit të zonave të përshtatshme për zhvillimin e vendbanimeve rezidenciale, zonës industriale dhe asaj turistike. Të gjitha të dhënat e grumbulluara janë aplikuar në procesin e vendimmarrjes brenda analizave të përshtatshme dhe procesit hierarkik të analizave duke përdorur sistemin informativ gjeografik (GIS-in) nga ana e ekipit projektues.

Teknikat e përdorura për përcaktimin e zonave të përshtatshme janë Analiza e Përshtatshmërisë dhe Procesi Hierarkik i analizës. Në procesin e vendimmarrjes, Analiza e Përshtatshmërisë është kryer duke përdorur sistemin informativ gjeografik. Të dhënat nga analiza e topografisë (pjerrësia, orientimi dhe ujëndarësit), klasifikimi i tokës, klasifikimi bujqësor i tokës, erozioni, pyjet dhe gjeologjia janë mbivendosur në përgjithësi me qëllim të vlerësimit të ambientit natyror. Për të kalkuluar shpenzimet optimale operative dhe të ndërtimit të zonave turistike dhe industriale, janë zgjedhur si faktorë të dhënat mbi afërsinë e transportit dhe infrastrukturën gjatë procesit të vlerësimit. 

Procesi Hierarkik i Analizës (PHA) është përdorur për të përcaktuar rëndësinë e faktorëve të identifikuar gjatë procesit të vendim marrjes. Kriteri për procesin e vendim marrjes është të përcaktohen dhe shkallëzohen zonat e reja të vendbanimit të cilat do të ruanin resurset natyrore dhe zonat potenciale bujqësore duke marrë në konsideratë zonat me rrezik natyror dhe shpenzimet optimale. Zonat me rrezik natyror si dhe zonat prioritare janë definuar si "veto zonat". Po ashtu është bërë vlerësimi i zonave tjera në aspektin e përshtatshmërisë ne hierarki.

### 3.3.1. Vendbanimet për Zhvillim të Ardhshëm

Zonat e banimit për zhvillim të ardhshëm janë të përcaktuar në kuadër të hierarkisë së zonave të përshtatshme në lidhje me mjedisin natyror brena kufijve administrative të Komunës së Prizrenit. Analiza e përshtatshmërisë së zonave për vendbanime të ardhshme është kryer përmes GIS-it. Në procesin e vendimmarrjes, kriteri për zonat e vendbanimeve të ardhshme është vlerësuar duke ruajtur burimet natyrore dhe zonat potenciale bujqësore por duke mos i harruar edhe rreziqet natyrore.

Për rritjen urbane, marrja në konsideratë e rreziqeve natyrore është vitale në përcaktimin e zonave të ardhshme të vendbanimit. Prandaj në këtë kontekst, faktorët e zonave erozive, të tokave pyjore, llojet e tokës dhe formacionet gjeologjike janë vlerësuar në hierarkinë e zonave të përshtatshme për zonat e banimit për zhvillim të ardhshëm. Zonat e dendura pyjore janë definuar si veto zonat primare të papërshtatshme për rritje urbane. Në kuadër të vlerësimit të analizës së erozionit, zonat të cilat janë definuar me erozion shumë të madh radhiten po ashtu në veto zonat. Në PZHKP 2025, analiza e rrezikut nga tërmeti bazohet në dobësitë e tokës, formacionet e ndryshme gjeologjike në makroformën urbane. Po ashtu edhe zonat me dhe të butë dhe të përshkueshëm, në veçanti brenda zonave ujëmbledhëse në analizën gjeologjike janë definuar si veto zona për zhvillim të mëtutjeshëm urban. (Tabela 3.10.).

**Tabela 3.10:** Veto Zonat në vlerësimin e zonave të vendbanimit për zhvillimin e ardhshëm

| Veto Zonat | Karakteristikat | | |
|---|---|---|---|
| Zonat pyjore | Pyjet e dendura | Pyjet e intensitetit të ultë | Shkurret |
| Zonat erozive | Shume të lartë | Të lartë | |
| Analiza gjeologjike | Zonat e rrezikuara në lidhje me analizën gjeologjike<br>Dheu i butë dhe i përshkueshëm | | |

*PZHKP 2025 , 2009*



Për të vlerësuar karakteristikat topografike, pjerrësinë dhe analizën e orientimit, klasifikimi i zonave bujqësore dhe analiza e erozionit janë faktorë që janë zgjedhur si kriter për zhvillimin e ardhshëm të zonave të vendbanimit.

Duke pasur parasysh analizën topografike të pjerrësisë, zonat më të përshtatshme janë ato të cilat kanë pjerrësi prej 5-15 %. Për të siguruar nivele optimale të drenazhimit dhe shpenzimeve infrastrukturore në vijim janë klasifikuar zonat e përshtatshme për rritje urbane: 0–5 %, 15 – 25 % dhe 25 – 40%. Zonat me pjerrësi më të madhe se 40 % janë më së paku të përshtatshme. Në aspektin e orientimit topografik dhe efekteve klimatike, zonat e kthyera kah jugu janë zona më të përshtatshme për zhvillim të vendbanimeve. Përderisa zonat topografike që orientohen kah veriu janë më pak të përshtatshme.

Për të ruajtur burimet bujqësore në llojin e tokës, zonat e përshtatshme për prodhimtari bujqësore janë definuar ne shkallën 4, 5 dhe 6 dhe paraqesin zonat më të përshtatshme për zhvillimin e vendbanimeve. Në zonat e shkallës 7 dhe 8, nevoja për masat mbrojtëse zvogëlohen, këto zona kanë kufizime për shkak të shpenzimeve operative, prandaj edhe thuhet për to se janë zona me përshtatshmëri më të vogël për zhvillimin e vendbanimeve (Tabela 3.11).

**Tabela 3.10.** Faktorët e vlerësimit të zonave të vendbanimit të zhvillimit të ardhshëm

| Faktorët | Karakteristikat | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Analiza e pjerrësisë | % 0 - 5 | % 5 - 15 | % 15 - 25 | % 25 - 40 | > % 40 |
| | 80 | 100 | 80 | 60 | 40 |
| Analiza e aspektit | I | II | III | IV | V |
| | 100 | 90 | 80 | 70 | 60 |
| Analiza e erozionit | Shumë e lartë | E lartë | Mesatarisht e lartë | Mesatare | E ultë |
| | VETO | VETO | 60 | 80 | 100 |
| Klasifikimi bujqësor i tokës | 2 – 3 | 4 – 5 – 6 | 7 – 8 | | |
| | 70 | 100 | 40 | | |

*PZHKP 2025, 2009*

Në gradimin e përdorur në Tabelën 3.11 (0-100) gradat më të larta përfaqësojnë zonat më të përshtatshme dhe e kundërta zonat me gradë më të vogël përfaqësojnë zona më pak të përshtatshme në zhvillimin e vendbanimeve të ardhshëm. Kur të mbivendosen të gjitha faktorët në ndërfaqen e GIS-it, atëherë kryhet Procesi Analitik Hierarkik për përparësitë në planifikimin e zhvillimit të vendbanimeve. Në procesin e vendim marrjes mund të nënvizohen nocione dhe pikëpamje të ndryshme. Për shembull, në qasjen ekologjike, ruajtja e burimeve natyrore ka rëndësi më të madhe ndërsa nëse përdoret qasja ekonomike, kriteri i zvogëlimit të shpenzimeve operative është kriter parësor në procesin e vendim marrjes. Për të definuar zonat e zhvillimit të ardhshëm, qasjet e ndryshme duhet të merren parasysh me skenarë të ndryshëm.



Në Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit, zonat e përshtatshme për vendbanime të ardhshme janë përcaktuar në bazë të tre skenarëve të ndryshme me procesin analitik hierarkik të bazuar në qasjet ekologjike, financiare dhe të qëndrueshme. Duke i analizuar të gjitha këto skenarë, të gjitha faktorët janë krahasuar dhe llogaritur në çifte në aspektin e rëndësisë së tyre në vendim marrje dhe në fund këto rezultate janë klasifikuar në bazë të rëndësisë së tyre (Tabela 3.12). Sipas kësaj metode del se faktori më i rëndësishëm është klasifikimi bujqësor i tokës me vlerën 0.43 i pasuar me analizën e erozionit me vlerën 0.37. Faktorët relativisht më pak të rëndësishëm janë analiza topografike e pjerrësisë me vlerën 0.13 dhe analiza e orientimit me vlerën 0.07.

**Tabela 3.11.** Rëndësia (peshat) e faktorëve të rëndësishëm në vlerësim të zonave të vendbanimit të zhvillimit të ardhshëm

| Faktorët | Rëndësia (pesha) |
|---|---|
| Klasifikimi Bujqësor i Tokës | 0,43 |
| Harta e Erozionit | 0,37 |
| Analiza e Pjerrësisë | 0,13 |
| Analiza e Aspektit | 0,07 |

*PZHKP 2025, 2009*

Faktorët e cekur në tabelën e mësipërme janë mbivendosur në Hartën 3.1. e cila ilustron zonat e përshtatshme për vendbanime të ardhshme të graduar në tri grada si dhe jep zonat e papërshtatshme në bazë të veto zonave të dhëna në Tabelën 3.10.

Gjatë përshkrimit të zonave të përshtatshme, del se trendi zhvillimor në veri të Prizrenit shfaqet si zhvillimi i vendbanimit i shkallës së parë (Tabela 3.13). Në rrethin e afërt të qytetit të Prizrenit dhe në regjionet e saja ka zona të përshtatshme të shkallës së parë për zhvillim të ardhshëm të vendbanimeve sidomos në fshatrat Atmaxha, Grazhdanik dhe Nashec. Duke marrë në konsideratë faktorët natyror, në regjionet e Anadrinit dhe Lumës shohim zona të përshtatshme për zhvillim të ardhshëm të vendbanimeve në Sërbicën e Poshtme, Sërbicën e Epërme, Trepetnicë, Zhur dhe Vlashnje.

Në anën tjetër, trend i zhvillimit të vendbanimeve i vërejtur kohët e fundit në fshatin Kabash dhe Lubizhde, nuk është i përshtatshëm për një zhvillim të mëtutjeshëm të vendbanimeve për shkak të tokës së butë dhe të përshkueshme e cila është e përshtatshme për prodhimtari bujqësore. Zona e ngushtë buferike e lumit Lumëbardhi si dhe pellgjet ujëmbledhëse në rrethin e saj është po ashtu jo e përshtatshme për zhvillim urban të vendbanimeve. Sa i përket Zhupës, meqë parku nacional i Malit Sharr është burim kryesor natyror i zonës, mund të thuhet se këtu nuk ka vend të përshtatshëm për zhvillim të ardhshëm të vendbanimeve.



**Tabela 3.12.** Madhësia e zonave të përshtatshme për zhvillimin e vendbanimeve në krahasim me regjionet

| Regjionet | Zonat e përshtatshme të shkallës së parë | | Zonat e përshtatshme të shkallës së dytë | | Zonat e përshtatshme të shkallës së tretë | | Zonat e papërshtatshme | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ha | % | ha | % | ha | % | ha | % | ha |
| Qyteti i Prizrenit | 594,6 | 16,01 | 938,5 | 25,27 | 344,1 | 9,26 | 1837,4 | 49,47 | 3714,6 |
| Prizreni | 883,4 | 18,71 | 1038,7 | 22,00 | 605,7 | 12,83 | 2194,3 | 46,47 | 4722,1 |
| Hasi | 334,9 | 2,41 | 2318,0 | 16,70 | 352,2 | 2,54 | 10871,2 | 78,34 | 14046,4 |
| Kabashi | 118,9 | 1,83 | 1394,1 | 21,50 | 163,0 | 2,51 | 4808,3 | 74,15 | 6585,5 |
| Luma | 430,1 | 6,47 | 1539,0 | 23,14 | 303,2 | 4,56 | 4379,5 | 65,84 | 6658,9 |
| Anadrini | 1261,1 | 16,10 | 0,02 | 0,00 | 3505,6 | 44,76 | 3065,7 | 39,14 | 7892,2 |
| Vërrini | 115,4 | 2,77 | 476,5 | 11,45 | 967,9 | 23,26 | 2601,7 | 62,52 | 4165,0 |
| Zhupa | 0,00 | 0,00 | 1055,6 | 6,62 | 6212,2 | 38,99 | 8666,8 | 54,39 | 15995,6 |
| Gjithsej | 3738,2 | 5,86 | 8760,4 | 13,74 | 12454,0 | 19,53 | 38424,9 | 60,25 | 63780,4 |

*PZHKP 2025, 2009*




**Harta 4.1:** Modeli hapësinor për zonat e përshtatshme për zhvillim të vendbanimeve

### 3.3.2. Zonat për Zhvillim të Ardhshëm Industrial

Zonat industriale për zhvillimin e ardhshëm janë përcaktuar në kuadër të hierarkisë së zonave të përshtatshme në lidhje me mjedisin natyror dhe afërsia me linjat e infrastrukturës transportuese brenda kufijve administrative të Komunës së Prizrenit. Në procesin e vendimmarrjes, kriteri vlerësues i zonave industriale për zhvillimin e ardhshëm është vlerësuar duke ruajtur burimet natyrore dhe zonat potenciale bujqësore, dhe duke marrë në konsideratë po ashtu shpenzimet optimale operative dhe ndërtimore si dhe vlerësimin e rrezikut natyror.

Për vlerësimin e zonave industriale për zhvillim të ardhshëm, veto faktori parësor është zona buferike prej qytetit në fshatra me ç'rast synohet ruajtja e vendbanimeve urbane dhe rurale nga efektet negative industriale. Duke pasur parasysh shpenzimet operative, zonat me pjerrësi më të madhe se 25 % janë neglizhuar për zhvillimin e ardhshëm industrial. Sikur në rastin e zonave të përshtatshme për vendbanime, ashtu edhe në rastin e zonave të përshtatshme për zhvillimin e ardhshëm industrial janë marrë në konsideratë faktorët e erozionit, tokat pyjore, llojet e tokave dhe formacioni gjeologjik. Pyjet e dendura janë karakterizuar po ashtu si veto zona për zhvillim industrial. Në kuadër të vlerësimit të analizës së erozionit, zonat të cilat janë të përcaktuara si zona me erozion jashtëzakonisht të lartë janë po ashtu veto zona si dhe zonat me dhe të butë dhe të përshkueshëm, posaçërisht brenda pellgjeve ujëmbledhëse, ku në analizën gjeologjike janë konsideruar si veto zona për të marrë parasysh cenueshmërinë e zhvillimit industrial (Tabela 3.14). 

**Tabela 3.13.** Veto zonat në vlerësimin e zonave industriale për zhvillimin e ardhshëm

| Veto Zonat | Karakteristikat | | |
|---|---|---|---|
| Zona buferike prej qytetit në fshatra | Zona buferike prej 2 km | | |
| Zonat me pjerrësi të madhe | > 25% | | |
| Zonat pyjore | Pyjet e dendura | Pyjet e intensitetit të ultë | Shkurret |
| Zonat erozive | Shume të lartë | Të lartë | |
| Klasifikimi bujqësor i tokës | Toka e lërueshme e shkallës së dytë | | |
| Analiza gjeologjike | Zonat e rrezikuara në lidhje me analizat gjeologjike:<br>Dheu i butë dhe i depërtueshëm | | |

*PZHKP 2025 , 2009*

Faktorët që janë marrë parasysh në vlerësimin e përshtatshmërisë së zonave për zona eventuale industriale janë rreziku natyror, analiza e pjerrësisë, klasifikimi i tokës bujqësore dhe analiza e erozionit.

Sa i përket analizës topografike të pjerrësisë, zonat më të përshtatshme për industri janë ato që kanë pjerrësi prej 0 – 5 %. Për të arritur një kosto optimale operative dhe infrastrukturore, në konsideratë vijnë pastaj zonat me: 5 – 10 % dhe 15 – 25 % pjerrësi. Ndërsa zonat me

pjerrësi prej më tepër se 25 % janë të papërshtatshme për zhvillim industrial. (Tabela 3.15). Në mënyrë për të ruajtur burimet bujqësore të llojit (tipit) të tokës, zonat të cilat janë të përshtatshme për prodhimtari bujqësore janë definuar në shkallën 4, 5 dhe 6 dhe paraqesin zonat më të përshtatshme për zhvillim industrial. Në zonat e shkallës 7 dhe 8, nevoja për masat mbrojtëse zvogëlohen, këto zona kanë kufizime për shkak të shpenzimeve operative, prandaj edhe thuhet për to se janë zona me përshtatshmëri më të vogël për zhvillimin e industrisë.

Për kriterin e kostove operative dhe të ndërtimit, afërsia me rrugët transportuese dhe infrastrukturën janë po ashtu faktorë jetik për zhvillimin industrial. Zonat që janë në afërsi të arterieve transportuese janë më të përshtatshme. Zonat më të largëta nga këto arterie janë dhëne në shkallë me zvogëlim gradual.

**Tabela 3.14.** Faktorët e vlerësimit të zonave industriale të zhvillimit të ardhshëm

| Faktorët | Karakteristikat | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Analiza e Pjerrësisë | % 0 - 5 | % 5 - 15 | % 15 - 25 | % 25 - 40 | > % 40 |
| | 100 | 50 | 10 | VETO | VETO |
| Analiza e Erozionit | Shume e lartë | E lartë | Mesatarisht e lartë | Mesatare | E ultë |
| | VETO | VETO | 60 | 80 | 100 |
| Klasifikimi i tokës bujqësore | 2 | 3 | 4 – 5 – 6 | 7 – 8 | |
| | VETO | 70 | 100 | 40 | |
| Afërsia me Infrastrukturën | 0 - 100 m | 100 - 500 m | 500 - 1000 m | 1 – 2 km | 2 – 5 km |
| | 100 | 80 | 60 | 40 | 20 |
| Afërsia me Transportin | 0 - 100 m | 100 - 500 m | 500 - 1000 m | 1 – 2 km | 2 – 5 km |
| | 100 | 80 | 60 | 40 | 20 |

*PZHKP 2025, 2009*

Kur të mbivendosen të gjitha faktorët në ndërfaqen e GIS-it, atëherë kryhet Procesi Analitik Hierarkik për planifikimin e zonave industriale ngjashëm sikur me planifikimin e zonave për vendbanime. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj metode, jepen të klasifikuar faktorët që ndikojnë në zonat turistike për zhvillim të ardhshëm sipas rëndësisë së tyre (Tabela 3.16).

Sipas kësaj metode del se faktorët më të rëndësishëm janë afërsia me arteriet transportuese (me vlerë prej 0.33) dhe afërsia me arteriet infrastrukturore (me vlerë prej 0.23). Klasifikimi i tokës bujqësore me vlerë prej 0.30 është një faktor tjetër i veçantë në përcaktimin e zonave industriale për zhvillimin e ardhshëm. Faktorët relativisht më pak të rëndësishëm janë analizat e pjerrësisë topografike me vlerë prej 0.08 dhe ajo e erozionit me vlerë 0.06.

**Tabela 3.15.** Faktorët e rëndësishëm të zonave industriale të zhvillimit të ardhshëm

| **Faktorët** | **Rëndësia** |
|---|---|
| Afërsia me Transportin | 0.33 |
| Afërsia me Infrastrukturën | 0.23 |
| Klasifikimi i Tokës Bujqësore | 0.30 |
| Analiza e Pjerrësisë | 0.08 |
| Analiza e Erozionit | 0.06 |

*PZHKP 2025 , 2009*

Faktorët e cekur në tabelën e mësipërme janë mbivendosur në Hartën 3.2. Harta ilustron zonat e përshtatshme për zonat industriale për zhvillimin e ardhshëm të graduar në tri grada si dhe jep zonat e papërshtatshme në bazë të veto zonave të dhëna në Tabelën 3.14 Gjatë përshkrimit të modelit hapësinor i zonave të përshtatshme, del se ka zona të përshtatshme industriale e shkallës së parë për zhvillimin e ardhshëm në Rajonin e Prizrenit (fshatrat Grazhdanik dhe Nashec) dhe Rajonit të Lumës (fshati Vlashnje). Duke marrë në konsideratë faktorët natyror, zona të përshtatshme për zhvillimin industrial kanë ndjeshmëri të pakët natyrore dhe qasje të lartë transportit rrugorë (Tabela 3.17). Sa i përket Qytetit të Prizrenit dhe Zhupës, këto regjione nuk janë të përshtatshme për zhvillimin e zonave industriale për shkak të resurseve natyrore dhe efektit ndaj vendbanimeve meqë këto regjione janë më të përshtatshme për aktivitete turistike (shih pjesën 3.3.3). Duke pasur parasysh se Komuna e Prizrenit është e pasur me resurse natyrore dhe ka një nivel të lartë të rrezikut natyror si dhe bollëk të tokave të pëlleshme bujqësore, rezervuare të ujit dhe trashëgimi të pasur natyrore, mund të thuhet se këto faktorë zvogëlojnë përshtatshmërinë për zhvillim të mirëfilltë të industrisë. Meqë parku nacional Malet e Sharrit është burim kryesor natyror i Regjionit të Zhupës, mund të thuhet se këtu nuk ka vend të përshtatshëm për zhvillim të ardhshëm të industrisë duke u bazuar në gjetjet analitike dhe vërejtjet e të gjitha këtyre vlerësimeve.



**Tabela 3.16.** Madhësia e zonave të përshtatshme për zhvillimin e vendbanimeve në krahasim me regjionet

| **Regjionet** | **Zonat e përshtatshme të shkallës së parë** | | **Zonat e përshtatshme të shkallës së dytë** | | **Zonat e përshtatshme të shkallës së tretë** | | **Zonat e papërshtatshme** | | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ha | % | ha | % | ha | % | ha | % | ha |
| Qyteti i Prizrenit | 0.0 | 0.00 | 0.5 | 0.01 | 0.0 | 0.00 | 3714.1 | 99.99 | 3714,6 |
| Prizreni | 512.9 | 10.86 | 354.3 | 7.50 | 126.5 | 2.68 | 3728.4 | 78.96 | 4722,1 |
| Hasi | 182.9 | 1.30 | 1087.2 | 7.74 | 396.0 | 2.82 | 12380.4 | 88.14 | 14046,4 |
| Kabashi | 24.3 | 0.37 | 308.7 | 4.69 | 155.2 | 2.36 | 6097.3 | 92.59 | 6585,5 |
| Luma | 295.9 | 4.44 | 915.1 | 13.74 | 368.5 | 5.53 | 5079.4 | 76.28 | 6658,9 |
| Anadrini | 34.8 | 0.44 | 1212.7 | 15.37 | 1356.4 | 17.19 | 5288.3 | 67.01 | 7892,2 |
| Vërrini | 25.0 | 0.60 | 286.6 | 6.88 | 276.1 | 6.63 | 3577.2 | 85.89 | 4165,0 |
| Zhupa | 0.0 | 0.00 | 23.6 | 0.15 | 1042.4 | 6.52 | 14929.6 | 93.34 | 15995,6 |
| Gjithsej | **1076.9** | **1.69** | **4190.7** | **6.57** | **3724.0** | **5.84** | **54794.8** | **85.91** | **63780,4** |

*PZHKP 2025 , 2009*






**Harta 4.2:** Modeli hapësinor për zonat e përshtatshme për zhvillim të industrisë

### 3.3.3. Aktivitetet turistike dhe shërbimet për zhvillim të ardhshëm

Zonat e përshtatshme për zhvillimin e aktivitete turistike në të ardhmen janë të përcaktuara në kuadër të hierarkisë së zonave të përshtatshme në varshmëri nga burimet atraktive kulturore dhe natyrore brenda kufijve administrative të Komunës së Prizrenit. Analiza e përshtatshmërisë bëhet për të përcaktuar zonat për zhvillimin e aktiviteteve dhe shërbimeve turistike me anë të Sistemeve Informative Geografike.

Në procesin e vendimmarrjes, janë vlerësuar kriteret në aktivitetet e turizmit dhe shërbimeve për zhvillimin e ardhshëm derisa punësimi i burimeve kulturore dhe natyrore me shërbimin e duhur kanë marrë parasysh edhe ruajtjen dhe ripërtëritjen ekonomike të Komunës së Prizrenit.

Për të vlerësuar atraktivitetin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, kriter fondamental për përcaktimin e përshtatshmërisë së një zonë për aktivitete turistike për zhvillimin e turizmit është marrë prezenca e trashëgimisë natyrore dhe kulturore nëpër vendbanime. Të gjitha pronat e regjistruara të trashëgimisë natyrore në komunën e Prizrenit, si dhe trashëgimia kulturore e regjistruar si ndërtesa historike, lokacionet dhe komplekset urbane historike si dhe lokacionet arkeologjike, luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit. Edhe pse Prizreni ka trashëgimi të pasur kulturore me qendrën e saj historike të qytetit, mund të thuhet se fshatrat dhe rrethinat e tyre kanë lokacione arkeologjike dhe monumente, ndërsa regjioni i Zhupës është i njohur me prezencën e Parkut Nacional Malet e Sharrit.



Brenda kontekstit të shërbimeve turistike, ekzistimi i objekteve hoteliere në afërsi është po ashtu një faktor i rëndësishëm për vlerësimin e zhvillimit të pritur. Për kriterin e shpenzimeve optimale operative, afërsia me rrugët transportuese dhe qendrave të banimit janë po ashtu faktorë të rëndësishëm për aktivitetet dhe shërbimet turistike. Zonat që janë në afërsi të arterieve transportuese dhe vendbanimeve janë më të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetet turistike. Zonat më të largëta nga këto arterie janë dhënë në shkallë me zvogëlim gradual (Tabela 3.18).

Kur të mbivendosen të gjitha faktorët, atëherë kryhet Procesi Analitik Hierarkik për planifikimin e zonave turistike ngjashëm sikur me planifikimin e zonave tjera. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj metode, faktorë të tërë në lidhje me aktivitetet e turizmit dhe shërbimeve për zhvillim të ardhshëm janë llogaritur dhe të renditur sipas rëndësisë së vlerave të tyre (Tabela 3.19) Sipas kësaj metode del se faktorët më të rëndësishëm janë prezenca e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (me një vlerë prej 0.40) dhe prezenca e objekteve hoteliere-akomodimi (me një vlerë prej 0.31). Ndërsa afërsia me rrjetin transportues (me një vlerë prej 0.19) dhe afërsia me vendbanimet (me një vlerë prej 0.10) janë faktorë relativisht më pak të rëndësishëm.

**Tabela 3.17.** Faktorët e vlerësimit të aktiviteteve turistike dhe shërbyese për zhvillimin e ardhshëm

| Faktorët | Karakteristikat | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Prezenca e Trashëgimisë* Kulturore dhe Natyrore | Prezent | Mungon | | | |
| | 100 | 0 | | | |
| Prezenca e Objekteve Akomoduese | Prezent | Mungon | | | |
| | 100 | 0 | | | |
| Afërsia me transportin | 0 - 100 m | 100 - 500 m | 500 - 1000 m | 1 – 2 km | 2 – 5 km |
| | 100 | 80 | 60 | 40 | 20 |
| Afërsia me Vendbanime | 0 - 100 m | 100 - 500 m | 500 - 1000 m | 1 – 2 km | 2 – 5 km |
| | 100 | 80 | 60 | 40 | 20 |

**Prezenca e trashëgimisë natyrore dhe kulturore përcaktohet nga:*

1. *Prania e Trashëgimisë kulturore për turizmin kulturor,*
2. *Parku nacional Mali Sharr dhe zonat tjera malore për turizmin dimëror dhe turizmin malor,*
3. *Tokat e pëlleshme bujqësore dhe fshatrat me sasi të madhe të prodhimeve bujqësore për agro turizmin.*

*PZHKP 2025, 2009*

**Tabela 3.18.** Faktorët e rëndësishëm të aktiviteteve turistike dhe shërbyese si dhe të objekteve për akomodim për zhvillimin e ardhshëm

| Faktorët | Rëndësia |
|---|---|
| Prezenca e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore | 0.40 |
| Prezenca e Objekteve Akomoduese | 0.31 |
| Afërsia me Transportin | 0.19 |
| Afërsia me Vendbanime | 0.10 |

*PZHKP 2025, 2009*



Prezenca e trashëgimisë natyrore dhe kulturore përcaktohet brenda tre titujve si: prania e trashëgimisë kulturore për turizmin kulturor, Parku nacional Mali Sharr dhe zonat tjera malore për turizmin dimëror dhe turizmin malor, dhe tokat e pëlleshme bujqësore dhe fshatrat me sasi të madhe të prodhimeve bujqësore për agro turizmin. Turizmi kulturor përcaktohet më prezencën e monumenteve historike dhe fetare, zonat urbane historike dhe zonat e monumentet arkeologjike. Zonat dhe monumentet e regjistruara historike kanë potencial të lartë me cilësinë e tyre për definimin e formacionit kulturor të zonës dhe sasisë kongreguese në zonat e përshtatshme sidomos në qendrën e qytetit të Prizrenit. Qendra e qytetit të Prizrenit është pikë qendrore për zhvillim të mundshëm të aktiviteteve të turizmit kulturor, duke u pasuar nga fshatrat e regjionit të Hasit si Krajku, Kushnini, Lukinaj, fshati Kabashi në regjionin e Kabashit, regjioni i Anadrinit fshati Krusha e Vogel dhe regjioni i Vërrinit fshati Poslishti për shkak të pranisë së lokacioneve arkeologjike dhe monumenteve historike. Zona e ngushtë buferike në afërsi të arterieve transportuese në këto fshatra dhe qendrën e qytetit të Prizrenit janë më të përshtatshme për zhvillimin e ardhshëm të aktiviteteve të turizmit kulturor (Harta 3.3).

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm turistik në Prizren është turizmi dimëror i cili vërehet në Malet e Sharrit. Mirëpo në Prizren duhet që krahas turizmit dimëror, të zhvillohet turizmi gjithëpërfshirës dimëror dhe malor që paraqet një potencial për një destinim global të turizmit. Turistët i tërheqin malet për disa arsye: klima dhe ajri i pastër, bukuria natyrore, si dhe mundësi të shumta për shëtitje dhe aktivitete sportive. Në këtë aspekt, Regjioni i Zhupës prin për nga përshtatshmëria për zhvillimin e ardhshëm të turizmit dimëror dhe malor (Harta 3.4).

Meqenëse në komunën e Prizrenit ka mjaft tokë pjellore bujqësore, atëherë mund të mendohet edhe për zhvillimin agro -turizmit si regjenerim të ekonomisë rurale. Agro-turizmi definohet si oferta e vizitave turistike në zonat ku ka prodhimtari bujqësore dhe fermave duke u lejuar vizitorëve të marrin pjesë në procesin e mbjelljes, rritjes dhe përpunimit të produkteve lokale ushqimore. Vizitorët duhet ta kenë të siguruar akomodimin në shtëpi të banorëve lokal. Aktivitetet e prodhimtarisë së posaçme bujqësore duhet të inkurajohen si pjesë e agro – turizmit. Meqë Prizreni ka një traditë të lashtë të prodhimit të verës, duhet të rigjenerohen vreshtat. Në fshatrat Gërncare në regjionin e Prizrenit, Krushë e Vogël në regjionin e Anadrinit, dhe në regjionin e Vërrinit fshatrat Jeshkovë dhe Leskovec ka prodhimtari të pijeve dhe këto fshatra bashkë me fshatrat rrethuese janë më të përshtatshme për zhvillimin e ardhshëm të agro turizmit. (Harta 3.5). Në vlerësimin e objekteve të turizmit për zhvillimin në të ardhmen, të gjitha hartat e mëparshme të veprimtarisë turistike janë përputhur dhe veto faktorët janë shumëzuar me aktivitetet totale turistike që janë të përshkruar në hartën e aktiviteteve turistike. Atëherë rezultati i përgjithshëm tregon vlerësimin e zonave të përshtatshme për shërbimet turistike dhe objekteve për akomodim. Faktorët e erozionit, tokat pyjore, llojet e tokave dhe formacioni gjeologjik janë vlerësuar me hierarkinë e zonave të përshtatshme për shërbimet turistike dhe objekteve të akomodimit për zhvillim të ardhshëm. Në kuadër të vlerësimit të analizës së erozionit, zonat të cilat janë të përcaktuar si zona me rrezikshmëri të lartë të erozion janë vlerësuar si veto zona. Zonat të cilat janë të vlerësuar si zona me tokë të butë dhe të depërtueshëm, sidomos brenda pellgjeve ujëmbledhës, në analizën gjeologjike janë konsideruar si zona të vetos për të marrë në konsideratë cenueshmërinë e zhvillimit të turizmit (Tabela 3.20).



**Tabela 3.19.** Veto Zonat në vlerësimin e aktiviteteve turistike për zhvillimin e ardhshëm

| Veto zonat | Karakteristikat | |
|---|---|---|
| Zonat Erozive | Shumë të lartë | Të lartë |
| Klasifikimi i Tokës Bujqësore | Toka e pëlleshme bujqësore e shkallës së dytë dhe tretë | |
| Analiza Gjeologjike | Zonat e rrezikuara në lidhje me analizat gjeologjike me:<br>Toka e butë dhe e përshkueshme | |

*PZHKP 2025, 2009*

*Faktorët e cekur në tabelën e mësipërme janë mbivendosur në Hartën 3.6. Harta ilustron zonat e përshtatshme për zonat e ardhshme të shërbimeve turistike dhe objekteve të akomodimit të graduar në tri grada si dhe jep zonat e papërshtatshme në bazë të veto zonave të mbivendosura.*






**Harta 4.3:** Modeli hapësinor për zonat e përshtatshme për zhvillim të turizmit kulturor






**Harta 4.4:** Modeli hapësinor për zonat e përshtatshme për zhvillim të turizmit dimëror dhe malor






**Harta 4.5:** Modeli hapësinor për zonat e përshtatshme për zhvillim të agro-turizmit




**Harta 4.6:** Modeli hapësinor për zonat e përshtatshme për zhvillim të shërbimeve turistike dhe objektet për akomodim

## 3.4. PROJEKTET STRATEGJIKE DHE ZONAT E VEÇANTA TË PËRCAKTUARA ME PLANIN HAPSINOR TË KOSOVËS DHE PLANET TJERA PËR ZONA TË VEÇANTA

Kjo pjesë flet për projektet e rëndësishme strategjike dhe zonat e posaçme që janë aprovuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe plane tjera për zona të veçanta.

**Plani për Konservimin dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit**

Ka shumë programe dhe projekte që kanë të bëjnë me konservimin në Prizren. Një pjesë e rëndësishme e strategjisë zhvillimore dhe investimeve në infrastrukturën kulturore të qytetit është edhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore me qëllim të krijimit të kushteve normale për përdorimin e këtyre objekteve për aktivitetet kulturore. Në këtë aspekt ka aktivitete konstante si kontakte, vizita dhe forma të tjera të bashkëpunimit me qëllim të arritjes së përvojës së nevojshme për prezantimin e duhur dhe profesional të aktiviteteve kulturore. Disa nga këto aktivitete janë: ekspozita –trashëgimia arkitektonike dhe urbane e Prizrenit, konferenca ndërkombëtare “Politikat kulturore të qyteteve” në Selanik të Greqisë, punëtoria e ekspertëve të organizuar nga Kolping Kosova dhe Asociacioni Numizmatik “Demastion” – “ruajtja e qytetit të vjetër të Prizrenit”, Perlat e kulturës kombëtarë të Prizrenit etj. (Raporti mbi Profilin Zhvillimor Hapësinor dhe vështrimi i përgjithshëm i Komunës së Prizrenit).

Në raportin mbi Profilin Zhvillimor Hapësinor të Prizrenit dhe vështrimi i përgjithshëm i Komunës së Prizrenit thuhet se ka nevojë urgjente për veprim në aspektin e ruajtjes së karakteristikave historike të Prizrenit nga ana e të gjitha institucioneve përfshirë këtu edhe Entin për Mbrojtjen e Monumenteve, drejtoritë komunale dhe Ministrinë e Kulturës. Duhet të bëhet çmos për të ndaluar ndërtimin ilegal e cila është jashtëzakonisht përbuzëse ndaj karakterit historik të qytetit. Paralelisht me angazhimin e ekspertëve për restaurim dhe ruajtje të trashëgimisë kulturore, duhet të shqyrtohen të gjitha mjetet e mundshme financiare për implementimin e këtyre objektivave.



Një nga organizatat më aktive në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë është Cultural Heritage Without Borders (CHwB) që vepron që nga viti 2001. CHwB-ja ka themeluar një zyrë lokale në Prishtinë për përkrahjen dhe mbikëqyrjen e projekteve që kanë të bëjnë me konservim. Kjo organizatë organizon seminare, ekspozita dhe punëtori jo vetëm në Prizren por edhe ne qytete tjera dhe përkrah shumë projekte si: trashëgimia kulturore e Dukagjinit, projektin e kullës së Isa Buletinit në Zveçan dhe restaurimin e xhamisë së Hadumit në Gjakovë.

Në maj të vitit 2006, Komuna e Prizrenit ka nënshkruar me CHwB-në një memorandum të mirëkuptimit për implementimin e programit rehabilitues të zonës historike të Prizrenit”. Ky program përfshin komponentët e ndryshme të rëndësishme në aspektin e ruajtjes dhe zhvillimit të zonës historike. “Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit” është hapi i parë konkret kah planifikimi i ruajtjes së zonës historike.

Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikimin e zhvillimit urban është me rëndësi të madhe për ruajtjen dhe zhvillimin e zonave historike në qendrat urbane. Kjo është një nga iniciativat e para të këtij lloji në Komunat e Kosovës për përpilimin e Planit Konservues të Zonës Historike.

Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit është produkt i Programit Rehabilitues të Zonës Historike të Prizrenit. Si rezultat i protokollit të nënshkruar në mes të OJQ-së suedeze CHwB dhe Qendrës Hulumtuese të Planifikimit Urban dhe Ambiental të Universitetit Teknik të Stambollit, është bërë një studim i Planit për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit (Figura 3.12).

Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit ka prodhuar propozime për planifikim në aspektin e çështjeve fizike, shfrytëzimit të tokës, transportit dhe të atyre që kanë të bëjnë me konservimin.

Në propozimet e dizajnit të Planit për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit, plani ka përmirësuar direktivat për dizajnin urban ku janë futur propozimet strukturale si për shembujt monumentale dhe arkitekturale ashtu edhe për aplikacionet në mes të ndërtesave. Sa i përket arkitekturës civile dhe monumentale, intervenimet janë përcaktuar në kuadër të parimeve të konservimit dhe ruajtjes. Për aplikacionet në mes të ndërtesave, propozimet strukturale janë nënvizuar me llojet e propozuara të ndërtimi në harmoni me arkitekturën tradicionale. Sipas planit të konservimit dhe zhvillimit, duhet të zbatohen intervenimet në arkitekturën civile, në rastin e mbrojtjes, pastrimi dhe mirëmbajtja, restaurimi, rindërtimi, renovimi i fasadave. Lloji i propozuar i kërkesave për ndërtimet e reja, plani ekzaminon këto elemente në kapitujt e vëllimit, fasadës, detajet dhe ornamentet dhe propozimi i pamjes së rrugëve (Figura 3.13) (Gulersoy Zeren, et.al, 2008).



Sipas parimeve të përdorimit të tokës, zona urbane historike e Prizrenit është rirregulluar me lloj-lloj përdorime të tokës dhe aktivitetet që synojnë zhvillimin e cilësisë urbane me modelin urban tradicional. Akomodomi dhe banimi, shërbime komerciale dhe kulturore-turistike në katet përdhes dhe tregtia me pakicë në harmoni me shkallën dhe madhësinë e përdorimit të zonës urbane të zonës urbane historike janë propozuar për nën zonat e përshtatshme. Në bazë të planit për konservim dhe zhvillim, veprimtaritë komerciale dhe prodhuese nuk janë në harmoni me modelin tradicional prandaj është propozuar decentralizimi i tyre jashtë zonës urbane historike. Për ri-rregullimin e qarkullimit optimal në sistemin e transportit, ky plan po ashtu parasheh rrugët shërbyese, rrugët këmbësorike, ndarjen e qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve në zonën bërthamore të pjesës historike (Gulersoy Zeren, et.al, 2008). Pas miratimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066/2012), është rishikuar kufiri i zonës së Qendrës Historike të Prizrenit me shtimin e Kalas së Prizrenit si pjesë përbërse të kësaj zone (Harta 1.21).




*Gulersoy Zeren, et.al, 2008*

**Figura 3.12.** Plani për Konservimin dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizreni






*Gulersoy Zeren, et.al, 2008*

**Figura 3.13.** Dizajni i Planit për Konservimin dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit

**Plani Hapësinor Zhvillimor i Parkut Nacional "Malet e Sharrit"**

Plani Hapësinor Zhvillimor i Parkut Nacional "Malet e Sharrit" rekomandon veprim të organizuar dhe të koordinuar të gjitha strukturave të përfshira dhe kërkon strategji dhe planifikim afatgjatë të bazuar në rezultatet e proceseve hulumtuese dhe planifikuese. Për të përballuar shfrytëzimin e pakontrolluar të vlerave natyrore dhe degradimin mjedisor në parkun nacional, plani propozon një kornizë në gjashtë sfidat e identifikuara në SWOT analizë.

Në kuadër të kornizave dhe kushteve, vizioni i planit është definuar me tre deklaratat e mëposhtme:

- Një Park i menaxhuar me kujdes për gjeneratat e ardhshme, me llojllojshmëri biologjike, peizazh karakteristik, vendbanime përreth, dhe kulturë të jetës tradicionale e cila vlerësohet, ruhet dhe zhvillohet.
- Një park ku gjenerohet profit nga aktivitetet ekonomike dhe turistike në favor të komunitetit dhe mbrojtjes së ambientit.
- Një park me qasje të lehtë që krijon mundësi dhe kënaqësi për turistët, rekreacion, sport, aktivitete hulumtuese dhe kulturore në çdo kohë.

Në plan përcaktohen tri zona të mbrojtjes ambientale në kuadër të parkut nacional. Zona e parë definohet si rezervat i saktë natyror ku nuk guxon të ketë aktivitete ekonomike por vetëm shtigje këmbësorie për vizitorët. Në zonën e dytë, parashihet një zhvillim i kufizuar ekonomik ku duhet të krijohet infrastruktura teknike vetëm për transportin e skiatorëve dhe aktivitete tjera turistike. Zhvillimi dhe aktivitetet ekonomike janë propozuar në zonën e tretë duke respektuar kushtet dhe konceptin e qëndrueshmërisë. Këto aktivitetet përfshijnë turizmin sportiv, turizmi veror dhe dimëror, turizmi shëndetësor, turizmi rural dhe kulturor, turizmi hulumtues dhe shkencor, turizmi alpin dhe turizmi çiklistik etj.



**Hidrocentrali i Zhurit**

Hidrocentrali i Zhurit është një sistem i cili përbëhet nga dy impiante HC Zhur I dhe HC Zhur II. Ky hidrocentral gjendet në jugperëndim të qytetit të Prizrenit. HC Zhur I gjendet afër fshatit Zhur ndërsa HC Zhur II gjendet në lumin Drini i Bardhë. Uji i grumbulluar transportohet nëpërmes të tunelit nën presion dhe portës së çeliktë të ujit në turbinat e HC Zhur I që përdor një kokë prej mesatarisht 565 m. Pasi të përdoret në HC Zhur I, uji përçohet përmes kanalit dhe tunelit përmes gravitacionit dhe portës së pjerrtë të ujit në HC Zhur II. Në fund i tërë uji i përdorur shkarkohet në Drinin e Bardhë.

Sipas Raportit të Studimit të fizibilitetit të vitit 1983 dhe Rishikimit ekonomik dhe financiar të vitit 2001, kapaciteti i HC Zhur I është 246 MW dhe prodhimi mesatar vjetor është 335 GWh. ndërsa i HC Zhur II është 46.8 MW me një prodhim mesatar vjetor prej 63.2 GWh.

Raporti i fizibilitetit të Hidrocentralit të Zhurit përmbledh të gjitha efektet favorizuese gjatë operimit të projektit siç është më shumë rend në zonën e planifikuar për projekt; sasi të mjaftueshme të ujit për vaditje; rritje të lagështisë së ajrit dhe rritjes së precipitimit që me siguri do të ketë ndikim favorizues në rritjen e zonave dhe produkteve pyjore.

Në aspektin sociologjik dhe demografik, nëse ndërmerren masat parandaluese, projekti i planifikuar nuk do të rrezikojë jetën dhe kushtet e popullatës lokale, do të ndalojë migrimin,

nuk do të rrezikojë jetën afariste dhe nuk do të kontaminojë burimet natyrore të zonës në fjalë. Në raport po ashtu thuhet se pas ndërtimit, toka mund të përdoret edhe për veprime turistike apo rekreative. Një efekt tjetër i projektit është edhe punësimi i përkohshëm apo permanent i fuqisë lokale punëtore gjatë implementimit të projektit.

**Parku i Biznesit i Prizrenit**

Projekti i parkut të biznesit gjendet afro 5 km larg Prizrenit në boshtin Prizren-Prishtinë, në segmentin rrugor Lubizhde-Korishë. Ky bosht do të lidhet me autostradën Morinë-Merdare e cila do të jetë lidhja më vitale komerciale për në portin e Durrësit në Shqipëri. Parku i biznesit do të sigurojë përqendrimin e biznesit në një zonë specifike.

**Autostrada Merdare Durrës**

Sipas Letrës për prapavijë teknike të Sektorit të Transportit (2008), për të siguruar integrimi të përmirësuar me rrjetin regjional të transportit, prioriteti kryesor i Qeverisë është përmirësimi i dy linjave thelbësore të SEETO (South East Europe Transport Observatory) më saktësisht të linjave 6 dhe 7 që kalojnë përmes Kosovës me ç'rast rëndësi primare i jepet linjës 7. Synimi afatgjatë është ndërtimi i autostradës në të dyja linjat, e cila lidh autostradën Durrës Morinë me Korridorin X si pjesë të Rrjetit trans evropian në Serbi, afër qytetit të Nishit.



Ndërtimi i autostradës Merdare Durrës e cila tani më është i përfunduar dhe është në shfrytëzim, e lidhë Kosovën me bregdetin Adriatik përmes portit të Durrësit dhe Shëngjinit.

## 3.5. VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO EKONOMIK DHE AMBIENTAL

Në këtë pjesë të raportit paraqitet vlerësimi i ndikimit ambiental dhe socio-ekonomik të kornizës së propozuar në PZHKP 2025.

PZHKP 2025 bazohet në parimet e Ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore, Qëndrueshmërinë Ambientale, Inkuadrimin Social, Barazinë Sociale dhe Kualiteti i Jetesës, Vitalitetin Ekonomik dhe Integritetin Hapësinor. Në varësi nga këto parime, plani i propozuar i PZHKP 2025 ka katër fusha kryesore të ndikimit në (Tabela 3.21):

- Resurset e mbrojtura natyrore dhe ambientale; ambient të qëndrueshëm, trashëgimi e mbrojtur natyrore dhe kulturore apo "Komponentët e ndikimit në Ambient Natyror dhe Kulturor"
- Objektet shëndetësore, kulturore, dhe arsimore të standardit të lartë me një qasje të lehtë, fuqia punëtore e kualifikuar dhe e edukuar, participimi i përmirësuar i publikut si "Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin Social"
- Zhvillimi i bujqësisë; zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë; zhvillimi komercial dhe financiar; zhvillimi i turizmit apo "Komponentët e Ndikimit në Strukturën Vitale Ekonomike"
- Ambienti atraktiv i jetesës; infrastruktura dhe transporti cilësor dhe efikas apo "Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin e Integruar Hapësinor"



**Tabela 3.20.** Komponentët e Ndikimit në PZHKP 2025

| | |
|---|---|
| Komponentët e Ndikimit në Ambient Natyror dhe Kulturor | Resurset e mbrojtura natyrore dhe ambientale; ambient të qëndrueshëm, trashëgimi e mbrojtur natyrore dhe kulturore |
| Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin Social | Objektet shëndetësore, kulturore, dhe arsimore të standardit të lartë me një qasje të lehtë, fuqia punëtore e kualifikuar dhe e edukuar, participimi i përmirësuar i publikut |
| Komponentët e Ndikimit në Strukturën Vitale Ekonomike | Zhvillimi i bujqësisë; zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë; zhvillimi komercial dhe financiar; zhvillimi i turizmit |
| Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin e Integruar Hapësinor | Ambienti atraktiv i jetesës; infrastruktura dhe transporti cilësor dhe efikas |

Trashëgimia e mbrojtur natyrore dhe kulturore është një ndikim i pritur i parimit të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore me përmirësimin e bashkëpunimit profesional dhe qeveritar. Meqë plani sugjeron integrimin e trashëgimisë me turizmin dhe programet sociale, mbrojtja e trashëgimisë në kuadër të kufijve të Komunës së Prizrenit do të përshpejtojë po ashtu edhe zhvillimin e turizmit ne Komunë.

Resurset e mbrojtura natyrore dhe ambientale dhe ambienti i qëndrueshëm në anën tjetër janë rezultat i ndikimit të parimit të qëndrueshmërisë ambientale që në mënyrë të tërthortë ndikon në zhvillimin e turizmit bujqësor dhe të ambientit atraktiv të jetesës.

Objektet shëndetësore, kulturore, dhe arsimore të standardit të lartë me një qasje të lehtë, dhe ambienti atraktiv i jetesës në qendrën e Prizrenit dhe pjesët rurale janë rezultat i ndikimit të parimit të inkuadrimit social, barazisë sociale dhe cilësisë së jetesës; zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë; zhvillimi komercial dhe financiar dhe zhvillimi i turizmit janë efektet e drejtpërdrejta të përmirësimit të objekteve dhe përkrahjes së fuqisë së kualifikuar dhe të edukuar punëtore.

Vitaliteti ekonomik, si një nga parimet më të rëndësishme, ka një ndikim në zhvillimin e bujqësisë; zhvillimin e organizuar të prodhimtarisë; zhvillimin komercial dhe financiar; si dhe zhvillimin e turizmit. Pos këtyre fushave, vitaliteti ekonomik në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në fuqinë punëtore të kualifikuar dhe të edukuar si dhe ndikim të tërthortë në zhvillimin e financiar dhe komercial.

Ambienti atraktiv i jetesës si dhe infrastruktura dhe transporti cilësor dhe efikas janë rezultatet e pritura të parimit të integritetit hapësinor. Meqë plani sugjeron standarde të larta dhe objekte kulturore shëndetësore dhe arsimore me qasje të lehtë, kjo do të përshpejtojë zhvillimin e zonave të reja të vendbanimit, të cilat krahas rigjenerimit urban kanë ndikim në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në parimin e integritetit hapësinor. 

Parimet e PZHKP 2025 dhe ndikimet e komponentëve janë dhënë në Tabelën 3.22. Sipas vlerësimit të analizës, ndikimi i komponentëve do të jepen në planin veprues të bazuar në zona si dhe programin veprues.

**Tabela 3.22:** Vlerësimi i Integruar i Ndikimit të PZHKP 2025

| | | Komponentët e ndikimit në Ambient Natyror dhe Kulturor | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin Social | | | Kompnentët e ndikimit në Strukturën Vitale Ekonomike | | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin e Integruar Hapësinor | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | OBJEKTIVAT | Resurset të mbrojtuna natyrore dhe | Mjedis i qëndrueshëm | Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe | Qasje, në objektet e arsimit, shëndetësisë dhe | Fuqia punëtore e kualifikuar dhe i arsimuar | Pjesëmarrje e përmisuar e publikut | Zhvillimi i bujqësisë | Zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë | Zhvillimi komercial dhe financiar | Zhvillimi i turizmit | Mjedis tërheqës jetese (banimi) | Transport dhe infrastrukturë të kualifikuar dhe |
| PARIMI 1. RUAJTJA E TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE | Trashëgimia kulturore në tërë komunën e Prizrenit do të Konservohet | | | ● | | | | | | | | ● | |
| | Bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar do të përmisohet në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore | | | ● | | ○ | | | | | ● | ● | |
| | Ruajtja e trashëgimisë kulturore do të integrohet me programet turistike dhe shoqërore | ● | ○ | ● | ● | ○ | ○ | | | ○ | ● | ● | |
| | Vetëdija për ruajtjen e trashëgimisë kulturore do të shtohet | | | ● | | | ● | | | | ○ | ● | |
| | Trashëgimia natyrore do të ruhet së bashku me asetet dhe resurset mjedisore | | | ● | | ○ | | | | | ● | ● | |
| | Bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar do të përmisohet në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë natyrore | | | ● | | ○ | | | | ● | ● | | ● |
| | Ruajtja e trashëgimisë natyrore do të integrohet me programet turistike dhe shoqërore | ● | ● | ● | | | | ○ | | | ○ | | |
| | Vetëdija për ruajtjen e trashëgimisë natyrore do të shtohet | ○ | ○ | ● | | | | | | ○ | ● | | |
| PARIMI 2. QËNDRUESHMËRIA AMBIENTALE | Resurset ambientale do të mbrohen dhe zgjerohen, duke ofruar përdorim potencial ekologik dhe të qëndrueshëm | ● | ● | ○ | | ○ | | ○ | | | ● | | ● |
| | Do të parandalohet ndotja dhe degradimi i ambientit | ● | ● | ● | | | | | | | ○ | ○ | |
| | Do të ofrohet një ambient i sigurtë dhe sensitiv urban ndaj mjedisit në zonat ku ekziston rreziku ambiental | ● | ● | | | | | | | | | | |
| | Zonat pyjore dhe zonat tjera të rëndësishme natyrore do të mbrohen me një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore | ● | ● | | | | | ● | | | ○ | ● | |
| | Tokat e pjeshme të Prizren do të përdoren për aktivitetet bujqësore | ○ | ○ | | | ● | ● | ● | | ○ | | | |

● Ndikim i drejtpërdrejt
○ Ndikimi indirekt

**Tabela 3.22:** Vazhdon nga faqja e mëparshme

| | | Komponentët e ndikimit në Ambient Natyror dhe Kulturor | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin Social | | | Kompnentët e ndikimit në Strukturën Vitale Ekonomike | | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin e Integruar Hapësinor | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | OBJEKTIVAT | Resurset të mbrojtura natyrore dhe | Mjedis i qëndrueshëm | Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe | Qasje, në objekte: e arsimit, shëndetësisë dhe | Fuqia punëtore e kualifikuar dhe i arsimuar | Pjesëmarrje e përmisuar e publikut | Zhvillimi i bujqësisë | Zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë | Zhvillimi komercial dhe financiar | Zhvillimi i turizmit | Mjedis tërheqës jetese (banimi) | Transport dhe infrastrukturë të kualifikuar dhe |
| PARIMI 3 BARAZIA SOCIALE DHE CILËSIA E LARTË JETËSORE | Të gjitha llojet e objekteve urbane do të zgjerohen dhe modernizohen si nga cilësia ashtu edhe nga sasia | | | | | | | | | | | | |
| | Mangësitë në vendbanimet rurale në drejtim të objekteve arsimore si kopshtete e fëmijëve, objektete e shkollave parashkollore dhe fillore do të evitohen | | | | ● | ● | | | | | | ● | |
| | | | | | ● | ● | | | | | | ● | |
| | Si objekte standarde shërbyese, në fshatrat qendrore do të sigurohen objektet e shkollave të mesme, objektet shëndetësore, socio e-kulturore, objektet sportive dhe shtëpi për të moshuar | | | | ● | ● | | | | | | ● | |
| | Objektet urbane në qytetin e Prizrenit do të përmisohen duke qenë në shërbim të të gjithë banorëve të komunës | | | | ● | ○ | | | | | | ● | ○ |
| | Do të sigurohet mbështetja për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të arsimuar | | | | | ● | ○ | ○ | ● | ● | ● | | |
| | Do të inkurajohen për punësim në sektorin e shërbimeve në qytetin e Prizrenit | | | | | ● | ○ | | ○ | ● | ● | | |
| | Në viset rurale do të krijohen mundësitë për punësim në turizëm, agro-industri dhe bujqësi | | | | | ● | ● | ● | | ○ | ○ | | |
| | Gjatë tërë procesit të planifikimit do të ofrohet pjesëmarrja e publikut | | | | | | ● | ○ | ○ | ○ | ○ | | |
| | Do të ngrihet vetëdija publike për jetën urbane dhe rurale | | | | | | ● | ○ | ○ | ○ | ○ | | |

● Ndikim i drejtpërdrejt
○ Ndikimi indirekt

**Tabela 3.22:** Vazhdon nga faqja e mëparshme

| | Komponentët e ndikimit në Ambient Natyror dhe Kulturor | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin Social | | | Kompnentët e ndikimit në Strukturën Vitale Ekonomike | | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin e Integruar Hapësinor | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| OBJEKTIVAT | Resurset të mbrojtura natyrore dhe [illegible] | Mjedis i qëndrueshëm | Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe [illegible] | Qasje në objektet e arsimit shëndetësisë dhe [illegible] | Fuqia punëtore e kualifikuar dhe tregu i punës | Pjesëmarrje e përmisuar e publikut | Zhvillimi i bujqësisë | Zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë | Zhvillimi komercial dhe financiar | Zhvillimi i turizmit | Mjedis tërheqës (banimi) | Transport dhe infrastrukturë të kualifikuar dhe [illegible] |
| Do të mbështeten mundësitë ndryshme për punësim në fshatrat qendrore | | | | | | | | | | | | |
| Do të zhvillohet prodhimtaria bujqësore dhe blegtoriale | | | | | ● | | ● | ○ | ● | ● | | |
| Do të mbështetet prodhimi dhe shitja e prodhimeve të reja bujqësore | | | | | ○ | | ● | | ○ | ○ | | |
| Do të nxitet prodhimtaria e verës | | | | | | | | | | | | |
| Toka e pllenshme e Prizrenit do të përdoret për aktivitetet bujqësore | | | | | | | | | | | | |
| Do të mbështetet gjenerimi i vlerës së shtuar nga prodhimet bujqësore | | | | | ● | | ● | ● | ○ | | | |
| Do të ofrohet mbështetje dhe reklamimi i prodhimeve tradicionale | | | | | ● | ○ | ● | ● | | ● | | |
| | | | | | ● | ○ | | ○ | ● | ● | | |
| Do të rritet efikasiteti i aktiviteteve tregtare | | | | | | | | | | | | |
| Do të mbështetet logjistika | | | | | ● | | | ● | | | | |
| Prizreni do të reklamohet si destinacion turistik | | | | | | | | | | ● | | |
| Do të inkurajohen aktivitetet turistike dhe kulturore në pjesën historike të Prizrenit | | | | | | | | | ○ | | | |
| Do të zhvillohen dhe përcaktohen aktivitetet e përshtatshme të turizmit në regjione si p.sh. turizmi dimëror, turizmi shëndetësor, eko-turizmi | | | | | ● | | ● | | | ● | | |

● Ndikim i drejtpërdrejt
○ Ndikimi indirekt

**Tabela 3.22:** Vazhdon nga faqja e mëparshme

| | | Komponentët e ndikimit në Ambient Natyror dhe Kulturor | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin Social | | | Kompnentët e ndikimit në Strukturën Vitale Ekonomike | | | | Komponentët e Ndikimit në Zhvillimin e Integruar Hapësinor | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | OBJEKTIVAT | Resurset të mbrojtuna natyrore dhe | Mjedis i qëndrueshëm | Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe | Qasje, në objektet e arsimit, shëndetësisë dhe | Fuqia punëtore e kualifikuar dhe i arsimuar | Pjesëmarrje e përmisuar e publikut | Zhvillimi i bujqësisë | Zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë | Zhvillimi komercial dhe financiar | Zhvillimi i turizmit | Mjedis tërheqës jetese (banimi) | Transport dhe infrastrukturë të kualifikuar dhe |
| PARIMI 5: INTEGRITETI HAPËSINOR | Do të zhvillohen lokacionet e reja për banim dhe do të përcaktohen sipërfaqet për rigjenerim urban | ● | ● | ● | ● | ○ | ● | ○ | ○ | ○ | ○ | ● | ● |
| | Nevojat për banim të popullatës së tanishme dhe të paraparë do të kordinohen me bashkëpunim me investitorët | | | | ● | | ● | | | | | ● | ● |
| | Do të sigurohet niveli i barabartë i banimit social për shtresat me të ardhura të vogla dhe mesatare | | | | | | | | | | | | |
| | Do të rriten standardet për cilësitë ambientale në vendbanime | | | | | | | | | | | | |
| | Rrjeti dhe infrastruktura transportuese do të zhvilohen asisoji që të shërbejnë në mënyrë efikase për të gjitha vendbanimet e Komunës | | | | ○ | | | ○ | ○ | ○ | ○ | ● | ● |
| | Transporti lokal do të integrohet në rrjetin nacional të transportit | | | | | | | | | | | | |
| | Do të zhvillohet një sistem efikas të transportit publik | | | | | | | | | | | | |
| | Do të sigurohet një trafik I sigurt urban | ● | ● | | ○ | | | ● | ○ | ○ | ○ | ● | ● |

● Ndikim i drejtpërdrejt
○ Ndikimi indirekt

# 4. STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Kjo pjesë paraqet fazën përfundimtare të PZHKP 2025 duke përcaktuar **strategjitë e zbatimit dhe veprimet** përmes programimit të veprimeve zbatuese, dispozitave, vlerësimit të performancës dhe të procesit të monitorimit, duke qenë një urë kaluese ndërmjet situatës aktuale dhe kornizës hapësinore. Strategjitë dhe veprimet janë zhvilluar në pesë grupe tematike, duke përfshirë trashëgiminë natyrore dhe kulturore, mjedisin natyror, mjedisin shoqëror (social), mjedisin ekonomik dhe mjedisin hapësinor.

## 4.1. Planet vepruese dhe strategjitë zbatuese të shoqëruar nga parimet dhe konceptet hapësinore

### 4.1.1. Shënimet Sqaruese të PZHKP

#### 4.1.1.1. Kufijtë

*Kufijtë Administrativ*

Komuna e Prizrenit mbulon një sipërfaqe rreth 625 km$^2$ dhe qyteti i Prizrenit është qendra administrative e komunës (Ligj për Kufijtë Administrativ të Komunave (Nr. 03/L-041/2008) (Figura 4.1). Ajo ka 74 fshatra nën kufijtë administrativ të Komunës. Mamusha, dikur ishte një ndër fshatrat e Komunës së Prizrenit, por në vitin 2005 u shndërrua në Komunë. Edhe pse Komuna e Mamushës ka qenë e përfshirë në seksionet e mëparshme në mënyrë që të sigurojë vlerësimin rajonal, në seksionin e Planifikimit të vendimeve dhe dispozitave të PZHKP 2025 nuk është përfshirë Komuna e Mamushës.



*Kufijtë Zhvillimor*

Kufijtë zhvillimor të PZHKP 2025 përputhen me kufijtë zyrtare administrativ të Komunës së Prizrenit dhe mbulojnë 625 km$^2$.

*Zona e Mbrojtur*

Sipas Ligjit për Zonat e veçanta të Mbrojtura (Nr.03/L-039/2008) dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066/2012) Qendra historike e qytetit të Prizrenit shpallet si zonë e mbrojtur.

*Zona e Përtëritur*

Zona e vjetër industriale në qytetin e Prizrenit me ndërtesa të braktisura propozohet të shpallet si zonë e përtëritur. Kjo zonë do të inkuadrohet në Qendrën urbane dhe do të jetë e hapur për projektet e përtëritjes.




**Figura 4.1:** Skema e Planit Zhvillimor, PZHKP 2025



### 4.1.1.2. Hierarkia e Vendbanimeve

Hierarkia e vendbanimeve e definuar në studimin e PZHKP 2025 përbëhet nga tri nivele. Qyteti i Prizrenit është qendër urbane e shkallës së parë. Planifikohet të zhvillohet si një qendër e fortë turistike e pasur jo vetëm me objekte urbane dhe objekte komerciale, por edhe si qendër administrative për qendrat rurale dhe vendbanimet tjera rurale.

Fshatrat qendrore të cilat kanë strukturë administrative sikur fshatrat tjera por që dallohen me faktin se aty mbahen të dhënat mbi lindjet, do të trajtohen si qendra rurale për të siguruar zhvillim të balancuar në pjesët rurale të Komunës së Prizrenit. Fshatrat qendrore janë Gjonaj, Hoça e Qytetit, Mushnikova, Pirana, Reçani, Romaja, Velezha, Zhuri dhe Zymi. Lubizhda, që për momentin është fshat qendror, por parashihet që ajo të bëhet paralagje e Prizrenit prandaj Korisha është caktuar të jetë si fshat qendror në përputhje me rrethanat e një qendre rurale.

Këto fshatra qendrore janë klasifikuar në bazë të potencialeve dhe nevojave të Komunës së Prizrenit dhe janë vlerësuar si qendra shërbyese, qendra bujqësore dhe qendra turistike. Korisha e cila ndodhet në afërsi të aksit rrugor Prizren-Prishtinë është fshati më i madh i regjionit të Kabashit dhe Podrimës, Zhuri i cili ndodhet në afërsi të rrugës Prizren-Shqipëri është fshati më i madh në regjionin e Vërrinit dhe Lumës, Gjonaj i cili është fshati më i madh i regjionit të Hasit ndërsa Reqani është fshat qendror i regjionit të Zhupës. Këto fshatra janë propozuar si

qendra shërbyese. Në anën tjetër, Velezha, Pirana, Romaja dhe Zymi të cilat gjenden në tokat e punueshme të Hasit dhe Anadrinit janë propozuar të jenë qendra bujqësore. Qendra bujqësore e Vërrinit që ka një potencial të ultë të tokës së punueshme por e cila i shërben Komunës së Dragashit me prodhimtarinë e saj bujqësore dhe serat, është Hoça e Qytetit. Struktura malore e Kabashit dhe Zhupës nuk ka kushte te përshtatshme për prodhimtarinë bujqësore. Prandaj në këto regjione nuk është propozuar qendra bujqësore. PZHKP 2025 parasheh përdorimin e platove të larta në këto regjione për blegtori. Këto regjione kanë potencial të dukshëm për turizmin dimëror dhe atë malor për faktin se këtu shtrihet Parku Nacional Malet e Sharrit, si park më i madh nacional në Kosovë. Fshati Mushnikovë në regjionin e Zhupës është propozuar të jetë qendër turistike ndërsa shërbimet turistike dhe akomodimi do të jenë në Struzhë, Manastiricë, Lubinje të epërme dhe Lubinje e poshtme në regjionin e Zhupës dhe Skorobisht në regjionin e Kabashit.

#### 4.1.1.3. Përdorimi i Tokës

*Zonat e Vendbanimit*

Përpos qytetit të Prizrenit, të gjitha zonat tjera janë planifikuar si vendbanime rurale. Lubizhda e cila pritet të bëhet para lagje e Prizrenit, konsiderohet si pjesë e zonës urbane.

Hierarkia e vendbanimeve është përcaktuar me tri faza dhe vendimet në lidhje me dendësinë e popullsisë janë marrë në përputhje me rrethanat. Qendra e Qyteti të Prizrenit që ka një karakter të dendur urban, planifikohet të këtë densitetin më të madh që është 200 b/ha. 

Zonat e nivelit të dytë të densitetit janë fshatrat qendrore. Këto vendbanime kanë një densitet mesatar prej 100 b/ha. Vendbanimet rurale kanë një densitet të vogël prej 50 b/ha.

*Zonat Zhvillimore*

Projeksionet e popullsisë tregojnë se rritje më të madhe të popullatës do të kemi në Qendrën e Qytetit të Prizrenit, Hoçë të Qytetit, dhe Zhur. Fusha e zhvillimit për këto vendbanime janë përcaktuar brenda zonave të zhvillimit potencial të banimit të treguara në analizat AHP. Këto zona të reja të vendbanime parashihen të kenë një densitet prej 100 b/ha.

*Vendbanimet Joformale dhe Banimi social*

Në mënyrë që të siguroj banim të përballueshëm për grupet me të ardhura veçanërisht të ulëta dhe të mesme, banimet sociale janë planifikuar në vendet urbane të rigjeneruara dhe vendbanimet e paligjshme (ilegale) të banimit të Komunës së Prizrenit, në planet e shkallës së nivelit të ulët të planifikimit, përmes inkurajimit të zhvillimit të qëndrueshëm të banimit në cilësi optimale të mjedisit dhe standardeve. Këto vende janë planifikuar që të kenë densitetin e përshtatshëm të popullsisë, në përputhje me madhësinë e popullsisë ekzistuese në vend.

**Tabela 4.1.** Projeksionet e popullatës në fshatrat qendrore dhe Qytetin e Prizrenit

| | Prizreni | Gjonaj | Hoca e Qytetit | Lubizhda | Mushnikova | Pirana | Reçan | Romaja | Velezha | Zhur | Zym |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1981 | 61,801 | 2,961 | 2,127 | 2,435 | 1,077 | 1,489 | 820 | 1,360 | 763 | 4,369 | 1,935 |
| 1991 | 92,303 | 3,666 | 2,658 | 2,960 | 1,084 | 1,790 | 890 | 1,702 | 865 | 5,230 | 2,138 |
| 2001 | 138,042 | 5,300 | 4,000 | 2,980 | 1,600 | 2,400 | 950 | 2,700 | 1,100 | 8,000 | 670 |
| 2008 | 150,000 | 4,000 | 5,000 | 3,000 | 1,200 | 2,500 | 1,300 | 2,200 | 1,200 | 9,000 | 2,500 |
| Popullsia Shtesë | 66,346* | 982 | 13,342* | 778 | 145 | 2,365 | 1,011 | 1,836 | 908 | 16,165* | 839 |

** Vendet që do të kenë rritje me të madhe të popullsisë në bazë të projeksionit.*



Duke i pasur parasysh këto densitete, kapaciteti i përgjithshëm i vendbanimeve ekzistuese dhe të atyre që do të zhvillohen është 429,643 banorë, që është një numër më i madh në krahasim me popullsinë e projektuar për Komunën e Prizrenit për vitin 2025 e që është 428,235 banorë (Tabela 4.2).

**Tabela 4.2.** Zonat ekzistuese dhe zona të Reja të Vendbanimit

| Vendbanimet | Sipërfaqja (ha) | Densiteti (p/ha) | Kapaciteti i banorëve |
|---|---|---|---|
| Vendbanimet Ekzistuese – densiteti i lartë | 1153,96 | 200 | 230 792 |
| Vendbanimet Ekzistuese – densiteti mesatar | 845,97 | 100 | 90 785 |
| Vendbanimet Ekzistuese – densiteti i ultë | 1024,22 | 50 | 51 648 |
| Vendbanimet e Reja – densiteti mesatar | 506,17 | 100 | 56 417 |
| Totali | | | 429 643 |

*Zonat Komerciale*

Një sipërfaqe e përafërt prej 294 ha në qytetin e Prizrenit ku hyn edhe pjesa e vjetër industriale planifikohet të jetë qendër komerciale e shkallës së parë ku do të ofrohen shërbimet tregtare dhe ato financiare. Fshatrat qendrore që janë zhvilluar në bazë të idesë për zhvillim të balancuar rural janë po ashtu qendra komerciale të shkallës së dytë. Këto qendra të shkallës së dytë parashihen të kenë dyqane dhe njësi ushqimore si funksione komerciale.

*Zonat Industriale*

Ndërtesat e vjetra industriale në Prizren janë ose të braktisura ose përdoren si depo. Kjo zonë konsiderohet si zonë regjeneruese dhe vlerësohet si qendër komerciale e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh potencialin bujqësor të Prizrenit, propozohet një zonë e posaçme prej 60 ha për industrinë e bazuar në bujqësi. Zona industriale propozohet të jetë në regjionin e Lumës përgjatë autostradës për Shqipëri, brenda zonave të përshtatshme për zhvillimin e industrisë që rrjedhin nga analiza AHP. Pos kësaj në pjesën lindore të kësaj zone propozohen rreth 110 ha për depo (magazinë) dhe përafërsisht rreth 80 ha për zonën e logjistikës dhe 70 ha zonë për shërbime doganore në juglindje të zonës agro - industriale.

Pos kësaj, përafërsisht rreth 157 ha planifikohet si zonë e industrisë së lehtë dhe përafërsisht 159 ha planifikohen për Parkun e Biznesit me R&D funksion, projekt ky që është duke u përgatitur nga Komuna e Prizrenit. Zona e industrisë së lehte ndodhet në rrugën Prizren Prishtinë, në fund të qytetit të Prizrenit në verilindje të tij. Ndërsa Parku i Biznesit parashihet të jetë në verilindje të fshatit Lubizhdë. Projekti Komunal në fshatin Korishë, mbi Planin Rregullativ Urban të projektit Boka konsiderohet gjithashtu në PZHKP 2025. Projekti përbëhet nga zhvillimi i destinimeve mikse (zhvillim rezidencial, sporti dhe rekreacioni, objekte arsimore dhe industri e lehtë).



*Zonat Turistike*

Sipas zbatimit të analizës AHP për vendndodhjen e shërbimeve turistike dhe të akomodimit dhe në përputhje me zonat e propozuara të turizmit del se zonat më të përshtatshme turistike gjenden në luginën e Zhupës dhe pjesët e larta të Maleve të Sharrit. Përpos qendrës turistike në Mushnikovë, objektet turistike po ashtu parashihen në Struzhe, Manastrice, Lubinje e Epërme, Lubinje e Poshtme dhe Skorobisht.

*Zonat Bujqësore*

Meqë një pjesë e madhe e rrafshit të Podrimës ka sistem të vaditjes, ai është paraparë si zonë për zhvillimin e bujqësisë. Pos kësaj, duke synuar ruajtjen e resurseve natyrore dhe zhvillim të qëndrueshëm bujqësore, tokat bujqësore të shkallës së dytë dhe tretë janë planifikuar si zonat e mbrojtura bujqësore. Plani propozon një sipërfaqe prej 3,380 ha për zhvillimin e bujqësisë dhe 9,984 ha si zonë e mbrojtur bujqësore.

Analiza e AHP në lidhje me zhvillimin e turizmit të bazuar në prodhimin bujqësor ka treguar se Rrafshi i Podrimës është më i përshtatshmi për zhvillimin e agro-turizmit dhe për këtë arsye janë ndarë rreth 1,593 ha sipërfaqe për këtë aktivitet.

*Zonat e mbrojtura Natyrore*

Parku Nacional Malet e Sharrit e cila është nën mbrojtje, është parku më i madh kombëtar në Kosovë e cila mbulon rreth 9,315 ha brenda kufijve administrativ të Komunës së Prizrenit.

Siç tregohet në seksionin 1.1.2.1. Modeli i Shfrytëzimit të Tokës, Komuna e Prizrenit ka për momentin 20,047 ha të pyjeve, prej nga 4,473 janë pyje të dendura, 3,995 pyje me densitet të ulët dhe 11,578 ha të shkurreve. Në kontekstin e studimit të PZHKP, të gjitha pyjet janë të mbrojtura dhe janë ri-klasifikuar në bazë të vetive të tyre.

Prerja e drunjve është e ndaluar në 1,328 ha të pyjeve të dendura që kanë një shkallë të lartë apo jashtëzakonisht të lartë të erozionit. Rreth 3,442 ha të pyjeve të densitetit të ultë dhe shkurreve që kanë një shkallë të lartë apo jashtëzakonisht të lartë të erozionit janë propozuar për pyllëzim. Zonat pyjore që nuk kanë shkallë të lartë të erozionit janë rreth 3,461 ha dhe këtu mund të lejohet prerja e kontrolluar e drunjve.

**Tabela 4.3.** Përdorimi i tokave në PZHKP

| PËRDORİMİ İ TOKËS | SİPËRFAQJA (ha) | RAPORTİ |
|---|---|---|
| Vendbanimet ekzistuese – Densiteti i Lartë (200 p/ha) | 1153,96 | 1,85% |
| Vendbanimet ekzistuese – Densiteti Mesatar (100 p/ha) | 845,97 | 1,35% |
| Vendbanimet ekzistuese – Densiteti i Ultë (50 p/ha) | 1024,22 | 1,64% |
| Vendbanimet e reja – Densiteti Mesatar (100 p/ha) | 506,14 | 0,81% |
| Qendra Urbane | 294,51 | 0,47% |
| Parku i Biznesit | 159,53 | 0,26% |
| Industria e Lehtë | 157,24 | 0,25% |
| Agro Industria | 61,45 | 0,10% |
| Depot | 109,76 | 0,18% |
| Logjistika | 79,78 | 0,13% |
| Doganat | 68,48 | 0,11% |
| Terminali | 14,25 | 0,02% |
| Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza | 12,82 | 0,02% |
| Zonat Zhvillimore Bujqësore | 9146,33 | 14,64% |
| Zonat Bujqësore me Sistem të Vaditjes | 3380,07 | 5,41% |
| Zona e Agro Turizmit | 1593,76 | 2,55% |
| Zonat e Reja të zhvillimit të Banimit - Baza Ekzistuese Ushtarake | 37,15 | 0,06% |
| Universiteti - Baza Ekzistuese Ushtarake | 56,27 | 0,09% |
| Parku Nacional | 9315,90 | 14,91% |
| Pyjet | 3461,63 | 5,54% |
| Zonat për Pyllëzim | 3442,01 | 5,51% |
| Zona e Ndaluar për Prerje të Drunjve | 1328,90 | 2,13% |
| Zonat e Mbrojtura Natyrore dhe Rurale | 25957,47 | 41,55% |
| Liqeni | 265,53 | 0,43% |
| TOTAL | 62473,13 | 100,00% |

Zonat tjera rurale me rreth 25,957 ha propozohen të jenë zonat e mbrojtura natyrore dhe rurale. Zona e mbrojtur e lumenjve (Drini i Bardhe, Lumëbardhi dhe Toplluha) do te jete zona buferike prej 100 m distancë nga lumenjtë.

*Zonat Ekzistuese Ushtarake.*

Tre bazat ushtarake që ndodhen brenda dhe në pjesën veriore të Prizrenit me një sipërfaqe totale prej 92 ha do të mbeten të tilla deri në ndonjë ndryshim eventual. Me përfundimin e mandatit të shërbimeve ushtarake të KFOR-it, zonat ushtarake dhe të sigurisë do të rigjenerohen ku këto zona do të shfrytëzohen përshtatshëm për zhvillimin e vendbanimeve të reja në bazën ushtarake të KFOR-it Gjerman në afërsi të rrugës së transitit, zona e kampusit universitar në bazën ushtarake të KFOR-it Gjerman në afërsi të aksit rrugor Prizren-Prishtinë dhe në bazën ushtarake të KFOR-it Turk në afërsi të zonës industriale të qytetit të Prizrenit do të shfrytëzohet si destinim i kampusit Universitar.

#### 4.1.1.4. Objektet urbane

Zhvillimi i balancuar rural i cili është përmendur më herët, është koncepti për planifikimin e objekteve urbane (arsim, kujdesi shëndetësor, objektet kulturore dhe sportive). Plani propozon përqendrimin e objekteve urbane në fshatrat qendrore nga ku do të marrin shërbime fshatrat rurale. Prandaj del se çështja e sigurimit të objekteve urbane në fshatrat qendrore është prioritet.

Duke pasur parasysh qasjen në objektet arsimore të nxënësve të institucioneve parashkollore dhe shkollave fillore duke u referuar deklaratës së Planit hapësinor të Kosovës 2010 si "edukim në distancë të vogël", "zhvillim të barabartë – shoqëri gjithëpërfshirëse", parashihet që çdo fshat në komunën e Prizrenit të ketë çerdhe dhe shkollë fillore, ku në objektet të shkollës fillore do të ndahet vendi edhe për çerdhe. Prandaj plani propozon ndërtimin e 13 shkollave fillore në fshatra të cilat nuk kanë shkolla fillore. Njashtu është propozuar hapja e 58 çerdheve të cilat do të japin shërbimet e tyre brenda objekteve të shkollave fillore në ato fshatra ku mungojnë këto objekte.



Po ashtu propozohet që fshatrat qendrore të ofrojnë shërbime të shkollave të mesme në përputhje me propozimet e planit për ndërtimin e 4 shkolla të mesme në fshatrat që nuk kanë objekte të shkollave të mesme. Meqë fshatrat qendrore që të gjitha i kanë objektet shëndetësore, atëherë PZHKP 2025 nuk parasheh ndërtim të objekteve të reja shëndetësore në këto fshatra. Duke pas parasysh kushtet e dobëta në objekte, plani propozon përmirësimin e kushteve në objektet ekzistuese dhe në objektet shërbyese. Krahas kësaj, propozohet ndërtimi 5 objekteve kulturore në fshatrat qendrore që nuk i posedojnë ato.

Duke marrë parasysh komentet e Komunës së Prizrenit, PZHKP 2025 propozon ndërtimin e Varrezave të Qytetit të Prizrenit, të cilat varreza do të shërbejnë për Komunitetin Mysliman, Katolik dhe Ortodoks, lokacioni i varrezave do të jetë në Landovicë në afërsi të rrugës së transitit të Qytetit të Prizrenit.

#### 4.1.1.5. Komunikacioni dhe infrastruktura

Komunikacioni

Linja 7, që paraqet një rrugë të rëndësishme të rrjetit rrugor South East Europe Transport Observatory (SEETO) dhe ndërtimi i së cilës ka një prioritet kombëtar, është pranuar si një nga inputet e PZHKP 2025. Linja 7 shkon deri në portin e Durrësit në Shqipëri me ç'rast Prizreni merr rolin e udhëkryqit të rëndësishëm që lidh pjesën më të madhe të Ballkanit me Detin Adriatik. Lidhje transporti nga Kosova – përmes rajonit të Prizrenit dhe Zhupës në Tetovë-Maqedoni është një tjetër rrugë e rëndësishme që lidh Kosovën dhe Maqedoninë.

Integrimi i autostradës në rrjetin lokal të komunikacionit sigurohet përmes dy pikëtakimeve që lidhin rrugën Prizren -Prishtinë, Prizren -Gjakovë dhe Prizren -Shqipëri. Hierarkia e rrjetit lokal të komunikacioni është rirregulluar siç shihet në plan dhe janë sugjeruar përmirësime të infrastrukturës ekzistuese rrugore.

Hekurudha është një mundësi e cila do ti mundësonte Prizrenit të bëhet qendër rajonale për transportin e mallrave dhe të pasagjerëve. Prandaj, plani propozon aktivizimin e hekurudhës e cila është pasive që nga viti 1999 duke filluar nga Prizreni, përmes komunës së Gjakovës të lidhet në Klinë në rrugën hekurudhore Pejë Prishtinë, si dhe në bazë të strategjisë së Planit hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$ obligohet komuna të bëj lidhjen hekurudhore në relacion Prizren Vërmicë ku kjo linje hekurudhore do te lidhet me hekurudhat e Shqipërisë e cila do të mundëson qarkullimin e mallrave në mes të dy shteteve dhe rajonit të gjërë.



*Infrastruktura Energjetike*

Hidrocentrali i Zhurit që është pjesë e Strategjisë Energjetike të Kosovës, ka dy hidrocentrale në kuadër të kufijve të Komunës së Prizrenit, një në fshatin Zhur dhe tjetrën në brigjet e lumit Drini i Bardhë. Linjat dhe objektet e Projektit të Hidrocentralit të Zhurit është pranuar si një nga inputet e PZHKP 2025.

### 4.1.2. Planet Vepruese të Shoqëruar nga Parimet dhe Konceptet e PZHKP 2025

Parimet kyçe të PZHKP 2025 të zhvillimit të Komunës së Prizrenit janë zhvilluar në pesë grupe tematike përfshirë këtu: trashëgiminë natyrore dhe kulturore, ambienti natyrorë, mjedisi social, mjedisi ekonomik dhe ai hapësinor. Parimet kyçe të PZHKP 2025 janë :

A. Ruajtja e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore
B. Qëndrueshmëria Ambientale
C. Inkuadrimi Social, Barazia Sociale dhe Cilësia e lartë Jetësore.
D. Vitaliteti Ekonomik
E. Integriteti Hapësinor

Për të realizuar vizionin e PZHKP 2025, në këtë studim janë caktuar qëllimet strategjike për zhvillimin afatgjatë si dhe objektivat që kanë të bëjnë me to. Pastaj, janë zhvilluar planet e veprimit në bazë të qëllimeve dhe objektivave dhe secili projekt është përkufizuar me kohëzgjatje (Harta 4.1 dhe 4.2).

## A-“ KONSERVIMI I TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE”

Në kuadër të këtij parimi janë dy qëllime strategjike:

1. Trashëgimia kulturore do të konservohet dhe përmirësohet
2. Trashëgimia natyrore do të konservohet dhe përmirësohet

### A.1 Trashëgimia kulturore do të konservohet dhe përmirësohet

Synimi A.1.1: Trashëgimia kulturore në tërë kufijtë administrativ të Komunës së Prizrenit do të konservohet.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.1.1.1** |
| Emri i projektit: | **“Programet e Implementimit te Dizajnit Urban dhe Projektet për Qendrën Historike të Qytetit të Prizrenit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Programet dhe projektet e zbatimit do të merren parasysh duke reflektuar implementimit e Planit të Zhvillimit dhe Konservimit të Zonës Historike të Prizrenit, si dhe Zonat e Veçanta të Mbrojtura për Qendrën Historike të Prizrenit si dhe dispozitat e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura(Nr. 03/L-039/2008) dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066/2012). |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi A.1.2: Bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar do të përmirësohet në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.1.2.1** |
| Emri i projektit: | **“Projektet Gjithëpërfshirëse për Restaurimin e Ndërtesave Historike”** |
| Përshkrimi i projektit: | Projektet gjithëpërfshirëse për restaurim do të realizohen me përkrahjen financiare dhe operative të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |



Synimi A.1.3: Ruajtja e trashëgimisë kulturore do të integrohet në programet turistike dhe ato shoqërore.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.1.3.1** |
| Emri i projektit: | **“Projektet Rehabilituese të Ndërtesave Historike dhe Lokacioneve për Akomodimin e Shërbimeve Turistike dhe Kulturore”** |
| Përshkrimi i projektit: | Shërbimet e reja akomoduese si dhe ato turistike dhe kulturore do të themelohen në kuadër të rehabilitimit të ndërtesave dhe lokacioneve historike sidomos të Qendrës Historike të Prizrenit. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.1.3.2** |
| Emri i projektit: | **“Projektet të Restaurimit të Ndërtesave Monumentale”** |
| Përshkrimi i projektit: | Projektet gjithëpërfshirëse të restaurimit të ndërtesave monumentale do të zbatohen si në qytet ashtu edhe në fshatra. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.1.3.3** |
| Emri i projektit: | **“Plani Menaxhues i Lokacioneve Historike”** |
| Përshkrimi i projektit: | Përgatitja e planit të menaxhimit të lokacionit në zonën e mbrojtur historike do të futet në agjendën e komunës dhe qeverisë. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.1.3.4** |
| Emri i projektit: | **“Promovimi i Programit “Vizito Prizrenin”** |
| Përshkrimi i projektit: | Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore do të inkurajohet në programe rajonale dhe globale. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi A.1.4: Vetëdija për ruajtjen e trashëgimisë kulturore do të shtohet

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.1.4.1** |
| Emri i projektit: | **“Programi Edukativ “ Mbroje Prizrenin”** |
| Përshkrimi i projektit: | Programet edukative informuese do të përgatiten nga institucionet qeveritare si dhe do të inkurajohen shoqatat jo qeveritare. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |



**A.2 Trashëgimia Natyrore do të Konservohet dhe Përmirësohet**

Synimi A.2.1: Trashëgimia natyrore do të ruhet së bashku me asetet dhe resurset mjedisore.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.2.1.1** |
| Emri i projektit: | **“Plani Menaxhues për Mbrojtje të trashëgimisë Ntyrore”** |
| Përshkrimi i projektit: | Projekti menaxhues për zonat e trashëgimisë natyrore do të zbatohet me qëllim të mbështetjes dhe ruajtjes së vlerave natyrore. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi A.2.2: Bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar do të përmirësohet në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë natyrore.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.2.2.1** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Integruar i Destinacioneve Natyrore dhe Historiko Turistike”** |
| Përshkrimi i projektit: | Itinerari dhe menaxhimi i destinacioneve të turizmit natyror dhe kulturor duke përfshirë edhe lokacionet arkeologjike dhe Parkun Nacional |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi A.2.3: Ruajtja e trashëgimisë natyrore do të integrohet në programet turistike dhe ato shoqërore.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.2.3.1** |
| Emri i projektit: | **"Projekti për vlerësimin e ndikimit ambiental në Parkun Nacional Malet e Sharrit"** |
| Përshkrimi i projektit: | Programet dhe projektet zbatuese do të merren parasysh me synim të reflektimit mbi politikat dhe propozimet e Planit Hapësinor të Parkut Nacional Malet e Sharrit . |
| Kohëzgjatja: | 15 vite |

Synimi A.2.4: Vetëdija për ruajtjen e trashëgimisë natyrore do të shtohet

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **A.2.4.1** |
| Emri i projektit: | **"Projekti i Ndërtimit të Kapaciteteve për Zhvillimin e Turizmit"** |
| Përshkrimi i projektit: | Programet edukative dhe njoftuese të përgatitura nga institucionet qeveritare dhe/ose të nxitura nga OJQ-të. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

**B – "QËNDRUESHMËRIA AMBIENTALE"**

Qëllimi kryesor strategjik sipas parimit "Qëndrueshmëria e Mjedisit" është Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i resurseve ambientale do të sigurohet. 

**B.1 Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i resurseve ambientale**

Synimi B.1.1: Resurset ambientale do të mbrohen dhe zmadhohen duke ofruar përdorim potencial ekologjik dhe të qëndrueshëm.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.1.1** |
| Emri i projektit: | **"Plani Zhvillimor i Turizmit Natyror"** |
| Përshkrimi i projektit: | Hapësira e Parkut Nacional do të ruhet në pajtim me planin për Parkun Nacional Malet e Sharrit duke mbështetur aktivitetet e turizmit dimëror, skijimin dhe alpinizmin. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.1.2** |
| Emri i projektit: | **"Plani Menaxhues i Pellgjeve të Lumenjve"** |
| Përshkrimi i projektit: | Të arrihet gjendja e mirë e trupave ujore në Prizren deri në vitin 2025 dhe sigurimi i furnizimit të bollshëm të ujit të pastër për gjeneratat e ardhshme, e për këtë nevojitet një plan gjithëpërfshirës për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve në Prizren i cili plan do të përdorë parimet e Direktivës së BE-s për Kornizën e Ujit. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.1.3** |
| Emri i projektit: | **“Ndërtimi i Objekteve për Trajtim e ujërave të zeza”** |
| Përshkrimi i projektit: | Objektet për Trajtim do të ndërtohen me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit në zonat e ngushta buferike të pellgjeve të lumenjve.<br>Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, në Tupec dhe Vlashnje |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi B.1.2: Do të parandalohet ndotja dhe degradimi i ambientit.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.2.1** |
| Emri i projektit: | **“Projekti për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor”** |
| Përshkrimi i projektit: | Programet që adresojnë degradimin dhe ndotjen mjedisore do të përpilohet për Parkun Nacional duke konservuar jetën natyrore dhe llojet endemike si dhe për tër regjionin e komunës së Prizrenit. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.2.2** |
| Emri i projektit: | **“Projektet e Posaçme për Mbrojtjen e Lumenjve Lumëbardhi dhe Drinit të Bardhë”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të përgatiten projektet e posaçme për mbrojtjen e Lumbardhat dhe Drinit të Bardhë |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |



Synimi B.1.3: Do të ofrohet një ambient i sigurt dhe sensitiv ndaj mjedisit në zonat ku ekziston rreziku ambiental

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.3.1** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Vlerësimit të Rreziqeve të Lokacioneve Natyrore”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të sigurohet një kontroll strikt i prerjes së drunjve në park dhe jashtë saj për të parandaluar humbjen e pyjeve dhe erozionin |
| Kohëzgjatja: | 15 vite |

Synimi B.1.4: Zonat pyjore dhe zonat tjera të rëndësishme natyrore do të mbrohen me një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.4.1** |
| Emri i projektit: | **“Plani i Menaxhimit të Pyjeve”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të bëhet nxitja e pyjëzimit të pyjeve me dendësi të ultë. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.4.2** |
| Emri i projektit: | **“Projekti Hulumtues për Lokacionin e Përshtatshëm për Aktivitete të Ekstraktimit të Zhavorrit dhe Gurëthyesve”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të inkurajohet shfrytëzimi i organizuar në regjionin e Lumës dhe Hasit ku aktualisht bëhet eksploatimi ilegal i zhavorrit dhe gurëthyesve, |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.4.3** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Rehabilitimit të Lokacioneve Aktuale ku Bëhet Ekstraktimi Ilegal i Zhavorrit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Eksploatimi ilegal i zhavorrit dhe gurëthyesve do të ndërpritet ndërsa sipërfaqet ku është bërë eksploatimi ilegal do të rehabilitohen. |
| Kohëzgjatja: | 15 vite |

Synimi B.1.5: Tokat e pëlleshme të Prizrenit do të përdoren për aktivitete bujqësore

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **B.1.5.1** |
| Emri i projektit: | **“Programet Edukative Bujqësore”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të inkurajohet prodhimtaria e drithërave në tokat e punueshme në veri të Prizrenit ku ekziston sistemi i vaditjes. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |



## C - INKUADRIMI SOCIAL, BARAZIA SOCIALE DHE KUALITETI I JETËS”

Sipas parimit të “Ruajtjes së Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore: Në këtë parim janë tre qëllimet kryesore strategjike. Këto janë:

1. Do të sigurohen objektet publike të balancuara me qasje të lehtë
2. Do të sigurohen mundësi të reja për punësim dhe shkalla e papunësisë do të ulet
3. Do të inkurajohet pjesëmarrja në vendimmarrje.

### C.1. Do të sigurohen objektet publike të balancuara me qasje të lehtë

Synimi C 1.1: Të gjitha llojet e objekteve urbane do të zgjerohen dhe modernizohen si nga cilësia ashtu edhe nga sasia

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C111** |
| Emri i projektit: | **“Projekti Vlerësues për Rikualifikimin dhe Organizimin e Objekteve Urbane”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të përmirësohet kapaciteti dhe cilësia e objekteve urbane duke u bazuar në studimin e dokumentacioneve që do të kryhet për te evidentuar objektet urbane si dhe për të përcaktuar kapacitetet dhe standardet e tyre. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi C.1.2: Mangësitë në vendbanimet rurale në aspektin e objekteve arsimore si kopshti i fëmijëve, objektet parashkollore dhe shkollave fillore do të evitohen

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C121** |
| Emri i projektit: | **“Projektet për Ndërtim të Çerdheve për Çdo Fshat”** |
| Përshkrimi i projektit: | Hapësirat për kopshte të fëmijëve do të ndahen (rezervohen) në objektet e shkollave fillore të çdo fshati. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C122** |
| Emri i projektit: | **“Projektet e Ndërtimit të Shkollave Fillore për Çdo Fshat”** |
| Përshkrimi i projektit: | Nga një shkollë fillore do të ndërtohen në fshatrat: Kojush, dhe Karashengjergji në regjionin e Hasit; Malësi e Re në regjionin e Kabashit; Muradem në regjionin e Lumës; në fshatrat Serbica e Epërme, Shpinadi, dhe Trepetnicë të regjionit të Anadrinit; Grazhdanik në regjionin e Prizrenit dhe Drajqiqi në regjionin e Zhupës. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi C.1.3: Si objekte standarde në fshatrat qendrore, do të sigurohen ndërtimi i objekteve si ato shkolla të mesme, objektet shëndetësore, socio-kulturore, objekte sportive dhe shtëpi për pleq.



| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C131** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Ndërtimit të Shkollave të Mesme”** |
| Përshkrimi i projektit: | Shkollat e mesme do të ndërtohen në secilin prej këtyre fshatrave: Lubizhdë (Kabashi), Piranë (Anadrini), Hoçë e Qytetit (Vrrini) dhe Mushnikovë (Zhupa).<br>Këto mund të veprojnë si shkolla teknike bazuar me specializimin e rajonit në rast nevoje (shkolla e mesme teknike e bujqësisë në regjionin e Anadrinit, shkolla e mesme teknike e turizmit në Prizren dhe regjionin e Zhupës dhe shkolla e mesme teknike e industrisë në Prizren) |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C132** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Ndërtimit të Objekteve Kulturore Multi Disciplinare – Destinime”** |
| Përshkrimi i projektit: | Objektet me funksion multi disciplinar do të ndërtohen në secilën prej këtyre fshatrave Piranë (Anadrini), Hoqë e Qytetit (Vërrini), Romajë (Has), Zhur (Luma), Lubizhdë (Kabash) dhe Mushnikovë (Zhupa). Librari, qendra rinore, teatër-kinema, etj. Do të ndërtohen në përputhje me konsensusin e popullsisë së fshatit. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C133** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Ndërtimit të Objekteve Sportive në Fshatrat Qendrore”** |
| Përshkrimi i projektit: | Objektet sportive do të ndërtohen në çdo fshat qendror (Gjonaj, Hoqa e Qytetit, Lubizhda, Mushnikova, Pirana, Recana, Romaja, Velezha, Zhur dhe Zym). |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi C.1.4: Objektet urbane në Qytetin e Prizrenit do të përmirësohen duke qenë në shërbim të gjithë banorëve të Komunës.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C141** |
| Emri i projektit: | **“Projekti Zhvillimor i Kapacitetit dhe Cilësisë së Objekteve Urbane”** |
| Përshkrimi i projektit: | Objektet urbane në Qytetin e Prizrenit do të përmirësohen në mënyrë që tu shërbejnë të gjithë banorëve të Komunës. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

**C.2. Do të sigurohen mundësi të reja për punësim dhe shkalla e papunësisë do të ulet**

Synimi C.2.1: Do të sigurohet mbështetja për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të edukuar



| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C211** |
| Emri i projektit: | **“Programi Edukues për Afarizmin e të Rinjve”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të fillohet me programin edukues për afarizmin e të rinjve për të përkrahur popullatën e re. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C212** |
| Emri i projektit: | **“Themelimi i Agjencisë për Zhvillimin e Projekteve dhe Konsultime”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të themelohen programet konsultative për të mbështetur projektet |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C213** |
| Emri i projektit: | **“Programi Zhvillimor i Ekonomisë Lokale”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të zhvillohet një program për shfrytëzimin më të mirë të potencialeve ekonomike dhe burimeve njerëzore e natyrore, sidomos në turizëm dhe bujqësi. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi C.2.2: Do të inkurajohen mundësitë për punësim në sektorin e shërbimeve në Qytetin e Prizrenit

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C221** |
| Emri i projektit: | **“Shërbimet Ndihmëse të Afarizmit dhe Programi për Rekrutimin për Punë”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të zhvillohen program konsultative dhe mbështetëse të fokusuar në investimet në sektorin e shërbimeve. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi C.2.3: Në viset rurale do të krijohen mundësitë për punësim në turizëm, agro industri dhe bujqësi

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C231** |
| Emri i projektit: | **“Programi për Shërbimet Ndihmëse të Afarizmit Bujqësor”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të zhvillohen shërbimet ndihmëse për mbështetjen e turizmit, agro industrisë dhe bujqësisë |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C232** |
| Emri i projektit: | **“Komunitetet në Projektet e planifikimit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të organizohen diskutimet publike për të gjithë qytetarët |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |



**C.3. Do të inkurajohet pjesëmarrja e banorëve në vendimmarrje.**

Synimi C.3.1: Gjatë tërë procesit të planifikimit do të ofrohet pjesëmarrja e banorëve

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C311** |
| Emri i projektit: | **“Projekti e-Prizreni”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të krijohet internet faqja e Komunës së Prizrenit për aplikimet e-Prizren. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi C.3.2: Do të ngrihet vetëdija publike për jetën urbane dhe rurale

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **C321** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i e-buletinit Komunal”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të përgatitet e-buletin Komunal për shërbimet komunale |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

## D – "VITALITETI EKONOMIK"

Sipas parimit " Vitaliteti Ekonomik" në kuadër të këtij parimi janë pesë objektivat kryesore strategjike. Këto janë:

1. Do të sigurohet zhvillimi i balancuar dhe i menaxhuar rural
2. Do të sigurohet zhvillimi i balancuar dhe i menaxhuar rural
3. Aktivitetet prodhuese do të nxiten dhe jenë më të organizuara
4. Aktivitetet komerciale dhe financiare do të nxiten
5. Aktivitetet turistike në Prizren do të zhvillohen dhe përmirësohen.

### D.1. Do të sigurohet zhvillimi i balancuar dhe i menaxhuar rural

Synimi D.1.1: Do të mbështeten mundësitë e ndryshme për punësim në fshatrat qendrore

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D111** |
| Emri i projektit: | **"Programi për Shërbimet Ndihmëse të Afarizmit Ndërmarrës"** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të zhvillohen programet konsultative dhe mbështetëse për afarizmin ndërmarrës |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

### D.2. Do të mbështetet prodhimtaria bujqësore

Synimi D.2.1: Do të zhvillohet prodhimtaria bujqësore dhe blegtorale

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D211** |
| Emri i projektit: | **"Programet Trajnuese dhe Konsulentë për Prodhimin e Kafshëve"** |
| Përshkrimi i projektit: | Programet trajnuese dhe këshilluese do të themelohen për të rritur efikasitetin e blegtorisë në regjionin e Prizrenit dhe Anadrinit. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |



| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D212** |
| Emri i projektit: | **"Fondet Nxitëse Komunale për Blegtori"** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të organizohen programet ekonomike si dhe do të sigurohen fondet financiare për zhvillimin e blegtorisë në regjionin e Zhupës dhe Vërrinit |
| Kohëzgjatja: | 15 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D213** |
| Emri i projektit: | **"Programi "Prodhimet e Prizrenit"** |
| Përshkrimi i projektit: | Aktivitetet e marketingut do të ndërmerren për të promovuar prodhimet lokale bujqësore. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D214** |
| Emri i projektit: | **“Programet Trajnuese dhe Konsulentë për Prodhimet e Qumështit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Prodhimet e qumështit nga fshatrat rrethuese do të grumbullohen dhe prodhohen në fermën qumështore. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi D.2.2: Do të mbështetet prodhimi dhe shitja e prodhimeve të reja bujqësore

Synimi D.2.3: Do të nxitet prodhimtaria e verës.

Synimi D.2.4: Toka e pëlleshme e Prizrenit do të përdoret për aktivitete bujqësore

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D2aa** |
| Emri i projektit: | **“Programi Zhvillimor Bujqësor”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të mbështetet prodhimtaria e drithërave, prodhimi i frutave dhe perimeve si dhe vreshtaria në regjione të Vërrinit, Prizrenit dhe Anadrinit do të përmirësohet.<br>Vreshtat në fshatrat Gërnçare, Krushë e Vogël, Jeshkove, dhe Leskovec do të rehabilitohen dhe aktivizohen.<br>Prodhimi i drithërave në tokat e punueshme do të inkurajohet në veri të qytetit të Prizrenit ku ekziston sistemi i ujitjes. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

**D.3. Aktivitetet prodhuese do të nxiten dhe jenë më të organizuara**

Synimi D.3.1: Gjenerimi i vlerës së shtuar nga prodhimet bujqësore do të mbështetet



| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D311** |
| Emri i projektit: | **“Projekti për Zonën e Re të Zhvillimit të Industrisë Bujqësore”** |
| Përshkrimi i projektit: | Një sipërfaqe e re industriale e bazuar në bujqësi do të themelohet në veriperëndim të Prizrenit dhe aktivitetet e tanishme prodhuese do të vazhdojnë. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi D.3.2: Do të ofrohet mbështetja dhe reklamimi i prodhimeve tradicionale

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D321** |
| Emri i projektit: | **“Programet Edukative për Prodhimin e Pijeve Lokale”** |
| Përshkrimi i projektit: | Programet alternative ekonomike si prodhimtaria e rakisë së rrushit dhe të verës do të mbështetet në viset rurale ku papunësia është në rritje e sipër. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D322** |
| Emri i projektit: | **“Programet Edukative për Prodhimin e Filigranit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Filigrani si një nga aktivitetet tradicionale të Prizrenit do të zhvillohet dhe pritet që ky aktivitet të mbështesë aktivitetet turistike. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

**D.4. Aktivitetet komerciale dhe financiare do të nxiten**

Synimi D.4.1: Do të rritet efikasiteti i aktiviteteve tregtare.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D411** |
| Emri i projektit: | **"Programet e Vazhdueshme Edukative për Aktivitete Komerciale dhe Tregtare"** |
| Përshkrimi i projektit: | Aktivitetet komerciale dhe tregtare do të zhvillohen dhe përmirësohen në fshatrat qendrore së bashku me qendrat komerciale në Prizren, |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi D.4.2: Do të mbështetet logjistika

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D421** |
| Emri i projektit: | **"Projekti i Nyjës Logjistike"** |
| Përshkrimi i projektit: | Përgjatë autostradës Durrës Merdare e cila kalon përmes komunës së Prizrenit, do të zhvillohet një nyje logjistike e cila do të jetë një lidhje jetike komerciale e cila do të kalon nëpër Prizren. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

**D.5. Aktivitetet turistike në Prizren do të zhvillohen dhe nxiten**

Synimi D.5.1: Prizreni do të reklamohet si një destinacion turistik.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D511** |
| Emri i projektit: | **"Themelimi i Zyrës së Turizmit në Prizren"** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të themelohet zyra për turizëm me qëllim të promovimit dhe reklamimit të kësaj ane. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |



Synimi D.5.2: Do të inkurajohen aktivitetet turistike dhe ato kulturore në pjesën historike të qytetit.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D521** |
| Emri i projektit: | **"Udhërrëfyes dhe Programi i Kontrollit të Objekteve Turistike"** |
| Përshkrimi i projektit: | Njësitë ekzistuese akomoduese do të rehabilitohen si dhe do të ndërtohen njësitë e reja në qytetin e Prizrenit. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi D.5.3: Do të zhvillohen dhe përcaktohen aktivitetet e përshtatshme turistike për rajonin si turizmi dimëror, turizmi shëndetësor, eko turizmi

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D531** |
| Emri i projektit: | **"Projekti i Qendrës Skijimore në Prevallë"** |
| Përshkrimi i projektit: | Sipërfaqet për skijim dhe alpinizëm në Prevallë dhe Malet e Sharrit do të përmirësohen dhe në bazë të strukturës natyrore të tyre do të ndërtohen projekte të reja të akomodimit. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D532** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Agro Turizmit në Fushën e Podrimës”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të zhvillohet dhe inkurajohet projekti i agro turizmit në fushën e Podrimës |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **D533** |
| Emri i projektit: | **“Plani Menaxhues dhe Zbatues i Parkut Nacional Malet e Sharrit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Parashihen ekskursione të ndryshme në Parkun Nacional Malet e Sharit dhe regjionin e Lumës. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

## E – “INTEGRITETI HAPËSINOR”

Sipas parimit të “Integritetit Hapësinor” në kuadër të këtij parimi janë dy qëllimet kryesore strategjike. Këto janë:

1. Do të krijohen ambientet atraktive për jetesë
2. Do të sigurohet transporti dhe infrastruktura efektive dhe e integruar hapësinore



### E.1. Do të krijohen ambientet atraktive për jetesë

Synimi E.1.1: Do të zhvillohen lokacione të reja për banim dhe do të përcaktohen sipërfaqet për regjenerim/dizajnim urban.

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E111** |
| Emri i projektit: | **“Revidimi i Planit Zhvillimor Urbanistik i Qytetit të Prizrenit në Pajtim me Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Plani zhvillimor urbanistik i qytetit të Prizrenit do të rishikohet në pajtim me Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E112** |
| Emri i projektit: | **“Planet Zhvillimore Urbane për Fshatrat Qendrore”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të përpilohen planet zhvillimore për secilin nga fshatrat qendrorë (Gjonaj, Hoça e Qytetit, Lubizhda, Mushnkova, Pirana, Romaja, Velezha, Zhuri dhe Zymi) |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi E.1.2: Nevojat për banim të popullatës së tanishme dhe të paraparë do të koordinohen me bashkëpunim me investitorët

Synimi E.1.3: Do të sigurohet niveli i barabartë i banimit social për shtresat me të ardhura të vogla dhe mesatare.

Synimi E.1.4: Do të rriten standardet për cilësinë e ambientit në vendbanime

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E1aa** |
| Emri i projektit: | **“Planifikimi i Qëndrueshëm i Vendbanimeve dhe Dizajni i Udhërrëfyesit për Dizajnin Urban të Prizrenit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do të përcaktohen Zonat urbanistike regjeneruese në Komunën e Prizrenit në planet e shkallës së ulët për të inkurajuar zhvillimin e përshtatshëm rezidencial, sidomos për banim social dhe të përballueshëm për rehabilitimin në vendbanimet joformale. |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

**E.2. Do të sigurohet transporti dhe infrastruktura efektive dhe e integruar hapësinore**

Synimi E.2.1: Rrjeti dhe infrastruktura transportuese do të zhvillohen asisoj që të shërbejnë në mënyrë efikase për të gjitha vendbanimet e Komunës

Synimi E.2.2: Transporti lokal do të integrohet në rrjetin nacional



Synimi E.2.3: Do të zhvillohet një sistem efikas i trafikut publik

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E2aa** |
| Emri i projektit: | **“Masterplani i Transportit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Do te përgatitet një masterplan i transportit për tërë komunën. Autostrada Durrës Merdare do të integrohet në rrjetin transportues të Prizrenit.<br>Lidhja rrugore regjionale mes Prizrenit-Kosovës me Tetovën Maqedoni (10 vite) |
| Kohëzgjatja: | 2 vite |

Synimi E.2.4: Do të zhvillohet sistemi efikas dhe i sigurt i transportit publik

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E241** |
| Emri i projektit: | **“Dizajni i Trafikut dhe Plani Menaxhues për Qytetin e Prizrenit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Trafiku lokal (brenda qytetit) do të ri rregullohet |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

Synimi E.2.5: Do të përmirësohet infrastruktura teknike

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E251** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Renovimit të Sistemit të Elektricitetit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Sistemi elektrik do të rinovohet si në aspektin e linjave ekzistuese dhe të reja ashtu edhe njësive shpërndarëse për të parandaluar ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E252** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Energjisë së Erës dhe Përzgjedhja e Lokacioneve”** |
| Përshkrimi i projektit: | Potenciali energjisë së erës do të vlerësohet si dhe do të bëhet studimi i lokacioneve të përshtatshme. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E253** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Themelimit dhe Renovimit të Rrjetit të Komunikimit”** |
| Përshkrimi i projektit: | Rrjeti i komunikimit do të zgjerohet për të shërbyer edhe fshatrat ku për momentin nuk ka rrjet (pos fshatit Mushnikovë, Lubizhdë, në fshatrat tjera nuk ka rrjet). |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |



| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E254** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Renovimit të Sistemit të Kanalizimit dhe Ndërtimi i Njësive për Pastrim”** |
| Përshkrimi i projektit: | Sistemi ekzistues i kanalizimit do të rinovohet dhe do të ndërtohen njësitë e pastrimit. |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

| | |
|---|---|
| Kodi i projektit: | **E255** |
| Emri i projektit: | **“Projekti i Renovimit të Sistemit të Vaditjes”** |
| Përshkrimi i projektit: | Rrjeti ekzistues i vaditjes do të rinovohet dhe do të zgjerohet për të mbuluar sipërfaqet bujqësore |
| Kohëzgjatja: | 5 vite |

## 4.2. VLERËSIMI I STRATEGJIVE NË BAZË TË KRÎTEREVE TË PËRCAKTUARA NGA PARIMET, POLITIKAT DHE LIGJET

PZHKP 2025 është përgatitur të jetë një dokument statusor që do të udhëheqë zhvillimin e ardhshëm të Komunës së Prizrenit. Plani është dizajnuar asisoj që të shërbejë si një kornizë e gjerë dhe udhërrëfyes për rritjen dhe zhvillimin e komunës duke ofruar një kornizë rregulluese afatgjate dhe gjithëpërfshirëse të përdorimit të tokës, ku do të përfshihen zhvillimi dhe rritja aktuale dhe ajo e projektuar. Dokumentet ligjore, planet e shkallëve të lartë, raportet e sektorëve dhe udhëzuesit që janë marrë në konsideratë në procesin e planifikimit të PZHKP 2025 janë cekur në mënyrë të thuktë në raportet paraprake. Këto janë:

- Hyrje (f.3),
- Pjesa 1.3 "Prizreni në kontekstin e gjerë hapësinor dhe udhëzimet për përpilimin e PZHKP" (f.241),
- Pjesa 2.1 " E ardhmja e Komunës së Prizrenit në kontekstin e planeve, raporteve sektoriale dhe udhëzimeve (f.262) dhe Pjesa 2.2 "Vizioni për të ardhmen e Komunës së Prizrenit" (f.272),
- Pjesa 3.4 "Projektet strategjike dhe zonat e Veçanta të cekura në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020 + dhe planet tjera për zona të veçanta" (f.323)



Siç është theksuar në raportin e fazës së parë "Profili i Zhvillimit Hapësinor dhe Analiza e Gjendjes", baza ligjore e PZHKP 2025 është Ligji për Planifikim Hapësinor (Nr. 2003/14) dhe Ligji (Nr. 03/L-106/2008) për ndryshimin e ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr.2003/14).
Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi Elementet Kryesore të Planit Zhvillimor të Komunës (Nr.rend.33, Nr.Pro. 29/03 /2003) është dokument kryesor që formon bazën strukturale të PZHKP 2025. Pos këtyre dokumenteve, kemi disa dokumente ligjore, plane të shkallës së lartë, raportet dhe udhëzuesit sektorial të cilat janë marrë në konsideratë gjatë procesit planifikues të PZHKP 2025. Ato janë:

- Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës (S/2007/168/ADD.1)
- Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ (Ligji për Planifikim Hapësinor (Nr. 2003/14); Ligji (Nr. 03/L-106/2008) për ndryshimin e ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr.2003/14).
- Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi Elementet Kryesore të Planit Zhvillimor të Komunës (Nr.rend.33, Nr.Pro. 29/03 /2003) dhe udhëzimet tjera administrative
- Raportet dhe udhëzuesit sektorial, strategjitë, duke inkuadruar edhe rekomandimet e Vizionit të integruar të Prizrenit (Komuna e Prizrenit/UN HABITAT, 2008)
- Ligjet

Dokumenti kryesor që identifikon vizionin 2025 të Prizrenit është Plani Hapësinor i Kosovës i përpiluar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2007. Përveç kësaj, për të vërtetuar vendimet e planifikimit është marrë në konsideratë edhe Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+. Vizioni i Kosovës, në bazë të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ është: „të sigurohet zhvillimi qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastruktura dhe teknologjia moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë dhe forcë pune të kualifikuar, vend që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve, me një shoqëri të hapur që promovon llojllojshmërinë dhe këmbimin e ideve duke respektuar të drejtat e të gjithëve. Strategjia e zhvillimit hapësinor bazohet në zhvillimin e rrjetit të fuqishëm të qyteteve me ndikim ekonomik, nëpërmjet të burimeve njerëzore, avancimin e bazës së njohurive, shfrytëzimi i planifikuar dhe racional i resurseve natyrore dhe atyre kulturore, mundësive për qasje në infrastrukturën fizike, ofrimi dhe përmirësimi i cilësisë jetësore, barazia shoqërore, të gjitha këto të mbështetura nga kapacitetet organizative. Parimet kryesore të strategjisë së zhvillimit hapësinor të cilat përbëjnë bazën e PZHKP 2025 janë elaboruar në kapitujt vijues: Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban të zhvillimit ekonomik, zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore dhe zhvillimi i lidhjeve strategjike. Dokumenti i dytë i rëndësishëm që përcakton vizionin 2025 të Prizrenit është Vizioni i integruar i Prizrenit i përgatitur nga Komuna e Prizrenit dhe UN HABITAT në Mars të vitit 2008. Duke përcjellë vizionin e përcaktuar në Planin Hapësinor të Kosovës, Prizreni definohet si: "qendra e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me një ekonomi që krijon potenciale për zhvillimin e shoqërisë si dhe udhëkryq i regjionit ku sundon tolerance dhe ligji". Ajo është strukturuar në pesë fusha themelore të intervenimit sa i përket zhvillimit komunal. Këto fusha janë: Zhvillimi Urban dhe Rural dhe Planifikimi, lëvizshmëria dhe transporti, trashëgimia kulturore dhe resurset natyrore, ambienti ekonomik dhe bujqësia, infrastruktura dhe shërbimet publike. Dokumenti i tretë me rëndësi për identifikimin e vizionit 2025 për Prizrenin është PZHU i Prizrenit që është përgatitur nga Komuna e Prizrenit më 2003 dhe paraqet një plan dhjetë vjeçar për zhvillimin e qëndrueshëm të qendrës së Prizrenit. Edhe pse vizioni këtu nuk është i qartë, perspektiva e planit bëhet më e qartë me përcaktimin e qëllimeve. Qëllimet e planit janë: Sigurimi i zhvillimit social që do t'i përgjigjej nevojave të secilit, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, promovimi i zhvillimit lokal ekonomik, sigurimi i përdorimit të kujdesshëm të resurseve natyrore dhe mbrojtja e ambientit, mbështetja dhe koordinimi i moduleve të trafikut duke përfshirë sigurinë dhe ofrimin e cilësisë në ndërtimin e objekteve. Dokumentet tjera të rëndësishëm për përcaktimin e vizionit 2025, parimeve dhe synimeve për Komunën e Prizrenit janë: Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit, Plani Hapësinor Zhvillimor i Parkut Nacional "Malet e Sharrit", Raporti Nacional mbi Transportin në Kosovë (nën rezolutën e UN-it 1244), Prapavija e Dokumentit teknik të Sektorit të Transportit dhe Strategjisë Energjetike të Kosovës.

Parimet e përgjithshme të zhvillimit për Komunën e Prizrenit që inkorporojnë rolin dhe prioritetet rezultojnë nga planet paraprake dhe udhërrëfyesit, si dhe analizat analitike të kryera në fazën e parë të PZHKP 2025. Siç është përmendur në kapitullin e Fazës II-të , parimet e përgjithshme duhet të marrin në konsideratë:

- Zhvillimin dhe ruajtjen e resurseve natyrore dhe kulturore
- Përmirësimin e kushteve jetësore me zhvillimin e shërbimeve publike
- Promovimi i zhvillimit të balancuar dhe të organizuar urban
- Zhvillimi i rrjetit të fortë urban të zhvillimit ekonomik
- Zhvillimi i linjave strategjike transportuese dhe të infrastrukturës

Siç është prezantuar në pjesën 2.1, parashikimet për Prizrenin 2025 në bazë të Planit Hapësinor të Kosovës, Vizionit të Integruar të Prizrenit dhe raporteve tjera sektoriale përqendrohen në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik, teknologji dhe infrastrukturë moderne, mundësitë për arsimim, respekti për ambient, trashëgimia natyrore dhe kulturore si dhe shoqëria diverse dhe e barabartë. Pos këtyre planeve, udhërrëfyesve dhe raporteve sektoriale, Vizioni i PZHKP 2025 inkorporon rolin dhe prioritetet e përcaktuara nga intervistat individuale të 75 kryetarëve të fshatrave të mbajtur në mars dhe prill të vitit 2009 dhe Debati publik i mbajtur në qershor të vitit 2009.



Duke i integruar rolet dhe prioritetet e caktuara më planet dhe udhërrëfyesit paraprak, pastaj rezultatet e debatit publik të mbajtur në qershor 2009, si dhe duke i bashkuar ato me potencialet/forcat shtytëse del që vizioni për ardhmërinë e Komunës së Prizrenit është “Të zhvillohet Prizreni si një qendër e qëndrueshme kulturore në Kosovë dhe Ballkan, duke promovuar potencialin e tij sa i përket aseteve historike, resurset natyrore dhe ambientale, diversitet social dhe vitalitet ekonomik ” Duke i kombinuar këto parime, del se parimet kyçe të PZHKP 2025 për zhvillim të Komunës së Prizrenit janë zhvilluar në pesë grupe tematike përfshirë këtu: trashëgiminë natyrore dhe kulturore, ambienti natyrore, mjedisi social, mjedisi ekonomik dhe ai hapësinor. Parimet kyçe të PZHKP 2025 janë :

- Parimi 1: Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Parimi 2: Qëndrueshmëria ambientale
- Parimi 3: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore
- Parimi 4: Vitaliteti ekonomik
- Parimi 5: Integriteti hapësinor

## Strategjitë lidhur me Ruajtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore

Strategjitë lidhur me ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore janë dizajnuar për të realizuar parimin e parë "Ruajtja e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore". Me ç'rast ligjet kryesore janë: Ligji për Ndërtimin (Nr.04/L-110/2012), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr.02/L-18/2005), Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr.03/L-025/2009) dhe Ligji për Mbeturinat (Nr.04/L-060/2011).

Ruajtja e resurseve natyrore është një nga parimet kyçe të Planit hapësinor të Kosovës duke konsideruar çështjet e humbjes së tokës kualitative bujqësore; shkallën e lartë të ndotjes mjedisore; shfrytëzimin joracional të resurseve dhe zgjerimin e pakontrolluar të vendbanimeve. Për më tepër, Prizreni paraqitet si nyje e rëndësishme për shkak të trashëgimisë së pasur historike dhe kulturore dhe resurse ambientale. Në raportin e Profilit të Zhvillimit Hapësinor dhe Vështrimit të Komunës së Prizrenit është theksuar nevoja e veprimit të fortë dhe urgjent për të ruajtur karakteristikat historike të Prizrenit dhe Plani Hapësinor i Kosovës e emëron Prizrenin si "Qytet Muze" që kontribuon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për zhvillimin e ekonomisë lokale. PZHKP 2025 po ashtu merr në konsideratë edhe zonat me interes të veçantë brenda rajonit paraqitur në planin hapësinor siç është pika kufitare në Vërmicë, Parku Nacional (Malet e Sharrit), zonat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, zonat e mbrojtura përreth lumenjve Drini i Bardhë dhe Lumëbardhit, akumulimi në fshatin Dragaqina zonat e kullotave në Dragash si dhe korridorin e autostradës Durrës Merdare. Pos kësaj, trashëgimia kulturore dhe resurset natyrore është fusha e tretë e intervenimit në Vizionin e Integruar të Prizrenit 2008. Ku synohet mbrojtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore dhe burimeve natyrore në zonat urbane dhe rurale si asete kryesore të Komunës. Dokumentet tjera të rëndësishme në identifikimin e strategjisë 2025 sa i përket trashëgimisë kulturore dhe natyrore janë Plani i Konservimit i Zonës Historike të Prizrenit dhe Plani Hapësinor i Parkut Nacional "Malet e Sharrit". Vendimet e dala nga Plani i Konservimit i Zonës Historike të Prizrenit i cili është përgatitur në pajtim me Memorandumin për Implementimin e Programit rehabilitues të Zonës Historike të Prizrenit të nënshkruar në Maj 2006, janë marrë parasysh në planin zhvillimor komunal.



Duke i pasur parasysh të gjitha këto, strategjitë e PZHKP 2025 janë përpiluar me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore në tërë Komunën e Prizrenit, të përmirësohet bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore, integrimi i ruajtjes së trashëgimisë kulturore në programet turistike dhe ato shoqërore, shtimi i vetëdijes për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ruajtje të trashëgimisë natyrore së bashku me asetet dhe resurset mjedisore, të përmirësohet bashkëpunimi profesional dhe ai qeveritar në aspektin e menaxhimit të trashëgimisë natyrore, integrimi i ruajtjes së trashëgimisë natyrore në programet turistike dhe ato shoqërore, dhe shtimi i vetëdijes për ruajtjen e trashëgimisë natyrore.

Trashëgimia e mbrojtur kulturore dhe natyrore është rezultat i pritur i parimit të ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore duke përmirësuar bashkëpunimin qeveritar dhe atë profesional. Meqë plani sugjeron integrimin e trashëgimisë me turizmin dhe programet sociale, ruajtja e trashëgimisë brenda kufijve administrative të Komunës së Prizrenit po ashtu do të përshpejtojë zhvillimin e turizmit në Komunë.

**Strategjitë që kanë të bëjnë me Qëndrueshmërinë Ambientale**

Qëndrueshmëria ambientale është po ashtu çështje e rëndësishme si nga aspekti ekonomik ashtu edhe nga aspekti natyror. Mbrojtja e zonave pyjore e sidomos e Parkut Nacional Malet e Sharrit është prioritet me qëllim të përdorimit të drejtë të burimeve natyrore si dhe të zhvillimit të turizmit. Strategjitë në lidhje me rruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore janë paraqitur në realizimin e parimit të dytë “Qëndrueshmëria Ambientale”. Ligjet që kanë të bëjnë me parimin e qëndrueshmërisë ambientale janë: Ligji për Ndërtimin (Nr.04/L-110/2012), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr.02/L-18/2005), Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr.03/L-025/2009) dhe Ligji për Mbeturinat (Nr.04/L-060/2011).

Ruajtja e burimeve natyrore është një nga parimet më të rëndësishme të Planit Hapësinor të Kosovës duke marrë në konsideratë çështjet si humbja e tokës kualitative bujqësore; shkallën e lartë të ndotjes mjedisore; shfrytëzimin joracional të resurseve dhe zgjerimin e pakontrolluar të vendbanimeve. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ nënvizon faktin se qasja për një zgjidhje të ardhshme duhet të konsistojë në veprime të përqendruara të mbrojtjes së mjedisit dhe resurseve natyrore, përkujdesjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e tokës kualitative bujqësore dhe promovimit të prodhimeve kualitative vendore, mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të resurseve minerale dhe kontrollit të rritjes së vendbanimeve.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto PZHKP 2025 ka zhvilluar strategjitë e bazuara në përdorimin e qëndrueshëm të resurseve ambientale që synon Ruajtjen e resurseve ambientale duke ofruar përdorim potencial ekologjik dhe të qëndrueshëm, parandalimi i ndotjes dhe degradimi të ambientit, ofrimi i një ambienti të sigurt dhe sensitiv ndaj mjedisit në zonat ku ekziston rreziku ambiental, ruajtjen e zonave pyjore dhe zonave tjera të rëndësishme natyrore me një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, përdorimin i tokave të pëlleshme të Prizrenit për aktivitete bujqësore. Si rezultat i respektimit të parimit të qëndrueshmërisë ambientale do të jetë mbrojtja e resurseve natyrore dhe ambientale si dhe ambienti i qëndrueshëm. Në mënyrë indirekte ky parim ndikon në zhvillimin e bujqësisë, turizmit dhe krijimin e kushteve tërheqëse të jetesës.

**Strategjitë lidhur me Inkuadrimin Social, Barazinë Sociale dhe Cilësinë e Lartë Jetësore.**

PZHKP 2025 në vete ka edhe strategjitë lidhur me inkuadrimin social, barazinë sociale dhe cilësinë e jetesës që synon sigurimin e balancuar të objekteve publike, mundësi të reja për punësim, inkurajimin e pjesëmarrjes në vendim marrje. Qasja e lehtë, objektet publike me standarde të larta dhe mjedisi atraktiv për jetesë në Prizren dhe zonat rurale janë ndikimet e pritura të këtij parimi. Zhvillimi i organizuar i prodhimtarisë, zhvillimi komercial dhe financiar dhe zhvillimi i turizmit janë po ashtu efektet direkte të përmirësimit të objekteve dhe mbështetjes së fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të edukuar.

**Strategjitë lidhur ne Vitalitetin Ekonomik**

Zhvillimi ekonomik i Prizrenit bazohet në strategjinë e qendrës së fuqishme të qytetit duke ruajtur zonat rurale. Sipas zhvillimit ekonomik, vendbanimet qendrore janë pikë qendrore për vendbanimet rurale. Vitaliteti ekonomik dhe zhvillimi i balancuar rural janë dy qëllime të PZHKP 2025.

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, rajonit më të gjerë, ku Prizreni ndodhet, kjo zonë është përcaktuar për turizmin kulturor, industrinë bujqësore dhe tregti, ku Prizreni ka rolin udhëheqës për shkak të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe potencialet e saja të turizmit kulturor dhe rekreative. Vizioni i Prizrenit, siç tregohet në Plan është që Prizreni të jetë një qendër e cila mbështetet në rrënjët e saja të lashtësisë, për të bërë atë si qendër kulturore të turizmit modern, bujqësisë industriale dhe shërbimeve dhe tregtisë, duke zhvilluar një rrjet funksional në krijimin e lidhjeve më të forta me fshatrat e largëta duke stimuluar aktivitetet të bazuara në potencialet natyrore, tërheqëse për të jetuar dhe punuar në to, dhe hapësirë të mjaftueshme për përfshirjen e sektorit privat në vreshtari, blegtori, bujqësi dhe turizëm. Plani po ashtu sugjeron krijimin e një mjedisi tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve afariste private dhe inkurajimin për shfrytëzimin më të mirë të potencialit ekonomik lokal dhe resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht në veprimtaritë e turizmit dhe bujqësisë. Në Vizionin e Integruar të Prizrenit, ambienti ekonomik dhe bujqësia janë fusha e katërt e intervenimit. Ku synohet sigurimi i infrastrukturës së butë dhe të fortë për të mbështetur aktivitetet dhe investimet private; mbështetja e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale dhe zhvillimi i politikave bujqësore në nivelin rajonal.



Lidhur me atë që u tha, janë përpiluar strategjitë për vitalitetin ekonomik për të siguruar dhe menaxhuar zhvillimin e balancuar rural me mundësi të llojllojshme për punësim në fshatrat qendrore, mbështetje të blegtorisë, prodhimtarisë, aktiviteteve komerciale dhe financiare si dhe turizëm. Si një nga parimet më të rëndësishme, vitaliteti ekonomik ka ndikim në zhvillimin e bujqësisë si dhe zhvillim të organizuar të prodhimtarisë dhe turizmit. Përveç këtyre, vitaliteti

ekonomik ka ndikim të drejtpërdrejtë në fuqinë punëtore të kualifikuar dhe të edukuar si dhe efekt indirekt në zhvillimin komercial dhe financiar.

**Strategjitë lidhur me Integritetin Hapësinor**

Vizioni i PZHKP është përpiluar asisoj që të fuqizojë fuqitë shtytëse për arritjen e lidhjeve të fuqishme me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet rrethuese. Duke synuar një komunikim optimal, qëllimi është të sigurohet një rrjet infrastrukturor i integruar hapësinor dhe efektiv i transportit në Prizren. Investimi në infrastrukturë është kërkesë fondamentale në përputhje me sasinë dhe cilësinë e veprimtarive të ndryshme ekonomike dhe shërbimeve sipas rritjes dhe shpërndarjes së popullatës siç është theksuar në vizionin e PZHKP, Parimet dhe Qëllimet, dhe në këtë mënyrë të ofrojë një zhvillim të qëndrueshëm.

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, strategjia e dyte përqendrohet në zhvillimin e lidhjeve strategjike duke inkuadruar edhe integrimin e infrastrukturës dhe komunikimit në Kosovë me ato në rajon dhe Evropë, përmirësimin e transportit përbrenda territorit të Kosovës, furnizimit stabil me energji elektrike për kërkesat vendore dhe rajonale dhe sigurimin e sasisë së mjaftueshme të ujit për pije familjeve dhe industri. Prizreni ka përparësi në ndërtimin e lidhjeve strategjikë meqë ka një popullatë të edukuar dhe trajnuar, burime të mjaftueshme të ujit dhe lidhje të mira transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet rrethuese. Në Vizionin e Integruar të Prizrenit, fusha e parë e intervenimit është zhvillimi urban dhe rural dhe planifikimi. Detyra e parë është themelimi i zhvillimit të organizuar urban dhe zbatimi i shfrytëzimit racional të tokës në mënyrë që të arrihet organizimi i qëndrueshëm i vendbanimeve, përmirësimi i konditave jetësore, përdorimi efikas i resurseve ekzistuese sidomos të tokës dhe infrastrukturës si dhe përdorimi i drejtë i tokës bujqësore.



Vizioni mbron idenë e krijimit dhe mbështetjes së shemës zhvillimore policentrike hapësinore në Komunën e Prizrenit me qëllim të mbështetjes së zhvillimit më të balancuar në mes të qendrës dhe pjesëve rurale, për të ndërtuar një partneritet të zhvillimit urban e rural dhe për të zvogëluar presionin e urbanizimit në qytetin e Prizrenit. Zhvillimi policentrik pasohet me përmirësimi dhe zgjerimin e rrjeteve regjionale për të mbështetur zhvillimin e pjesëve rurale dhe zhvillimin policentrik duke lehtësuar qasjen në infrastrukturë dhe shërbime që i ofrohen nën qendrave. Preferohet zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit ndërkombëtar të transportit për të lidhur komunën me regjionet fqinje dhe për të lehtësuar shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve.

Këto synime janë mbështetur nga Raporti i përpiluar nga Sektori i Transportit në Kosovë dhe Prapavija teknike e sektorit të transportit. Raporti i përpiluar nga Sektori i Transportit në Kosovë i përpiluar në Maj të vitit 2009 ku kryesisht jepet një përshkrim i zhvillimeve të kaluar në sektorin e transportit në Kosovë e që përbëhet nga rrugët, hekurudha dhe transporti ajror. Prapavija

Teknike e Sektorit të Transportit e përpiluar në Korrik të vitit 2008, përmban një vizion për zhvillimin e sektorit dhe përshkruan strategjitë për përmirësimin e rrjetit rrugor dhe sigurisë rrugore. Dokumenti përmban prioritetet në tre nën-sektorë siç janë transporti urban, hekurudha dhe aviacioni. Strategjia energjetike e Kosovës, e Korrikut të vitit 2005 përmban kornizën fondamentale të bazuar në synimet dhe prioritetet zhvillimore të sektorit të energjisë.

Duke i marrë në konsideratë të gjitha këto, janë përpiluar strategjitë për integritetin hapësinor që synojnë krijimin e kushteve tërheqëse të jetesës dhe ofrimin e transportit dhe infrastrukturës efektive dhe të integruar hapësinore. Mjedisi atraktiv i jetesës dhe infrastruktura cilësore dhe efektive e transportit janë rezultatet e pritura të parimit të integritetit hapësinor. Siç sugjeron plani, standardet e larta dhe objektet kulturore, shëndetësore dhe arsimore me qasje të lehtë do të përshpejtojnë synimet e zhvillimit të lokacioneve të reja të vendbanimit. Përveç këtyre, zhvillimi i vendbanimeve të reja dhe rigjenerimi urban ka ndikim mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe mbrojtjen e resurseve natyrore dhe mjedisore në parimin e integritetit hapësinor.

## 4.3. KORNIZA INSTITUCIONALE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KOHËZGJATJET

Zbatimi i PZHKP 2025 do të bëhet përmes planeve të veprimit në kuadër të kornizës kohore dhe financiare.

Është propozuar një kornizë institucionale për zbatimin, monitorimin dhe raportimin mbi PZHKP 2025. Kornizë e propozuar institucionale është esenciale për zbatimin e PZHKP 2025 (Figura 4.2).

- Të gjitha projektet dhe programet që Komuna e Prizrenit ka për qëllim të zhvillojë në suaza të Planit Zhvillimor 1/25000 që mbulojnë tërë pjesën rurale dhe urbane të Komunës do të parashihen në PZHKP 2025.
- Të gjitha veprimet që duhet të aplikohen, do të zbatohen në pajtim me dispozitat e ligjeve të mëposhtme:
  - Ligji për Ndërtimin (Nr.04/L-110/2012);
  - Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr.02/L-18/2005);
  - Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Ne.03/L-025/2009);
  - Ligj për Parkun Kombëtar “Sharri” (Nr. 04/L - 087/2012);
  - Ligji për Trashëgimin Kulturore (Nr.02/L-88/2006);
  - Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Nr.03/L-039/2008);
  - Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066/2012);
  - Ligji për Mbeturina (Nr.04/L-060/2011);
  - Ligji për Planifikimin Hapësinor (Nr.2003/14); Ligji (Nr.03/L-106/2008) për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr. 2003/14),
  - Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit (Nr.03/L-164/2010);
  - Ligji për Shitjen e Banesave për të cilat Ekzistojnë e Drejta Banesore (Nr.04/L-061/2011);
  - Ligji për Shfrytëzimin, Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Banesave në bashkëpronësi (Nr.03/L-091/2009);

- Komisionet për zbatim, monitorim dhe raportim (Komisioni A: Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore; Komisioni B: Qëndrueshmëria ambientale; Komisioni C: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore; Komisioni D: Vitaliteti ekonomik; Komisioni E: Integriteti hapësinor) do të themelohen në pajtim me parimet, qëllimet dhe prioritetet fondamentale të definuar në kontekstin e PZHKP 2025 në kuadër të organizimit institucional të Komunës (Figura 4.2).
  - Organizimi institucional
    - Administrata e Përgjithshme dhe Bashkësitë Lokale
    - Drejtoria e Inspektoratit

- Arsimi dhe Shkenca
- Financat dhe Ekonomia
- Shërbimet publike
- Urbanizmi dhe Planifikimi Hapësinor
- Gjeodezia dhe Kadastra
- Emergjenca dhe Siguria
- Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
- Shëndetësia dhe Zhvillimi Social
- Kultura, Rinia dhe Sporti
- Avokati Publik
- Zyra e Komuniteteve
- Turizmi dhe Zhvillimi Ekonomik

- Komisionet për Zbatim, Monitorim dhe Raportim të PZHKP 2025
  - Komisioni A: Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
  - Komisioni B: Qëndrueshmëria ambientale
  - Komisioni C: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore
  - Komisioni D: Vitaliteti ekonomik
  - Komisioni E: Integriteti hapësinor



- Planet dhe programet vepruese të propozuara në kontekstin e PZHKP 2025 do të zbatohen, menaxhohen dhe monitorohen nga komisionet për zbatim, monitorim dhe raportim të cilat do të dorëzojnë raportet vlerësuese njësive relevante Komunale.

- Komisionet për zbatim, monitorim dhe raportim do të bëjnë parëzimin e veprimeve të PZHKP 2025 të definuar si synime afat shkurtra, afatmesme dhe afatgjata. (Figura 4.3).

- Për të siguruar realizimin e çdo projekti në mënyrë ideale, do të monitorohen proceset fizike dhe financiare, si dhe performancat dhe problemet e procesit pas implementimit. Monitorimi do të kryhet nga ekspertët e komisioneve në intervalet e rregullta. Raportet e monitorimit do t'i dorëzohen kryetarit dhe do të publikohen online në faqen zyrtare të komunës.

- Do të përcaktohet vlerësimi i ndikimit të secilit veprim dhe raportet do t'i dorëzohen komisioneve për zbatim, monitorim dhe raportim në fund të procesit të zbatimit.




**Figura 4.2:** Korniza institucionale për zbatimin e PZHKP 2025




**Harta 4.1:** Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit




**Harta 4.2:** Planet e Veprimit dhe Lokacionet e Propozuara në Planin Zhvillimor Komunal




**Figura 4.3:** Kohëzgjatja e PZHKP 2025

# 5. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Kjo pjesë e plotëson fazën përfundimtare të PZHKP 2025 përmes përcaktimit të dispozitave zbatuese. Duke siguruar një urë lidhëse në mes të gjendjes ekzistuese dhe kornizës hapësinore, ajo përcakton perspektivën zbatuese për komunën së Prizrenit duke përfshirë këtu:

- Udhëzimet mbi çështjet e interpretimit të planit zhvillimor komunal gjate përpilimit te planeve rregulluese dhe planeve tjera,
- Kushtet e përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin e Komunës së Prizrenit,
- Dispozitat lidhur me bashkëpunimin;
- Dispozitat lidhur me rendin kronologjik të fazave të zbatimit;
- Elementet dhe udhëzimet për kërkimin e mëtutjeshëm.

## 5.1. UDHËZIMET MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL GJATE PËRPILIMIT TE PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TJERA.

5.1.1. PZHKP 2025 është kompletuar me planet e saja, dispozitat e zbatimit të planit dhe raporti i planit.

5.1.2. PZHKP 2025 është plan multi-sektorial që përcakton synimet afatgjata ekonomike, sociale, te zhvillimit hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e pjesëve rurale dhe urbane të Komunës së Prizrenit. 

5.1.3. Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës (S/2007/168/ADD.1), Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020$^{+}$,(Ligji për Planifikim Hapësinor, Nr. 2003/14; Ligji (Nr.03/L-106/2008) për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr. 2003/14), Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi Elementet Kryesore të Planit Zhvillimor të Komunës (Nr.rend.33, Nr.Pro. 29/03 /2003) janë baza e PZHKP 2025.

5.1.4. PZHKP 2025 mbulon një periudhë kohore prej 15 vitesh.

5.1.5. PZHKP 2025 vlen për tërë komunën e Prizrenit dhe përfshin 63,780.67 ha. Edhe pse Komuna e Mamushës ka qenë i përfshirë në tre seksione të parë të PZHKP në mënyrë që të sigurojë vlerësimin rajonal në kontekst më të gjerë, planifikimi i vendimeve dhe dispozitave në PZHKP 2025 nuk përmbahet Komuna e Mamushës.

5.1.6. PZHKP 2025 përmban profilin e zhvillimit hapësinor dhe analizën e situatës; vizionin, parimet dhe qëllimet; kornizën e zhvillimit hapësinor; strategjitë zbatuese dhe veprimet dhe dispozitat e implementimit.

5.1.7. PZHKP 2025 paraqet bazën e Planit Zhvillimor Urban për qytetin e Prizrenit dhe planet rregullative urbane të fshatrave qendrore (E112).

5.1.8. Plani Zhvillimor Urban (Ligji mbi planifikimin hapësinor, neni 14) do të përcaktojë projeksionet afatgjate të zonave urbane; ndërsa Planet Rregulluese Urbane (Ligji mbi Planifikimin Hapësinor, neni 15) do të përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirës.

## 5.2. KUSHTET E PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJET E RËNDËSISHME LIDHUR ME SHFRYTËZIMIN E TOKËS DHE ZHVILLIMIN E KOMUNËS SË PRIZRENIT.

5.2.0. Kushtet e përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështjet lidhur me shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin e Komunës së Prizrenit përfshijnë kushtet për përcaktimin e destinimit të zonave në territorin e komunës; rregullimin hapësinor; themelimi i aktiviteteve publike dhe ekonomike; përcaktimin e korridoreve dhe shtigjeve; zonat e komunikimit dhe sistemet tjera infrastrukturore; masat për rruajtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe entiteteve kulturore dhe historike; parandalimin e ndikimeve të dëmshme mjedisore; parandalimin e ndikimeve negative sociale dhe së fundit masat për zbatimin e PZHKP 2025.

### 5.2.1. Kushtet për përcaktimin e destinimit të zonave në territorin e komunës

5.2.1.1. Në planet me shkallë 1/50.000, janë dhënë në mënyrë sistematike kufijtë e zonave të ndryshme dhe zonave të banimit të shfrytëzimit të tokës. Është joadekuate për të marrë matje (masa) në lidhje me planin për përcaktimin e vendeve (lokacioneve) për zbatim. Shpërndarja dhe vendimet mbi densitetin, kufijtë dhe detajet e funksioneve, në vend të funksionit kryesor dhënë në plan, do të përcaktohet në planet e shkallës më të ulët.



5.2.1.2. Është thelbësore për vendimet rreth funksioneve (turizmi, pajisjet, transporti, përzgjedhja e lokacionit industrial, logjistika etj.), që janë paraqitur si simbole në PZHK 2025 apo nuk janë paraqitur për shkak të shkallës së PZHKP 2025, të bëhet nga institucionet përkatëse ose duke respektuar opinionet e tyre përmes hulumtimeve shkencore dhe studimet sektoriale mbi çështjet mjedisore që mund të ndikojnë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë urbanizimit.

5.2.1.3. Është esenciale për zonat e projekteve të veçanta, të cilat do të përcaktohen me planet detaje të Prizrenit të shkallës së ulët të planifikimit, e cila është me rëndësi për përpilimin e projekteve që mundësojnë zbatimin e parimeve të dizajnit urban dhe zgjidhjeve origjinale arkitektonike. Në këto zona, kushtet për ndërtimin në aspektin e funksionit dhe densitetit do të përcaktohen në përputhje me parimet të dizajnit urban të integruar me vendimet e planifikimit të shkallës së lartë.

5.2.1.4. Vendimet rreth kontrollit të zhvillimit dhe densitetit të zonave urbane dhe rurale, të cilat krijojnë apo mund të paraqesin kërcënim për sistemet e mirëmbajtjes së jetës, përveç ruajtjes së zonave natyrore dhe kulturore do të përcaktohen me planet detaje të shkallës së ulët të planifikimit në pajtim me parimet e qëndrueshmërisë ambientale dhe kulturore.

**5.2.2. Kushtet e rregullimit hapësinor**

5.2.2.1. Është thelbësore vendimi për vlerat e evidentuara historike dhe kulturore si dhe zonat tjera urbane, natyrore, arkeologjike, historike, zonat mikse, zonat e mbrojtura dhe grupet e ndërtesave për Prizren do të përpilohet në pajtim me rekomandimet e Planit për Zhvillimin dhe Konservimin e Zonës Historike të Qytetit të Prizrenit.

5.2.2.2. **Në zonat e ekzistuese të vendbanimeve**, mund të parashihen objekte të cilat i shërbejnë zonave të vendbanimeve si: objektet komerciale, sociale, kulturore, objekte të infrastrukturës teknike dhe objekte të vogla të prodhimtarisë (i.e. artizanate tradicionale). Projektet e rehabilitimit, renovimit apo të tjetërsimit mund të zbatohen në zonat të cilat janë identifikuar si zona jo të shëndosha nga institucionet relevante me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës duke marrë parasysh statusin ligjor, gjendjen ekzistuese urbane, gjendja e stokut të ndërtimit, analiza të hollësishme gjeologjike, cilësia dhe sasia e shfrytëzueshmërisë dhe struktura socio-ekonomike e banorëve. Vendimet rreth projeksionit të popullsisë dhe shpërndarjes së densitetit do të përcaktohen me planet të shkallës së ulët të planeve të detajizuar duke marrë në konsideratë dhe siguruar opinionet e organizatave dhe institucioneve relevante.



5.2.2.3. **Në zonat për zhvillimin e vendbanimeve,** shpërndarja e densitetit dhe parashikimi i popullatës do të përcaktohet në pajtim me parimet e politikave urbane me planet detaje të shkallës së ulët duke marrë parasysh opinionin e institucioneve dhe organizatave relevante. Në këto zona, funksionet industriale dhe ato të deponimit, përpos objekteve komerciale, sociale, kulturore dhe objekteve teknike infrastrukturore dhe objekte të vogla të prodhimtarisë (i.e. artizanate tradicionale) të cilat i shërbejnë zonave të banimit, nuk janë të lejuara në këto zona.

5.2.2.4. Sa i përket **vendbanimeve bujqësore dhe pyjore në statusin e zonave të vendbanimeve rurale,** do të përmirësohet cilësia e jetës, duke ruajtur qëndrueshmërinë e vlerave ekonomike, sociale, vlerave kulturore dhe natyrore. Ku do të ruhet qëndrueshmëria e vendbanimeve rurale duke mbuluar (përfshirë) edhe fshatrat e mëparshëm të cilat kanë arritur kohëve të fundit statusin administrativ të 'lagjes'. Në këto zona, vendimet në lidhje me rritjen e popullsisë, strukturën sociale dhe fizike si dhe nevoja për vendbanime të reja do të vlerësohen në kuadër të planeve detaje të shkallës së ulët të planifikimit.

5.2.2.5. Në zonat **jashtë zonave ekzistuese të vendbanimeve**, është me rëndësi të analizohet përshtatshmëria e karakterit ambiental dhe karakteri unik arkitektonik i densitetit të ultë. Në këto zona, kushtet e ndërtimit do të përcaktohen në pajtim me integritetin e sistemit transportues si dhe vendimeve të planifikimit të shkallës së lartë në kuadër të kornizës për harmonizim me kusht të përcaktimit të parimeve të dizajnit urban që është me rëndësi të posaçme.

**5.2.3. Kushtet për vendosjen e aktiviteteve ekonomike**

**5.2.3. Qendra Tradicionale:** Shfrytëzimi i përzier i zonës urbane të Qendrës Historike të Prizrenit e formuar gjatë zhvillimit historik të Prizrenit dhe rrethina e saj që karakterizohet me tregtinë, shërbime dhe objekte turistike, objektet shoqërore për shfrytëzim të aktiviteteve kulturore–artistike dhe rekreative (i.e. teatro, kinema, objekti i operës, salla të konferencave dhe salla për panaire, muze, parqe etj.) do të avancohet në aspektin e industrisë kulturore dhe përdorimit si zonë për banim në mënyrë që të ofrojë 24 h një qendër të gjallë. Shfrytëzimi i përzier i propozuar duhet të marrë parasysh identitetin natyror, kulturor, historik dhe strukturën ekzistuese urbane. Objektet e shërbimeve të nivelit të lartë, mundë të marrin pjesë në qendrën tradicionale të Prizrenit në përputhje me parimin e diversitetit funksional, me kusht që funksioni i vendbanimeve nuk është nën kërcënim, dhe funksionet e propozuara janë në përputhje me strukturën ekzistuese urbane. 

5.2.3.2. **Nën-Qendrat:** Lidhur me strategjinë policentrike të zhvillimit hapësinor i propozuar nga PZHKP 2025, nën qendrat (Gjonaj, Hoqa e Qytetit, Mushnikova, Pirana, Reçanë, Romaja, Velezha, Zhur, Korisha); ku niveli aktual hierarkik i të cilave do të përcaktohet në planet e shkallës së ulët, këto qendra janë propozuar për të reduktuar presionin në strukturat ekzistuese urbane ku parashihet decentralizimi i popullatës, zhvillimi i tregtisë, objekte shërbyese dhe publike (shoqërore) me qëllim për t'iu përgjigjur nevojave të banorëve të këtyre zonave nën presion.

5.2.3.3. **Zonat Industriale:** Zonat industriale janë, zonat ekzistuese industriale të cilat përfshijnë teknologjinë e avancuar, dhe ato zona industriale që planifikohen të riorganizohen me teknologji të lartë të avancuar. Objektet e prodhimit, lloji i të cilave do të përcaktohet në bazë të ligjeve dhe rregulloreve, mund të zhvillohen në këto zona me kusht që mbetjet industriale e tyre nuk krijon kërcënim për shëndetin publik dhe të mjedisit. Në zonat industriale të cilat janë propozuar për grupet (klasterët) sektoriale (d.m.th. në aksin rrugor Prizren-Zhur), mund të zhvillohen zonat e vogla industriale dhe objektet e logjistikës siç janë parkingjet për kamionë transportues; objekte të depos me kusht që ato janë të përshtatshme për grupet sektoriale.

5.2.3.4. **Zona e Industrisë së Lehtë dhe Agro-Industrisë:** Zonat e industrisë së lehtë dhe e Agro-Industrisë që ndodhen në zonat ekzistuese rezidenciale (Prizren dhe Lubizhdë), të cilat duhet të jenë të vendosur në brendi të qytetit gjegjësisht në zonat ekzistuese industriale, do të ri-përshtaten si prodhues të vegjël në pajtim me legjislacionin përkatës që rregullon çështjen e zonave të industrisë së lehtë me kusht që ato të shërbejnë për banorët, ku mbeturinat industriale nuk paraqesin kërcënim për shëndetin publik dhe të mjedisit.

**5.2.3.5. Edukimi, Parku i Teknologjisë dhe Informacionit (Parku i Biznesit):** Në këtë zonë parashihen objektet për prodhimin dhe përdorimin e teknologjisë informative, komunikimit dhe të teknologjisë së avancuar, tekno parqet, universitetet dhe institucionet e teknologjisë së avancuar. Njësitë për hulumtim dhe zhvillim mund të zhvillohen në fusha të përcaktuara si, Parku i Arsimit, i Teknologjisë Informative (Parku i Biznesit). Në këto zona janë të paraparë të zhvillohen edhe objekte të hapura kulturore, sipërfaqe gjelbëruese rekreative dhe objekte sporti, duke marrë në konsideratë korridorin ekologjik të vendbanimit me kusht që këto zhvillime nuk e bllokojnë qarkullimin e ajrit. Në këto zona nuk lejohen aktivitetet e prodhimtarisë masive dhe fleksibile, përveç objekteve për zhvillimin e teknologjisë së avancuar dhe hulumtues.

5.2.3.6. **Zona e Zhvillimit e Teknologjisë Bujqësore:** Zonat, nga të cilat cilësia bujqësore do të rritet dhe përmirësohet, do të shfrytëzohet për hulumtime dhe zhvillime bujqësore si dhe për edukim të fermerëve, eksperimente dhe praktika në lidhje me zhvillimet në sektorin e bujqësisë, metoda praktike dhe përzgjedhje të përshtatshme të produktit. Institucionet me teknologji të avancuar për prodhimin e produkteve bujqësore, qendrat për zhvillim dhe hulumtim dhe departamenteve Universitare të bujqësisë dhe botanikës mund të zhvillohen në zonat e zhvillimit të teknologjisë së prodhimit bujqësor. Prodhimi industrial nuk është i lejuar në këto zona. Ndërtimet e reja me proporcion të ndërtimit të ulët mund të propozohen në zonat të cilat nuk pengojnë integritetin e tokës bujqësore. Zonat, jashtë zonave të banuara do të shfrytëzohen për bujqësi.



5.2.3.7. **Zonat e Turizmit Kulturor**: Objektet që shërbejnë sektorit të turizmit duke përfshirë ushqim dhe pije, argëtim, aktivitete kulturore, njësi tregtare, objekte të prodhimit të shkallës së ulët për turizëm, funksionet tregtare dhe shërbyese, si artizanatet dhe industria kulturore mund të marrin pjesë në zonat e turizmit kulturor (Qendra Historike e Qytetit të Prizrenit), në të cilën ekziston dendësia e pasurive historike dhe kulturore të cilat kanë një potencial të lartë turistik, me kusht që ato janë në harmoni me strukturën urbane dhe rurale. Është esenciale për objektet turistike, të cilat i përgjigjen kërkesave në rritje të akomodimit si rrjedhojë e turizmit kulturor, që do të planifikohen në shkallën e ulët të planeve në përputhshmëri me legjislacionin përkatës.

5.2.3.8. **Zonat Natyrore Turistike:** Zonat turistike të cilat tentojnë të ruajnë, përmirësojnë dhe zhvillojnë vlerat natyrore të Prizrenit janë (Lugina e Zhupës dhe Malet e Sharrit). Këtu parashihet konservimi dhe përdorim i balancuar i burimeve natyrore në pajtim me strukturën ekologjike dhe të integruar me ambientin rrethues për qëllime të argëtimit dhe rekreacionit. Sipas planit (Mushnikova, Struzha, Manastrica, Lubinja e Epërme, Lubinja e Poshtme dhe Skorobishti) kanë potencial për turizëm natyror, kampim dhe sporte fushore, prandaj planet detaje mund të inkuadrojnë qendrat e skijimit, hotelet, motelet, zonat për kamping, kampet për vëzhguesit, objektet sportive, restorantet, objektet socio kulturore, parqet, zonat për rekreacion dhe parqet shëndetësore.

5.2.3.9. **Zonat e Agro Turizmit:** Në këto zona (regjioni i Anadrinit), mund të parashihen objektet e turizmit ekologjik dhe atij bujqësor si dhe objektet përcjellëse. Në vendbanimet rurale parashihet prodhimtaria për agro turizmin, objektet hoteliere që marrin parasysh vlerat ambientale dhe cilësitë arkitektonike, kryesisht duke përdorur strukturat ekzistuese.

**5.2.3.10. Zonat e Rekreacionit Ditor:** Zonat ditore të rekreacionit janë zonat e hapura me gjelbërim në qytet dhe rrethinën e tij të cilat mund të përdoren çdo ditë. Planet e Komunës së Prizrenit do të përfshijnë edhe zonat ku ka përfunduar eksploatimi i minierave dhe zhavorrit si zona të rekreacionit ditor në pajtim me aktivitetet restauruese dhe në konsultim me organizatat relevante dhe Komunën e Prizrenit.



### 5.2.4. Kushtet për themelimin e aktiviteteve publike

5.2.4.1. **Zona e Universitetit:** Janë zonat e edukimit të lartë të projektuar si kampuse për të nxitur hulumtime dha për të prodhuar informacione. Në këto zona Universitare parashihen të marrin pjesë mësimdhëniet dhe objektet të edukimit universitar dhe institucionet tjera të arsimit të lartë, institutet, r&d dhe qendra të zhvillimit të teknologjisë, njësitë mbështetëse të edukimit të lartë (d.m.th. Bibliotekat, qendrat konvenciale (kongrese, simpoziume etj.), konviktet, banesat, sipërfaqe të hapura gjelbëruese, etj.). Duke pasur parasysh vizionin dhe parimet e PZHKP 2025; është esenciale për zonat universitare të kenë një rol udhëheqës në sektorët mbështetës (kultura, turizmi, financa, shërbime të larta, teknologji e avancuar, moda etj.) që kanë ose mund të ketë avantazh konkurrues ndërkombëtar, dhe në bërjen e marrëveshjeve për të siguruar kalimin në ekonominë dhe të shoqërinë informative. Vendimet lidhur me zonat ekzistuese universitare dhe hapësirave të ardhshme universitare janë të obliguar të jepen në planet e shkallës së ulët me aprovim të Komunës së Prizrenit dhe institucioneve relevante.

5.2.4.2. **Zonat e Objekteve Urbane dhe Regjionale:** Janë zonat ku mund të marrin pjesë objektet e të gjitha llojeve sociale (shkollat fillore, shkollat e mesme, universiteti dhe objektet tjera arsimore, pastaj objektet shëndetësore, sociale, kulturore etj.) dhe objektet teknike nën shërbimin e qyteteve të banuara të strukturës urbane dhe zonave të reja të zhvilluara. Gjatë përzgjedhjes të lokacioneve të këtyre zonave të objekteve urbane dhe regjionale duhet të merret në konsideratë vendosja e objekteve me cilësi të lartë të cilat e reduktojnë presionin ndaj strukturës ekzistuese urbane dhe për t'iu përgjigjur nevojave të banorëve të këtyre zonave nën presionin me decentralizim të popullatës kryesisht në nën-qendrat (Gjonaj, Hoqa e Qytetit, Mushnikova, Pirana, Reçani, Romaja, Velezha, Zhur, Korisha), niveli aktual hierarkik i cili do të përcaktohet në planet e shkallës së ulët, bazuar në strategjinë policentrike të zhvillimit hapësinor, e propozuar nga PZHKP 2025. Duke marrë në konsideratë objektet shoqërore në vendbanimet rurale, PZHKP 2025 propozon ngritjen e objekteve primare arsimore në çdo fshat. Shkollat e mesme, të cilat mund të jenë specializuara me aktivitetet prodhuese lokale në rrethinat e afërta të fshatrave qendrore mund të themelohen në formë të shkollave të mesme teknike (sikurse shkolla e mesme teknike e bazuar në bujqësi në regjionin e Anadrinit, shkolla e mesme teknike e bazuar në turizëm në regjionin e Prizrenit dhe Zhupës si dhe shkolla e mesme teknike e bazuar në industri në qendër të Prizrenit).



5.2.4.3. **Zonat e Hapura Urbane dhe Regjionale:** janë zonat e gjelbra aktive dhe pasive si dhe terrenet sportive, në shërbim të Prizrenit si tërësi, e dizajnuar për tu shfrytëzuar nga të gjithë qytetarët për argëtim, rekreacion dhe kohë të lirë. Në këto zona mund të marrin pjesë, si parqet, kopshtet zoologjike, fushat sportive, varrezat, fushat e rekreacionit dhe parqet rajonale, të cilat do të dizajnohen për të siguruar një vend takimi në fatkeqësitë e mundshme potenciale dhe situata kritike. Objektet sikur, për panaire, konvenciale dhe qendra për ekspozitë, akuaparqet dhe objekte të akomodimit të cilat shërbejnë për shëndetin dhe turizmin sportiv mund të zhvillohen në këto zona duke siguruar se ato do të përdoren në përmbushjen e nevojave të banorëve dhe vizitorëve. Në zonat e dizajnuara për panairet dhe festivalet, do të përcaktohen me planet e shkallës së ulët të planifikimit, duke përfshirë funksionet e panaireve, objekteve konvencionale dhe mbështetjen e objekteve administrative, objekteve sociale dhe infrastrukturës teknike, hapësirat e hapura dhe të gjelbra, objektet akomoduese dhe funksionet komerciale siç janë njësitë shitëse, të gjitha këto në pajtim me planet detaje. Në hapësirat tjera të hapura me rëndësi natyrore, historike dhe kulturore, është thelbësore për organizimin e ngjarjeve festive të zhvilluara në bashkëpunim me organizata dhe institucionet përkatëse.

5.2.4.4. **Parku Nacional Mali Sharr:** është një zonë e njohur ku është ruajtur biodiversiteti dhe resurset biologjike janë shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme. Është e rëndësisë së veçantë për të siguruar mbrojtjen e diversitetit gjeologjik dhe gjeomorfologjik të regjionit dhe diversitetit biologjik, duke përfshirë këtu edhe burimet e pasura të ujit dhe specieve endemike të regjionit. Zonat për rekreacion në Parkun nacional Malet e Sharrit do të përcaktohen në planet detaje të shkallës së ulët të planifikimit duke marrë në konsideratë opinionet e organizatave dhe institucioneve relevante duke u bazuar strategjive të Planit Hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr". .

5.2.4.5. **Zonat Ekzistuese Ushtarake dhe Zonat e Sigurimit ushtarak:** Kufijtë e Zonave të ndaluara ushtarake janë të caktuara në plan në mënyrë skematike dhe nuk janë nocione statutare. Me përcaktimin e ridestinimit (rivendosjes) të objekteve në zonat ushtarake nga ana e Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës, këto zona kryesisht do të shfrytëzoheshin si zona sociale dhe zona për infrastrukturë teknike. Me procesin e përfundimit të qëndrimit të shërbimeve ushtarake të KFOR-it, zonat ushtarake dhe zonat e sigurisë do të rigjenerohen sipas përdorimit të përshtatshëm të tokës si, zonë e zhvillimit të ri të vendbanimeve në zonën e KFOR-it Gjerman në afërsi të rrugës transitore të qytetit të Prizrenit, zona e kampit universitar në zonën e KFOR-it Gjerman në afërsi të aksit rrugor Prizren-Prishtinë si dhe në zonën e KFOR-it Turk në afërsi të zonës industriale në brendi të qytetit të Prizrenit.



**5.2.5. Kushtet për ndërtimin e korridoreve dhe shtigjeve, zonave të komunikimit dhe sistemeve tjera të infrastrukturës.**

5.2.5.1. Projektet afatgjate për transportin e shkallës së lartë janë definuar në PZHKP 2025 në nivelin e strategjive, në pajtim me vizionet e planit, qëllimet, objektivat dhe parimet qëndrueshmërisë. Projektet e transportit që nuk figurojnë në Plan për shkak të shkallës së tyre, do të vlerësohen me studimet planifikuese të shkallës së ultë në pajtim me parimet e PZHKP 2025.

5.2.5.2. **Autostrada dhe Autostrada e Shpejtë:** Autostrada është rruga me kontroll të plotë apo gjysmë të plotë të qasjes që i shërben Prizrenit dhe Kosovës në tërësi.

5.2.5.3. **Rrugët Primare dhe Sekondare:** Rrugët primare dhe ato sekondare bëjnë qasjen e kontrolluar në mes të pikave hyrëse të autostradës.

5.2.5.4. **Stacioni Qendror dhe ato Sekondare:** Planet e shkallës së ultë do të përcaktojnë lokacionin e saktë të stacionit qendror dhe atyre sekondare si dhe lidhjen e tyre me rrugët kryesore.

5.2.5.5. **Sistemi i Transportit Hekurudhor:** përfshin sistemin ndërurban dhe format tjera të sistemit hekurudhor (metro, tramvaji, sistemi i lehtë hekurudhor,etj) e cila shërben për

transportin e pasagjerëve dhe mallrave. Lidhja e propozuar me rrugë hekurudhore me Shqipërinë do të krijohet, dhe sistemi hekurudhor do të lidhet me sistemin ndërkombëtar hekurudhor.

5.2.5.6. **Zonat e Logjistikës:** Këto janë zona të rezervuara për objektet logjistike siç janë doganat, magazinat dhe depot, objektet për transferin e ngarkesave, hallat, zonat deponuese për caktimin e barkodeve, paketimin, sigurimi, parqet e kamionëve transportues, objektet për trajtimin e plehrave, agjencitë përcjellëse logjistike dhe pajisjet sociale. Objektet për trajtimin e mbeturinave reversibile që janë të rrezikshme për ambientin mund të parashihen në zonat logjistike vetëm pasi që institucionet relevante të japin mendimin e tyre. Objektet industriale nuk mund të vendosen në zonat logjistike.

5.2.5.7. **Zona për Shërbime Doganore:** Shërbimet e zonave doganore duke përfshirë shërbimet mbështetëse; logjistikë, magazinim dhe ruajtje, do të themelohet me respekt në afërsi të vendndodhjes të stacionit hekurudhor dhe stacionit qendror të autobusëve.

5.2.5.8. **Infrastruktura Energjetike:** Stabilimentet prodhuese për burimet e ripërtërishme të energjisë (era, dielli etj) mund të ndërtohen në pajtim me ndikimin e tyre ambiental nëse institucionet përgjegjëse japin leje. Ndërtimi i hidrocentralit të Zhurit është pranuar si një nga inputet e PZHKP 2025.



5.2.5.9. **Rrjeti i Komunikimit:** Rrjeti I komunikimit do të zgjerohet në fshatrat që aktualisht nuk kanë rrjet.

5.2.5.10. **Sistemi i Vaditjes:** Sistemi aktual i vaditjes do të rehabilitohet dhe do të zgjerohet për të mbuluar zonat bujqësore.

**5.2.6. Masat për ruajtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësitë kulturo-historike**

5.2.6.1. Është esenciale për **korridoret ekologjike** të lumenjve Drini i Bardhë, Lumëbardhi dhe Toplluha, pastaj pellgjet e lumenjve të Zhupës dhe Parkut Nacional Malet e Sharrit, të mirëmbajnë karakteristikat e tyre natyrore dhe rurale, lëvizshmërinë e shtazëve të egra dhe qarkullimin e ajrit. Densiteti i ndërtesave urbane do te përcaktohet me plane të shkallës së ultë dhe ky densitet do të jetë i vogël në zona ku korridoret ekologjike hapen ndaj zonave urbane.

5.2.6.2. Është me rëndësi që autoritetet përgjegjëse të marrin masa për parandalimin e ndotjes dhe rritjes së kapacitetit për përdorim të sërishëm të **burimeve nëntokësore të ujit** dhe zonat e konservuara të burimeve nëntokësore të ujit.

5.2.6.3. Lejet për menaxhimin e **Objekteve të minierave dhe eksploatimin e gurit dhe zhavorrit:** licenca për operim do të bazohet në ligjet dhe rregulloret ekzistuese si dhe aprovimin e autoriteteve relevante të cilat do të ofrojnë kontrollin e këtyre zonave (ose njësitë

e Komunës së Prizrenit), natyrisht në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Zonat e eksploatimit jashtë pyjeve të cilat më nuk përdoren, do të rehabilitohen dhe do të përdoren si zona të deponimit në pajtim me ligjet në fuqi dhe dispozitat e PZHKP 2025. Eksploatimi i zhavorrit, guroreve dhe aktivitetet e minierave mund të zhvillohen në zonat e përshtatshme në lidhje me rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Është me rëndësi që eksploatuesit e gurit dhe të zhavorrit të përdorin teknika për gërmim dhe hulumtim që pakëson dëmtimin e zonave të afërta të banuar dhe zonat natyrore, në krahasim me teknikat që përdorin me eksplodimin e dinamitit.

5.2.6.4. Në lidhje me **përdorimin e brigjeve të liqenit dhe lumit** dhe brigjeve përreth tyre, është me rëndësi të ruhen karakteristikat ekologjike të lumenjve dhe liqeneve si dhe brigjeve duke pasur parasysh përfitimin publik. Zona e mbrojtur e burimeve të ujit do të definohet në planet e shkallës së ultë në pajtim me hulumtimet shkencore të drejtuara nga institucionet relevante.

5.2.6.5. Objektet për pushim mund të ndërtohen në **zonat e konservimit natyror**, të cilat mund të përdoren për turizmin ditor, rekreacion, pushim, argëtim, festivale, etj. Në përputhshmëri me opinionet dhe hulumtimet shkencore të institucioneve relevante. Planet e shkallës së ultë do të caktojnë lokacionin, madhësinë dhe kushtet e ndërtimit.

5.2.6.6. **Zonat Pyjore:** Zonat pyjore janë zona të mbrojtura të rregulluara me ligjet në fuqi që përdoren për të mirën e popullatës dhe ku mund të ndërtohen objektet për turizëm. Objektet për rekreacion ditor mund të parashihen në këto zona me kusht që mos të kërcënojnë ekosistemin pyjor dhe duke mirëmbajtur diversitetin e florës dhe faunës. Zonat pyjore me rëndësi të posaçme mund të përdoren vetëm për qëllime shkencore. Zonat pyjore në PZHKP 2025 janë skematike; kufijtë e zonave pyjore do të marrin statusin e vetë ligjor vetëm pasi që institucionet relevante të përfundojnë me studimet e kufijve detaje të zonave pyjore dhe do të jenë qartë të theksuara në planet e shkallës së ultë në pajtim me mendimin e institucioneve relevante. Zonat e cekura në PZHKP 2025 për shkak të statusit të paqartë kadastral, do të vlerësohen në pajtim me ligjet në fuqi pas aplikimit të regjistrit të pyjeve. Prerja e drunjve mund të bëhet me aprovimin dhe nën kontrollin e institucioneve relevante.



5.2.6.7. **Zonat e Pyllëzimit për Integrimin Ekologjik të Pyjeve:** Ruajtja e drunjve aktual si dhe pyllëzimi i zonave të zbrazëta në pajtim me karakteristikat klimatike të regjionit ka rëndësi të madhe. Ngastrat private në zonat e parapara për pyllëzim do të përdoren për objektet siç janë ato për rekreacion ditor, kamping, serat etj. derisa të përfundojnë procedurat e ekspropriijimit.

5.2.6.8. **Zonat ku duhet Ruajtur Karakteri Bujqësor:** Këtu hyjnë zonat bujqësore të cekura në PZHKP 2025 kufijtë e të cilëve do të përcaktohen nga institucionet relevante. Në këto

zona inkurajohet themelimi i ndërtimeve ekologjike bujqësore. Është me rëndësi që institucionet relevante të bëjnë studimet e hollësishme për rritjen e llojllojshmërisë së produkteve në zonat tradicionale bujqësore ku prodhimi ekologjik është i papërshtatshëm. Në pajtim me planet për përdorimin e tokës bujqësore si dhe pas aprovimit dhe nën kontrollin e institucioneve relevante, do të sigurohen objektet e bazuara në bujqësi. Për ngritjen e efiçiencës bujqësore në zonat ku duhet ruajtur karakteri bujqësor, është me rëndësi që të ofrohen shërbimet për zhvillimin e brendshëm të fushës (kanalizimi, ujësjellësi, rrjeti rrugor etj). Kushtet lidhur me ndërtimin e strukturave bujqësore do të identifikohen me planet e shfrytëzimit të tokës bujqësore në përputhje me opinionet e institucioneve përkatëse duke pasur parasysh karakteristikat hidrogjeologjike, gjeologjike, dhe ekosistemet e rrezikuara etj. Deri në përgatitjen, aprovimin dhe zbatimin e planeve për përdorimin e tokave bujqësore, maksimumi i mbulueshmërisë së strukturave bujqësore të definuar në rregulloret përkatëse është 0.05 për 10.000 m2 sipërfaqe dhe 0.02 për sipërfaqet mbi 10.000 m2 pas aprovimit prej autoriteteve përkatëse. Ndërtimi do të monitorohet nga institucionet përkatëse. Mbulimi i ndërtimit në zonat ku karakteri bujqësorë duhet të ruhet është 0.02, pa i përfshi sipërfaqet e ngastrave në kushtet e nëndarë. Zonat bujqësore në PZHKP 2025 janë skematike; kufijtë e këtyre zonave do të marrin statusin e vetë ligjor vetëm pasi që institucionet relevante të përfundojnë me studimet e kufijve detaje të zonave bujqësore dhe do të jenë qartë të theksuara në planet e shkallës së ultë në pajtim me mendimin e institucioneve relevante.



5.2.6.9. **Zonat për Ruajtjen e Karakterit Natyror dhe Rural:** Në këto zona mund të marrin pjesë aktivitetet bujqësore dhe strukturimi rural siç janë vreshtat dhe objektet e fermave, kopshtet për hobi për  të cilat kushtet ndërtimore do të përcaktohen në planet e shkallës së ultë, ku mund të marrin pjesë në rajonet ku karakteri natyror dhe rural do të mbrohet. Ndërtesat e reja mund të ndërtohen vetëm pas aprovimit dhe nën kontroll të autoriteteve gjegjëse me kusht që ngastra është minimum 5000 m2 me një shkallë të mbulueshmërisë së ndërtesës prej 0.02.

5.2.6.10. **Zonat e Mbrojtura të Rezervave të Ujit:** Këto janë zonat brenda kufijve të Komunës duke përfshirë rezervat e ujit dhe zonat për mbrojtjen e lumenjve, të cilat shërbejnë për furnizimin e nevojave të Prizrenit për ujë të pijshëm dhe shfrytëzim. Dispozitat planifikuese që nuk janë përmendur në PZHKP 2025, përcaktohen në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Basenet e ujërave që definohen si zona absolute e mbrojtjes së lumenjve përmbajnë burimet e ujit të freskët dhe rezervuarët përcjellëse. Përdorimi i tokës në këto zona do të definohet në planet e shkallës së ultë në pajtim me kushtet për grumbullimin dhe kontrollin e burimeve të ujit të freskët.

5.2.6.11. **Zonat e Mbrojtura të Burimeve të Ujërave Nëntokësore:** Në zonat e mbrojtura të ujërave nëntokësore, është me rëndësi substanciale të mos të dëmtohet aftësia e

ujëmbledhës dhe kullimit. Në rezervuarët ekzistuese nëntokësore të ujit, është me rrëndësi thelbësore përcaktimi i rrezikshmërisë së shfrytëzimit të tokës në lidhje me e qarkullimin e ujit me analizat të detajuara, dhe të përpilojnë vendimet për, shembjen e objekteve dhe më pastaj të revitalizimit të duhur në zonat urbane që janë mbi burimet e ujërave nëntokësore në bazë të analizave.

5.2.6.12. **Zonat e Papërshtatshme Gjeologjike për Vendbanime:** Kufijtë dhe vendimet për shfrytëzimin e tokës së papërshtatshme gjeologjike për vendbanime do të sqarohen në planet e shkallës së ultë në bazë të këndvështrimeve dhe mendimeve të autoriteteve dhe organizatave përgjegjëse. Për ndërtimet e detyrueshme dhe ekzistuese, rehabilitimet apo përforcimet e tokës janë të detyrueshëm.

5.2.6.13. **Zonat Kulturore, Natyrore dhe Zonat e Mbrojtura:** Udhëzimet e konservimit të vlerave të regjistruara urbane dhe historike siç janë zonat urbane, natyrore, historike dhe zonat e mbrojtura mikes, grupet e ndërtesave, ndërtesat historike dhe vendimet planifikuese do të bazohen në Planin Zhvillimor të Konservimit të Zonës Historike të Prizrenit (në pajtim me Ligjin për Trashëgimin Kulturore (Nr.02/L-88/2006), Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtuna (Nr.03/L-039/2008); dhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066/2012)).

5.2.6.14. **Parku nacional Mali Sharr:** Aplikimi dhe implementimi i çfarëdo projekti në Parkun Nacional Mali Sharr do të bëhet në pajtim me mendimet e institucioneve gjegjëse në kuadër të Ligj për Parkun Kombëtar “Sharri” (Nr. 04/L - 087/2012), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr.02/L-18/2005), Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Ne.03/L-025/2009) dhe Planit Hapësinor për Parkut Nacional “Mali Sharr”. Strukturat e lehta të montuara mund të vendosen në pjesët e përshtatshme të Parkut Nacional për të ofruar shërbime turistike. Çfarëdo renditje dhe strukturë që dëmton florën dhe faunën dhe ambientin natyror është i ndaluar sipas Planit Hapësinor për Parkun Nacional Malet e Sharrit.



5.2.6.15. **Liqenet dhe Pendët:** Ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me liqenet, pendët dhe burimet e ngjashme të ujërave, të cilat mund të përdoren për ujë të pijshëm apo vaditje të zonave bujqësore, do të merren parasysh.

5.2.6.16. Projektet dhe programet e propozuara nga plani zhvillimor komunal duhet të implementohen dhe zbatohen pas përpilimit të raporteve të vlerësimit të ndikimit mjedisor bazuar në legjislacion dhe ligjet.

### 5.2.7. Metodat e trajtimit të plehut

5.2.7.1. Brenda kontekstit të ligjeve udhëzuese për mbrojtjen e natyrës, duke përfshirë Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr.02/L-18/2005), Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Ne.03/L-025/2009), Ligji për Mbeturina (Nr.04/L-060/2011), paraqesin bazën e rruajtjes së natyrës të cilat e

parandalojnë ndërtimin e deponive, qoftë të plehut shtëpiak apo të plehut industrial, në mënyrë të paorganizuar.

5.2.7.2. Deponitë e mbeturinave do të planifikohen larg vendbanimeve dhe zonave natyrore e bujqësore. Deponia e tanishme e Landovicës do të zhvendoset në një lokacion të përshtatshëm.

5.2.7.3. Deponitë e reja të plehut dhe objektet për pastrimin e ujërave të zeza do të planifikohen në pajtim me opinionet dhe aprovimet e institucioneve përkatëse dhe në pajtim me vlerësimet për ndikimet ambientale.

### 5.2.8. Masat për parandalimin e ndikimeve negative ambientale

5.2.8.1. Planet e shkallëve te ultë do të definojnë kufijtë e zonave me rrezik të lartë të katastrofave natyrore, sidomos të tërmetit (gjeologjike, zonat me rreziqe potenciale hidrogjeologjike dhe zonat e rrezikut nga erozioni, përmbytjet dhe zjarri), në pajtim me mendimet e autoriteteve përgjegjëse. Këto kufij ku studimet e mikrozonave nuk janë kryer, do të definohen me hartat gjeologjike të shkallës 1/5.000, 1/2.000 apo 1/1.000 si dhe studimet dhe raportet gjeo-tektonike.

5.2.8.2. Nuk do të lejohen ndërtimet që mund të cenohen nga zjarri, eksplozioni apo fatkeqësitë tjera në zonat me rrezik të lartë. Autoritetet gjegjëse do të njoftohen për aktivitete të tilla në mënyrë të zhvendosjes larg vendbanimeve me aprovimin e planeve të shkallës së ultë.



5.2.8.3. Në zonat me qasje të lehtë në qendrën e qytetit dhe pjesët tjera të banuara siç janë zonat urbane të gjelbra, parqet dhe objektet sportive, do të planifikohen zonat e evakuimit për të lehtësuar rrezikun nga fatkeqësitë dhe zvogëlimin e numrit të viktimave.

5.2.8.4. Autoritetet përgjegjëse do të përgatisin vlerësimin e rrezikut dhe studimet e menaxhimit gjatë studimeve të mikro zonave për rrezikun nga tërmeti.

5.2.8.5. Qendrat për menaxhimin e rrezikut dhe qendrat për veprime emergjente do të parashihen në mënyrë që të menaxhohen veprimet kërcënues në mënyrë efikase e të shpejtë. Po ashtu do të planifikohen edhe rrugët për evakuim në pajtim me hierarkinë rrugore.

### 5.2.9. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

5.2.9.1. PZHKP 2025 përmban strategjitë e bazuara në inkuadrimin social barazinë sociale dhe cilësinë e lartë jetësore me synim të sigurimit të objekteve publike të balancuara me

qasje të lehtë, sigurimin e mundësive të reja për punësim dhe inkurajimin e pjesëmarrjes në vendim marrje.

5.2.9.2. Komuna e Prizrenit dhe ministritë gjegjëse do të zhvillojnë dhe inkurajojnë programet ekonomike që avancojnë zhvillimin e organizuar të prodhimtarisë si dhe zhvillimin financiar, komercial dhe atij turistik.

5.2.9.3. Programet sociale dhe projektet e definuar të PZHKP 2025, do të zbatohen si në qendrën e Prizrenit ashtu edhe në vendbanimet rurale nga ana e institucioneve gjegjëse duke respektuar parimin e qasjes dhe inkuadrimit për të gjithë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës.

### 5.2.10. Masat për zbatimin e planit

5.2.10.1. PZHKP 2025 e cila është përgatitur në bazë të dispozitave të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020$^{+}$, paraqet bazën e zhvillimit urban dhe planeve rregulluese të qendrës së qytetit, vendbanimet tjera, si dhe zonat tjera të posaçme apo zonat e mbrojtura që ndodhen në Komunën e Prizrenit.

5.2.10.2. Parimet e planifikimit, vendimet dhe projekt propozimet e PZHKP 2025 janë instrumentet ligjore zbatuese për të gjitha planet e detajuara të shkallës së ulët si dhe institucionet dhe organizatat që do të përgatisin, zbatojnë dhe kontrollojnë këto plane. 

5.2.10.3. Të gjitha projektet dhe programet që mendon të zhvillojë Komuna e Prizrenit në kuadër të Planit Zhvillimor 1/50.000 që mbulon zonat urbane dhe rurale të komunës do të bazohen dhe varen nga PZHKP 2025.

## 5.3. DISPOZITAT PËR BASHKËPUNIM

5.3.1. Institucionet dhe organizatat përgjegjëse, të cilat janë të identifikuara në seksionin e raportit të planit sipas numrit “4.3. Korniza Institucionale, Implikimet Financiare, Korniza Kohore”, janë përgjegjës për implementimin e programeve sociale, kulturore dhe ekonomike të PZHKP 2025, do të veprojë në bashkëpunim me Komunën.

5.3.2. Një kornizë institucionale është propozuar për zbatimin, monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e PZHKP 2025. Korniza e propozuar institucionale është fondamentale për zbatimin e planit.

5.3.3. Komisionet për zbatim, monitorim dhe raportim (Komisioni A: Konservimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore; Komisioni B: Qëndrueshmëria ambientale; Komisioni C: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e jetës; Komisioni D: Vitaliteti ekonomik;

Komisioni E: Integriteti hapësinor) do të përcaktohen në pajtim me parimet fondamentale, qëllimet dhe objektivat e PZHKP 2025 si dhe me organizimin institucional të Komunës.

5.3.4. Planet e veprimit dhe programet e propozuara në kontekstin e 2025 do të zbatohen, menaxhohen dhe monitorohen nga komisionet IMR të cilat to të dorëzojnë raportet e vlerësimit autoriteteve relevante komunale.

## 5.4. DISPOZITAT LIDHUR ME RENDIN KRONOLOGJIK TË FAZAVE TË ZBATIMIT.

5.4.1. Implementimi i PZHKP 2025 do të bëhet përmes planifikimit të planeve të veprimit në kuadër të kushteve kohore dhe financiare.

5.4.2. Komisionet IMR (4.3. Korniza Institucionale, Implikimet Financiare, Korniza Kohore) do të bëjnë listën e prioriteteve të cekura në PZHKP 2025 për periudha afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate.

5.4.3. Për të siguruar realizimin ideal të çdo projekti, do të vlerësohen të gjitha çështjet fizike dhe financiare, performanca si dhe problemet pas implementimit. Monitorimi do të kryhet nga Komisionet IMR në intervalet e rregullta kohore. Raportet e monitorimit do ti dorëzohen Kryetarit të Komunës dhe do të shpallen në faqen zyrtare te Komunës.



5.4.4. Vlerësimi i ndikimit të veprimeve do të përpilohet dhe dorëzohet komisioneve IMR në fund të procesit të implementimit.

## 5.5. ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR KËRKIMIN E MËTUTJESHËM.

5.5.1. Institucionet dhe organizatat e përmendur në parimet zbatuese të PZHKP 2025, janë përgjegjëse për ndërmarrjen e kërkimeve relevante si dhe grumbullimin e menaxhimin e të dhënave me metoda moderne teknologjike.

5.5.2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komuna e Prizrenit do të inkurajojnë dhe përkrahin institucionet dhe organizatat që të ofrojnë të dhënat e duhura për azhurnimin e studimeve planifikuese e sidomos planit zhvillimor urban.

5.5.3. Komuna e Prizrenit do të ndërmarrë studimet e nevojshme për përpilimin e hartave digjitale urbane në shkallë 1/5000 dhe 1/1000 me qëllim të zbatimit të studimeve të shkallës së ultë të përcaktuar në parimet zbatuese të PZHKP 2025.

# REFERENCAT

Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës (S/2007/168/ADD.1);

Ligji për Planifikimin Hapësinor (Nr.2003/14), Kuvendi i R. Kosovës 2003;

Udhëzimin Administrativ për Zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinorë mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor të Komunës (Nr. Rend.33; Nr.prot: 29/03) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2003;

Ligji (Nr.03/L-106/2008) për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr. 2003/14), Kuvendi i R. Kosovës 2008, (Shpallur me dekretin Nr. DL- 055- 2008, datë 17.11.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu);

Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike (Nr.54/2005; Nr.prot.15/5), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2005;

Plani Hapësinor i Kosovës 2005-2015, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për Planifikimin Hapësinor, 2005;

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për Planifikimin Hapësinor, 2010;



Plani Hapësinor Parku Kombëtar “Sharri” , Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për Planifikimin Hapësinor, 2013;

Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit 2003-2013, Komuna e Prizrenit, 2003;

Ligji për Kufıjtë Admınıstratıv të Komunave (Nr.03/L-041/2008), Kuvendi i R. Kosovës 2008;

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr.03/L-025/2009), Kuvendi i R. Kosovës 2009;

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr.02/L-18/2005), Kuvendi i R. Kosovës 2005;

Ligji për Mbeturina (Nr.04/L-060/2012), Kuvendi i R. Kosovës 2012;

Ligj për Parkun Kombëtar “Sharri” (Nr. 04/L - 087/2012), Kuvendi i R. Kosovës 2012;

Ligji për Ndërtimin (Nr.04/L-110/2012), Kuvendi i R. Kosovës 2012;

Ligji për Shfrytëzimin, Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Banesave në bashkëpronësi (Nr.03/L-091/2009), Kuvendi i R. Kosovës 2009;

Ligji për Shitjen e Banesave për të cilat Ekzistojnë e Drejta Banesore (Nr.04/L-061/2011), Kuvendi i R. Kosovës 2011;

Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit (Nr.03/L-164/2010), Kuvendi i R. Kosovës 2010;

Ligji për Trashëgimin Kulturore (Nr.02/L-88/2006), Kuvendi i R. Kosovës 2006;

Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Nr.03/L-039/2008), Kuvendi i R. Kosovës 2008;

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066/2012), Kuvendi i R. Kosovës 2012;

Vizioni i Integruar i Prizrenit, Udhëzimet dhe Rekomandimet për Planifikimin dhe Zhvillimin e Komunës së Prizrenit. Komuna e Prizrenit, UN HABITAT, Mars 2008.

Analiza e Statistikave Vitale për Periudhën më të Re Kohore, Enti i Statistikës së Kosovës, K.G.T., Prishtinë, Kosovë, Qershor 2008.

Analiza e Informatave themelore për Kosovën, para përgatitje për Asistencë të Ardhshme të JICA (Agjencia Ndërkombëtarë Japoneze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar), UNDP (Kombet e Bashkuara programi për Zhvillim) , 2008.

Trashëgimia Kulturore në Evropën Juglindore: Kosovë, Raporti i Misionit të Kosovës, UNESCO, 2006. http://portal0.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=20053&URL_DO=DO_PRINTPAGE&URL_SECTION=201.html



Ndryshimet Demografike të Popullatës së Kosovës 1948-2006, Enti i Statistikës së Kosovës, K.G.T., Prishtinë, Kosovë, Shkurt 2008.

Strategjia e Energjisë së Kosovës, Ministria e Energjisë dhe Minierave, 2005.

Europa Nostra Forumi, “Trashëgimia Kulturore në Kosovë: Prej Mollës së Grindjes (sherri) deri te Tharmi i Pajtimit.” UNESCO Headquarters / Siège de l’UNESCO (Paris) 14 Nëntor 2006.

Fakte për Mjedisin, Enti i Statistikës së Kosovës, 2007.

Gulersoy-Zeren, N. Eyuboğlu, E., Koramaz, K., Abacılar, P., 2008. Zona Historike e Prizrenit, Plani për Konservim dhe Zhvillim, Universiteti Teknik i Stambollit Qendra Hulumtues e Planifikimit Urban dhe Mjedisor dhe Cultural Heritage Without Borders, 2007.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosovë 2004, Ngritja e Qytetarit:Sfidat dhe Mundësitë UNDP(Kombet e Bashkuara programi për Zhvillim), 2004.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Rinia 2006, UNDP(Kombet e Bashkuara programi për Zhvillim), 2006.

Kosova gjatë shekujve 15, 16 dhe 17, Skënder Rizaj, Prishtinë 1982.

Plani Veprues për Mjedisin në Kosovë 2006 – 2010 në Bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore, zyra në Kosovë (e financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmes Swedish International Development Corporation Agency), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, Prill 2006.

Kosovo Factsheet (fletushkë), ECIKS- Iniciativa Ekonomike për Kosovën

Kosovë në Figura (shifra) 2006, Seria 1: Statistikat e Përgjithshme, Enti i Statistikës së Kosovës, K.G.T., Prishtinë, Kosovë, Dhjetor 2006.

Kosovë në Figura (shifra) 2007, Seria 1: Statistikat e Përgjithshme, Enti i Statistikës së Kosovës, K.G.T., Prishtinë, Kosovë, Prill 2008.

Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë Vëllimi I dhe II, Banka Botërore Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore Enti i Statistikës së Kosovës, Tetor 2007

Profili i Kosovës, Zhvillimi Hapësinor i Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për planifikimin hapësinor, Qershor 2004

Kosovë, Një histori e Shkurtër, Noel Malcolm, Koha, Prishtinë, 1998.



Profili Komunal, Enti i Statistikës së Kosovës, OSCE, 2006, http://www.ks-gov.net

Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Arsimit, të Dhënat Zyrtare të Nxjerra nga Plani Zhvillimor Komunal I Prizrenit, 2009.

Raporti Kombëtarë, Sfondi mbi Transportin për Kosovën (sipas rezolutës së UNSCR-Së 1244), 2009.

Udhëzimi për Politikat Planifikuese për Përpilimin e Planeve Lokale Zhvillimore, Instituti për Planifikimin Hapësinor.

Zona Historike e Prizrenit, Plani për Konservim dhe Zhvillim, Gulersoy. 2008. Materiali mbi historinë e Prizrenit është përgatitur nga Prof. Dr. Jahja Drançolli duke shfrytëzuar referencat e (i) John V.A. Fine, Jr., Ballkani në Mesjetën e Hershme, dhe 2. Ballkani në Mesjetën e Vonshme, Ann Arbor, The University of Michigan Press, 1997. (ii) Kosova, Një Histori e Shkurtër, Noel Malcolm, Koha, Prishtinë, 1998. (iii) Kosova gjatë shekujve 15, 16 dhe 17, Skënder Rizaj, Prishtinë 1982. (iv) Ragusanët në Kosovë, Jahja Drançolli, Instituti i Historisë, Prishtinë 1986.

Prizreni Udhëtim Nëpër Kohë Prizren, Krasniqi, S., Prizren, 2002.

Ragusanët në Kosovë, Jahja Drançolli, Instituti i Historisë, Prishtinë 1986.

Qendra Rajonale e Punësimit Prizren, të dhënat zyrtare të nxjerra nga Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit, 2009.

Rishikimi i Studimit të Fizibilitetit të HC Zhur, duke përfshirë përgatitjen e Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi paraprak Social, Ministria e Energjetikës dhe Minierave, Zyra Projektuese PATEL, 2009.

Manuali i Reviduar për kthim të qëndrueshëm, UNMIK, Prishtinë Korrik 2006.

Monumentet Sakrale dhe Profane të periudhës Otomane të shekullit XV-XVII në Kosovë, Rexha, I., Monumentet e Kosovës , Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Historike, Prishtinë, f.77-92, 2004.

Profili i Zhvillimit Hapësinorë dhe pasqyra e Komunës së Prizrenit (Profili Komunal i Prizrenit), Komuna e Prizrenit, UN HABITAT, 2007.

Raporti mbi Gjendjen e Natyrës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, Agjensioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, 2008.

Atlasi Statistikor 2008, Enti i Statistikës së Kosovës, K.G.T., Prishtinë, Kosovë, Prill 2008.

Dokument me Sfond Teknik mbi Historikun e Transportit, 2008.



Ballkani në Mesjetën e Hershme, dhe 2. Ballkani në Mesjetën e Vonshme, John V.A. Fine, Jr., Ann Arbor, University of Michigan Press, 1997.

Drejt Planit Zhvillimor të Kosovës: Gjendja e Ekonomisë së Kosovës dhe Rrugët e Mundshme të Përparimit, ESPIG Policy Paper No. 1 Prishtinë, Economic Strategy and Project Identification Group (ESPIG) (Strategjia Ekonomike dhe Grupi Identifikues i Projekteve), Gusht 2004.

Kombet e Bashkuara, Departamenti i Çështjeve Sociale dhe Ekonomike, Divizioni i Statistikës, Statistical Papers, Seria M, No.4, Rev. 4, Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Aktiviteteve Ekonomike (ISIC), New York, 2008.

**Lista e Web - Faqeve**

http://www.chwb.org/

http:// www.komuna-prizren.org/

http:// www.ks-gov.net/

http:// www.shqiperia.com/

http:// www.theodora.com/

http:// www.pak-ks.org/

http:// www.pseetoint.org/